

UNIVERSITETI I EJL
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈИЕ
SEE UNIVERSITY



FAKULTETI JURIDIK
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
LAW FACULTY

STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË
DREJTIMI: E DREJTA KUSHTETUESE DHE ADMINISTRATIVE

T E Z A:

MARRËVESHJA E PRESPËS SI BURIM SPECIFIK I SË DREJTËS
KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

KANDIDATI:
Emir KURTISHI

MENTORI:
Prof. Dr. sc. Jeton SHASIVARI

Tetovë, Dhjetor, 2020

DEKLARATË

Unë, Emir Kurtishi deklaroj dhe vërtetoj se unë jam autori origjinal i këtij punimi të magjistraturës me titull: **“Marrëveshja e Prespës si burim specifik i së drejtës kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut”** dhe se të gjitha referencat e shënuara në këtë punim si dhe citimet apo shërbimet e ndryshme të marrura nga burimet e ndryshme materiale apo elektronike janë të shënuara me fusnota në fund të çdo faqeje si dhe në fund të këtij punimi. Me këtë rast, poashtu deklaroj se Universitetit ia barti të gjitha të drejtat autoriale të këtij punimi, për qëllime edukative-arsimore dhe hulumtuese.

Dhjetor 2020, Tetovë

Emir Kurtishi, ID: 124451

Falenderime

Ju faleminderit atyre që e brumosën dhe e gatuan personalitetin tim që në fëmijëri e që padyshim ato janë prindërit e mi të mrekullueshëm të cilët nuk kursyen asgjë nga vetja e tyre për të më shkolluar, ata kanë qenë motivi dhe mbështetja ime gjatë këtyre viteve të shkollimit.

Nëse do të duhej të merr trajtë të humorit amerikan ky falenderim, atëherë kush tjetër shquhet për këtë humor, përpos Mark Twain, i cili suksesin e karrierës së tij ia dedikonte të gjithë shoferave të makinave që nuk e kishin shtypur. Këtu do të dëshiroja t'i falenderohem fqinjëve të mi, kushërinjve të mi që herë pas here me makinën e tyre më dërguan në Universitet, pa asnjë kompensim, me vetë dëshirë. Faleminderit edhe biçikletës sime që më ka shpëtuar disa herë për të arritur në kohë në provime. Faleminderit shokëve, miqëve që më kanë dhënë kurajo me fjalët e tyre inkurajuese: "Ti mundesh, do t'ia dalësh!" Faleminderit dhe mirënjohje të veçanta të gjithë stafit akademik të Fakultetit Juridik të UEJL-së, e posaçërisht mentorit tim, Prof. Dr. Jeton Shasivari, që nuk kurseu asgjë nga dituria e tij për të më furnizuar mua me dituri, gjithmonë do t'i kujtoj fjalët e tij të bukura, inkurajuese dhe ngushëlluese përgjatë këtyre viteve të kaluara të studimit. Ai ka qenë dhe do të jetë inspirimi im gjatë tërë karrierës sime të ardhshme, si një jurist i shquar i shoqërisë sonë, i cili do të dijë t'i mbrojë të drejtat dhe liritë kushtetuese të njeriut me dinjitet.

Dhe përfundimisht, faleminderit dhe mirënjohje të pafundme edhe të gjithë personave të tjerë që më ndihmuan të jem këtu.

PËRMBAJTJA

Abstrakti/Апстракт/Abstract.....	7
Hyrje.....	10
Metodologjia e punimit.....	11
Arsyeshmëria e punimit.....	13

KAPITULLI I PARË

VËSHTRIMI I PËRGJITHSHËM HISTORIK I KONTESTIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT DHE GREQISË

1.1. Dimensioni historik i kontestit.....	15
1.1.1. Identiteti etnik i maqedonasve.....	16
1.1.2. E ashtuquajtura “çështje maqedonase” inekzistente sipas vështrimit grek.....	20
1.1.3. Maqedonasit në Greqi.....	23
1.2. Çështja e Bukureshtit.....	26
1.3. Dimensioni juridik i kontestit.....	28
1.3.1. Pranimi i Maqedonisë në OKB.....	29
1.3.2. Zgjidhja e emrit para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe vendimi i saj.....	35
1.3.3. Karakteri dhe efektet e Marrëveshjes së Përkohshme.....	38

KAPITULLI I DYTË

PROPOZIMET PËR ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES SË EMRIT

2.1. Propozimet e Grupit Ndërkombëtar të Krizave.....	41
2.2. Modeli i “emrit të dyfishtë”.....	45
2.2.1. Nuk ka nevojë për referendum për “emrin e dyfishtë”.....	47
2.2.2. Kërkesa e Kryetarit Gligorov për pranim të Maqedonisë në OKB nën emrin	

kushtetues.....	48
2.3. Emri “Maqedonia e Epërme” i papranueshëm!.....	51
2.4. Çështja e emrit nuk është problem për në NATO.....	54
2.5. Propozimet e Metju Nimicit.....	58
2.5.1. Kush është Metju Nimici?.....	62
2.5.2. Aspektet kritike të zgjidhjeve të ofruara nga Metju Nimici.....	65
2.6. Vetoja greke në Samitin e NATO-s në Bukuresht.....	70

KAPITULLI I TRETË

RATIFIKIMI I MARRËVESHJES SË PRESPËS

3.1. Natyra dhe statusi juridik i marrëveshjeve paqësore.....	76
3.2. Procesi i normalizimit të marrëdhënieve mes Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë.....	80
3.3. Marrëveshja e Prespës: parimet dhe elementet kyçe të marrëveshjes.....	89
3.4. Organizimi dhe realizimi i referendumit për ndryshimin e emrit kushtetues të 30.09.2018 dhe aspektet juridike të tij.....	104
3.5. Republika e Maqedonisë së Veriut voton amendamentet kushtetuese, “RMV shteti i ri i Ballkanit?”.....	116

KAPITULLI I KATËRT

PERIUDHA PAS RATIFIKIMIT TË MARRËVESHJES SË PRESPËS

4.1. Analiza e mundësive eventuale për dështimin e Marrëveshjes së Prespës.....	127
4.2. Analiza juridike kushtetuese e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të RMV-së të 19.09.2018 mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e vendimit të Kuvendit të RMV-së për shpalljen e referendumit për ndryshimin e emrit kushtetues.....	136
4.3. Kompetenca eventuale kushtetuese e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së për të vlerësuar	

kushtetutshmërinë e Marrëveshjes së Prespës – argumentet juridike për dhe kundër.....	150
4.4. Bashkimi Evropian duhet të mbështesë fuqishëm integrimin evropian të RMV-së.....	162
4.5. Ecja përpara përtej konfrontimit, bashkëpunimi midis RMV-së dhe Republikës së Greqisë nën frymën e Marrëveshjes së Prespës.....	174
PËRFUNDIMET.....	184
BIBLIOGRAFIA.....	188

ABSTRAKTI

Marrëveshja e Prespës paraqet burim specifik të së drejtës kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Meqënëse është bartëse e një rëndësie të madhe juridike por edhe historike, kjo marrëveshje ndërkombëtare juridike në vendin tonë, paraqet marrëveshje mbi kushtetuese e cila në vete ngërthen ndryshime kushtetuese për Republikën e Maqedonisë dhe ajo ishte e detyruar t'i zbatojë dispozitat imperative që rrjedhin nga ajo, duke kryer intervenime të caktuara kushtetuese në Kushtetutën e RM-së. Marrëveshja në fjalë i dha fund kontestit shumë vjeçar me Greqinë mbi çështjen e emrit, me ndërmjetësimin e OKB-së, të cilët arritën kompromis me “Marrëveshjen përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve të përshkruara në rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për shfuqizimin e Marrëveshjes së Përkohshme të vitit 1995” apo ndryshe e njohur në opinion si “Marrëveshja e Prespës”, e cila mes tjerash përmbante ndryshimin e emrit kushtetutes të vendit nga “Republika e Maqedonisë” në “Republika e Maqedonisë së Veriut”. Ky dokument thelbësor RMV-së i solli emër të ri në historinë e saj, me çka arriti ta ruajë emrin “Maqedonia” si dhe identitetin kombëtar maqedonas, kësaj here, të pakontestuar nga ana e Greqisë dhe e njohur nga bota mbarë. Së këndejmi, ky punim mëton hulumtimin e këtij dokumenti juridik në detaje dhe argumentimin e mirëfilltë juridik të tij, për të demonstruar se ky burim specifik i së drejtës kushtetuese në vendit tonë ka obligueshmëri juridike dhe në këtë drejtim bëhet sqarimi i “kanosjes së rrezikut” në kontinuitet që i bëhet kësaj marrëveshjeje nga “oponentët e saj” si dhe benefitet që rezultojnë nga kjo marrëveshje për palët nënshkruese të saj jo vetëm në vendet e tyre, por edhe për rajonin e gjerë, e cila definitivisht hap rrugën e perspektivës evro-atlantike dhe e cila u shndërrua në sinonim të paqes afatgjate, stabilitetit dhe sigurisë më të madhe për vendin tonë.

Fjalët kyçe: Marrëveshja e Prespës, Kushtetuta, kontesti, emri kushtetues, perspektiva evro-atlantike;

АПСТРАКТ

Преспанскиот договор претставува специфичен извор на уставното право на Република Северна Македонија. Бидејќи е пренослив на едно големо правно значање, но и историско, овој меѓународен правен договор во нашата земја, претставува над уставен договор кој сам по себе содржи уставни измени за Република Македонија која беше принудена да ги спроведе императивните одредби кои произлегуваат од тоа, извршувајќи одредени уставни интервенции во Уставот на Република Македонија. Со договорот се стави крај на долготрајниот спор за името со Грција, со посредство на ООН, кој постигна компромис со „Конечна спогодба за решавање на разликите опишани во резолуциите 817 (1993) и 845 (1993) на Советот за безбедност на Обединетите нации, за престанување на важноста на Привремената спогодба од 1995 г. и за воспоставување на стратешко партнерство меѓу страните,, или поинаку познат во јавноста како „Преспански договор,, кој меѓу другото содржеше промена на уставното име на земјатавод „Република Македонија,, во „Република Северна Македонија,. Овој суштински документ на РСМ и донесе ново име во својата историја, со што успеа да го зачува името „Македонија,, како и македонскиот национален идентитет, овој пат, неспорен од страна на Грција и познат од целиот свет. Затоа, овој труд се обидува детално да го истражи овој правен документ и неговата оригинална правна аргументација, за да се докаже дека овој специфичен извор на уставното право кај нас има правна обврска и во овој правец ја разјаснува „заканата од опасност,, во континуитет што и се прави на овој договор од страна на неговите „противници,, како и придобивките што произлегуваат од овој договор за нејзините потписници не само во нивните земји, туку и за поширокиот регион, што дефинитивно го отвара патот кон евроатланска перспектива и која стана синоним за долгорочен мир, стабилност и поголема безбедност за нашата земја.

Клучни зборови: Преспански договор, Устав, спор, уставно име, евроатланска перспектива;

ABSTRACT

The Prespa Agreement is a specific source of constitutional law of the Republic of North Macedonia. As it bears a great legal but also historical importance, this international legal agreement in our country is a constitutional agreement which includes constitutional changes for the Republic of Macedonia and it was obliged to implement the imperative provisions deriving from it, carrying out certain constitutional interventions in the Constitution of the Republic of Macedonia. The agreement ended the long-running name dispute with Greece, mediated by the UN, which reached a compromise with the “Final Agreement for the settlement of the differences as described in the United Nations Security Council Resolution 817 (1993) and 845 (1993), the termination of the Interim Accord of 1995, and the establishment of a strategic partnership between the parties” or otherwise known among the public opinion as the “Prespa Agreement”, which among other things contained the change of the constitutional name of the country from “Republic of Macedonia” to “Republic of North Macedonia”. This essential document brought a new name to RNM’s history, thus managing to preserve the name “Macedonia” as well as the Macedonian national identity, this time, undisputed by Greece and known by the whole world. Therefore, this paper seeks to research this legal document in detail and its genuine legal argumentation to demonstrate that this specific source of constitutional law in our country has a legal obligation and in this regard clarifies the “threat of danger” in continuity of this agreement did by its “opponents” as well as the benefits resulting from this agreement for its signatories not only in their countries, but also for the wider region, which definitely paves the way for the Euro-Atlantic perspective and which became synonymous with long-term peace, stability and greater security for our country.

Key words: Prespa Agreement, Constitution, dispute, constitutional name, Euro-Atlantic perspective;

HYRJE

Kuptimin si dhe rëndësinë e Marrëveshjes së Prespës, do të përpiqemi ta trajtojmë përmes Brainstorming (nxitjes dhe fiksimit të ideve (mendimeve)) me qëllim që të japim një ide më të përgjithshme mbi këtë marrëveshje, përmes asociacionit të ideve për secilën shkronjë në përbërje të fjalës: “MARRËVESHJA E PRESPËS”. Në këtë drejtim, shkronja e parë M asocon në: mençuri, maturi, mbarësi, mbijetesë, marrëdhënie, marrëveshje, Maqedoni, etj. Shkronja e dytë A asocon në: akt, afërsi, aktivitet, aleancë, amendament, ardhmëri, etj. Shkronja e tretë RR asocon në: rregull, rreptësi, rrezatim, rrugë, rrugëzgjdhje, rrugëdalje, etj. Shkronja e katërt E asocon në: ëndërr, ëndërrim, ëndërruar, ëndërrt, etj. Shkronja e pestë V asocon në: vullnet, vazhdimësi, veçanti, veprim, vendosmëri, vendimtar, etj. Shkronja e gjashtë E asocon në: efekt, elozh, ekuacion, emancipim, emërim, ekzekutim, etj. Shkronja e shtatë SH asocon në: shabllon, shekull, shend, shenjë, shkaktar, shkathtësi, etj. Shkronja e tetë J asocon në: jarani, jehonë, jetesë, juridik, etj. Shkronja e nëntë A asocon në: aftësi, afirmim, akord, aktbesim, aleat, anëtarësim, etj. Ndërkaq, shkronja E në mes të fjalës “Marrëveshja” dhe “Prespës” asocon vetëm në Evropë. Shkronja e parë e fjalës Prespës, pra P asocon në: i padiskutueshëm, paqe, pajtim, pakt, progres, pandryshueshmëri, etj. Shkronja e dytë R asocon në: racional, ratifikim, reflektim, reciprocitet, referendum, respekt, etj. Shkronja e tretë E asocon në: epokë, edukim, efektiv, esencial, elegancë, eufori, etj. Shkronja e katërt S asocon në: sakrificë, sanksionim, sedër, sendërtim, siguri, specifik, etj. Shkronja e pestë P asocon në: përparim, paradigmë, parashtesë, parlament, perspektivë, përfitim, etj. Shkronja e gjashtë E asocon në: ëndërr, ëndërrim, ëndërruar, ëndërrt, etj. Shkronja e shtatë S asocon në: sovranitet, stabilitet, sigël, simbolik, synim, sukses etj. Të gjitha këto emra e karakterizojnë Marrëveshjen e Prespës e cila konsiderohet si burim specifik i së drejtës kushtetuese të RMV-së, e cila i dha fund kontestit (konfliktit) shumëvjeçar me Greqinë, e cila që nga pavarësia e RM-së ia kontestonte emrin dhe si pasojë e kësaj Maqedonia nuk arrinte të anëtarësohej në organizata ndërkombëtare sepse çdo herë në këto organizata ballafaqohej me veton greke. Kjo gjë Maqedonisë i solli probleme të mëdha, emër të përkohshëm nën referencë “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”, krizë shtetërore, destabilizime të kohë pas kohshme, pengesa për ushtrimin e ndikimit të saj në plan ndërkombëtar, presione të ndryshme si nga ana e Greqisë, ndërkombëtareve por edhe të

shqiptarëve, të cilët urdhëronin në ndryshimin e emrit të saj kushtetues. Kjo çështje sa ishte komplekse aq edhe sentimentale për popullin maqedonas, të cilët kishin krijuar bindje të thellë se me ndryshimin e emrit të shtetit, do të preket dhe do të ndryshohet edhe identiteti i tyre kombëtar. Por, me kompromisin e arritur me Greqinë përmes Marrëveshjes së Prespës, identiteti maqedonas lëre që nuk u prek fare, por kuptimi i termeve “Maqedoni” dhe “maqedonas” u la në interpretim të lirë të popujve përkatës duke pasur parasysh referimin e kontekstit të ndryshëm historik dhe trashëgimisë kulturore, madje edhe gjuha e tyre maqedonase do të jetë gjuhë zyrtare në përputhje me pranimin e gjuhës në Konferencën e tretë të Kombeve të Bashkuara për standardizimin e emrave gjeografik si dhe shtetësia e tyre përjetoi një rirregullim origjinal duke e mbajtur emrin e tyre në përbërje të shtetësisë si “maqedonase/qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut” e cila deri më tani ka qenë vetëm “e Republikës së Maqedonisë”. Si kompensim për këto ndryshime dhe detyrime ndaj RMV-së, Greqia do të angazhohet për mbështetjen mbi proceset integruese të RMV-së në BE dhe NATO. Andaj, me këtë Marrëveshja RMV si dhe Greqia kanë bërë të arritura historike, duke e tejkaluar këtë kontest e cila e mbante të bllokuar RMV-në nga organizatat ndërkombëtare dhe nuk e njihte emrin e saj kushtetues dhe kjo marrëveshje padyshim që është bërë sinonim i paqes, stabilitetit, sigurisë dhe ardhmërisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Metodologjia e hulumtimit

Për realizimin e këtij punimi, jemi shërbyer me disa metoda shkencore, duke filluar me atë historike, duke dhënë të dhëna shkencore historike mbi kontestin e emrit, zanafillën e saj, si ka filluar, si ka rrjedhur dhe peripecitë dhe vorbullën e ngjarjeve të ndryshme që kanë karakterizuar këtë periudhë kohore, deri në momentin e nënshkrimit dhe të ratifikimit të Marrëveshjes së Prespës. Pra, metoda historike i ka dhënë një ngjyrim historik si dhe një retrospektivë të ngjarjes në lidhjen me kontestin e emrit. Edhe pse, Marrëveshja e Prespës paraqet një marrëveshje “sui generis” apo marrëveshje specifike e arritur deri më tani në nivel ndërkombëtar, për shkak edhe të specifikës së kontestit, në këtë drejtim, ndihmesë të veçantë mbi këtë studim ka dhënë edhe metoda krahasuese mbi marrëveshjet apo traktet ndërkombëtare të tjera apo të ngjashme si ajo e Prespës, që janë lidhur deri në atë moment kohor, duke dhënë një pasqyrë të qartë mbi këto lloje të marrëveshjeve, rëndësinë e tyre,

mënyra e lidhjes, vlefshmërisë dhe zbatueshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare dhe qasja e shteteve kombëtare në përgjithësi ndaj së drejtës ndërkombëtare e në veçanti ndaj marrëveshjeve ndërkombëtare. Në këtë punim vend të rëndësishëm zë edhe qasja apo metoda statistikore, gjë që e ka bërë edhe më të begatshëm këtë studim, duke dhënë informacione të intervistave dhe statistikave të ndryshme që janë realizuar nga organizata dhe shoqata të ndryshme civile dhe joqeveritare, si ato të vendit po ashtu edhe ato ndërkombëtare, me çka japin një pasqyrë burimore të disponimit të qytetarëve ndaj një çështjeje të caktuar. Kuptohet, vend të rëndësishëm në këtë punim zë metoda juridike, e cila është theksuar bukur shumë në një pjesë të madhe të këtij studimi, për shkak edhe të natyrës së kontestit, sepse kjo çështje përveç që paraqet çështje historike, fundi fundit është më tepër çështje juridike dhe politike e një shteti edhe pse në vete ngërthen mospajtueshmëri të historisë së të dyja palëve tanguese të kësaj çështjeje që lidhet drejtpërdrejtë me emrin shtetëror kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Pra, vetë çështja e kontestit në vete e involvon apo e implikon drejtësinë, madje duke e lënë anësh edhe çështjen politike, sepse ajo edhe më tepër e bënë më të rëndë, por edhe e ka bërë edhe më të komplikuar këtë situatë tash e sa vite, në kërkim të kuptimit, të së vërtetës dhe drejtësisë që t'i jepetnjërës palë apo tjetrës një të drejtë të kontestuar apo të mohuar. Edhe pse kompromisi paraqet çështje më tepër politike, por prapëprapë ajo ndërlidhet me drejtësinë, për shkak të vet karakterit dhe efektit të marrëveshjes që është kryekëput çështje juridike, e cila përmban norma juridike jo dosido, por norma ndërkombëtare jus cogens, të karakterit të detyrueshëm (imperativ) dhe pasojat që dalin nga marrëveshja si zbatimi i dokumenteve të rëndësishme ndërkombëtare, çështja e referendumit, ndryshimet kushtetuese e kështu me radhë. Pra, kjo metodë është më e rëndësishmja e këtij studimi e cila e përmbush esencën, qëllimin e hulumtimit dhe të studimit të kësaj çështjeje. Në elaborimin e kësaj teme, sigurisht kemi shfrytëzuar edhe të dhëna të tjera të ndryshme dhe të rëndësishme duke filluar nga burimet materiale, të dhënat e ndryshme të institucioneve relevante, publikimet e ndryshme historike, politike, sociologjike, juridike, revista si dhe burime të tjera juridike relevante të vendit si dhe ato ndërkombëtare.

Gjatë këtij hulumtimi shkencor do të paraqesim disa hipoteza, të cilat gjatë përpunimit të tezës do të vërtetohen. Hipotezat e punimit janë:

- Marrëveshja e Prespës arriti të zgjidh kontestin shumëvjeçarë mes RMV-së dhe Greqisë;
- Marrëveshja e Prespës është në përputhje me Kushtetutën e RMV-së;
- Marrëveshja e Prespës paraqet garancë për deblokimin e proceseve evrointegruese të RMV-së;
- Marrëveshja e Prespës nënkupton ardhmëri, paqe, stabilitet dhe siguri.

Arsyeshmëria e punimit

Marrëveshja e Prespës padyshim paraqet ngjarje historike për Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe jo vetëm, është dokument i rëndësishëm juridik dhe politik i sistemit juridiko-kushtetues i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shkak se me anë të zgjidhjes së kontestit shumëvjeçar mes fqinjit jugor, Greqisë dhe vendit tonë, ndryshoi emri i saj kushtetues nga “Republika e Maqedonisë” apo siç ishte e njohur në nivel ndërkombëtar me emrin zyrtar “Ish Republika Jugosllave Maqedonisë” (IRJM) në “Republika e Maqedonisë së Veriut.” Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, Republika e Maqedonisë së Veriut fitoi një partneritet të rëndësishëm, i cili do ta ndihmojë gjatë rrugës së saj në integrimin e strukturave atlantike. Frytet e kësaj marrëveshjeje, janë në fillim e sipër. Jo më larg se pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, Republika e Maqedonisë së Veriut arriti që të merr ftesë për anëtarësim në NATO dhe më 27 Mars 2020, vetëm dy vjet pas nënshkrimit të marrëveshjes u bë anëtarja e 30-të e NATO-s. Arsyeshmëria e këtij punimi konstiton në elaborimin juridik të këtij studimi, duke pasur parasysh rëndësinë e zgjidhjes së kontestit, me çka Maqedonisë së Veriut i hapet rruga drejt anëtarësimit në strukturat evro-atlantike, i hapet perspektiva e ardhmërisë së shtetit, si një shtet stabil dhe i sigurtë, i barabartë me shtetet tjera evropiane me një emër, histori, gjuhë, kulturë të pakontestuar nga e mbarë bota. Analizimi i burimeve kushtetuese të një vendi, paraqetitet interesim i veçantë i këtij punimi, sidomos pozita e tyre hierarkike, sepse rëndom, marrëveshjet ndërkombëtare zënë vend nën kushtetutën e një vendi si akt më i lartë juridiko-politik i një shteti dhe mbi ligjet e zakonshme të shtetit përkatës. Mirëpo, Marrëveshja e Prespës, konsiderohet si një lloj i veçantë, specifik apo “sui generis” e cila pas nënshkrimit dhe ratifikimit të saj u bë burim specifik i së drejtës kushtetuese, me çka e zgjidhi këtë kontest me dekada dhe e detyroi RMV t’i qaset ndryshimeve kushtetuese konform përmbajtjes së normave

juridike të parapara me këtë marrëveshje. Kontestimi i saj paraqet çështje me interes gjë që është elaboruar në shumë pika të këtij punimi, si mundësia eventuale e dështimit të saj, sfidimi i saj përpara Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, kompetenca eventuale e saj mbi vlerësimin e kushtetutshmërisë së saj e kështu me radhë, gjë që lexuesit i jep informacione të mjaftueshme mbi rëndësi dhe vlefshmërinë e marrëveshje ndërkombëtare të cilët në raste të caktuara mund të jenë marrëveshje mbi kushtetutën. Arsyeshmëria e këtij punim konsiston edhe në informacionet e pakta apo formale në lidhje me këtë temë dhe qasja që i bëhet kësaj teme një nivel të tillë serioz dhe akademik, padyshim që do ta begatojë lexuesin me informacione të rëndësishme por edhe ndoshta do të jetë motiv për analiza të tjera të mirëfillta shkencore mbi këtë temë, gjë që do ta begatojë shkencën e së drejtës kushtetuese në përgjithësi dhe do t'i nxjerrë në pah anët pozitive dhe negative të kësaj marrëveshjeje.

KAPITULLI I PARË

VËSHTRIMI I PËRGJITHSHËM HISTORIK I KONTESTIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT DHE GREQISË

1.1 Dimensioi historik i kontestit

Dikur Konrad Adenauer kishte biseduar me një historian, profesor i historisë bashkëkohore të një universiteti gjerman rreth çështjes së historisë se çka mendon për zhvillimin e ngjarjeve si historian. Ai ishte përgjigjur se detyra e historianëve nuk qëndron në parashikimin e zhvillimit të ngjarjeve dhe se historianët nuk janë profet. Detyra primare e tyre përbëhej në vështrimin e tyre si dhe në dhënien e sqarimeve më të besueshëm të asaj që ka ndodhur. Adenauer, kishte mendim ndryshe nga historiani në fjalë duke thënë se detyra e historianit është më ndryshe. Historianët, përkatësisht profesorët e historisë bashkëkohore, duhen në instancë të fundit, të mundohen me ndihmën e analogjive nga ngjarjet e kohës sonë, madje edhe të atyre të ditëve tona, ta zbulojnë drejtimin e mundshëm drejt së cilës do të zhvillohen ngjarjet dhe më pas të tregojnë për zhvillimet që do t'na presin, si dhe eventualisht t'na paralajmërojnë.¹

Po e filloj punimin me këtë prelude, për të sqaruar se megjithëse historia nuk e parashikon të ardhmen, por mësimi për të kaluarën, na ndihmon ta kuptojmë të tashmen dhe na mëson që gabimet e njëjta të mos përsëriten në të ardhmen. Megjithëse ngjarjet nuk mund të parashikohen, por në njëfarë mënyre ishte e ditur që në fillim se Republika e Maqedonisë si shtet i pavarur që u shkëput nga Jugosllavia socialiste pa konflikt të armatosur, nuk do të kishte ardhmëri të qartë edhe pse u cilësua me epitetin “oazë e paqes” në Ballkan,² pikërisht për shkak të miratimit të Kushtetutës dhe anashkalimit të së drejtës historike dhe trashëgimore të popullit shqiptar të Maqedonisë së Veriut nga njëra anë si dhe historisë maqedonase nga ana tjetër, e kaluara e popullit maqedonas dhe përpjekjet e tij për të formuar shtetin nacional me emrin kushtetues “Republika e Maqedonisë” duke u mbështetur në vendimet e ASNOM-it, e cila fuqimisht do të kontestohet nga ana e Greqisë emri dhe historia e saj.³

¹ Аданауер, Конрад, Секавања, (превод од германски јазик Бобан Здравковски Андреевски), Конгресен Сервисен Центар Микена, Макабеј, Скопје, 2014, стр. 7.

² Shprehja “oaza e paqes”, ishte propaganda e maskuar. Kjo shprehje u shpik nga kryetari i Republikës Kiro Gligorov, i cili e shfrytëzonte si propagandë për të sqaruar se vetëm në vendin e tij arriti që të ruhet paqja. Për më tepër shih: Rexhepi, Zeqirija, Zhvillimet politiko-shoqërore te shqiptarët në Maqedoni 1990-2001, Tringa Design, Tetovë, 2005, fq. 19.

³ Për më tepër shih: Rexhepi, Zeqirija, Zhvillimet politiko-shoqërore te shqiptarët në Maqedoni 1990-2001, Tringa Design, Tetovë, 2005, fq. 48, 49.

I vetëdijshëm se informacionet e së kaluarës së herët, e sidomos asaj antike nuk mund të vërtetohen lehtë, përveç asaj që kanë shkruar autorë të ndryshëm vendas por edhe të huaj, jam munduar që dimensionin historik tashmë të Maqedonisë së Veriut ta paraqes në mënyrë sa më objektive dhe kredibile, duke marrur për bazë shkrime të ndryshme që i referohen së kaluarës së saj që nga antikiteti e deri në kohën e sotme.

Për cilën Maqedoni bëhet fjalë? Në trajtimin e termit “Maqedonia” si në periudhat e paraformimit të shtetit në kuptimin juridik-politik me këtë emër, ky term ngërthen në vete edhe përdorimin e saj për demarkimin e territorit të Maqedonisë në kuptimin gjeografik dhe të popullsisë së ndryshme etnike në kuptim të kulturës, traditës (gjuhës, folklorit, përcaktimit fetar) e cila ka jetuar në këtë territor. Për qëllimet e këtij studimi, së pari, në mënyrë të përgjithshme këtë term do ta përdorim për përshkrimin e raportit të faktorit “të jashtëm” ndaj këtij territori dhe popullsisë, pavarësisht kristalizimit të mëvonshëm, të vetëidentifikimit të popullit me atë emër. Pra, vëmendje të posaçme do t’i kushtohet popullsisë e cila ka manifestuar etno-kulturë të veçantë, i kuptuar sot si populli maqedonas, i cili gjatë proceseve historike, ndër atë emër, ka krijuar vetëdije identitare, të cilën e formon si popull konstitutiv, shtetbërës dhe raporti i tij institucional ndaj botës dhe anasjelltas, terminologjikisht, ato raporte në memorien historike si dhe në shekullin e ri të cilët kanë ndikuar në formimin e etnogjenezës së popullit e cila në konstelacionin bashkëkohor të etno-nacionalizmit në plan më të gjërë ndërkombëtar ka sjellur deri te konstituimi i vetëdijes për krijimin e shtetit të vet tashmë nën emrin e tij nacional.⁴

1.1 Identiteti etnik i maqedonasve

Interesimi për studimin e Maqedonisë antike u rrit veçanërisht pas shpërthimit të kontestit mes Greqisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut në lidhje me emrin e shtetit maqedonas, pas rrënies së Federatës Jugosllave në vitin 1991. Politika bashkëkohore ose moderne e rriti fuqishëm interesimin për Maqedoninë antike më shumë se sa arkeologjia dhe historia. Rreth interesimit për studim më të gjërë mbi Maqedoninë antike ka edhe pavarësimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Me pavarësimin e saj krijohen kushte më të mira për studim më thelbësorë dhe objektiv të Maqedonisë antike dhe të identitetit të maqedonasve

⁴ Габер, Виктор, Од објект до субјект, Македонија во меѓународните односи, Фондација „Фридрих Еберт“, Скопје, 2017, стр. 9, 13, 14.

antikë. Nga këtu rrjedh edhe kontesti i egër i emrit të shtetit maqedonas nga ana e Greqisë.⁵

Identiteti etnik i maqedonasve antikë është çështje e kontestueshme në shkencë. Para saj, ekzistojnë dy vështrime kundërthënëse: vështrimi i parë konsideron se maqedonasit antikë janë grekë me preardhje, e dyta se maqedonasit janë popull i veçantë – ndryshe nga grekët e vjetër dhe popujtë e tjerë që kanë jetuar në Ballkan. Përfaqësuesit e vështrimit se maqedonasit janë grekë, kryesorja, vijnë prej radhët e historianëve grekë nga koha më e re. Pozicioni grek është se dëshmitë arkeologjike tregojnë në përdorimin e gjuhës greke nga ana e maqedonasve. Mbretërit maqedonas e kanë konsideruar vetën e tyre për pasardhës të Argut grek (nga Peleponezi), që kanë marrë pjesë në ngjarjet panhelenistike, oborri në përmasa të mëdha ka qenë i helenizuar, ka ekzistuar ndikimi i konsiderueshëm grek në arte dhe tradita si dhe emrat e vendeve dhe ato personale, tregojnë një shkallë të lartë të ndikimit grek.⁶ Vështrim të ngjashëm ka edhe arkeologu grek Manolis Andronikos. Mbi bazën e interpretimit të dëshmimeve epigrafike të gjetura në Ajga, Andronikos thekson se maqedonasit janë fis grek dhe se ata të cilët thonë se territoret janë me preardhje ilir ose thrake, por që janë helenizuar nga Filipi dhe Aleksandri, nuk mbështeten mbi kritere objektive.⁷ Politika bashkohore greke plotësisht pajtohet me vërtetimet e Andronikosit dhe se sipas kësaj politike, Maqedonia antike është pjesë përbërëse e Greqisë dhe maqedonasit antikë janë grekë, për shkak se kanë mbajtur emra grekë. Ajo është edhe mesazhi i Andronikosit drejtuar vizitorëve të muzeut në Ajga (Vergina).⁸

Identiteti etnik i maqedonasve antik dallohet nga gjuha dhe tradita e këtij populli. Dëshmitë për gjuhën e maqedonasve si gjuhë e veçantë vijnë që nga koha e Aleksandrit III Maqedonas, nga çka, gjuha maqedonase veçanërisht theksohet. Dëshmitë, mbi veçantitë e traditave janë të vërtetuara me hulumtime të shumta arkeologjike...dhe ata theksojnë se gjuha maqedonase ka qenë e ndryshme nga gjuha antike greke që është përdorur si gjuhë në oborrin maqedonas si dhe në diplomaci. Dëshmi për këtë është fondi i 100 apo 200 fjalëve burimore të mbijetuara maqedonase të cilët nuk hasen në gjuhën greke: “Në këtë raport gjuha maqedonase

⁵ Шкариќ, проф. д-р, Светомир; Иванов, проф. д-р, Ѓорѓе, Политички теории – Антика, учебник за политички науки на Правниот факултет „Јустинијан Први“, при Универзитетот „Св. Кирил и Методиј“, – Скопје, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 9, 10; cituar sipas: Јуџин Н. Борза, Во сенката на Олимп – појава на Македон; Патрија, Скопје, 2004; стр. 7.

⁶ По ату, fq. 9, 10.

⁷ По ату, fq. 10, 11, cituar sipas: Manolis Andronikos, Vergina; Athens, 1984; p. 73.

⁸ По ату, fq. 11.

është më e përafërt me atë ilire dhe thrake se sa dialekteve greke.”⁹

Në lidhje me aspektin historik së paku për t’ju afruar të së vërtetës duhet të thuhet edhe variantin tjetër që ekziston e që më pas lidhet edhe me kontestin e Maqedonisë së Veriut tashmë me Greqinë, se Maqedonasit dhe Maqedonia, në kuadër të botës pellazge-ilire, zënë një vend të veçantë si etni dhe si mbretëri. Maqedonasit dhe Maqedonia, po ashtu, zënë një vend të veçantë edhe në botën helene dhe helenizmi si qytetërim në përgjithësi, ngaqë në kohën e Aleksandërit të Madh, kur perandoria e tij arriti përmasat botërore, u kthye në një kulturë universale. Kështu, etnia maqedonase në njërin anë si pjesë e botës pellazge-ilire ku gjendet djepi i antikitetit dhe mbretëria maqedonase – bartëse e një koncepti dinamik shoqëror-politik ndër më të njohurit në botë, në tjetrën anë, hapin çështjet e raporteve historike ende gjithnjë të pasqaruara midis faktorit pellazg-ilir dhe atij helen, më vonë grek, si dhe helenizimit në kuadër të antikitetit. “Diferencim” i brendshëm i faktorit etnik maqedonas dhe ai mbretërisë së Maqedonisë, si një parakusht i vlerësimit të tyre objektiv historik, gjithsesi kalon nëpërmes pamjes mitike të tyre, karakteristikë për faktorët e gjithmbarshëm të antikitetit në fazat e hershme të zhvillimit kur të menduarit mitik dhe mitologjia në përgjithësi shënojnë kapërcimin e njohur të filozofia, nëpër të cilën u zhvilluan proceset e mëvonshme kulturore dhe ato shoqërore dhe politike.¹⁰ Pra, Maqedonia antike, si mbretëri ndër më të njohurat e kohës dhe Maqedoninë si shtet politik i krijuar në fund të shekullit njëzetë, pos emrit dhe një takimi të vogël në një pjesë gjeografike, jashtë çfarëdo reference historike, i lidh vetëm prania e shqiptarëve, të cilët historikisht janë trashëgimtarë të maqedonasve antikë si pjesë e botës pellazge-ilire ku kishin shtratin e tyre të barabartë mbretëria e Maqedonisë dhe mbretëria e Dardanisë. Ky qëndrim, megjithatë thyen stereotipat e deritanishëm rreth asaj se Maqedonia antike dhe maqedonasit ishin pjesë e Greqisë antike, pra grek. Ndërsa përkatësia botës pellazgo-ilire dhe mbretërive që kishte ajo, thyen edhe atë të çështjes së helenizmit si ekskluzivitet grek për faktin e pamohueshëm se e gjithë ajo që shfaqet si kulturë dhe qytetërim antik, nga miti e deri te filozofia, e ka shtratin të një qytetërim paraprak i njohur si pellazg, mbi të cilin u ngrit ai i

⁹ Шкариќ, проф. д-р, Светомир; Иванов, проф. д-р, Ѓорѓе, Политички теории – Антика, учебник за политички науки на Правниот факултет „Јустинијан Први“, при Универзитетот „Св. Кирил и Методиј“, – Скопје, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 11; cituar sipas: Јуџин Н. Борза, Во сенката на Олимп – појавата на Македон; Патрија, Скопје, 2004, стр. 107, 108.

¹⁰ Për më tepër shih: Vuxhovi, Jusuf, Maqedonia (Nga antika deri te koha jonë), JalifatPublishing, Houston, Faik Konica, Prishtinë, 2019, fq. 17, 18.

mëvonshmi që iu artibua atij grek. Kjo pranohet me të madhe dhe dëshmohet edhe nga autorë anikë dhe të mëvonshëm.¹¹ Por, kjo nuk e pengon Greqinë që pas pavarësimit maqedonas në vitin 1991, “ta tërheqë për hunde” opinionin botëror dhe të theksojë se në Republikën e Maqedonisë jeton një pakicë prej 300.000 (treqind mijë) grekë. Për këtë propagandë djallëzore me numra, Athina më vonë arsyetohej se nën ata numra nënkuptonin (maqedonasit) refugjatë dhe të shpërngulurit (në kohërat e luftërave ballkanike dhe luftës qytetare në Greqi), të cilët më herët kanë jetuar në Greqinë Veriore.¹²

Në harta ekzistojnë dy Maqedonia, të cilët në mënyrë specifike quhen si Maqedoni (Ish Republika Jugosllave) dhe Maqedonia (regjion). Këto harta tregojnë se mund të arrihet në huti dhe në dilema. Termi gjeografik Maqedonia mund të përdoret me domethënie të dyfishtë ndaj dy entiteve të ndryshme: pavarësia e re e Republikës së Maqedonisë, nga njëra anë dhe regjioni grekë i Maqedonisë në anën tjetër. Ajo tregon se mund të ekzistojnë dy grupe të ndara njerëzish maqedonas, si: maqedonasit (në kuptim nacional) të cilët nuk janë grekë dhe maqedonasit (në kuptim regjional) të cilët janë grekë.¹³ Në vitin 1992 ministri grek i punëve të jashtme Papakonstatinu në një brifing zyrtar donte t’i bindte vendet miqësore të BE-së në vitin 1994 se Titoja me vetëdëshirë dhe në mënyrë kundërligjore ia ndau emrin Maqedonisë, Republikës Popullore të Maqedonisë në kuadër të FPRJ.¹⁴ Pas vitit 1992, për Republikën e Maqedonisë përdoret emri IRJM (Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë). Me këtë emër para syve të botës Republika e Maqedonisë, integriteti i saj shtetëror është i degraduar në nivel të entitetit të përkohshëm. Greqia, për dallim nga Bullgaria dhe Sërbia, mund të lejojnë që të sillet si të dojë me BE-në dhe NATO-n, sepse si anëtare nuk duhet të frikësohet as nga presioni e as nga largimi dhe në rastin më të keq ajo do të ishte vetëm një paralajmërim. Me këtë populli maqedonas duhet të jetojë me faktin se qysh kur e fitoj pavarësinë dhe lirinë, ajo në mase të madhe varet nga vullneti i fqiu të saj, posaçërisht anëtarësimi i saj në NATO dhe BE.¹⁵

¹¹ Vuxhovi, Jusuf, Maqedonia (Nga antika deri te koha jonë), JalifatPublishing, Houston, Faik Konica, Prishtinë, 2019, fq. 11, 12.

¹² Костиќ, Моника; Наумовски, Владимир, Македонски јазол, се автори на овој есеј кој го разработува истоименото дело од Ханс Лотар Штепан – поранешен амбасадор на Германија во Р. Македонија, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 109; cituar sipas: X. Л. Штепан, Македонски јазол; стр. 391.

¹³ По ату, fq. 109, cituar sipas: Лоринг М. Денфорт, Македонски конфликт, стр. 275.

¹⁴ По ату, fq. 109; cituar sipas: X. Л. Штепан, Македонски јазол; стр. 47.

¹⁵ По ату, fq. 110.

1.1.2. E ashtuquajtura “çështja maqedonase” inekzistente sipas vështrimit grek

E ashtuquajtura “çështja maqedonase”, e cila reflekton mospajtueshmërinë ndërmjet shteteve të Gadishullit Ballkanik dhe ndërhyrjet e fuqive të mëdha në varësi të interesave të tyre, ka një histori të gjatë. Ngjarjet e së kaluarës janë të lidhura me presionet që t’i merret Greqisë kontrolli mbi Maqedoninë dhe rajoni të ankesohet në vendet tjera ose Bullgarisë dhe shtetit të atëhershëm sërb t’i sigurohet qasje në Detin Egje. Çështja kaloi nëpër faza të suksesshme të tensionit dhe përmirësimit. Tash përsëri është në pikë kritike, për shkak se Shkupi dëshiron të tregojë një ekzistencë të “popullit maqedonas”, “gjuhë maqedonase” dhe “vetëdije maqedonase”.¹⁶ Nëse bëhet një vështrim i shkurtër i së kaluarës së saj, do të shihet se çështja për herë të parë u paraqit në Revolucionin grek për çlirim nga turqit në vitin 1821, kur Bullgaria i shfaqti në horizont kërksat territoriale për Maqedoninë. Pretendimet territoriale bullgare e arritën kulminacionin e tyre si rezultat i ngjarjeve tjera. Në vitin 1878 u krijua hegjemonia bullgare, kurse në vitin 1885 Bullgarisë ju bashkua Rumelia Lindore. Në vitin 1893 u themelua Organizata e brendshme revolucionare maqedonase (VMRO), kurse në vitin 1895 Komiteti Qendror në Sofje. Që të dy grupet u shfrytëzuan me dhunë dhe me sulme të armatosura nga ana e pushtuesve otoman. Nga fundi i shek. XIX edhe Sërbia filloi ta publikojë të drejtën e saj për korridor të lirshëm në atë mënyrë që u mundua t’i përfitoj sllavofonët e Maqedonisë së Veriut (Maqedonia jugosllave e sotme) përmes kishës dhe shkollës. Tensioni arriti kulminacionin e saj në fillim të shek. XX kur nga Bullgaria kanë qenë të sjellura grupe të armatosura dhe inkurajoheshin lëvizjet revolucionare, me qëllim që të krijonin shtetin maqedonas e cila më vonë do të ankesohet nga Bullgaria. Përfundimisht shteti grekë hyri në aksion dhe grekët në Maqedoni filluan që të organizojnë mbrojtjen e armatosur e njohur në histori si Lufta maqedonase (1904-1911). Lufta i anuloi planet e Bullgarisë, kurse me Luftëtrat Ballkanike nga 1912-1913 i hapi rrugë Maqedonisë për çlirim nga turqit. Greqia e dëshmoi të drejtën e saj përse gjysma e më shumë e Maqedonisë ishte e aneksuar nga shteti grek. Pas

¹⁶ Папареогиу, Е., А., *Таканареченото македонско прашање*, (Materiali në vijim paraqet vështrimin grek dhe është marrur nga “E ashtuquajtura çështja maqedonase” nga autori grek E. A. Papageorgiu dhe është botuar në revistën e agjencionit të Athinës, në edicionin Fokus, me 18 korrik 1989 – origjinali është shkruar në gjuhën angleze. Është marrur nga një dokument i brendshëm dërguar Sekretariatit republikan për marrëdhënie me jashtë, nën numrin 1102-483/2 nga 21.07.1989, dhe është i nënshkruar nga zv. sekretari i atëhershëm, z. Boris Çalovski. Konsiderojmë se është e nevojshme ta përfshijmë edhe një të ashtuquajtur vështrim grek mbi kontestin shekullor mes maqedonasve dhe grekëve, që mos të jemi të akuzuar me subjektivizëm të tepërt në analizën e fakteve që i ekspozojmë.), Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 73.

Luftës së Dytë Botërore në skenë u paraqit një element i ri ku Jugosllavia e shpalli vërtetimin e saj se ekziston një “popull maqedonas” i veçantë. Ngjarjet që pasuan nuk dhanë rezultate të mira, por as nuk i kënaqën aspiratat jugosllave. Me 31 janar 1945, në Jugosllavinë e Titos u formuan gjashtë republika popullore të cilët më vonë u kryqëzuan në “republika socialiste” – Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali Zi, Sërbia dhe Maqedonia. Krijimi i Republikës Socialiste të Maqedonisë, e cila e kapi 10% e hapësirës së përgjithshme të Jugosllavisë, me kryeqytet Shkupin, kishte për qëllim forcimin e Jugosllavisë Jugore dhe t’i mundësojë ta shmang ndikimin e pakontestueshëm bullgar dhe tendencave probullgare në njësitë dhe të transformohet në Maqedoni jugosllave në një bashkim e cila do t’i lidh tre pjesët e Maqedonisë, nën kontrollin e Jugosllavisë. Njëkohësisht u ndërmorrën iniciativa për krijimin e një federate të sllovenëve të jugut me qëllime afatgjate që të vendoset Gadishulli Ballkanik nën kontrollin e Jugosllavisë së Titos. Deri te ajo periudhë, pjesën që e përbënte Maqedonia jugosllave quhej “Sërbia jugore”. Tani jugosllavët e quajnë “Maqedonia e Vardarit”, përkundër Greqisë “Maqedonia e Egjeut”, dhe asaj bullgare “Maqedonia e Pirneut”, duke mundur që në atë mënyrë të krijohet përshtypja se ajo është një njësi e unifikuar. Ana jugosllave, me atë që e krijojë Maqedoninë në Shkup, kishte për qëllim t’i jepte entitet të veçantë etnologjik dhe historik dhe për arritjen e saj përdori mjetet në vijim:

E para, krijoji administratë të veçantë shtetërore ashtu që të gjitha trupat lokale të formuara në kuadër të administratës në Shkup do të thirren “maqedonase”. Në atë mënyrë, formohet “Qeveria maqedonase”, “Parlamenti maqedonas” etj., me qëllim që të prezantohet termi “maqedonas” me domethënie të re politike dhe administrative, e cila me kalimin e kohës do të nikoqirizohet. E dyta, është bërë përpjekje që të krijohet një gjuhë e veçantë të cilën kushtetuta jugosllave e pranoi so gjuhë zyrtare shtetërore. Në esencë, “gjuha maqedonase” është dialekt lokal i gjuhës bullgare, në të cilën është bërë përpjekje që të pastrohet nga shumë fjalë bullgare dhe të prezantohet si gjuhë e veçantë. Fundi fundit, vërtetimi se e ashtuquajtura “gjuhë maqedonase” është krijim artificial e nxorri edhe Milovan Gjilas i cili në atë kohë ishte përgjegjës për çështje ideologjike dhe kulturore në Partinë Komuniste Jugosllave (PKJ). Në vitin 1945, Bllazhe Koneski, shkrimat dhe poet nga Shkupi, shkoi në Beograd që ta shqyrtonte çështjen rreth alfabetit dhe gjuhës sllavomaqedonase. Duke ndjekur propozimin e tij, u përdor

një dialekt lokal i Maqedonisë jugosllave e cila do të shërbejë si bazë për krijimin e një dialekti të ri “maqedonas”. E treta, ishte krijuar kisha e pavarur maqedonase edhe përskaftë faktit se një prezencë e tillë fetare ishte e padëshiruar për një rezhim komunist. Megjithatë, patjetër duhej të krijohesh kisha që t’i shërbente aspiratave të Maqedonisë, duke pasur parasysh faktin se popullsia në njësi ishte shumë religjioze, kurse kisha ishte fortë e lidhur me traditën. Pikërisht, për atë arsye, në vitin 1968 u formua “Kisha autoqefale maqedonase”, me ndërhyrje të partisë, me seli në Shkup edhe përkundër asaj se Patriarkana sërbe fuqimisht reagoi dhe u nda nga ajo kishë. E katërta, krijimi i nacionalitetit të veçantë që t’i jepej bazë politikës së Maqedonisë së Shkupit. Në kuadër të kësaj janë bërë presione të vazhdueshme që popullata lokale të kuptojë se i takon një nacionaliteti të veçantë “maqedonas” e cila ka vetëdijen e saj nacionale. Presionet, gjithashtu, ishin të drejtuara nga krijimi i “historisë maqedonase” me qëllim që të mbështetej ekzistimi i këtij nacionaliteti të sapoformuar, u bëri thirrje shërbimit të shkencëtarëve, profesorëve universitar dhe të tjerëve të cilët filluan ta ndërtojnë “historinë maqedonase” mbi shtrembërime historike, rekonstruksione dhe falsifikime. Njëkohësisht ata kërkuan mënyra që ta fshijnë prezencën e grekëve në Maqedoni dhe ta falsifikojnë historinë e vërtetë të Maqedonisë, ashtu që ndikimi grekë në rajon do të binte në minimum dhe do të falsifikoheshin kontributet e mëdha të Greqisë, të Kishës Ortodokse Greke dhe të shkollave greke. Janë bërë përpjekje plotësuese të cilat kishin për qëllim që të dëshmonin se te “maqedonasi” ekziston vazhdimësia historike dhe identiteti nacional nga koha e vjetër e këndeje.¹⁷ Kjo ndjeshmëri e madhe e Greqisë ndaj Maqedonisë ka më tepër burime duke filluar prej luftës qytetare në Greqi, ku sllovenët aktivisht morrën pjesë, plaga afatgjate e Greqisë ndaj irredentizmit të kufijëve verior, frika nga destabilizimi i tradicionalëve, ndarjet e brendshme mes Athinës dhe rajoneve të saj në veri si dhe mohimi irritues në lidhje me lidhshmërinë e Greqisë moderne me Greqinë antike dhe Bizantin. Por, kjo sot është më pak e ndjeleshme sesa përpara një dekade. Shkencëtari eminent grek, Evangelos Kofos thotë se Greqia është duke u stabilizuar

¹⁷ Папареогиу, Е., А., *Таканареченото македонско прашање*, (Materiali në vijim paraqet vështrimin grek dhe është marrur nga “E ashtuquajtura çështja maqedonase” nga autori grek E. A. Papageorgiu dhe është botuar në revistën e agjencionit të Athinës, në edicionin Fokus, me 18 korrik 1989 – origjinali është shkruar në gjuhën angleze. Është marrur nga një dokument i brendshëm dërguar Sekretariatit republikan për marrëdhënie me jashtë, nën numrin 1102-483/2 nga 21.07.1989, dhe është i nënshkruar nga zv. sekretari i atëhershëm, z. Boris Çalovski. Konsiderojmë se është e nevojshme ta përfshijmë edhe një të ashtuquajtur vështrim grek mbi kontestin shekullor mes maqedonasve dhe grekëve, që mos të jemi të akuzuar me subjektivizëm të tepërt në analizën e fakteve që i ekspozojmë.), Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 73.

dhe është pjekur që nga periudha e Luftës së Dytë Botërore, çështja maqedonase është zhvilluar nga problemet e vërteta mbi sigurinë nacionale deri në çështjen e identitetit dhe përfundimisht si rezultat i paraqitjes së kahershme të Greqisë se anëtar i sigurt dhe prosperues i BE-së dhe NATO-s, e deri te problemet e të drejtave të njeriut, të drejtat e grekëve në kulturën e tyre trashëguese.¹⁸Në çdo rast, qëndrimi grek akoma është se Republika e Maqedonisë paraqet mohim të identitetit grek dhe shfaqje të qëllimeve irredentiste. Politika zyrtare kërkonte “kompromis” me propozimin e emrit “Maqedonia e Epërme”¹⁹, siç do të shohim në kapitujt në vijim mbi propozimet e emrave të Republikës së Maqedonisë.

1.1.3. Maqedonasit në Greqi

Përqindja e maqedonasve etnikë në Maqedoninë e Egjeut thuhet se është e njëjtë me atë para 100 viteve, kur territori i saj i sotshëm nuk ka qenë i shtetit grek. Aktivisti për të drejtat e njeriut të maqedonasve në Greqi, Gjorgji Kanzurov në librin e tij “Mbijetojmë me dinjitet”, ka bërë hulumtime gjashtë vjet dhe ka arritur t’i numëroj maqedonasit atë që deri më tani nuk është arritur edhe në Maqedoninë Veriore, duke vizituar fshatra, duke biseduar me banorët, ka arritur në të dhëna statistikore që sipas tij 30% e banorëve të regjionit janë maqedonas, përreth diku 600 dhe 720 mijë, që i vjen përafërsisht diku 5% deri 7% të numrit të përgjithshëm të Greqisë. Sipas tij, ata e flasin gjuhën maqedonase dhe e kujdesen për kulturën e tyre në familje ose në shoqëritë kulturore në vend. Megjithatë, ka edhe maqedonas etnik të greqizuar, të cilët jetojnë në qendrat e qyteteve dhe në vendbanime ku grekët e shpërngulur kanë qenë shumicë.²⁰ Edhe sipas raportimit të BBC duke i kujtuar rrethanat historike ku Maqedonia ka qenë e ndarë në tre shtete, me ç’rast nga Greqia disa kanë qenë të larguar, kurse disa të tjerë u janë nënshtruar asimilimit sistematik, por ende në disa vendbanime me emra jo grekë, u jepen emra të rinj të zgjedhura nga komisioni nga fundi i shek.XX të shekullit të kaluar edhe pse një shekull më vonë, “lokalistët” ende vazhdojnë t’i shfrytëzojnë emrat e tyre të vjetër.²¹ Vlen të përmendet se gjatë vitit 1900 në Maqedoninë e Egjeut ka pasur 1.163.477 banorë, prej të cilëve 326 mijë maqedonas të krishterë dhe 41 mijë maqedonas-muslimanë. Ata kanë qenë më të

¹⁸ Името на Македонија: Зошто е важен спорот и како да се разреши, МКГ - Извештај за Балканот, бр. 122, Скопје/Брисел, 10 декември 2001, cituar sipas: Интервју на МКГ со проф. Кофос, на 4 октомври 2001; стр. 19, 20.

¹⁹ По ату, fq. 20.

²⁰ Македонците во Грција се пребројани, Македонска Нација, 09 декември 2015, linku në dispozicion: <http://www.mn.mk/aktuelno/11261>, (15 Prill 2020).

²¹ Репортажа на Би-Би-Си за македонците во Егејска Македонија, IN TV Australia, 19 Март 2019.

numërt, para grekëve, të cilët kanë qenë 20%, kurse gjatë vitit 2012 Maqedonia e Egjeut ka tre rajone, dhjetë qarqe, 39 komuna dhe 470 vendbanime, në të cilat jetojnë maqedonas dhe flasin gjuhën maqedonase. Sipas analizave të vitit 2001, në Maqedoninë e Egjeut ka 2.424.765 banorë, prej të cilëve 19,04% deri 24,09% janë me identitet maqedonas etnikë, përkatësisht prej 460.642 deri 582.912. Në vitin 2011 ka pasur 2.393.450 banorë, prej të cilëve 20,9% deri 27,2% janë me identitet maqedonas etnikë, përkatësisht 454.562 deri 570.091. Në atë numër përfshihen maqedonasit etnik të greqizuar të cilët janë të pa evidentuar.²²

Edhe përskaj të këtyre numrave jo zyrtare, partia e pakicës maqedonase në Greqi, Aleanca e Evropës së Lirë “Ylberi”, disa u është drejtuar autoriteteve greke mbi përjashtimin e maqedonasve nga procesi i shtetit grek, përkatësisht i është drejtuar ministrisë së punëve të jashtme të Greqisë në të cilën ka kërkuar takime për çështjen e kthimit të refugjatëve politikë maqedonas në Greqi dhe përpjekjet e tyre të pasuksesshme për t’i rikthyer shtetësitë me ligjet diskriminuese të miratuara nga ana e shteti grek si dhe në kërkesën drejtuar ministrisë së arsimit të Greqisë dhe ministrisë për komunikim dhe televizion dhe radio në të cilën kanë kërkuar futjen e gjuhës maqedonase në sistemin arsimor grekë, përkatësisht emitimin e programeve në gjuhën maqedonase në mediumet nacionale greke. Ndaj këtyre kërkesave, partia në fjalë nuk ka marrur asnjëherë përgjigje.²³ Gjithashtu përfaqësuesi i Shtëpisë së kulturës maqedonase në takimin e organizuar nga ana e OSBE mbi çështjet e lidhura me dimensionin njerëzor, potencoi se gjatë kohës së luftës qytetare greke (1946-1949), mijëra qytetarë grekë e lëshuan Greqinë dhe gjithë atyre u janë marru shtetësitë si dhe pronat e tyre. Në vitin 1982 qeveria greke miratoi Ligjin për amnesti (Ligji 106841), ku qëndron se refugjatët politikë të cilët kanë ikur gjatë kohës së luftës qytetare dhe ndaj të cilëve u është marrur shtetësia mund të kthehen, vetëm nëse vërtetohen se janë “grekë për nga preardhja”. Gjithashtu, edhe me ligjin (aktin) 1540, refugjatëve politikë u është lejuar kthimi i pronave të

²²Македонците во Грција се пребројани, Македонска Нација, 09 декември 2015, linku në dispozicion: <http://www.mn.mk/aktuelno/11261>, (15 Prill 2020).

²³ Për më tepër shih: Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 133, 134, 135; situar sipas: стенограми од говорите на дискутантите кои учествуваа во петте работни сесии (сесија 10 – сесија 14), на различни теми, на средбата организирана од страна на ОБСЕ – Организација за безбедност и соработка во Европа (поранешен КЕБС), во Варшава, главниот град на Полска – од 09 до 11 октомври 2006 година, под наслов: Прашања поврзани со човечката димензија. Изборот на говорите и репликите кои Ви се изложени го направи Д. Апасиев. Извор: www.florina.org.; Тема: „Демократски институции; Демократијата на национални, регионални и локални нивоа,,“ излагање на претставник на „Виножито,, – организација на македонското национално малцинство во Грција.

konfiskuara nëse paraprakisht deklarohen se janë “grekë për nga preardhja”. Termi “grekë për nga preardhja” është referencë të cilën e shfrytëzon qeveria e Greqisë për të gjithë ata të cilët identifikohen si grekë etnikë. Nga këtu, maqedonasit etnikë të cilët janë refugjatë politikë dhe shtetësia e të cilëve u është pushuar dhe/ose pronat u janë konfiskuar, janë të përjashtuar nga gëzimi i të drejtave të barabarta të cilët janë të garantuara me ligj. Pra, formulimi i tyre dhe vetë stilizimi i tyre nuk është çështje naiviteti, por kanë qëllimi i tyre është i qartë e ajo është diskriminimi ndaj të gjithë atyre të cilët nuk janë “grekë për nga preardhja”, kështu maqedonasit duke u bërë shënjestër e këtyre definicioneve tendencioze, pasojat negative të të cilave më së shumti i kanë përjetuar. Ligjet që janë në fuqi, shërbehen me këto principe themelore dhe bien ndesh me dokumentin e Kopenhagës në të cilin thuhet se individët të cilët i takojnë pakicës nacionale kanë të drejta të plota dhe efektive që t’i realizojnë të drejtat e tyre njerëzore dhe liritë themelore, pa asnjë farë diskriminimi dhe barazi të plotë përpara ligjeve.”²⁴

Si kundër përgjigje ndaj kësaj, përfaqësuesi i delegacionit grekë duke e shfrytëzuar të drejtën e replikës në takimin në fjalë, theksoi se, në esencë në Greqi ekzistojnë 2,5 milion grekë maqedonas, krenar për trashëgiminë dhe traditet e tyre, të cilët datojnë një mijë vjet më herët dhe se “pakica maqedonase” të cilën e thekson përfaqësuesi i partisë së pakicës maqedonase, rikujtoi se një pakicë e tillë nuk ekziston në Greqi dhe se partia në fjalë me pjesëmarrjet e zgjedhjeve të fundit politike në Greqi, nuk ka arritur të fitojë më shumë se 0,02% të votave edhe përkaj asaj që kanë qenë pjesë e koalicionit me grupe të tjera më të vogla, dëshmon se ekzistimi i tyre është i paekzistentë.²⁵

Në këtë drejtim, edhe përkundër dispozitës kushtetuese, as Republika e Maqedonisë së Veriut, as Jugosllavia nuk janë kujdesur (por, as që kanë mundur të kujdesen) në një masë të madhe për pakicat në vendet fqinje. Përderisa për kujdes nuk konsiderohen letrat protestë të cilët qeveria maqedonase i drejtohej Bullgarisë, gjithmonë kur ndonje politikanë bullgar apo historian do të deklaronte se nuk ekziston gjuha maqedonase dhe kombi maqedonas. Aktivitete tjera të veçanta nuk kishte. Ajo më tepër kishte karakter deklarativ e aq më pak është vepruar

²⁴ Për më tepër shih: Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 136, sipas: Тема: „Државјанство и политички права“, излагање на претставникот на Домот на македонската култура.

²⁵ По ату, fq. 135, sipas: изјава на претставник од грчката делегација.

konform pozicionit kushtetues për kujdesjen e pakicave në Greqi.²⁶

1.2. Çështja e Bukureshtit

Lufta e Dytë Ballkanike filloi me konfliktin mes Bullgarisë, Greqisë dhe Sërbisë në korrik të vitit 1913, në lidhje me dallimet kuptimore se cilit shtet dhe në sa pjesë Maqedonia duhet t'ju takojë. Analizat e mëvonshme treguan se ishte shumë e besueshme se Bullgaria do të korrite fitore madje edhe në të dyja frontet, përderisa situatën e tillë nuk do ta shfrytëzonte Rumania, e cila e shtyer nga Franca dhe Britania e Madhe i shpalli luftë Sofjes. Duke pasur parasysh se pjesa veriore e Bullgarisë ka qenë thujse pa ushtarë, aradhat rumune në fillim të korrikut janë shëtitur në vendin bullgar dhe kanë arritur para portës së qytetit kryesor bullgar. Të njëjtën e ka shfrytëzuar edhe Turqia, e cila hapi katër fronte kundër ushtrisë bullgare. Pas kësaj, humbja e Bullgarisë ka qenë e pashmangshme dhe ajo ka kërkuar pushim të armiqësisë dhe negociatave. Me 14 korrik 1913, e diell, anija sërbe në të cilën ka vuar flamuri sërb, malazes, grek dhe ai rumun, në Turnu Severin kanë arritur të gjithë së bashku delegacionet sërbe, greke dhe malazese. Aty, kanë qenë të pritur nga Treanea Greçeano, shefi i protokollit të oborrit rumun. Nga këtu, me tren, janë larguar për në Bukuresht. Negociatat kanë filluar me 17 korrik 1913 dhe kanë zgjatur deri më 28 korrik 1913. Për kryesimin e seancave është zgjedhur kryetari i qeverisë rumune, Titu Majoresku.²⁷

Marrëveshja paqësore e Bukureshtit e 28 korrikut të vitit 1913, si traktat paqeje mes palëve ndërluftuese në përfundim të Luftës së Dytë Ballkanike, u nënshkrua më 28 korrik (10 gusht) 1913, në Bukuresht të Rumanisë, nga delegatët e Bullgarisë, Greqisë, Malit të Zi, Rumanisë dhe Sërbisë, mes gjithash ku thuhet se: "...të udhëhequr nga dëshira për t'i dhënë fund gjendjes së luftës, e cila ekziston mes shteteve të tyre të respektuara, duke dëshiruar vendosjen e rendit dhe paqes mes popujve të tyre, të vendosur në gjykime afatgjata, vendosën të lidhin një marrëveshje përfundimtare për paqe..."²⁸

Sipas Traktatit të Bukureshtit, Maqedonia u nda në atë mënyrë që pjesën më të madhe

²⁶ Për më tepër shih: Колбе, Кица, За македонското малцинство во Грција и за „грижата“, за него, 20.06.2018; linku në dispozicion: <https://okno.mk/node/72087>, (22.04.2020).

²⁷ Për më tepër shih: Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 43, cituar sipas: Текстот е преземен од неделникот Фокус бр. 666, од 4 април 2008 година. Автор е г. Дарко Јаневски. Целиот текст на Букурешкиот договор видете го во Третиот дел на ова книга.

²⁸ Për më tepër shih: Букурешкиот мировен договор од 28 јули 1913 година, ПРАВДИКО, linku në dispozicion: <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/bukureskiot-miroven-dogovor-na-makedonski-jazik.pdf>, (22.04.2020).

të saj, përkatësisht pjesën e Egjeut të Maqedonisë, me sipërfaqe prej 34.356 km² e morri Greqia, pjesën e Maqedonisë së Vardarit (Republika e sotme e Maqedonisë), me sipërfaqe prej 25.342 km² e morri Serbia, ndërsa pjesa e Maqedonisë së Pirinit, me sipërfaqe prej 6.798 km² iu dha Bullgarisë. Me këtë u mbyll përgjithmonë çështja e ashtuquajtur maqedonase, përmes së cilës organizata VMRO, e themeluar në vitin 1893 në Selanik, (Partia e sotme me emrin VMRO-DPMNE është trashëgimtare e saj), kërkonte që Maqedonisë t'i njihej e drejta për autonomi në kuadër të Perandorisë Osmane, me kryeqytet Selanikun (jo Shkupin!).²⁹

Në një takim shkencor të Akademisë së shkencave të Maqedonisë ku u debatua për 100 vjetorin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Bukureshtit erdhën në konkluzion se jo çdo konferencë ndërkombëtare ka vendosur paqen në Ballkan. Kjo bën që kohë pas kohe marrëveshjet ndërkombëtare të rishqyrtohen nga prizmi i periudhës së tanishme, me qëllim të sendërtimit të një paqeje të qëndrueshme në Ballkan. Sipas akademikut Beqir Meta, efektet e saj edhe pas 100 viteve janë negative për tërë Ballkanin, e në veçanti për disa popuj të cilët ishin viktimë e luftrave ballkanike,³⁰ duke pasur parasysh se në shekullin XIX, në rajonin e Maqedonisë kanë banuar disa grupe etnike, si: bashkësia sllavishtfolëse, grekët, shqiptarët, turqit, vllehtë, hebrenjtë. Me fjalë të tjera, kemi një përzerje popujsh. Për shkak të kësaj përzierjeje, në restorantet e Francës ekziston e ashtuquajtura sallatë maqedonase. Asnjëra prej këtyre grupeve etnike nuk përbënte shumicë, për të qenë mbartëse e ndonjë ideje kombëtare. Sipas Bullgarisë, sllavishtfolësit e këtij rajoni janë bullgarë dhe paraqesin shumicë ndaj grupeve etnike të tjera.³¹ Kështu, sipas akademikut Beqir Meta, ata jo vetëm që humbën të drejtat e tyre legjitime por në disa raste, kanë humbur edhe territoret e tyre. Në radhë të parë është populli shqiptar, i cili u sakrifikua më shumë nga luftrat ballkanike pas Marrëveshjes së Bukureshtit sepse u krijua një shtet politik shqiptar shumë i dobët, meqë gjysma e etnitetit dhe territorit

²⁹ Maqedonia nuk duhet të ndahet, as të bashkohet, por të çlirohet nga ndikimi serb dhe rus!, (Disa argumente për idenë e ndarjes, ose bashkimit të pjesëve të Maqedonisë me ndonjë shtet tjetër fqinj), PORTALB, linku në dispozicion: <https://portalb.mk/368316-maqedonia-nuk-duhet-te-ndahet-as-te-bashkohet-por-te-çlirohet-nga-ndikimi-serb-dhe-rus/>, (22.04.2020).

³⁰ Ballkani ka nevojë për pajtim – Konferencë shkencore në Shkup, DW, linku në dispozicion: <https://www.dw.com/sq/balkani-ka-nevoj%C3%AB-p%C3%ABr-pajtim-konferenc%C3%AB-shkencore-n%C3%AB-shkup/a-17211257>, (22.04.2020).

³¹ Zejneli, Xhelal, Maqedonia – nyje e Gordit, TetovaNews, linku në dispozicion: <https://www.tetovanews.info/2018/02/maqedonia-nyje-e-gordit/>, (22.04.2020).

mbetën jashtë shtetit politik si dhe humbësit e tjerë janë maqedonasit dhe vllahët.³² Edhe sipas kryetarit të Akademisë së Shkencave të Maqedonisë, Vllado Kambovski, paqartësitë nga Marrëveshja e Bukureshtit edhe pas 100 viteve ndjehen në Ballkan. Ai sugjeron nënshkrimin e një marrëveshjeje rajonale, e cila do të sillte paqe dhe stabilitet të përhershëm në Ballkan dhe që në të njëjtën kohë do të korigjonte padrejtësitë e Marrëveshjes së Bukureshtit nga viti 1913 për popujt e Ballkanit, ndërsa akademiku Bllazhe Ristovski konsideron se nëse në vitin 1913 Maqedonia do të fitonte pavarësinë, ajo nuk do të përballje me konteste të natyrave të ndryshme nga fqinjët.³³ Sipas historianit maqedonas Todor Çepreganov thotë se historia shpesh përsëritet dhe kjo në veçanti reflektohet te Maqedonia nëse kemi parasysh problemet e saj për anëtarësim në strukturat Euroatlantike. Pra, sipas tij, “të njëjtit ata që e ndanë territorin e Maqedonisë në vitin 1913, sot njëri prej atyre shteteve, Greqia, të cilës kohë pas kohe i bashkangjitet edhe Bullgaria, ende nuk dëshirojnë të njohin ekzistimin e Maqedonisë, kombin maqedonas, ekzistimin e gjuhës dhe kulturës maqedone.”³⁴ Sipas të njëjtit, ndër vite sikur Marrëveshja paqësore e Bukureshtit nuk është tërësisht në funksion, nëse merret parasysh se në vitin 1944 Sërbia, një nga vendet nënshkruese të kësaj marrëveshje hoqi dorë nga ajo dhe lejoi në territorin të cilin e ka marrë ajo (Serbia) në vitin 1913 lejoi të formohet Republika Federative Popullore e Maqedonisë në kuadër të Jugosllavisë. Nga këto dhe argumente të tjera, shtetet fqinje të Maqedonisë së sotme, Greqia, Serbia dhe Bullgaria e kanë humbur përgjithmonë të drejtën e tyre mbi Maqedoninë.³⁵

1.3. Dimensioni juridik i kontestit

Edhe pse në shikim të parë ky kontest duket se ka vetëm dimension historik, për çka edhe realisht ka ekzistuar problemi me emrin, por, çështja aq shumë është ndërlikuar me vite me radhë, sa që ky kontest është bërë multidimensional, ku janë implikuar edhe dimensionet politik por edhe ai juridik i kontestit. Nëse deri para pavarësisë së Maqedonisë, pasojat që mund të vinin nga ky kontest ende nuk ishin shfaqur në horizontin maqedonas dhe ende nuk i kishin

³² Ballkani ka nevojë për pajtim – Konferencë shkencore në Shkup, DW, linku në dispozicion: <https://www.dw.com/sq/balkani-ka-nevoj%C3%AB-p%C3%ABr-pajtim-konferenc%C3%AB-shkencore-n%C3%AB-shkup/a-17211257>, (22.04.2020).

³³ Po aty.

³⁴ Po aty.

³⁵ Maqedonia nuk duhet të ndahet, as të bashkohet, por të çlirohet nga ndikimi serb dhe rus!, (Disa argumente për idenë e ndarjes, ose bashkimit të pjesëve të Maqedonisë me ndonjë shtet tjetër fqinj), PORTALB, linku në dispozicion: <https://portalb.mk/368316-maqedonia-nuk-duhet-te-ndahet-as-te-bashkohet-por-te-çlirohet-nga-ndikimi-serb-dhe-rus/>, (22.04.2020).

përjetuar të njëjtat, por ky kontest filloi të merr përmasa serioze në momentin kur u hap çështja e njohjes ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë, pas pavarësisë së saj nga Ish Republika Socialiste e Jugosllavisë. Andaj, ky dimension ishte më i vështirë për Maqedoninë plot 27 vite, duke pasur parasysh procedurën që është zhvilluar për pranimin e saj në OKB, me një emër “pa emër”, por që vlerësohet si ngjarje historike e periudhës pas pavarësisë së Maqedonisë, si dhe bllokimi i procesit evro-integrues i Maqedonisë, ishte tejet serioze dhe u bë shkak që shpesh herë Maqedonia të përjetojë kriza të brendshme shtetërore dhe si dukej presioni që vinte jo vetëm nga Greqia, por edhe nga ndërkombëtare, presioni më i madh si duket ishte nga vetë natyra e kontestit u rrinte si gurë në qafë maqedonasve, por fundja edhe shqiptarët nuk bënëin përjashtim në këtë drejtim. Ata shpesh herë, u janë kërcënuar maqedonasve, që ta ndryshojnë emrin dhe Maqedonia të bëhet anëtare e barabartë me shtetet evropiane dhe mos t’ua shkatërrojnë ardhmërinë atyre, rrjedhimisht edhe shtetit të tyre. Pra, ky dimension është mos më e rëndësishmja në krejt këtë histori të kontestit greko-maqedonas, sepse siç do të shohim në pikat në vijim të këtij punimi, Maqedonia në gjithë jetën politike dhe juridike të saj në politikën e jashtme përballë me veton greke, gjë që e pamundësonte Maqedoninë të integrohej në çdo organizatë ndërkombëtare, pa zgjidhur çështjen e emrit. Edhe pse, shpesh herë Greqia është akuzuar për shkeljen e Marrëveshjes së Përkohshme të arritur me Maqedoninë dhe ka humbur betejën në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, por kjo nuk i jepte të drejtë të plotë Maqedonisë për insistimin me çdo kusht për ta mbajtur emrin e tyre kushtetues dhe ta detyronte Greqinë që të heq dorë nga ky kontest. Ajo, herdo kurdo do të duhej të përballë me realitetin dhe problemin real që ekzistonte tashmë e një kohë dhe kjo e detyruar të mendohej për zgjidhje afagjata të këtij kontesti, për të mbijetuar si çdo shtet tjetër në Ballkan. Alternativa tjera, pos integritit të saj në strukturat evro-atlantike nuk kishte!

1.3.1. Pranimi i Maqedonisë në OKB

Republika e Maqedonisë në procesin e pavarësisë së saj dhe njëkohësisht të njohjes ndërkombëtare, është ballafaquar me një numër të madh sfidash, si në planin e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Në atë drejtim, çështja e njohjes ndërkombëtare e Republikës së Maqedonisë në më shumë mënyra paraqiste precedent – si në plan politikë ashtu edhe në

atë juridik.³⁶

Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, Federata Demokratike e Jugosllavisë ishte njëra nga 51 shtetet themeluese të OKB-së. Republika e Maqedonisë, si pjesë përbërëse e saj, tregoi kontinuitet në kuptim të aktiviteteve paraprake të subjektit federativ në kuadër të organizatës, por nuk tregoi kontinuitet në kuptim të anëtarësimit. Pas shkatërrimit të Ish Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë u hapën procedurat për pranim të shteteve të sapoformuara të trashëguara nga IRFSJ në OKB. Vendimin për hyrje në anëtarësim në OKB e solli Kuvendi i RM-së më 29.07.1993.³⁷ Këtu, duhet të theksohet se Republika e Maqedonisë si rezultat i pamundësisë së Bashkimit Evropian që të ballafaqohet me çështjen e njohjes së shtetit e cila kulminoi me Samitin e Lisbonës së Bashkimit Evropian, në kuadër të aktiviteteve diplomatike gjatë korrikut të vitit 1992, theksin e vendosi në kërkesën e pranimin në OKB. Qeveria e Republikës së Maqedonisë dorëzoi propozim për anëtarësi të Republikës së Maqedonisë në OKB, në të cilën me 29 korrik solli vendim për anëtarësi. Një ditë më parë, kryetari i Republikës së Maqedonisë, mbi bazën e nenit 4 të Kartës së OKB-së dhe në përputhje me dispozitat e rregullave të procedurës së Këshillit të Sigurisë dhe dispozitat e rregullave të procedurës së Parlamentit të përgjithshëm të OKB, dorëzoi kërkesë deri te Sekretari i gjeneral i OKB-së, Butros Gali, për pranim të Republikës së Maqedonisë për anëtarësi në OKB. Në kërkesë për anëtarësi, kryetari Gligorov theksoi se Republika e Maqedonisë i pranon normat e gjithëpërfshirëse të së drejtës ndërkombëtare dhe konsideron se pranimi për anëtarësi të OKB-së do të përfaqësonte një hap domethënës kah zgjidhja paqedashëse e krizës së territorit të ish Jugosllavisë.³⁸ Në vazhdim të kërkesës për anëtarësi në OKB ka qenë dorëzuar edhe Deklarata për pranim të detyrimeve të përmbajtura në Kartën e OKB-së. Përsëri, si rezultat i më shumë faktorëve, në

³⁶ Докмановиќ, м-р, Мишо, Грчкиот и македонскиот меморандум за приемот на Македонија во ООН, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 243; cituar sipas: Докмановиќ М., (2006) „Проблемот со меѓународното признавање на Република Македонија“, во Зборник посветен на почесни доктори, доктори и магистри на науки (2001-2006 година), Скопје: Правен факултет „Јустинијан Први,“; Dokmanovic, Miso (2006). *The Legal and International Aspects of Recognition of States*. (Unpublished MA thesis, University of Malta).

³⁷ Република Македонија и Организацијата на Обединетите Нации, MACEDONISM, 11 октомври 2018, линку në dispozicion: <https://macedonism.org/%D0%9C%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%B0%D0%95%D0%BD%D1%86%D0%B8%D0%BA%D0%BB%D0%BE%D0%BF%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D1%98%D0%B0/%D1%80%D0%B5%D0%BF%D1%83%D0%B1%D0%BB%D0%B8%D0%BA%D0%B0-%D0%BC%D0%B0%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%98%D0%B0-%D0%B8-%D0%BE%D1%80%D0%B3%D0%BD%D0%B8%D0%B7%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0/>, (24.04.2020).

³⁸ Докмановиќ, м-р, Мишо, Грчкиот и македонскиот меморандум за приемот на Македонија во ООН, cituar sipas: Application of the Republic of Macedonia for admission to UN membership, 30 July 1992 (UN Doc. A/47/876-S/25147, Annex).,; Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 244.

rend të parë pozicioni grek, si dhe përpjekjet e qeverisë britanike për zgjidhje të çështjeve të hapura të cilët e pamundësonin njohjen e Maqedonisë nga ana e bashkësisë, kërkesa e Maqedonisë për anëtarësi në OKB nuk ishte administruar në mënyrë ekspeditive dhe e njëjta ka qenë e prolonguar deri në janar të vitit 1993. Si rezultat i mospjesëmardësisë së qeverisë britanike dhe misionit të Robin O' Nil³⁹, pas Samitit të Edinburgut të Bashkimit Evropian⁴⁰ procesi i njohjes së Maqedonisë tërthorazi i është lënë OKB-së. Duke pasur parasysh rezultatet e samitit të Edinburgut, Maqedonia në fillim të vitit 1993 e përsëriti kërkesën për anëtarësi në OKB, kurse sekretari gjeneral i OKB-së, Butros Gali me 22 Janar të vitit 1993 e ndoqi kërkesën maqedonase për anëtarësi deri te kryetari i Këshillit të Sigurimit së bashku me kërkesën fillestare për anëtarësi të 30 korrikut të vitit 1992. Si rezultat i kësaj, Greqia në mënyrë ekspeditive deri te OKB dorëzoi Memorandum ku i shprehu qëndrimet dhe pozicionet e Qeverisë së Greqisë në lidhje me kërkesën e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë për pranim në OKB. Ky memorandum, në një mënyrë të sistematizuar në 16 pika, shpreh vërejtjet kryesore të qeverisë greke për pranim të Republikës së Maqedonisë për anëtarësi në OKB me emrin që do ta mbajë termin "Maqedonia".⁴¹

Memorandumi i 25 janarit i vitit 1993, bazohet në më tepër teza, të cilët sipas qeverisë greke e vendosin në pikëpyetje gatishmërinë e "republikës së re" që t'i plotësojë detyrimet të cilët rrjedhin nga Karta e OKB-së. Këto teza para së gjithash i takojnë sigurisë, çështjes së akteve juridike të miratuara në procesin e pavarësisë së Republikës së Maqedonisë, por edhe çështjeve të simboleve dhe historisë. Në atë drejtim, qeveria greke konsideronte se pranimi i shtetit në anëtarësim në OKB "nën përdorimin e termit në aplikimin e saj për anëtarësim" do të shkaktonte destabilizim të mëtejshëm në Ballkanin jugor si në plan afatshkurtër ashtu edhe në plan afatgjatë. Edhe përkaj asaj se qeveria greke shfaqti një numër të madh vërejtjesh në lidhje me kërkesën për anëtarësim, që vetë pjesa hyrëse tingëllonte se Republika nuk duhet të

³⁹ Докмановиќ, м-р, Мишо, Грчкиот и македонскиот меморандум за приемот на Македонија во ООН, стр. 244; Sa i përket propozimit të Robin O' Nil për zgjidhjen e kontestit mes Greqisë dhe Maqedonisë ka qenë si në vijim: ruajtja e emrit kushtetues për përdorim të brendshëm dhe pranim të emrit "Republika e Maqedonisë (Shkup)" ose "Republika e Maqedonisë – kryeqyteti Shkup" për përdorim ndërkombëtar. Ky propozim ka qenë i pranuar për krerët e shtetit maqedonas, por nën presion të diskutimeve në Kuvend – Maqedonia u tërhoq prej këtij propozimi. Njëkohësisht edhe Greqia duke u thirrur në deklaratën e Lisbonës, e pranoi propozimin e O' Nil. Me atë, roli ndërmjetësues i saj përfundoi pa sukses. Për më tepër shih: Докмановиќ М., (2006) *Осамостојување на Република Македонија – магистарски труд*, Правен факултет, Скопје.

⁴⁰ Po aty, fq. 245, cituar sipas: European Council Declaration on the former Yugoslav Republic of Macedonia, *Edinburgh; 11 – 12 December 1992 (UN Doc. S/24960, Annex III)*.

⁴¹ Po aty, fq. 245.

pranohet në anëtarësim të organizatës pa arritjen e marrëveshjes për çështje kyçe të caktuara (certain outstanding issues). Njëkohësisht, Greqia shprehu edhe gatishmërinë e saj, pas arritjes së marrëveshjes, ta njoh shtetin edhe të vendos bashkëpunim me të.⁴²

Në elaborimin e mëtejshëm të shkaqeve për kundërshtimin e pranimit të Maqedonisë, qeveria greke e hapi çështjen e përmbajtjes së akteve juridike të miratuara në procesin e pavarësimin të Maqedonisë, më konkretisht të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë. Vërejtjet i referohen preambulës dhe pjesës normative të Kushtetutës. Në raport të preambulës, referenca në lidhje me vendimet historike të ASNOM-it të përfshira në preambulën e Kushtetutës, qeveria greke e shfrytëzoi që të thirret në Manifestin e ASNOM-it dhe të njëjtën ta përfaqësojë si përpjekje për aneksim të provincës maqedonase në Greqi dhe Bullgari dhe krijim të Maqedonisë së bashkuar.⁴³ Sa i përket pjesës normative të Kushtetutës, qeveria greke vuri në dukje nenet 3 dhe 49 të Kushtetutës së cilët i referohen ndryshimit të kufinjëve në përputhje me Kushtetutën “përderisa” territori i Republikës është i pandashëm dhe i patjetërsueshëm përkatësisht në dispozitat e kujdesit të Republikës për pozitën dhe të drejtat e popullit maqedonas për vendet fqinje. Dispozita e nenit 49 e Kushtetutës në memorandumin grek është i kualifikuar si përpjekje për përzierje në punët e brendshme të vendeve fqinje në kontekst të “statusit dhe pozita e gjojave pakicave”. Në vazhdim të asaj, qeveria greke citoj shembuj të qarkullimit masiv të hartave të Maqedonisë së Bashkuar, propagandës armiqësore dhe literaturë e cila “uzurpon” trashëgiminë greke si dhe simbolet, përdorimin e simbolit të dinastisë maqedonase antike...gjithashtu ka qenë e theksuar se përdorimi i termit “Republika e Maqedonisë” tregon një ekskluzivitet dhe monopolizim i përdorimit të termit Maqedoni dhe se përdorimi i tillë ekskluziv i termit në emrin zyrtar do të paraqet stimul për kërkesa ekspansioniste jo vetëm e atyre ekzistuese por edhe të gjeneratave të ardhshme të “Shkupit”.⁴⁴

⁴² Докмановиќ, м-р, Мишо, Грчкиот и македонскиот меморандум за приемот на Македонија во ООН, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 245.

⁴³ Ро ату, fq. 245; Оваа забелешка се однесува на повикот за обединување содржан во *Манифестот на АСНОМ: „Македонци под Бугарија и Грција! Обединението на целиот македонски народ зависи од вашето учество во гигантскиот антифашистички фронт. Само со борба против подлиот фашистички окупатор ќе го спечалиме правото на самоопределување и обединение на целиот македонски народ под покровот на Титова Југославија, која стана слободна заедница на слободни и рамноправни народи,*.. В. Документи за борбата на македонскиот народ за самостојност и национална држава – том први (1981), Скопје; Универзитет „Св. Кирил и Методиј“.

⁴⁴ Докмановиќ, м-р, Мишо, Грчкиот и македонскиот меморандум за приемот на Македонија во ООН, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 247; cituar sipas: Memorandum

Duke pasur parasysh rëndësinë e shfaqjes së qëndrimeve greke, si dhe faktin se memorandumimi ka qenë dorëzuar të gjithë anëtarët e OKB-së të cilët in ultima linea duhej të vendosnin për këkesën maqedonase për anëtarësim. Ministria maqedonase për punë të jashtme me 3 Shkurt 1992 u drejtua me një Memorandum në lidhje me pranimin e Republikës së Maqedonisë në OKB. Memorandumimi maqedonas⁴⁵ paraqiste përgjigje mbi pozicionin grek, të prezantuar në Memorandumin e 25 janarit të vitit 1992 edhe atë mbi të gjitha bazat: çështja e procedurës juridike për pranim në OKB, çështje mbi ndikimin e pranimin të Maqedonisë mbi sigurinë e rajonit, çështja e emrit, pretendimet territoriale dhe ekspansionit por edhe procedura e pavarësisë së shtetit dhe njohja e saj ndërkombëtare. Sa i përket procedurës juridike të pranimin në OKB, në këtë memorandum, Maqedonia e shfaqti qëndrimin se i plotëson të gjitha kriteret për pranim në anëtarësim të OKB-së, të parapara në nenin 4 të Kartës. Përveç asaj, në memorandumin maqedonas ka qenë e nënvizuar se nuk ekziston bazë legale dhe procedurale që një shtet ta pengojë ose ta mbikushtëzojë pranimin e vendit tjetër në OKB, për shkak të “çështjeve kyçe të caktuara” dhe se e njëjta është në kundërshtim me parimet e OKB-së dhe të principit të përgjithshëm të organizatës. Gjithashtu, qëndrimi se problemet duhet të zgjidhen para pranimin të shtetit në anëtarësi të OKB-së, nga ana e Maqedonisë ka qenë e vlerësuar si e papranueshme, me çka shteti “mbahet në pozita të pabarabarta”. Edhe përkaj të gjithave, Republika e Maqedonisë nuk arriti t’i përfitojë vendet kyçe të Këshillit të Sigurimit nga ana e saj. Në fillim të shkurtit të vitit 1992, Britania e Madhe, Franca dhe Spanja në emër të BE-së ia dorëzuan Këshillit të Sigurimit propozimin për pranim të vendit për anëtarësi në OKB me emrin “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”. Ky propozim, më vonë u pranua edhe nga SHBA. Edhe përkaj aktiviteteve intezive diplomatike nuk erdhi deri te ndryshimi i propozimit për pranim të Republikës së Maqedonisë për anëtarësim në OKB nën referencën e përkohshme “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”. Për atë arsye, kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Branko Crvenkovski me 24 mars 1993 drejtoi letër deri te kryetari i Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Në këtë letër, e shprehu pakënaqësinë nga pafuqia e Këshillit të Sigurimit që të miratojë një rezolutë për pranim të vendeve të reja në OKB. Në atë kontekst, kryeministri theksoi se

Reflecting the View and Position of the Government of Greece Concerning the Application of the former Yugoslav Republic of Macedonia for Admission to the United Nations, *New York; 25 January 1992.*

⁴⁵ По ату, fq. 248; cituar sipas: Андоновски З., „Меморандум на Македонија наречен „најдрска провокација“, грчка реакција на новиот потег на македонската дипломатија, во весникот *Нова Македонија* (6 февруари 1993).

Republika e Maqedonisë në asnjë rast nuk do ta pranojë referencën “Ish Republika e Maqedonisë”.⁴⁶

Ditën e ardhshme, ministri grek i punëve të jashtme, Mihalis Papakonstantinu deri te Këshilli i Sigurimit drejtoi letër me çka propozoi se Propozim-Rezoluta në lidhje me kërkesën e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë për anëtarësi në OKB paraqet bazë të pranueshme për pranim. Përveç asaj, ministri grek theksoi se zgjidhja e kontestit rreth emrit, miratimi i masave adekuate për ndërtim të besimit dhe pranimit të shtetit në anëtarësi në OKB nën emrin e përkohshëm janë pjesë integrale e pakos e cila në mënyrë të vetme mund t’i zgjidh “dallimet kyçe” mes Greqisë dhe Republikës së “re”. Gjithashtu, ministri grek e përcolli seriozitetin për kujdes të qeverisë greke në lidhje me problemet të cilët mund të dalin nga vendosja e flamurit me diell të Vergjinës (Kutleshit) në OKB.⁴⁷

Si rezultat i pajtueshmërisë së Greqisë, Këshilli i Sigurimit të OKB-së e miratoi Rezolutën 817/93 me të cilën i propozoi Parlamentit të përgjithshëm që ta pranojë në anëtarësi të OKB-së shtetin i cili për të gjitha nevojat e organizatës përkohësisht do të emërtohet si “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”, deri në zgjidhjen e dallimeve që u paraqitën rreth emrit të shtetit.⁴⁸ Pas miratimit të Rezolutës, kryetari i Këshillit të Sigurimit e lexoi deklaratën në të cilën ishte theksuar se referenca “Ish Republika Jugosllave” në rezolutë nuk përçon kurrfarë implikime se shteti të cilit i referohet ka çfarëdo lidhje me Republikën Socialiste të Jugosllavisë (Serbia dhe Mali Zi) dhe se ajo vetëm e pasqyron faktin historik se ky shtet në të kaluarën ka qenë Republikë në ish Federatën Socialiste të Republikës së Jugosllavisë. Mbi bazën e propozimit të Këshillit të Sigurimit, Parlamenti i përgjithshëm i OKB-së me 8 Prill të vitit 1993 e solli Rezolutën 47/225 me të cilën Republika e Maqedonisë u pranua si anëtarja e 181 e OKB-së.⁴⁹

Mbi bazën e këtyre ngjarjeve të zhvilluara, mund të konkludojmë se me sjelljen e rezolutës 817/1993 Këshilli i Sigurimit dhe rezoluta 47/225 (1993) e Parlamentit të Përgjithshëm është lënduar neni 4 paragrafi 1, si dhe neni 2 paragrafi 1 dhe 7 e Kartës dhe se qëndrimet e

⁴⁶ Докмановиќ, м-р, Мишо, Грчкиот и македонскиот меморандум за приемот на Македонија во ООН, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 250; cituar sipas: Letter from the President of the Government of the Republic of Macedonia addressed to the President of the Security Council, *Skopje*; 5 April 1993 (UN Doc. S/25542, Annex).

⁴⁷ Po aty, fq. 251; cituar sipas: Letter from the Minister for Foreign Affairs of Greece addressed to the President of the Security Council, 6 April 1993.

⁴⁸ Po aty, fq. 251; cituar sipas: UN Security Council *Resolution 817/93*.

⁴⁹ Po aty, fq. 251, cituar sipas: UN General Assembly *Resolution 47/225*.

grekëve në lidhje me emrin e Maqedonisë nuk janë edhe aq të bazuara juridikisht, për shkak se është vënë në pikëpyetje respektimi sa i përket mbrojtjes së pavarësisë politike të shteteve si dhe anëtarësimi i Maqedonisë në OKB nën emrin referues nënkupton shkelje e principit të barazisë së shteteve.⁵⁰ Gjithashtu, mund të konkludojmë se janë shkelur edhe një sërë çështjesh tjera sa i përket anëtarësimin të Maqedonisë në OKB, duke pasur parasysh kushtet plotësisht që është dashur ajo t'i plotësojë, vënia në pikëpyetje e sovranitetit të shtetit vis a vis me procedurat e pranimit të shteteve tjera pas anëtarësimin të saj si dhe e drejta e mospërzierjes në punët e brendshme të shteteve tjera.⁵¹

Së fundmi, duke pasur parasysh statusin diskriminues të Maqedonisë në OKB në aspekt të emrit e njëjta nuk mund të vazhdojë deri në pafundësi dhe se vullneti i zgjedhjes së emrit të shtetit, si e drejtë inherente nuk mund të kufizohet me mjete si dhe instrumente të pjesës dispozitive të së drejtës ndërkombëtare.⁵²

1.3.2. Zgjidhja e emrit para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe vendimi i saj

Sipas profesoreshës së të drejtës ndërkombëtare publike, Tatjana Petrushevka, kërkesat e Republikës së Greqisë në raport me Republikën e Maqedonisë rreth çështjes së emrit jo vetëm që janë të pabazuara sipas së drejtës ndërkombëtare, por edhe thyejnë një sërë principesh themelore dhe rregullave të së drejtës ndërkombëtare. Bëhet fjalë për kërkesa që i referohen një të drejtë të brendshme (emri i shtetit) që është ekskluzivisht në kompetencë të brendshme të RM-së, me çka, në esencë, Republika e Greqisë përzihet në punët e brendshme të Republikës së Maqedonisë.⁵³

Ndërkaq, sipas profesoreshës Tatjana Petrushevka dhe Marjan Popevskit, Republika e Greqisë, interesin kyç nacional në raport me Republikën e Maqedonisë e realizon përmes një sërë nëninteresa të cilët më lidhje me çështjen kryesore janë të instrumentalizuara si: ndryshimi i flamurit të shtetit maqedonas, tërheqja nga përkujdesja e pakicave maqedonase në Republikën e Greqisë, pranim në OKB nën referencën e përkohshme të Ish-Republikës Jugosllave

⁵⁰ Për më tepër shih: Јанев, Проф., Д-р, Игор, Стратегија за прашањето на користење на уставното име на Република Македонија во ОН, МКД, 24 јули 2020, линку në dispozicion: <https://www.mkd.mk/kolumni/strategija-za-prashanjeto-na-koristenje-na-ustavnoto-ime-na-republika-makedonija-vo-on>, (25.04.2020).

⁵¹ По ату.

⁵² По ату.

⁵³ Петрушевска, д-р, Татјана, Името пред Меѓународниот суд за правда, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 305.

të Maqedonisë, lidhjen e Marrëveshjes së Përkohshme për normalizim të raporteve mes dy shteteve, ndërmarrja e detyrave për kryesim të negociatave për ndryshimin e emrit kushtetues – Republika e Maqedonisë, mospranimi në anëtarësi të koalicionit ushtarak NATO, për shkak të vendosjes së veto-s nga ana e Republikës së Greqisë dhe frenim të procesit për anëtarësim në koalicionin ekonomik – BE, për të njëjtën arsye, për shkak të vendosjes së veto-s nga ana e Republikës së Greqisë, etj.⁵⁴ Pra, nuk bëhet fjalë për këkesa juridike, për qëndrime të bazuara mbi të drejtën ndërkombëtare, por për interes politik “të lakuriqësuar” të Republikës së Greqisë që në kufirin verior të saj të mos ekzistojë një subjekt që në emrin e saj zyrtar do ta përdor emrin “Maqedonia”, me arsyetimin se ky emër paraqet pretendime territoriale drejt Greqisë. Përkundrazi, insistimi i Republikës së Maqedonisë ishte që përdorimi i cilido emër në trafikun ndërkombëtar, përfshirë edhe emrin Maqedonia, vetvetiu as edhe faktikisht nuk është e as nuk mund të bëhet faktor për rrezikimin e sigurisë së dikujt, e aq më pak të mbijetesës dhe se ai i cili e problematizon këtë çështje sjell në pikëpyetje një sërë principesh themelore të ius cogens të së drejtës ndërkombëtare publike mbi të cilët mbështetet bashkësia ndërkombëtare si: vetëvendosja e popujve, kompetenca ekskluzive e punëve të brendshme të shteteve, barazia e shteteve sovrane, janë padyshim kriteret më relevante të cilët e “betonojnë” kontestin si të drejtë par excellance.⁵⁵

Në këto rrethana, vlerësovan se Republika e Maqedonisë duhet të mbështetet në të drejtën ndërkombëtare dhe të kërkojë zgjidhje përpara Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Çështja që parashtrohet këtu sipas profesoreshës, Tatjana dhe Popeski është se e njëjta pamundësohet nga Marrëveshja e Përkohshme. Pra, sipas nenit 5 të Marrëveshjes palët dhe të dy shtetet kanë marrur përsipër detyrimin që t’i zgjasin negociatat nën mbikëqyrjen e sekretarit gjeneral të OKB-së mbi Rezolutën 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit. Pra, sipas nenit 21 të Marrëveshjes të gjitha kontestet që rrjedhin nga implementimi i Marrëveshjes mund të dorëzohen për zgjidhjen e tyre përpara Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, përveç kontesti

⁵⁴ Петрушевска, Проф., Д-р., Татјана; Попевски, м-р, Марјан, Моргентау и спорот меѓу Република Македонија и Република Грција, Македонски Политиколошки Форум, е-Зборник на трудови, Year II, Number 5, September 2015, стр. 20; cituar sipas: Petrushevska T., во едисијата на Skaric S., Apasiev D., Patchev V., The Name Issue: Greece and Macedonia, Matica Makedonska, Скопје, 2009, стр. 250, et. seq.

⁵⁵ Петрушевска, д-р, Татјана, Името пред Меѓународниот суд за правда, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 306.

në lidhje me emrin.⁵⁶ Si pasojë e kësaj, duke pasur parasysh atë periudhë të situatës së rënduar mes Republikës së Maqedonisë dhe Greqisë, ku gjasat rreth zgjidhjes së mosmarrëveshjes në të ardhmen e afërt ishin shterrur dhe se aktiviteti diplomatik ishte shpenzuar, të dyja palët erdhën në përfundim se mungon vullneti i mirë dhe i nevojshëm i palës tjetër. Kombinimi i provokimeve të Shkupit, duke filluar me emrin e aeroportit dhe shkelja nga Athina e Marrëveshjes së Përkohshme në Bukuresht, ka zvogëluar vesimin e dyanshëm në nivel që nuk është parë për më shumë se një dekadë. Duke pasur parasysh këtë atmosferë helmuese, në nëntor 2008, qeveria maqedonase e paditi Greqinë në Gjyqin Ndërkombëtar të Drejtësisë (GjND) për shkelje të Marrëveshjes së Përkohshme.⁵⁷ Shkupi kërkoi nga GjND-ja që ta urdhërojë Greqinë të respektojë marrëveshjen e vitit 1995 dhe “të pushojë së insistuari nga kundërshtimi i çfarëdo mënyre, drejtpërdrejtë apo tërthorazi”, i anëtarësisë së Maqedonisë në NATO apo në cilëndo organizatë tjetër ndërkombëtare.⁵⁸ Athina u përgjigj duke thënë se, me dorëzimin e rastit para GjND-së, Shkupi po demonstronte se nuk ishte i interesuar në zgjidhjen e shpejtë të mosmarrëveshjes rreth emrit. Ajo gjithashtu pohoi se Maqedonia vetë e kishte shkelur disa herë Marrëveshjen e Përkohshme⁵⁹, duke riemëruar aeroportin e Shkupit, pastaj me përdorimin nga Shkupi brenda OKB-së të emrit të saj kushtetues, e jo emrit të përkoshëm, si shkelje e frymës së saj,⁶⁰ me ç’rast në fund të dhjetorit të vitit 2008, Athina dorëzoi kundër-padi para GjND-së rreth shkeljeve të tilla të Marrëveshjes.⁶¹

Gjyqi i Hagës, zyrtarisht solli aktgjykim në lidhje me padinë e Maqedonisë kundër Greqisë dorëzuar përpara kësaj gjykate me qëllim që të dëshmojë se fqiu i saj jugor e ka shkelur Marrëveshjen e Përkohshme, me çka e ka bllokuar pranimin e vendit në NATO në samitin e vitit 2008. Gjykata, fillimisht me 14 vota për dhe 2 kundër, konfirmoi se ka kompetencë të veprorë në rastin e filluar të Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë të vitit 2008. E dyta, me 15 vota për dhe 1 kundër, konfirmoi se Republika e Greqisë, me kundërshtimin për pranimin e Ish-

⁵⁶ Петрушевска, Проф., Д-р., Татјана; Попевски, м-р, Марјан, Моргентау и спорот меѓу Република Македонија и Република Грција, Македонски Политиколошки Форум, е-Зборник на трудови, Year II, Number 5, September 2015, стр. 20.

⁵⁷ Për më tepër shih: Emri i Maqedonisë: Zgjidhja e nyjes, Briefing i Grupit të Krizave për Evropë Nr. 52, Prishtinë/Bruksel, 12 janar 2009, fq. 9.

⁵⁸ Po aty, fq. 10; cituar sipas: Deklaratës për shtyp, GjND, 17 nëntor 2008, www.icj-cij.org/docket/files/142/14881.pdf; Po ashtu shih në: *Balkan Insight*, BIRN, 17 nëntor 2008, <http://balkaninsight.com/en/main/news/14845>;

⁵⁹ Po aty, fq. 10; cituar sipas: Deklaratës së ministrisë së jashtme greke, raportuar në *Kanal 5*, 17 nëntor 2008.

⁶⁰ Po aty, fq. 10, 11; cituar sipas: letrës së 27 nëntorit nga përfaqësuesi i përhershëm i Greqisë në OKB për Sekretarin e Përgjithshëm.

⁶¹ Po aty, fq. 11, cituar sipas: A1 televizioni, 28 dhjetor 2008.

Republikës Jugosllave të Maqedonisë në NATO, i ka shkelur detyrimet në përputhje me nenin 11, paragrafi 1 të Marrëveshjes së Përkohshme. E treta, me 15 vota për dhe 1 kundër, i refuzoi të gjitha parashtrirat tjera të dorëzuara nga Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë.⁶²

Sipas arsytimit të aktgjykimit e cila kishte zgjatur rreth një orë, gjykata ka refuzuar një numër të madh të argumenteve të palës së paditur, përkatësisht Greqisë mes së cilës edhe atë se është shkelur marrëveshja përgjigja e së cilës ka qenë se shkelje paraprake të marrëveshjes ka bërë Maqedonia si dorëzues i padisë. Si shkelje të vetme të marrëveshjes, të konfirmuar nga gjykata, Maqedonia e ka shkelur në vitin 2004 si rezultat i përdorimit të simboleve të palës kundërshtarë, por ajo nuk e vlerësoi si argument të mjaftueshëm që të bllokohet anëtarësimi i vendit në organizata ndërkombëtare. Nuk ka pasur shkelje as në pjesën e vullnetit të mirë që të kërkohet zgjidhje në lidhje me kontestin dhe nuk gjeti përgjegjësi në asnjërën prej palëve, për shkak se deri tani nuk kishin arritur deri te zgjidhja e kontestit, i cili ishte në kompetencë të OKB-së.⁶³ Gjkata vendosi që Greqia e ka shkelur Marrëveshjen e Përkohshme, por nuk i pranoi edhe kërkesë paditë e Republikës së Maqedonisë që e detyrojnë Greqinë që mos ta pengojë anëtarësimin e mëtutjeshëm të Maqedonisë në të ardhmen në organizatat e ndryshme ndërkombëtare (posaçërisht në NATO dhe BE), me mirëbesim se Greqia me vullnet të mirë do t'i kryejë të gjitha detyrimet e veta ndërkombëtare juridike.⁶⁴

1.3.3. Karakteri dhe efektet e Marrëveshjes së Përkohshme

Kontesti për emrin Maqedonia aktualizohet pas pavarësisë së Maqedonisë në vitin 1991 kur Greqia e kundërshtoi përdorimin e emrit Maqedonia nga ana e Republikës së Maqedonisë, duke u thirrur në shkaqe historike dhe territoriale. Greqia atëherë konsideronte se ka të drejtë ekskluzive ta përdorë emrin për provincën e saj Maqedonia si dhe për banorët e saj. Edhe pse Maqedonia përmes Komisionit të Arbitrazhës të ish-Jugosllavisë, i plotësoji kushtet për njohje të pavarësisë (së bashku me Slloveninë), Greqia e bllokoi njohjen nga ana e Bashkimit Evropian, si dhe pranimin në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Më 27 Qershor 1992, BE e atëhershmit

⁶² Грција ја прекршила Времената Спогодба, Радио Слободна Европа, 05 декември 2011, linku në dispozicion: <https://www.slobodnaevropa.mk/a/24411989.html>, (25.04.2020).

⁶³ По аты.

⁶⁴ Për më tepër shih: Петрушевска, Проф. Д-р. Татјана; Попевски, м-р, Марјан, Моргентау и спорот меѓу Република Македонија и Република Грција, Македонски Политиколошки Форум, е-Зборник на трудови, Year II, Number 5, September 2015, стр. 21; ose aktgjykimin e GJND-së në linkun në dispozicion: <https://www.icj-cij.org/files/case-related/142/142-20111205-JUD-01-00-EN.pdf>; (25.04.2020).

(BEE) nën ndikimin e Greqisë në të ashtuquajturën Deklaratën e Lisbonës, ofroi njohje “nën emrin në të cilën nuk do ta përmbajë fjalën Maqedonia”. Përskaj asaj, Greqia në periudhën e vitit 1992-1995 dy herë e bllokoi kufirin greko-maqedonas për çfardo lloj tregtije, me qëllim që të ushtrojë presion mbi Republikën e Maqedonisë.⁶⁵

Në këto rrethana, duke u thirrur në principet e paprekshmërisë së kufijve dhe integritet territorial të shteteve si dhe duke i pasur parasysh dispozitat e OKB-së të cilët i referohen detyrimeve të shteteve në marrëdhëniet ndërkombëtare që të përmbahen nga kërcënimet si dhe nga përdorimi i forcës kundër integritet territorial ose pavarësisë politike, dëshirës për aprovimin e kufijve ndërmjet shteteve si kufi ndërkombëtarë si dhe duke u thirrur në detyrimin e mospërzierjes së punëve të brendshme të tjetrit dhe për zhvillimin e marrëdhënieve paqësore, ministri grek i punëve të jashtme, Karlos Papulas, si përfaqësues i Greqisë si dhe ministri maqedonas i punëve të jashtme, Stevo Crvenkovski, si përfaqësues i Republikës së Maqedonisë më 13 Shtator 1995 me ndërmjetësim të përfaqësuesit special të sekretarit të përgjithshëm të OKB-së Sajrus Vens, u pajtuan për raporte miqësore dhe ndërmarrjen e masave për ndërtimin e mirëbesimit, me ç’rast e nënshkruajtën Marrëveshjen e Përkohshme mes Republikës së Greqisë dhe Republikës së Maqedonisë.⁶⁶

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshje, u pajtuan për aprovimin e kufijëve të përbashkët ekzistues, si kufijë të ndërkombëtarë të përhershëm dhe të paprekshëm si dhe çdo palë e kësaj marrëveshje duhet ta respektojë sovranitetin, integritetin territorial si dhe pavarësinë politike.⁶⁷ Me anë të kësaj marrëveshje, palët u pajtuan që t’i vazhdojnë negociatat nën mbikëqyrjen e sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, sipas Rezolutës 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit, me qëllim që të arrihet një marrëveshje për dallimet e theksuara në Rezolutën në fjalë si dhe në Rezolutën e 817 (1993) të Këshillit të Sigurimit. Çështje me rëndësi e kësaj marrëveshje është se Republika e Maqedonisë me anë të kësaj marrëveshje nuk guxon të interpretojë asgjë nga Kushtetuta e saj së bashku me Preambulën si dhe nenin 3 të saj, gjithçka që paraqet ose ndonjëherë do të paraqet bazë për kërkesa territoriale që nuk janë pjesë

⁶⁵ Сте ја прочитале ли Времената спогодба помеѓу Македонија и Грција?, ПРАВДИКО, 21.11.2013, linku në dispozicion: <https://www.pravdiko.mk/842/>, (26.04.2020).

⁶⁶ Пër më tepër shih: Привремена спогодба меѓу Република Македонија и Република Грција, Њујорк, 13 септември 1995 година.

⁶⁷ По аty, neni 2 dhe 3 i Marrëveshjes së Përkohshme.

përbërëse e kufirit të saj ekzistues. Ajo gjithashtu me anë të kësaj marrëveshje është deklaruar se asgjë nga Kushtetuta e saj, posaçërisht neni 49 i saj, nuk duhet të interpretohet se paraqet ose ndonjëherë do të paraqet bazë për përzierje në punët e brendshme të shtetit tjetër, me qëllim që ta ruajë statusin dhe të drejtat e personave në shtete tjera, të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Maqedonisë.⁶⁸ Gjithashtu me anë të kësaj marrëveshje, sidomos pas hyrjes në fuqi të saj, Republika e Greqisë është pajtuar që mos ta kontestoj thirrjen për anëtarësim ose anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare, multilaterale dhe regjionale në të cilën Republika e Greqisë është anëtare, por me të drejtën që Republika e Greqisë ta mbajë të drejtën që të kontestojë çdo anëtarësimin të saj, nëse në organizatave të tilla ose institucioneve u drejtohet ndryshe nga ajo që është paraparë në Rezolutën 817 (1993) të Këshillit të Sigurimit.⁶⁹ Në nenin 21 të dispozitave përfundimtare të marrëveshjes në fjalë është paraparë edhe kompetenca e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në rast se paraqiten dallime ose konteste mes palëve nënshkruese të marrëveshjes në lidhje me interpretimin ose gjatë implementimit të Marrëveshjes së Përkohshme, me përjashtim të nenit 5, paragrafi 1 të Marrëveshjes së Përkohshme, që ka të bëjë për çështjen e emrit gjë që edhe këtë çështje si dhe të tjerat sa i përket respektimit, implementimit dhe shkeljes së saj i kemi konsumuar gjatë nënkapitujve paraprakë.⁷⁰

⁶⁸ Për më tepër shih: Привремена спогодба меѓу Република Македонија и Република Грција, Њујорк, 13 септември 1995 година, член 6.

⁶⁹ По ату, neni 11 i Marrëveshjes së Përkohshme.

⁷⁰ По ату, neni 21 i Marrëveshjes së Përkohshme.

KAPITULLI I DYTË

PROPOZIMET PËR ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES SË EMRIT

2.1. Propozimet e Grupit Ndërkombëtar të Krizave

Sipas shënimeve formale institucionale, Grupi Ndërkombëtar i Krizave (GNK) është shembull shkollor i një organizate ndërkombëtare joqeveritare.⁷¹ Në shikim të parë të painformuarit do të përfundonin se bëhet fjalë më tepër për një “bishtajë” në skenën ndërkombëtare e cila përpiqet që “të sigurojë një kafshatë buke” në fatkeqësinë e dikujt. Pra, ajo nuk është subjekt i së drejtës ndërkombëtare. Në fund të fundit ajo do të thotë se vendimet që i sjell, çfarëdo qofshin për nga përmbajtja, nuk kanë fuqi të detyrueshme juridike për asnjë subjekt të së drejtës ndërkombëtare, përkatësisht, asnjë subjekt i së drejtës ndërkombëtare nuk mundet të thirret në përgjegjësi të së drejtës ndërkombëtare përpara institucioneve kompetente gjyqësore për shkak të mosrespektimit të dokumenteve/vendimeve të kësaj organizate. Megjithatë, në kuptim material substancial kjo organizatë është aktor në skenën ndërkombëtare, përkatësisht subjekt në politikën ndërkombëtare.⁷²

Raporti i Grupit Ndërkombëtar të Krizave mbi Ballkanin me numër 122 i 10 Dhjetorit 2001, mban titullin: “Emri i Maqedonisë: përse është i rëndësishëm dhe si mund të zgjidhet” dhe është i treti në vazhden e raporteve të cilën kjo organizatë i nxorri analizat e veta mbi krizën të cilën e kaploi Republikën e Maqedonisë në fillim të viteve 2001.⁷³ Raporti përmban 33 faqe tekst dhe ka 88 fusnota. Bëhet fjalë për material analitik, i shkruar mbi bazën e më tepër burimeve: analiza të shtypit, intervista me personalitete të caktuara, vëzhgim aktiv të gjendjes së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe konsultim i literaturës së caktuar relevante mbi kontestin e emrit.⁷⁴

Raportin e 10 Dhjetorit të vitit 2001 e karakterizojnë disa cilësi: e para, bëhet fjalë për një dokument më voluminoz për dallim nga dy raportet paraprake, e dyta, ky shënim formal i

⁷¹ Петрушевска, Д-р., Татјана, Зошто и покрај се, употреба на поимот „спор„?, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 307; cituar sipas: Lobasso F.-Martini K. – Oriani S., Organizzazione internazionale: il diritto e le istituzioni delle organizzazioni internazionali, Edizione Simone, Napoli, 1997; pp. 59 et. seq..

⁷² Po aty, fq. 307.

⁷³ Po aty, fq. 309, 310.

⁷⁴ Шкарик, Д-р., Светомир, Составот на МКГ и предлогот за Словенска транскрипција на името, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 297; cituar sipas: Името на Македонија: Зошто е важен спорот и како да се разреши, МКГ, 10 декември 2001, Скопје-Брисел, стр. 3-33.

raportit është i lidhur drejtpërdrejtë me gjërësinë e elaborimit të problematikës në të. Ka përmbajtje të ngjashme me raportet paraprake të kësaj organizate mbi politikën aktuale dhe sigurinë në RM. Megjithatë, pjesët tjera të raportit, janë plotësisht të reja, për herë të parë janë lënde e analizës së GNK. Në esencë, bëhet fjalë për analizë të kontestit të emrit kushtetues të RM (shfaqja e saj, zhvillimi i saj, kërkesat dhe qëndrimet e GNK-së, si dhe qëndrimet e RM në lidhje me atë, etj.)⁷⁵ Ky raport është më i largët se cilido dokument tjetër i saj kushtuar RM më parë. Gjërësia e saj konsiston në analizën e përmbajtjes në të dhe lidhet edhe me thellësinë që e tejkalon atë të rëndomtën, sipërfaqësoren, rishikimin deskriptiv i kontestit ndërkombëtarë rreth emrit kushtetues të RM,⁷⁶ deri në paraqitjen konkrete të propozimeve për zgjidhjen/tejkalimin e kontestit si dhe në rishikimin e problemeve tjera që i prekin akoma problemet e hapura me Republikën e Maqedonisë me Republikën e Bullgarisë dhe Republikën e Serbisë rreth simboleve maqedonase, përkatësisht të Republikës së Maqedonisë me Republikën e Shqipërisë dhe me Republikën e Bullgarisë rreth statusit të përkatësisë së pakicave maqedonase.⁷⁷

Propozimet e Grupit Ndërkombëtar të Krizave përmbajnë tri elemente kryesore të cilët do të hynin në fuqi njëkohësisht:

- Marrëveshja bilaterale mes Shkupit dhe Athinës e cila përmban kompromis për ankesat greke;
- Nota diplomatike nga shtetet anëtare të BE-së dhe NATO-s si dhe nga të tjerët të cilët e njohin emrin Republika e Maqedonisë (Republika Makedonija) si dhe kushtet e marrëveshjes bilaterale, me premtimin se do të konsultohen me Greqinë për masa adekuate të cilët do të zbatoheshin përderisa do të shkelej marrëveshja.
- Pranim dhe përdorim të emrit Republika e Maqedonisë (Republika Makedonija) në gjuhën maqedonase për të gjitha nevojat e punës nga ana e OKB-së dhe organizatave tjera ndërqeveritare.⁷⁸

Para se të pranohet emri “Република Македонија,, do të ishte e arsyeshme për bashkësinë ndërkombëtare që më përpara të kërkojë prej Maqedonisë së paku dy lëshime lidhur me Marrëveshjen Kornizë edhe atë: Shkupi të kërkojë prej NATO-s ta vazhdojë misionin e

⁷⁵ Për më tepër shih: Петрушевска, Д-р., Татјана, Зошто и покрај се, употреба на поимот „спор,,?, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 309, 310.

⁷⁶ По ату, fq. 310.

⁷⁷ По ату, fq. 310.

⁷⁸ Името на Македонија: Зошто е важен спорот и како да се разреши, МКГ, Извештај за Балканот бр. 122, Скопје/Брисел, 10 декември 2001, стр. 19.

tyre edhe gjashtë muaj pas marsit të vitit 2002 dhe Shkupi të kërkojë nga OSBE që ta vazhdojë misionin e saj edhe 12 muaj të tjerë pas dhjetorit të vitit 2001 dhe ta rris dukshëm rolin e tyre të zgjedhjeve.⁷⁹

Në elementin numër një përfshihet marrëveshja bilaterale për kompromiset që duhet t'i bëjë Athina pas marrjes së sinjaleve të gatishmërisë nga ana e bashkësisë ndërkombëtare që të kalojnë në zgjidhjen e çështjes dhe pas lidhjes së marrëveshjes që do ta përmban kompromisin maqedonas:

1. Maqedonia pranon që Republika e Greqisë ta përdor emrin "Maqedonia e Epërme" dhe "Maqedonasit e epërm" (ose ndonjë formulim të ngjashëm), e cila do t'i përket Republikës së Maqedonisë dhe popullit të saj, në të gjitha raportet me të, përfshirë edhe organizatat multilaterale;
2. Të dyja palët lidhen që mos ta pengojnë përdorimin e emrit "Maqedonia" ose "Maqedonas" në çdo formë në kontekst tregtar në lidhje me prodhimet ose shërbimet të cilët vijnë nga Republika e Greqisë ose nga Republika e Maqedonisë;
3. Maqedonia lidhet të sigurojë deklaratë formale parlamentare për çështjet kulturore dhe historike të cilët: e theksojnë rreshtimin formal maqedonas, si anëtar i UNESCO-s si dhe nënshkruese e konventave relevante ndërkombëtare që ta respektojnë dhe ruajnë trashëgiminë e traditës greke në kuadër të territorit të Republikës së Maqedonisë dhe të drejtat e trashëgimisë kulturore të të gjithë popujve të cilët e popullojnë rajonin gjeografik të Maqedonisë dhe premtan se do ta inkurajon plotësisht bashkëpunimin në frymën më të lartë të shkencës dhe zbulimit të së vërtetës, në forumet akademike rajonale dhe ndërkombëtare për avancimin e kuptimit të përbashkët të historisë (antike, mesjetare dhe moderne), të rajonit gjeografik të Maqedonisë të të gjitha popujve të tyre;
4. Pranimi i dispozitave të Marrëveshjes së Përkohshme të cilët përfshijnë: detyrim të përheshëm të të dyja palëve sipas paragrafit 1 të nenit 7 të Marrëveshjes së Përkohshme, për ndalim të propagandës së kontrolluar shtetërore dhe mosinkurajim të personave privat të cilët stimulojnë dhunë, urrejtje ose armiqësi; detyrim të të dyja palëve për përdorimin e simboleve të cilët janë pjesë e trashëgimisë historike dhe kulturore sipas paragrafit 2 dhe 3 të nenit 7 të

⁷⁹ Името на Македонија: Зошто е важен спорот и како да се реши, МКГ, Извештај за Балканот бр. 122, Скопје/Брисел, 10 декември 2001, стр. 19.

Marrëveshjes së Përkohshme; dhe të gjitha dispozitat tjera të Marrëveshjes së Përkohshme përveç atyre për të cilët edhe të dyja palët pajtohen se më nuk janë të zbatueshme. Ajo d.m.th. se masat praktike do të vazhdojnë të vlejné në lidhje me automjetet dhe pasaportat.

5. Të thirret UNESCO, Këshilli i Evropës ose ndonjë palë tjetër që pajtohet (p.sh. ndonjë bordë i pavarur ekspertësh) që ta studiojnë planin arsimor maqedonas, në veçanti në lëndët e historisë dhe gjeografisë, që të sigurohet mbështetja drejt standardeve ndërkombëtare dhe a është në pajtueshmëri ose në frymën e kornizave të nenit 7 të Marrëveshjes së Përkohshme.

6. Maqedonia obligohet që të sigurojë deklaratë parlamentare formale e cila më tutje do ta sqaron nenin 49 të Kushtetutës (sipas së cilës Maqedonia “kujdeset për statusin dhe të drejtat e maqedonasve të cilët jetojnë në shtetet fqinje”) dhe neni 6 i Marrëveshjes së Përkohshme. Në sqarimin do të theksohej se pranimi i një statusi të tillë dhe të drejtë do të ishte i ashpër në përputhje me zakonet ndërkombëtare dhe në bashkëpunim me organizatat relevante ndërkombëtare.

7. Nëse do t’i fitonte të gjitha të drejtat sipas zakoneve ndërkombëtare të cilët i kushtohen kërkesave të mundshme të banorëve të saj ose të vet shtetit, Republika e Maqedonisë deklaron se ekzistimi i kësaj marrëveshje ose cila do qoftë dispozitë e saj, ose pranimi i emrit të saj kushtetues nga pala e tretë, nuk do ta interpretojë si platformë të vetme ose të zgjeruar të Republikës për sjelljen e kërkesave të tilla.⁸⁰

Në elementin numër dy përfshihet pranimi i emrit kushtetues nga ana e bashkësisë ndërkombëtare. Pra, vendet anëtare të NATO-s dhe BE-së dhe të tjerët do ta pranojnë formalisht këtë marrëveshje bilaterale përmes shkëmbimit të notave diplomatike me të dyja palët. Këto nota diplomatike do ta pranojnë “Republika e Maqedonisë” dhe njëkohësisht do t’i pranojnë kushtet e marrëveshjes bilaterale Athinë-Shkup. Ato gjithashtu do të premtojnë se do ta konsultojnë Greqinë mbi masat adekuate të cilët do të ndërmerren nëse do të shkelen kufijtë e përmbajtura në marrëveshje.⁸¹

Në elementin numër tre përfshihet OKB-ja dhe organizatat tjera ndërqeveritare që do ta miratojnë dhe do ta përdorin emrin “Republika Makedonija” për të gjitha qëllimet e punës. Së

⁸⁰ Për më tepër shih: Името на Македонија: Зошто е важен спорот и како да се разреши, МКГ, Извештај за Балканот бр. 122, Скопје/Брисел, 10 декември 2001, стр. 20, 21.

⁸¹ По аty, fq. 21.

këndejmji, emri formal në OKB dhe në organizatat tjera ndërqeveritare do të jetë emri kushtetues, “Republika Makedonija”, e shkruar në gjuhën maqedonase, në latinisht, ndërkaq emri i shkurtër (ose joformal) do të mbetet Republika e Maqedonisë – jo “Macedonia” ose “Makedonija” – dhe do të vendoset nën shkronjën “r” dhe jo “m” në regjistrin alfabetik. Greqia do të ketë të drejtë në OKB që ta përdor emrin “Maqedonia e Epërme” për shtetet ose “Maqedonasit e Epërm” për popullin (ose ndonjë emër të ngjashëm sipas marrëveshjes bilaterale me Maqedoninë) dhe të gjithë të tjerët do ta përdorin formën e mbiemrit “të Republikës së Maqedonisë” përveç kur bëhet fjalë për gjuhën ose popullin. Në atë rast forma e mbiemrit do të jetë “populli maqedonas” ose “gjuha maqedonase”. P.sh. “Këshilli i Sigurimit i dëshiron mirëseardhje përfaqësuesit të Republikës së Maqedonisë dhe ia uron festën kombëtare të popullit maqedonas.” ose “Greqia gjithashtu dëshiron t’ia urojë ditën kombëtare të përfaqësuesit të Republikës së Maqedonisë së Epërme dhe të popullit të Maqedonisë së Epërme.”⁸²

Në fund, raporti gjithashtu përmban edhe interesin e bashkësisë ndërkombëtare të cilët synojnë stabilizimin e Maqedonisë dhe janë të interesuar për implementimin e reformave afatgjate të nënshkruara në Ohër. Kjo nga ana e saj i jep bashkësisë ndërkombëtare shkak strategjik të punojë me Greqinë për gjetjen e mënyrës së pranimit të emrit kushtetues të Maqedonisë si çështje e stabilitetit rajonal. Sfida është përfundimtare që të tejkalohet prej zero-dinamikës dhe të gjindet një mënyrë për vërtetimin e identitetit maqedonas, pa mohuar atë të Greqisë dhe rikthimin e ankesave kryesore greke.⁸³

2.2. Modeli i “emrit të dyfishtë”

Formula e dyfishtë ose formula e Irlandës sipas Robin O’ Nil është e bazuar mbi zgjidhjen mes Irlandës dhe Britanisë së Madhe, sipas së cilës Irlanda mund ta quan Britaninë e Madhe me emër tjetër ndryshe nga ajo zyrtarja.⁸⁴

Emri i dyfishtë ishte njëra ndër propozimet që GNK-ja propozoi për Maqedoninë në raportin e saj të vitit 2001 si zgjidhje për kontestin me Greqinë. Ky raport edhe pse bëri bujë të

⁸² Името на Македонија: Зошто е важен спорот и како да се разреши, МКГ, Извештај за Балканот бр. 122, Скопје/Брисел, 10 декември 2001, стр. 21.

⁸³ По ату, fq. 18.

⁸⁴ Клековски, Сашо, Спорот за името Македонија (ставови на јавноста во Македонија), МЦМС, ИДЦС, Скопје, октомври 2011 г., стр. 9.

madhe mbi mënyrën e elaborimit dhe propozimeve rreth emrit për të cilin kishte opinionin dhe kritika të shumta, por si duket vetëm ky model fitoi atë kohë fitoi simpati tek pala maqedonase, përkundër grekëve që nuk pajtoheshin për një kompromis të tillë. Emri i dyfishtë, konsiston në përdorim të brendshëm të emrit kushtetues të Republikës së Maqedonisë si dhe në plan ndërkombëtar, ndërkaq Greqia pavarësisht se rreth cilit emër do të pajtohet, ajo do të ishte çështje irrelevante.

Kështu sipas profesorit Ljubomir Frçkoski, në raportin e GNK-së bëhet një hap para që pozicioni i Republikës së Maqedonisë, kreativiteti i saj si dhe politika e suksesshme dhe e përmbajtur “të mbindërtohet” me ç’rast propozohen amerikanët si aktor kryesor të një etape të re procedurale, me ç’rast çështja e modelit të emrit të dyfishtë (formula e vjetër e propozuar në vitin 1993) do të jetë bazë e qëndrimit ndërkombëtar për zgjidhjen e krizës, për shkak se pa formulë të dyfishtë për emrin, përkatësisht një emër në plan të brendshëm edhe atë ndërkombëtar do të ishte një situatë e rëndë për kompromis. Me formulën e dyfishtë, Maqedonia nuk duhet ta ndërrojë emrin, me atë e fiton të drejtën edhe në përdorim ndërkombëtar, përveçse në raport me Greqinë. Sipas tij, pa formulë të dyfishtë s’ka dalje.⁸⁵

Për profesorin Vllado Buçkovski, njëherit edhe ish kryetar i partisë maqedonase LSDM, vlerësoi se i kanë bërë dëm vetës që nuk i kanë kushtuar vëmendjen e duhur atëherë raportit, për shkak të realitetit dhe kompromisit që përmban ajo, mirëpo fajtor sipas tij kanë qenë ata të cilët nuk e kanë pranuar atë formulën e dyfishtë dhe kanë dhënë propozime vetëm një për një emër. Fatkeqësisht vlerëson ai se edhe Maqedonia nuk ka pasur gatishmëri dhe se për zgjidhjen e kontestit duhet pasur kompromis nga të dyja palët.⁸⁶ Ndërkaq, sipas Nikola Popovskit, modeli i emrit të dyfishtë është i pranueshëm për shkak se tashmë emrin “IRJM” 2/3 e shteteve në botë e përdorin atë, në mesin e të cilëve BE si dhe SHBA-të. Sipas tij është i pranueshëm për shkak se vetëm një emër universal si Maqedonia i shkruar në latinisht do ta njoh e gjithë bota. Mirëpo, problemi konsiston tek pala greke për shkak se ato e kontestuan zgjidhjen e emrit të Republikës së Maqedonisë dhe nuk mundohen aspak të gjejnë zgjidhje. Në esencë, Republika e Maqedonisë vetë diku në vitin 1995 kërkoi pajtueshmëri nga Republika e Greqisë për fillimin e

⁸⁵ Без двојна формула нема излез, интервју со проф. д-р Љубомир Д. Фрчковски, 25 мај 2002 година, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 331.

⁸⁶ Предлогот на МКГ е прифатлив за нас, интервју со проф. д-р Владо Бучковски, 15 април 2002 година, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 357.

zgjdhjes së kësaj çështjeje në mënyrën si është paraparë në raportin e GNK-së që Republika e Greqisë ta thërret Republikën e Maqedonisë me ndonjë emër tjetër, por që në të gjitha organizatat ndërkombëtare, Republika e Maqedonisë të njihet nën emrin e saj kushtetues si Republika e Maqedonisë.⁸⁷

Për palën shqiptare, Republika e Greqisë nuk ka edhe aq të drejtë sa është kapur aq për emrin, por ajo ka qëllime tjera. Më e qëlluar është për shkak se pjesa e egjeut të Maqedonisë asnjëherë nuk ka qenë greke. Ajo e ka përvetësuar dhe pretendon se edhe pjesët tjera të uzurpuara duhet të ndahen dhe se për zgjidhjen e kontestit e shfrytëzon ndikimin e saj. Kështu vlerëson Sejfedin Haruni, ish deputet i PPD-së, sipas të cilit pala maqedonase nuk duhet të lëshojë pe.⁸⁸ Ndërkaq, sipas Xhevat Ademit, ish sekretar i PDP-së, vlerëson se kompromiset për Maqedoninë duhet të jenë elastike dhe se ajo duhet të bëjë kompromis përderisa nuk e ndryshon emrin e saj.⁸⁹

2.2.1. Nuk ka nevojë për referendum për “emrin e dyfishtë”

Pas publikimit të raportit të GNK-së mbi zgjidhjen e kontestit të emrit mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë, e sidomos propozimi që përmbante ky raport mbi “emrin e dyfishtë” si zgjidhje të kontestit, atëherë u hapën shumë çështje hipotetike mbi mënyrën e implementimit të kësaj marrëveshjeje nëse arrihet që propozonte GNK-ja dhe se për të njëjtën a do të ishte e nevojshme të mbahet referendum. Për të fituar një pasqyrë më të saktë rreth asaj situate ka qenë i intervistuar Nikola Popovski i partisë maqedonase LSDM. Sipas tij, nuk ka nevojë për realizim të referendumit për shkak se nuk bëhet fjalë për ndryshim të emrit nga ana e më shumë shteteve por bëhet fjalë kryesisht për çështje e cila duhej të zgjidhej mes dy shteteve, pra, mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë.⁹⁰

Ndërkaq, vlen të përmenden qëndrimet e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, në rast se do të vendosnin për një zgjidhje të tillë të emrit apo përcaktimit të ndonjë emri tjetër,

⁸⁷ Нема потреба од Референдум за „двојното име,“ средба со г. Никола Поповски, 25 април 2002 година, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 360.

⁸⁸ Македонија не треба да попусти, интервју со г. Сејфедин Харуни, 23 април 2002 година, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 378.

⁸⁹ Македонија треба да направи отстапки за името, интервју со г. Џеват Адеми, 14 мај 2002 година, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 383.

⁹⁰ Për më terër shih: Нема потреба од референдум за “двојното име,“ средба со г. Никола Поповски, 25 април 2002 година, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 360, 361.

rezultuan se çdo i dyti qytetarë është kundër çdo ndryshimi të emrit, ndërkaq çdo i pesti qytetarë do ta pranonte “formulën e dyfishtë”. Pra, gjithsej në mes “kundër çdo ndryshimi” dhe “formulës së dyfishtë” janë deklaruar diku 66,1 % e qytetarëve ose dy e treta e qytetarëve.⁹¹

Në vitin 2010 ka pasur dallime mbi baza etnike, pa shumë dallime mbi baza partiake, kurse në vitin 2011 bien poshtë dallimet etnike, përkatësisht qëndrimet janë përafuar në drejtim të zgjidhjes mes “kundër çdo ndryshimi” dhe emrave të dakorduar për përdorim në organizatat ndërkombëtare me mbështetje të identitetit dhe gjuhës dhe vendimeve për referendum. Për shumicën e maqedonasve etnikë (57 %) zgjidhja më e mirë ka qenë “asnjë ndryshim”, përderisa për shqiptarët etnik qëndrimet kanë qenë më të larmishme. Emri i përcaktuar (i pajtueshëm) për në organizatat ndërkombëtare ka pasur më shumë mbështetje (28,3 %). Te maqedonasit etnikë edhe më tutje ka qenë e lartë mbështetja “kundër çdo ndryshimi dhe formulës së dyfishtë, diku rreth (76,4 %), me rritje të vogël të mbështetjes së emrit për përdorim në organizatat ndërkombëtare (7,1 % në vitin 2010 dhe 15,1 % në vitin 2011). Shqiptarët etnikë i janë përafuar qëndrimeve të maqedonasve etnikë. Rritje të vogël është vërejtur në mbështetje “kundër çdo ndryshimi” (prej 13,9 % në vitin 2010 në 19,8 % në vitin 2011) dhe rritje më të madhe të “formulës së dyfishtë” (nga 15,8 % në vitin 2010 në 25,6 % në vitin 2011) ose gjithsej “kundër çdo ndryshimi dhe formulës së dyfishtë” është rritur (nga 29,7 % në vitin 2010 në 45,4 % në vitin 2011). Qytetarët e të gjitha përkatësive etnike si dhe asaj partiake e kanë mbrojtur linjën e kuqe të identitetit dhe kanë kërkuar vendim për referendum për çështjen e emrit.⁹²

2.2.2. Kërkesa e kryetarit Gligorov për pranim të Maqedonisë në OKB nën emrin kushtetues

Duhet të theksohet se Republika e Maqedonisë si rezultat i pamundësisë së Bashkimit Evropian që të ballafaqohet me çështjen e njohjes së shtetit e cila kulminoi më Samitin e Lisbonës në BE-së në kuadër të aktiviteteve diplomatike gjatë korrikut të vitit 1992, theksin ajo e vendosi në kërkesën për pranim në OKB. Qeveria e Republikës së Maqedonisë, dorëzoi propozim për anëtarësim të Republikës së Maqedonisë në OKB, në të cilin me 29 korrik e solli vendimin e saj. Një ditë më parë, kryetari i Republikës së Maqedonisë, mbi bazën e nenit 4 të

⁹¹ Клековски, Сашо, Спорот за името Македонија (ставови на јавноста во Македонија), МЦМС, ИДСЦС, Скопје, октомври 2011 г., стр. 10.

⁹² По аty, fq. 21.

Kartës së OKB-së dhe në përputhje me dispozitat e rregullave të procedurës së Këshillit të Sigurisë dhe dispozitat e rregullave të procedurës së Parlamentit të përgjithshëm të OKB-së, dorëzoi kërkesë deri te Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Butros Gali, për pranim të RM-së në OKB. Në kërkesë, kryetari Gligorov theksoi se RM-ja i pranon normat gjithpërfshirëse të së drejtës ndërkombëtare dhe konsideron se pranimi në OKB do të përfaqësonte një hap domethënës kah zgjidhja paqedashëse e krizës së territorit të ish Jugosllavisë.⁹³ Në vazhdim të kërkesës për anëtarësim në OKB ka qenë dorëzuar edhe Deklarata për pranim të detyrimeve të përmbajtura në Kartën në OKB-së. Përsëri, si rezultat i më tepër faktorëve, në rend të parë pozicioni grek, si dhe përpjekjet e qeverisë britanike për zgjidhjen e çështjeve të hapura të cilët e pamundësonin njohjen e Maqedonisë nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, kërkesa e Maqedonisë për anëtarësim në OKB nuk ishte administruar në mënyrë ekspeditive dhe e njëjta ka qenë e prolonguar deri në janar të vitit 1993. Si rezultat i mospjesëmardësisë së qeverisë britaneze dhe misionit të Robin O'Nil pas Samitit të Edinburgut të BE-së, procesi i njohjes së Maqedonisë në mënyrë indirekte i është lënë OKB-së. Maqedonia në vitin 1993 e ripërsëriti kërkesën për anëtarësim në OKB, kurse sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Butros Gali me 22 Janar 1993 e përcolli kërkesën maqedonase për anëtarësim deri të kryetari i Këshillit të Sigurimit së bashku me kërkesën e parë për anëtarësim të 30 Korrikut 1992. Si rezultat i kësaj, Greqia në mënyrë ekspeditive deri te OKB-ja dorëzoi Memorandum me të cilën i shfaqti qëndrimet dhe pozicionet e Qeverisë së Greqisë në lidhje me kërkesën e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë për pranim në OKB.⁹⁴

Për këtë situatë, Kiro Gligorov në një intervistë të zhvilluar ka përmendur dy situata karakteristike. Kur ministri danez për punë të jashtme ka qenë në vizitë tek ai është njoftuar më hollësisht mbi problemin e Maqedonisë dhe me historinë e saj. Më pas ai ka udhëtuar në Athinë dhe në mbledhjen e mbajtur me Papandreun e ka parashtuar çështjen e maqedonasve se janë popull krejtësisht tjetër dhe përse ata nuk e pranojnë. Për atë deklaratë ai është kritikuar nga shtypi grek dhe më pas Papandreu u ka sugjeruar kompanive afariste greke që ta bojkotojnë

⁹³ Për më tepër shih: Докмановиќ, м-р, Мишо, Грчкиот и македонскиот меморандум за приемот на Македонија во ООН, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 244; cituar sipas: Application of the Republic of Macedonia for admission to UN membership, 30 July 1992 (UN Doc. A/47/876-S/25147, Annex).

⁹⁴ По аты, fq. 244, 245.

mallin danez të cilëve u kishte kushtuar rreth miliarda dollarë.⁹⁵ Sipas tij, ministri danez ka vlerësuar se kontesti nuk mund të zgjidhet për shkak se grekët verbërisht janë kapur pas çështjes së emrit, kurse BE nuk mund të reagojë për shkak se të njëjtën do ta bënin edhe me të dhe Evropa për shkak të kësaj çështjeje do të vuante dëm të madh ekonomik si pasojë e Republikës së Maqedonisë. Ai vlerëson se me pranimin e Maqedonisë në OKB shumë njerëz nuk janë pajtuar me të dhe se nuk kanë qenë të kënaqur për shkak se quhemi Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, por ai thekson se përsëri kanë arritur ta ruajnë emrin “Maqedonia”, që nga njëra anë do të thotë edhe si kompromis i Republikës së Greqisë, të cilët në vazhdimësi nuk kanë pranuar asnjë lloj kompromisi. Ai për këto çështje pranon se në periudhë prej 7-8 muajve katër herë ka shkuar në Nju-Jork në takim me sekretarin e përgjithshëm të OKB-së, Butros Galin, së bashku me deputetin e tij Vasil Tupurkovskin, i cili ka qenë i njoftuar me kërkesat e tij për pranim të Maqedonisë në OKB. Butros Gali edhe pse u kishte thënë se do t’i pranonte ata në OKB, por ai njëherit u kishte premtuar grekëve se do të ushtronte presion mbi Maqedoninë. Dhë në fund kishte mësuar se lutja e tij e parë kishte përfunduar në sitratin e sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, për shkak se kontesti i Maqedonisë me Greqinë ka qenë i natyrës politike dhe se punët e tilla nuk zgjidheshkan në seanca të Parlamentit të Përgjithshëm të OKB-së.⁹⁶

Sipas profesorit Vasil Turpurkovski, vendi ynë nuk i shfrytëzoi dy shanse të shkëlqyeshme, e para, letrën e presidentit amerikan Bushit të vjetër i cili atë vit deklaroi se SHBA-të janë të gatshëm ta njohin pavarësinë e Maqedonisë dhe më pas takimin Gligorov-Gali në OKB. Ai vlerëson se Kiro Gligorov ka pasur shumë vendime pozitive për vendin, por edhe shumë pasoja të dëmshme për shkak të pavendosmërisë së tij. Në Nju-Jork ku është organizuar takimi me sekretarin e përgjithshëm të OKB-së, Butros Galin, ku Maqedonia kishte plotësisht të drejtën e saj për anëtarësim në OKB, mirëpo kryetari maqedonas, për shkaqe të panjohura asnjëherë nuk e hapi çështjen e pranimit në këtë takim.⁹⁷

⁹⁵ Për më tepër shih: Барањето на Глигоров за прием на Македонија во ООН под уставното име, разговор со експретседателот Киро Глигоров, 16 април 2002 година, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 363, 364.

⁹⁶ По ату, fq. 364.

⁹⁷ Për më tepër shih: Тупурковски: Глигоров беше нерешителен за признавањето на Македонија, DW, 02.08.2011, linku në dispozicion:

<https://www.dw.com/mk/%D1%82%D1%83%D0%BF%D1%83%D1%80%D0%BA%D0%BE%D0%B2%D1%81%D0%BA%D0%B8->

2.3. Emri “Maqedonia e Epërme” i papranueshëm

Emri “Maqedonia e Epërme” si propozim për zgjidhjen e kontestit mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë, shumë herë ka qarkulluar në opinione të ndryshme si propozime jo zyrtare për zgjidhje të mundshme të këtij kontesti. Tendencat e zgjidhjes së këtij kontesti gjithmonë konsistojnë në ruajtjen e emrit “Maqedoni” me çdo kusht, që do të shfaqej si kompromis i grekëve kurse parashtresat ose prapshtrësata tjera në emrin “Maqedoni” si kompromis i maqedonasve. Të tilla kanë qenë si p.sh. “Republika e Maqedonisë – Shkupi”, Republika e Maqedonisë (Shkupi) pra në kllapa dhe jo me vizë në mes si rregullim i gabimkurthit nga ana e grekëve që ishte e propozuar nga Konstatin Micotakis, ndërkaq kjo e dyta nga Kiro Gligorov me arsyetimin që Shkupi të mos bëhet emër gjithëpërfshirës i shtetit, “Sllavomaqedonia”, “Maqedonia e Veriut”, “Maqedonia e Re” si dhe “Maqedonia e Epërme” si propozim i ish kryeministrit grek Kostas Simitis i propozuar në pres-konferencë në Shkup, në hotelin Aleksandar Palas, në kohën kur ka qenë kryeministër Lubço Georgievski me partnerin e tij të koalicionit Vasil Tupurkovski. “Maqedonia e Epërme” i kemi kushtuar një vëmendje dhe elaborimin të posaçëm në këtë punim, për shkak se për dallim nga emrat tjerë të propozuara jozyrtarisht, ky emërtim si duket ngjalli më tepër kritika të ashpra në opinionin maqedonas që do ta elaborojmë më gjërësisht në vijim.⁹⁸

Në nënkapitujt e më sipërme kemi theksuar se emri “Maqedonia e Epërme” ka qenë e propozuar edhe nga ana e GNK-së, megjithatë si emër të dyfishtë, pra OKB-ja dhe të gjithë organizatat tjera ndërqeveritare ta miratojnë dhe ta përdorin emrin Republika Makedonija, ndërkaq Greqia të ketë të drejtën e përdorimit të emrit “Maqedonia e Epërme” në OKB ose në marrëdhënie ndërmjet tyre. Megjithatë, profesori Jonuz Abdullahi këtë propozim nga ana e GNK-së e vlerësoi si plotësisht të papranueshme, duke i pasur parasysh edhe të gjitha kompromiset, kërkesat, me një fjalë të gjitha detyrimet që i bien mbi barrën e Republikës së Maqedonisë. Ai vlerëson se ne si Republikë e Maqedonisë këtë shtet e shohim si të plotë dhe të vetme, kurse përdorimi i termit “Maqedonia e Epërme” madje edhe në marrëdhëniet bilaterale me

%D0%B3%D0%BB%D0%B8%D0%B3%D0%BE%D1%80%D0%BE%D0%B2-%D0%B1%D0%B5%D1%88%D0%B5-%D0%BD%D0%B5%D1%80%D0%B5%D1%88%D0%B8%D1%82%D0%B5%D0%BB%D0%B5%D0%BD-%D0%B7%D0%B0-%D0%BF%D1%80%D0%B8%D0%B7%D0%BD%D0%B0%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5%D1%82%D0%BE-%D0%BD%D0%B0-%D0%BC%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%98%D0%B0/a-15289224, (01.05.2020).

⁹⁸ Për më tepër shih: (Не)официјални предлози за решавање на “name issue”, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 282, 283, 284.

Republikën e Greqisë është e papranueshme, për shkak se sipas tij, pas këtij termi qëndrojnë qëllimet e fshehura politike të Greqisë, qëllime të cilat mund të jenë të dëmshme për shtetësinë maqedonase.⁹⁹

Arsyetimi i dhënies së këtij emërtimi nga pala greke konsiston në argumentimin se në Mbretërinë antike maqedonase ajo ka qenë e përfaqësuar me emërtimet Maqedonia “e epërme” dhe “e poshtme”. Pra, si term gjeografik për proceset historike që kanë ndodhur në këto hapësira dhe në atë se çfarë domethënia ka ky term në antikë është mësuar nga burime historike antike. Të dhënat themelore për territorin dhe historinë e Maqedonisë së Epërme i gjejmë në veprat e Herodotit, Thukiditit dhe Strabonit. Herodoti ka qenë krijues i konceptit Maqedonia “e epërme”, duke treguar legjendën për udhëheqësin e parë maqedonas Perdika i parë i cili nga qyteti Arg ka ardhur në Maqedoninë e Epërme. Thukiditi fillimisht i ka përcaktuar pozicionet gjeografike të Maqedonisë së poshtme. Sipas tij, Maqedonia e poshtme është quajtur i gjithë rajoni i cili ka qenë nën pushtetin e Perdikës së dytë.¹⁰⁰

Në ndriçimin e këtij fakti, ka nga ato që thojnë se duhet të mbrohet teza se emri “Maqedonia e epërme” të pranohet nga ana e Republikës së Maqedonisë, për shkak se do të mundej të tregohet një fakt historik se regjioni Maqedonia, ose Maqedonia në kufijt e saj etnik, ndonjëherë ka qenë lëndë e ndarjes. Sipas profesoreshës maqedonase, Tatjana Petrushevska, në vëzhgim komparativ gjithmonë kur përdoren nocionet e epërme, e poshtme, perëndimore, lindore, veriore, jugore si pjesë e emrit të shtetit konkret, ajo është bërë me qëllim të tregohet, përkatësisht të përshkruhet rezultati i realizimit të procesit paraprak të ndarjes së një shteti juridik konkret në ind kombëtar (më shpesh në rrugë të realizuar me dhunë), këtu duke përmendur bazën e vendimit të fuqive sovjetive të korrikut 1945, Gjermania ka qenë e ndarë në katër zona luftarake-okupuese, në lindje ajo sovjetike, në perëndim ajo amerikane, britaneze dhe franceze. Më 12 Shtator 1949, është krijuar pjesa perëndimore apo Republika Federale e

⁹⁹ Për më tepër shih: Името „Горна Македонија,, е неприфатливо!, интервју со г. Јонуз Абдулаи, тогашен пратеник на ДПА, 14 мај 2002, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 381.

¹⁰⁰ Për më tepër shih: Поповска, Наталија, Поимот Горна Македонија, Глобус, неделен весник, 16.04.2013, linku në dispozicion: <http://www.globusmagazin.com.mk/default.asp?ItemID=1EB0096C5FC2924BAE0DD34A128EFFF6>, (03.05.2020).

Gjermanisë apo ajo lindorja ose Republika Demokratike e Gjermanisë.¹⁰¹ Këto emra si tillë kanë funksionuar edhe në Regjistrin e shteteve anëtare të OKB-së.¹⁰² Gjithashtu, të gjitha shtetet tjera në komunikim zyrtar me dy shtetet gjermane i kanë përdorur emrat e tyre kushtetues dhe jo formulimet “Gjermania Lindore apo Gjermania Perëndimore”. Shembull tjetër që imponohet si durueshëm për krahasim është Koreja e cila nga 1910-1945 ka qenë nën okupim japonez. Në vitin 1945 është ndarë në gjatësi të paraleles së 38-të të Koresë së Veriut e cila ka qëndruar nën okupim sovjetik deri në vitin 1948 dhe Koreja Jugore deri në vitin 1948 ka qenë nën okupim amerikan. Në vitin 1948 të dyja shtetet koreane kanë qenë të konstituuar si shtete të pavarura me emrat e tyre zyrtare si “Republika Popullore Demokratike e Koresë” dhe “Republika e Koresë”.¹⁰³ Në këto emra këta shtete kanë qenë të vendosura në regjistrin e anëtarëve të OKB-së.¹⁰⁴ Këto emra i kanë përdorur të gjitha shtetet tjera në komunikim zyrtar me të dyja shtetet koreane. Shembulli tjetër, pjesa veriore e Vietnamit nga paralelja e 17-të në vitin 1954, ka fituar pavarësi si Vietnami Verior (jozyrtarisht), përkatësisht, si Republika Socialiste e Vietnamit (zyrtarisht). Pjesa jugore e Vietnamit nën emrin Republika e Vietnamit ka qenë nën dominim amerikan deri në vitin 1975. Si përfundim, asnjë nga shtetet që i përmendëm për krahasim nuk kanë qenë të pranuar në anëtarësim të OKB-së nën emrin që do të nënkuptonte regjion apo fushë gjeografike, asnjëra prej tyre nuk ka qenë e kushtëzuar me ndërrim paraprak të emrit të tyre kushtetues në emër që do të drejtonte në regjion pa shtet. Në sistemin e OKB-së, në të gjitha marrëdhëniet bilaterale, të gjitha këto shtete funksionojnë nën emrat e tyre kushtetues. Megjithatë, si rast specifik i shtetit i cili ka mbajtur nocion “e epërme” në emrin origjinal kushtetues të tij ka qenë Volta e epërme. Bëhet fjalë për ish shtet afrikan (ka ekzistuar nga 1960-ta deri më 1983), kurse sot funksionin nën emrin Burkina Faso.¹⁰⁵

Më vonë, sipas gazetës greke “Nea selida”, qeveria greke paska propozuar emër të thjeshtë, i papërkthyer për të gjitha përdorimet (erga omnes), p.sh., vendi mund të thirret “Горнамакедонија,, e jo me dy fjalë “Горна Македонија,, gjithashtu edhe shkurtesa “МК” të

¹⁰¹ Për më tepër shih: Петрушевска, Д-р, Татјана, Зошто и покрај се, употреба на поимот „спор,,?, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 313; cituar sipas: Мала општа енциклопедија, Просвета, Београд, 1959, стр. 147.

¹⁰² Po aty, fq. 314, cituar sipas: Growth in United Nations Membership: 1945-2000; <http://www.un.org/overview/growth.html>.

¹⁰³ Po aty, fq. 314; cituar sipas: Правна енциклопедија, Београд; 1989, стр. 664-665.

¹⁰⁴ Po aty, fq. 314; cituar sipas: List of Member States; <http://www.un.org/overview/unmember.html>;

¹⁰⁵ Po aty, fq. 314; cituar sipas: <http://www.bartleby.com/65/bu/BurkinaF.html>.

cilën Greqia nuk e pranonte dhe se ajo duhet të jetë “GO” ose “GM”.¹⁰⁶

Për pranimet e një emërtimi të tillë nga ana e popullatës së Maqedonisë ka reflektuar edhe në anketat e vitit 2011. Në pyetjen në lidhje me pranimet e shtesave gjeografike, të cilët më shpesh janë përdorur për Maqedoninë si: veriore, vardarit, e epërme, si dhe ajo e Shkupit, etj., ka rezultuar se (44,6 %) e qytetarëve kanë qenë kundër çdo pranimi të një prapashtesë të tillë, ndërkaq për atë veriore kanë qenë (20,3 %), Shkupi (10,2 %), Vardarit (7,4 %), e epërme (7,1 %) etj. Në bazë të përbërjes etnike dhe partiake, rezulton se për prapashtesën “Veriore” maqedonasit qëndrojnë me (16,5 %), shqiptarët (25,8 %), ndërkaq mbi bazën partiake për këtë emër: VMRO DPMNE (14,3 %), LSDM (22,7 %), BDI (24,3 %) dhe PDSH (28,6 %). Për prapashtesën “e epërme” maqedonasit janë deklaruar se (6,2 %) është e pranueshme, shqiptarët (10,6 %), ndërkaq mbi bazën partiake: VMRO DPMNE (4,8 %), LSDM (9,1 %), BDI (9,7 %) dhe PDSH (10,2 %). Për prapashtesën “Vardarit”, maqedonasit janë deklaruar (5,6 %), shqiptarët (12,5 %), mbi baza partiake: VMRO DPMNE (4,3 %), LSDM (10,0 %), BDI (10,7 %) dhe PDSH (14,3 %). Për prapashtesën “Shkupi”, maqedonasit janë (5,6 %), shqiptarët (21,0 %), mbi baza partiake: VMRO DPMNE (5,2 %), LSDM (3,6 %), BDI (21,4 %) dhe PDSH (22,4 %).¹⁰⁷ Pra, nga këto anketa siç shihet, pranim bindshëm më të madh ka prapashtesa “Veriore” pavarësisht përkatësisë etnike dhe partiake, ndërkaq ajo “e epërme” nuk kanë qenë e pranueshme për asnjë etni në Maqedoni e aq më tepër për partitë politike.

2.4. Çështja e emrit nuk është problem për në NATO

Çështja e emrit të Maqedonisë është përmendur nga qarqe të caktuara politike si pengesë serioze për anëtarësimin e vendit në NATO. Por, ka edhe të atillë që vlerësojnë se emri është problem bilateral mes Maqedonisë dhe Greqisë. Bob Simons, ndihmës sekretari i përgjithshëm i NATO-s, vlerësoi e Maqedonia i përmbush të gjitha kriteret për anëtarësim në NATO, duke pasur parasysh se i ka përfunduar reformat me sukses dhe se ky vend tashmë i jep një kontribut të çmueshëm në misionet paqësore ndërkombëtare dhe se e drejta e vendosjes pro ose kundër anëtarësimit të Maqedonisë në NATO tani e drejta politike është zhvendosur në

¹⁰⁶ Për më tepër shih: Грчките медиуми: Атина предлага слеано име (Горнамакедонија, а не Горна Македонија), Фокус, 04.03.2018, linku në dispozicion: <https://fokus.mk/grchkite-mediumi-atina-predlaga-sleano-ime-gornamakedonija-a-ne-gorna-makedonija/>, (03.05.2020).

¹⁰⁷ Клековски, Сашо, Спорот за името Македонија (ставови на јавноста во Македонија), МЦМС, ИДЦС, Скопје, октомври 2011 г., стр. 11.

duart e vendeve anëtare të NATO-s.¹⁰⁸

Ndërkaq, në pyetjen e parashtruar z. Kreg Retklifit i cili gjatë vitit 2002 ishte zëdhënës i NATO-s në Republikën e Maqedonisë mbi qëndrimet e GNK-së sa i përket propozimeve mbi zgjidhjen e kontestit të emrit mes Greqisë, ai theksoi se NATO nuk ka qëndrim sa i përket kësaj çështjeje, për shkak se NATO-ja nuk është e involvuar në këtë proces. NATO-ja nuk është në gjendje të mbaj anë dhe nuk do të inkuadrohet në zgjidhjen e çështjes së kontestit me emrin dhe se zgjidhjen ajo e parasheh te e drejta ndërkombëtare me përkrahjen dhe ndihmën e OKB-së dhe me ndihmën e të dyja shteteve të implikuara në këtë kontest.¹⁰⁹

Vlen të përmendet se Daniel Server ish përfaqësuesi amerikan i cili ka qenë në Bosnjë dhe Hercegovinë në rolin e mediatorit mes kroatëve dhe boshnjakëve në bisedimet për Marrëveshjen paqësore të Dejtonit, i cili udhëheq programe për menaxhim të konflikteve në Universitetin “Xhon Hopkins” në Uashington, vlerëson se tashmë është koha që emri të zgjidhet mes Maqedonisë dhe Greqisë dhe se kjo do të ishte në favor për të dyja vendet si dhe për rajonin në përgjithësi. Por, ai vlerëson se ndoshta momentum nuk ka ardhur akoma dhe se nëse nuk ka zgjidhje të kontestit në këtë drejtim, ai mendon se Maqedonia duhet të hyjë në NATO nën përcaktimin e përkohshëm, pra si IRJM (Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë) dhe se për këtë shpesh herë ua ka paraqitur qeveritarëve amerikan të cilët mossuksesin për të gjetur zgjidhje e shohin si shkak të tensioneve të marrëdhënieve ndëretnike. Daniel Server, gjithashtu përmend pozicionin grek i cili thotë se: “...Greqia thekson se kam të drejtë ekskluzive të emrit Maqedoni. Ajo është marrëzi. Në SHBA ekzistojnë mbi 200 vende të janë të emërtuara me termin Maqedonia...” dhe sipas tij ky pozicion nuk është si pasojë e arsyes por e varësisë dhe se ky konstatim rrjedh nga ajo se grekët e sodit pretendojnë se janë pasardhësit direkt të grekëve antik. Por, sipas Server e vërteta është se ata nuk janë aq të sigurt në atë pretendim dhe për atë arsye tregojnë animozitet dhe armiqësi. Duke pasur parasysh se zvarritja e këtij kontesti mund të vazhdojë deri në pafundësi, kjo edhe si pasojë e mosmarrëveshjeve të brendshme mes partive politike në Greqi, ai vlerëson se nëse garnitura qeveritare e udhëhequr nga Siriza nuk

¹⁰⁸ Çështja e emrit zyrtar të Maqedonisë drejt zgjidhjes, DW, 19.02.2008, linku në dispozicion: <https://www.dw.com/sq/%C3%A7%C3%ABshtja-e-emrit-zyrtar-t%C3%AB-maqedonis%C3%AB-drejt-zgjidhjes/a-3136011>, (04.05.2020).

¹⁰⁹ Името не е проблем на НАТО, интервју со г.Крег Ретклиф, портпарол на НАТО во Р. Македонија, 10 август 2002 година, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 384.

mund të arrijë marrëveshje me opozitarët Nea të demokracisë dhe të partisë së grekëve të pavarur, Maqedonia duhe të hyjë në NATO, e sidomos nëse kemi parasysh situatën kur Rusia zgjeron konfrontime dhe tregon agresion në Evropë dhe në Ballkanin Perëndimor, ajo është mëse e nevojshme. Si në Stejt Departamentin Amerikan, ashtu edhe në Shtëpinë e Bardhë, kujton Server se ka politikanë me përvoja politike të mbetur që nga koha e presidentit Xhorxh Bush, të cilët pajtohen se Maqedonia duhet të jetë pjesë e NATO-s, dhe se disa burokratë të lartë kujtohen se Bush është përpjekur ta bëjë atë, mirëpo pa sukses.¹¹⁰

Për të dhënë një përgjigje sa më saktë dhe objektive mbi atë se a ka mundur atë kohë Republika e Maqedonisë të pranohet si anëtare e NATO-s, pa zgjidhur çështjen e kontestit me emrin me Greqinë, vlerësojmë njëherë se duhet të shqyrtohet se çka paraqet NATO-ja dhe si funksionon ajo dhe cilët kushte duhet të plotësojë shteti kandidat për anëtarësim në këtë organizatë veriatlantike.

Pra, më 4 Prill 1949 themelohet Organizata e Aleancës Veri-Atlantike (NATO) në Uashington si komponente ushtarako-politike trans-atlantike në Evropën e pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo organizatë për dallim nga organizatat tjera ndërkombëtare, të cilët përbëhet nga vendet evropiane, kjo organizatë në strukturat e saj përfshin edhe SHBA-të si dhe Kanadanë. Qëllimi i saj kryesor është kryesisht mbrojtës, pra, mbrojtja kolektive në Evropën e pasluftës dhe sigurimi i paqes, stabilitetit dhe sigurisë evropiane gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë. NATO-ja është zgjeruar për nga aspekti i fushëveprimit të saj, përkrah objektivit themelor mbrojtjes në rast të luftërave në Evropë u shtuan edhe qëllimet politike: mbrojtja e vlerave demokratike dhe civilizuese dhe parandalimin e gjenocidit. Nga viti 2001 objektivi i NATO-s ishte lufta kundër terrorizmit, ndërkaq nga viti 2014 mbrojtja e Evropës nga kërcënimi i Rusisë.¹¹¹ Klauzola për zgjerimin e NATO-s është përfshirë në nenin 10 të Traktatit të Atlantikut të Veriut më 4 Prill 1949 në Uashington, e cila përbën bazën e politikës së dyerve të hapura për pranimin e vendeve të reja anëtare. Vendimet mbi ofrimin e ftesave ndaj vendeve të reja anëtare të mundshme për të

¹¹⁰ Сервер: И без промена на името Македонија треба да влезе во НАТО, Нова Македонија, 30.03.2018, linku në dispozicion: <https://www.novamakedonija.com.mk/featured/%D1%81%D0%B5%D1%80%D0%B2%D0%B5%D1%80-%D0%B8-%D0%B1%D0%B5%D0%B7-%D0%BF%D1%80%D0%BE%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%B8%D0%BC%D0%B5%D1%82%D0%BE-%D0%BC%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D0%B8/>, (04.05.2020).

¹¹¹ Për më tepër shih: Reka, Blerim; Bashota, Bardhok; Sela, Ylber, Marrëdhëniet ndërkombëtare (Një hyrje), Instituti për studime politike dhe ndërkombëtare, Shkup, 2016, fq. 210, 211.

filluar bisedimet për hyrje, merren bashkërisht nga të gjithë anëtarët ekzistues.¹¹² Kështu, “palët në marrëveshje të plotë, mund të ftojnë çdo shtet tjetër evropian në një pozitë të tillë që të nxitë më tej parimet e këtij traktati dhe të kontribuojë në sigurinë e zonës së Atlantikut të Veriut që të adresojë në këtë traktat. Çdo shtet i ftuar në këtë mënyrë mund të bëhet palë në këtë traktat duke depozituar instrumentin e tij të aderimit pranë Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të informojë secilën nga palët për depozitim të çdo instrumenti të tillë të aderimit.”¹¹³ Mirëpo, e rëndësishmja është se vendimet për ftesat e fillimit të bisedimeve të hyrjes merren me konsensus ndërmjet vendeve të NATO-s dhe për çdo rast më vete¹¹⁴ dhe se një vendim i NATO-s është shprehje e vullnetit kolektiv të të gjithë 30-të vendeve anëtare meqenëse të gjitha vendimet merren me konsensus.¹¹⁵ Pra, duke pasur parasysh se Greqia është anëtare e NATO-s që nga 18 Shkurti i vitit 1952 dhe ka të drejtën e vetos në këtë organizatë ajo rrjedhimisht edhe për të ndikuar në zgjidhjen e kontestit të emrit mes Maqedonisë do ta shfrytëzon këtë të drejtë sa herë që do t’i paraqitet mundësia, pavarësisht konstatimeve të ndërkombëtareve se ajo ka mundur të anëtarësohet nën referencën e përkohshme IRJM dhe se anëtarësimi i saj do ta ruaj stabilitetin e Maqedonisë si dhe vetë rajonit.

Greqia para mbajtjes së Samitit edhe u kërcënua me veto ndaj anëtarësimit maqedonas nëse nuk do ta ndryshojë emrin e saj (Republika e Maqedonisë). Mirëpo, funksionerët maqedonas vlerësuan se vendi ka nevojë për anëtarësim në organizata të sigurtat e më vonë edhe në Bashkimin Evropian që vendi ta ruaj stabilitetin pas pavarësisë së Kosovës dhe ngelën me shpresë së ndoshta pa e zgjidhur këtë çështje Maqedonia do të pranohet në samitin e ardhshëm në NATO dhe se pas kësaj periudhe do të fillon bisedimet me BE-në edhe përkaj asaj se funksionari i lartë i BE-së, Oli Ren pati vlerësuar se “nëse nuk mund ta zgjidhim këtë çështje, fatkeqësisht do të kemi pasoja negative (për zgjerimin e BE-së).¹¹⁶

Ish kryeministri maqedonas nga rradhët e VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski, pati

¹¹² Manual i NATO-s, Public Diplomacy Division NATO, 1110 Brussels, Belgium, NATO, 2006, fq. 195.

¹¹³ Traktati i Atlantikut të Veriut, Uashington D.C., 4 Prill 1949, (neni 10), linku në dispozicion: https://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_17120.htm?selectedLocale=sq, (04.05.2020).

¹¹⁴ Manual i NATO-s, Public Diplomacy Division NATO, 1110 Brussels, Belgium, NATO, 2006, fq. 201.

¹¹⁵ Çfarë është NATO?, linku në dispozicion: https://www.nato.int/nato-welcome/index_sq.html, (04.05.2020);

¹¹⁶ Игнатова, Елена, Македонија: Промена на името за влез во НАТО, ЕУ?, Global Voices, 17 март 2008, linku në dispozicion: <https://mk.globalvoices.org/03/17/46/>, (06.05.2020).

premtuar se do të bëj gjithçka që është e mundshme për zgjidhjen e këtij problemi të vjetër 17 vjeçar dhe gjithsesi se nëse do të ishte i lehtë, atë do ta zgjidhnin deri më tani. Mirëpo, qëndrimi i ambasadorëve të NATO-s ka qenë se ajo çështje duhet të zgjidhet sa më shpejt si dhe negociatat të vazhdojnë me intensitet të lartë duke dhënë mbështetje morale por duke u distancuar nga ky kontest se ajo nuk është detyrë e NATO-s por e OKB-së dhe se Maqedonia po ec në kilometrat e fundit për në Bukuresht,¹¹⁷ dhe në momentin kur problemi me emrin të tejkalohej, gjë që Aleanca nuk mund ta zgjidh sipas kolonelit Jirgen Borneman, Maqedonia shumë shpejtë mund të bëhet anëtare e NATO-s.¹¹⁸

2.5. Propozimet e Metju Nimicit

Propozimet e Metju Nimicit të vitit 2005¹¹⁹ por edhe këndeje, që zyrtarisht e ka njoftuar edhe ambasadorin e autorizuar të Republikës së Maqedonisë në SHBA dhe njëkohësisht negociator i RM-së në kontestin me Greqinë, Nikola Dimitrov, propozimin që e paraqiti me 09 Tetor 2005 u njoftua si propozim i OKB-së,¹²⁰ edhe pse në një masë të madhe këto propozime u etiketuan si “dokumenti i Nimicit”, “propozimi i Nimicit”, “propozimet e Nimicit”, përkatësisht, “Pakoja e Nimicit”, e cila edhe sot e kësaj ditë mbizotëron në diplomaci, në politikë, në zhurnalistike, madje edhe në shkencë sidomos në RM, edhe pse në esencë letra apo këto propozime të Nimicit janë dokumente zyrtare të OKB-së.¹²¹

Dokumenti për nga vëllimësia është solid, diku me gjashtë faqe ku është i shtypur vetëm teksti kryesor i saj, pa fusnota dhe shënime tjera të pafundme. Dokumenti në fjalë, përbëhet prej tre titujve: Protokollin i përdorimit të emrit në kuadër të OKB-së, Draft propozimi i Rezolutës

¹¹⁷ Проблемот со името пречка за членство во НАТО? DW, 23.01.2008, linku në dispozicion:

<https://www.dw.com/mk/%D0%BF%D1%80%D0%BE%D0%B1%D0%BB%D0%B5%D0%BC%D0%BE%D1%82-%D1%81%D0%BE-%D0%B8%D0%BC%D0%B5%D1%82%D0%BE-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%87%D0%BA%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-%D1%87%D0%BB%D0%B5%D0%BD%D1%81%D1%82%D0%B2%D0%BE-%D0%B2%D0%BE-%D0%BD%D0%B0%D1%82%D0%BE/a-3085135>, (06.05.2020).

¹¹⁸ НАТО не може да го реши проблемот со името, DW, 10.11.2011, linku në dispozicion:

<https://www.dw.com/mk/%D0%BD%D0%B0%D1%82%D0%BE-%D0%BD%D0%B5-%D0%BC%D0%BE%D0%B6%D0%B5-%D0%B4%D0%B0-%D0%B3%D0%BE-%D1%80%D0%B5%D1%88%D0%B8-%D0%BF%D1%80%D0%BE%D0%B1%D0%BB%D0%B5%D0%BC%D0%BE%D1%82-%D1%81%D0%BE-%D0%B8%D0%BC%D0%B5%D1%82%D0%BE/a-15520717>, (06.05.2020).

¹¹⁹ Петрушевска, д-р, Татјана, Кој е Метју Нимиц!?, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 412; cituar sipas: <http://www.2dw-world.de/macedonian/temamace/1.157161.1.html>.

¹²⁰ По ату, fq. 412; cituar sipas: <http://www.A1.com.mk/vesti/default.asp2vestid=52476;52442;52458;52425;52444>.

¹²¹ По ату, fq. 412; cituar sipas: <http://macedonian-heritage.92/officialDocument/Nimetz/html>.

së Këshillit të Sigurimit dhe Shembulli 1 i Rezolutës (2005) i Këshillit të Sigurimit.¹²²

Ne vetëm gjatë elaborimit të kësaj teme, kemi përmendur disa emra jozyrtar si propozime për zgjidhjen e kontestit të emrit mes Maqedonisë dhe Greqisë, me ç'rast aty përmenden edhe disa emra të propzuara nga ndërmjetësuesi Nimic që disa i konsideruan si “vaji amerikan” dhe u kundërshtuan nga Athina. Të tilla ishin si “Republika Kushtetuese e Maqedonisë”, “Republika Demokratike e Maqedonisë”, “Republika e Pavarur e Maqedonisë”, “Republika e Re e Maqedonisë”, “Republika e Maqedonisë së Epërme”.¹²³

Kështu, me 8 Prill 2005, Metju Nimic doli me propozimin “Republika Makedonija – Skopje” për përdorim zyrtar në forume dhe në raporte ndërkombëtare, kurse vendet e treta mund ta zgjidhnin cilindo emër, duke u përcaktuar për atë ose për emrin kushtetues të Maqedonisë dhe ky propozim paraqiste “formulën e dyfishtë të emrit”, ndërkaq përsëri gjatë vitit 2005 Nimic foli për “formulën e trefishtë të emrit”. Kjo formulë parashihte emrin “Republic of Macedonia” për përdorim ndërkombëtar dhe për ato vende të cilët vetëm se e kanë njohur më Maqedoninë nën emrin e saj kushtetues, Greqia ta përdor formulën “Republika Makedonija – Skopje”, kurse “Republika Makedonija” të shfrytëzohet për organizatat ndërkombëtare si dhe për në OKB. Ky propozim parashihte edhe çështjen nacionale, e cila duhet të jetë “qytetarë i Republikës së Maqedonisë (citizen of the Republic of Macedonia).¹²⁴

Ky propozim i ndërmjetësuesit Nimic përmbante edhe dy ankese tjera të çuditshme sa i përket zgjidhjes së kontestit të emrit, me afatizme të parapara, gjë që për herë të parë kjo ndodhi, me ç'rast këtu ishte e paraparë që, e para emri të jetë “Republika Makedonija deri në vitin 2008, kurse më pas të jetë “Republic of Macedonia”. Ankesi i dytë parasheh përsëri të ketë rishqyrtim të marrëveshjes së arritur pas 15 viteve, me vërejtjen se askush nuk ka të drejtë ekskluzive të emrit Maqedonia.¹²⁵

Me gjasë përcaktimet gjeografike shfaqën simpati sa i përket propozimeve të emrave nga ana e ndërmjetësuesit Nimic, gjë që kjo reflektoi te pala greke e cila ishte e kënaqur që emri

¹²² Петрушевска, д-р, Татјана, Кој е Метју Нимиц!?, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 412, 413.

¹²³ (Не)официјални предлози за решавање на “name issue”, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 284.

¹²⁴ Сите предлози за името: од Нова Македонија, преку Република Македонија – Скопје до Република Горна Македонија, 14 февруари 2018, линку në dispozicion: <https://www.mkd.mk/makedonija/politika/site-predlozi-za-imeto-od-nova-makedonija-preku-republika-makedonija-skopje-do>, (06.05.2020).

¹²⁵ По ату.

Maqedonisë ta përmbajë përcaktimin gjeografik “e Epërme”. Ky propozim u dha në vitin 2008. Në mesin e këtyre propozimeve ishin edhe emrat si “Republika Kushtetuese e Maqedonisë”, “Republika Demokratike e Maqedonisë”, “Republika e Pavarur e Maqedonisë”, “Republika e Re e Maqedonisë”, ose “Republika e Maqedonisë së Epërme” dhe njëra prej këtyre emrave duheshte të jetë për përdorim të organizatave ndërkombëtare si dhe për marrëdhëniet bilaterale me Greqinë. Në këtë propozim si kompromis paraqitet emri “Maqedonia” dhe “maqedonasi”, që mund ta shfrytëzojnë të dyja palët, por vetëm në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar, konventat dhe praktikat, përfshirë përdorimin gjeografik të emrave për qëllime komerciale, por askush të mos ketë të drejtë ekskluzive të emrit Maqedonia. Në këtë propozim parashiheshte edhe ndërrimi i pasaportave.¹²⁶

Pra, siç shihet propozime deri në këtë periudhë kishte shumë nga ana e ndërmjetësuesit Nimic, por siç duket asnjëra nga shtetet nuk ishte e gatshme të përballlet me këto propozime duke u përcaktuar për njërin e cila do të reflektonte në tejkalimin e këtij kontesti. Vetëm një muaj më vonë Nimic përsëri doli me plan të reviduar të emrave, e cila përmbante 8 pika, i cili përveç emrit kushtetues të Maqedonisë, “Republika e Maqedonisë së Epërme”, Republika e re e Maqedonisë”, “Republika e Maqedonisë së Re” ose “Republika e Maqedonisë – Shkupi”, “pala e dytë” ta përdor si emër ndërkombëtar zyrtar për përdorim në organizatat ndërkombëtare ose në marrëveshjet apo në konventat ndërkombëtare, por të gjitha në gjuhën angleze. Ai emër gjithashtu do të ishte i evidentuar edhe në pasaportat e qytetarëve maqedonas, kurse fjala “Maqedonia” vetvetiu formalisht jo joformalisht nuk do të mundej të pranohej si emër zyrtar. Shumë shpejt pas kësaj, Nimic doli me propozimin final të tij, me përmbajtje relativisht të ndryshuar të planit të tij. Ky propozim konsistonte në emra me përcaktime gjeografike, për përdorime gjithpërfshirëse (erga omnes). Emri kushtetues mund të përdoret për përdorim të brendshëm, por në qirilicë, “Република Македонија,,,” kurse “Republika Makedonija (Skopje) në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në marrëdhëniet bilaterale propozohet “Republic of Macedonia (Skopje)”, me atë që vendet e treta të cilët e pranojnë Maqedoninë nën emrin e saj kushtetues do të “sugjerohen” por jo edhe të “detyrohen” të ndryshojnë vendimin për emrin e

¹²⁶ Сите предлози за името: од Нова Македонија, преку Република Македонија – Скопје до Република Горна Македонија, МКД, 14 февруари 2018, линку në dispozicion: <https://www.mkd.mk/makedonija/politika/site-predlozi-za-imeto-od-nova-makedonija-preku-republika-makedonija-skopje-do>, (06.05.2020).

Maqedonisë. Termet “Macedonia” dhe “Macedonian” do të munden t’i shfrytëzojnë të dyja palët, me atë që pika shtesë në këtë propozim është se të dyja palët do të respektojnë raportet e mira fqinjësore, kurse Greqia do ta mbështet integrimin e Maqedonisë në BE dhe NATO.¹²⁷

Në vitin 2008, Nimic paraqitet me propozime tjera gjithmonë duke pasur parasysh “formulën e dyfishtë të emrit” si zgjidhje më ideale e emrit, me ç’rast këtu parasheh për përdorim zyrtar në OKB, BE dhe NATO emrin “Republic of North Macedonia” (Republika e Maqedonisë së Veriut), me sugjerim edhe të vendeve të treta ta përdorin të njëjtën, kurse për përdorim të brendshëm emrin zyrtar “Republic of Macedonia” në gjuhën maqedonase. Sipas këtij propozimi në ballinën e pasaportave do të qëndron “Republic of North Macedonia” në gjuhën angleze, “Republique de Macedonie du Nord” në gjuhën franceze, si dhe “Република Македонија,” në gjuhën maqedonase dhe si zakonisht duke pasur parasysh gjithmonë që të dyja palët dotë dëshmojnë se nuk kanë pretendime territoriale ndaj njëra tjetrës. Propozim të ngjashëm kemi edhe në vitin 2009, ku parashihet vetëm emri “Republic of North Macedonia” për të gjitha përdorimet, kurse për përdorim të brendshëm ngel emri kushtetues i Maqedonisë.¹²⁸

Më 9 Prill të vitit 2013 nën titullin “Propozim”, një tekst me dy faqe me 10 pika, siç duket ndërmjetësuesi Nimic këtë çështje e kishte pastruar duke dhënë vetëm propozimin për emrin “Republika e Epërme e Maqedonisë”. Zyrtarja sipas tij do të jetë “Upper Republic of Macedonia”, përdorimi do të jetë “erga omnes”, pa përdorim bilateral si dhe atë nacional, gjuha do të jetë “Macedonian/Makedonski”, shtetësia (nationality) “of the Upper Republic of Macedonia”; alternate “Makedonsko/Macedonian”. Propozimi parasheh vendet anëtare të OKB-së ta përdorin këtë emër në kontekst zyrtar, por lejohet edhe përdorimi i emri Republika Makedonija në gjuhën maqedonase por vetëm brenda shtetit.¹²⁹

Ky propozim sipas informatave të atëhershmit, ka qenë kinse më i pranueshëm për qeverinë e Nikolla Gruevskit, por jo edhe për palën greke. Vërejtjet e Athinës konsistonin në pozicionimin e përcaktimit gjeografik të emrit të thjeshtë, ajo insistonte në emrin “e Epërme” të

¹²⁷ Сите предлози за името: од Нова Македонија, преку Република Македонија – Скопје до Република Горна Македонија, МКД, 14 февруари 2018, линку në dispozicion: <https://www.mkd.mk/makedonija/politika/site-predlozi-za-imeto-od-nova-makedonija-preku-republika-makedonija-skopje-do>, (06.05.2020).

¹²⁸ По ату.

¹²⁹ По ату.

jetë përpara termit Maqedonia, dhe jo para Republikës.¹³⁰

Siç shihet, të gjitha propozimet janë kundërshtuar si nga ana e Maqedonisë ashtu edhe nga ana e Greqisë, duke mos arritur në kompromis që do ta zgjidhte njëherë e përgjithmonë kontestin me emrin. Pavarësisht propozimeve të shumta që janë dhënë, siç e pranon edhe vetë ndërmjetësuesi Metju Nimic, “dhashë shumë ide për emrin, të cilët nuk ishin vetëm propozimet e mia por edhe të njerëzve të tjerë...” vendet e implikuara vazhdonin në inatet e tyre historike duke qenë gjithmonë mohues ndaj çdo propozimi të emrit, sidomos Maqedonia në mungesë të vullnetit për zgjidhjen e saj nuk arriti asnjëherë në ndonjë simpati prej emrave të propozuara nga ana e ndërmjetësuesit Nimic ose nëse njëra palë pajtohej tjera kundërshtonte dhe anasjelltas duke mos gjetur asnjëherë mirëkuptim si dhe kompromis. Metju Nimic kujton njëherë se edhe vetë ish sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki Mun, i kishte thënë se duhet ta zgjidhnin këtë çështje, për shkak të problemeve të emërtimit të saj që asnjëherë nuk arrinte ta mbante në mend emrin e shtetit. Njëherë ai kishte thënë “Ish Republika Jugosllave e Jugosllavisë”, me çka ka krijuar ngatërresa dhe nuk ka arritur ta kupton mirë se si cili ishte emri i shtetit. “Problemi është në vetë rajonin i cili është i madh...” deklaroi Nimic, “...kurse shteti është vënë në kuadër të rajonit, por që nuk e kap gjithë rajonin. Nga pikëvështrimi grek, nëse thirreni Republika e Maqedonisë, atëherë nënkupton se i gjithë rajoni është i juaji.” Ai thotë se ky problem është real dhe kështu e konsideron edhe vetë Këshilli i Sigurimit. Ai madje jep edhe një shembull se si duket në të vërtetë ky problem kompleks duke marrë për shembull “...rajonin Skandinav. Nëse Suedia vendos ta ndërron emrin në Skandinavija, atëherë norvegjezët mesiguri do të rebeloheshin. Bëhet fjalë për çështje të kësaj natyre dhe për atë përcaktimi gjeografik...” sipas tij ishte “zgjidhje e mirë”.¹³¹

2.5.1. Kush është Metju Nimici?

Metju Nimici ka qenë përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki Mun-it i cili ka qenë i përcaktuar për ndërmjetësimin e zgjidhjes së kontestit mes Republikës së

¹³⁰ Сите предлози за името: од Нова Македонија, преку Република Македонија – Скопје до Република Горна Македонија, МКД, 14 февруари 2018, линку në dispozicion: <https://www.mkd.mk/makedonija/politika/site-predlozi-za-imeto-od-nova-makedonija-preku-republika-makedonija-skopje-do>, (06.05.2020).

¹³¹ Нимиц: Не ме ни исплатија, Нова Македонија, 04.03.2019, линку në dispozicion: <https://www.novamakedonija.com.mk/makedonija/politika/%d0%bd%d0%b8%d0%bc%d0%b8%d1%86-%d0%bd%d0%b5-%d0%bc%d0%b5-%d0%bd%d0%b8-%d0%b8%d1%81%d0%bf%d0%bb%d0%b0%d1%82%d0%b8%d1%98%d0%b0/>, (07.05.2020).

Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë, i vendosur më 23 Dhjetor 1999,¹³² pas tërheqjes së përfaqësuesëve parapak të OKB-së për kontestin e emrit, së pari Butros Gali, më pas edhe Kofi Ananit – Sajrus Vensi, i vendosur më 1 Gusht 1993.¹³³

Sipas BBC News, Metju Nimicin e kanë përshkruar si “njeriu që ka qenë i fokusuar 23 vite në një fjalë.”¹³⁴ Ai ka lindur më 17 Qershor 1939 në Brooklyn, New York City, në një familje hebreje është djali i Joseph dhe Elsie Nimetz dhe ka qenë i shkolluar në shumë shkolla të njohura në SHBA. Ai është diplomat amerikan. Ka qenë i dërguari special i OKB-së për çështjen e emrit mes Greqisë dhe IRJM-së (tash: Republika e Maqedonisë së Veriut).¹³⁵ Hapi i tij më i madh ka qenë në vitin 1977 kur presidenti i SHBA-së, Jimmy Carter, e ka emëruar për këshilltar të Stejt Departamentit Amerikan. Ai e ka këshilluar këshilltarin shtetëror Sajrus Vens (Cyrus Vance), me të cilin do të vazhdojë ta zgjidh edhe çështjen e kontestit të emrit. Ai shumë shpejt ka përparuar në karrierën e tij edhe pse nuk ka qenë diplomat. Ka qenë i emëruar edhe si zv.sekretar në vitin 1979, por funksionet e tij shtetërore nuk kanë vazhduar gjatë¹³⁶ nga nëpunës në Gjykatën Supreme të SHBA-së, ku ka qenë asistent i personelit të presidentit Lyndon B. Johnson deri në vitin 1969 dhe ka punuar në stafin e politikës së brendshme. Më pas ka punuar në një firmë juridike të qytetit të New York-ut si bashkëpunor nga viti 1969 deri më 1973 dhe si partner kryesor nga 1974 deri më 1977. Në Janar 1977 u emërua nga presidenti Jimmy Carter si këshilltar i Departamentit të SHBA-së. Në këtë post, ai dha ca këshilla sekretarit të shtetit Sajrus Vens dhe kishte përgjegjësi të veçanta në lidhje me çështjen e Qipros, çështjet e Lindjes së Mesme përfshirë mosmarrëveshjet greko-turke, zbatimin e marrëveshjeve të Helsinkut dhe çështje tjera që përfshijnë Evropën Lindore dhe Qendrore.¹³⁷ Në vitin 1981, kur presidenti Carter nuk u zgjodh për një mandat të dytë, Nimici i kthehet avokaturës. Por, përsëri ka qëndruar në pozita të larta në zyre të njohura. Në diplomaci përsëri e kthejnë demokratët e tij.

¹³² Петрушевска, д-р, Татјана, Кој е Метју Нимиц!?, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 411; cituar sipas: <http://un.org.news/press/dots/1999/19991223.sga717.doc.html>.

¹³³ По ату, fq. 411, cituar sipas: <http://www.un.org/french/news/oss/ffsrsg/html>.

¹³⁴ The man who has focused on one word for 23 years, BBC NEWS, Magazine, 2 August 2017, linku në dispozicion: <https://www.bbc.com/news/magazine-40781213>, (10.05.2020).

¹³⁵ Matthew Nimetz, Wikipedia the free encyclopedia, linku në dispozicion: https://en.wikipedia.org/wiki/Matthew_Nimetz, (10.05.2020).

¹³⁶ Никовски, Ристо, Кој е и за кого работи Метју Нимиц?, МКД, 18 јануари 2013, linku në dispozicion: <https://www.mkd.mk/91079/kolumni/koj-e-i-za-kogo-raboti-metju-nimic>, (10.05.2020).

¹³⁷ Matthew Nimetz, Wikipedia the free encyclopedia, linku në dispozicion: https://en.wikipedia.org/wiki/Matthew_Nimetz, (10.05.2020).

Në vitin 1994, Bil Clinton e emëron për përfaqësues personal në kontestin mes Maqedonisë dhe Greqisë. Në atë funksion mbetet deri në nëntor të vitit 1997 atëherë kur Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së e vendos për zëvendës të Sajrus Vensit. Pas dorëheqjes së Vensit në dhjetor të vitit 1999, Nimici mbetet ndërmjetësuesi kryesor i këtij procesi.¹³⁸

Ndërmjetësuesi Metju Nimic, në disa intervista që i kanë zhvilluar me të është deklaruar se në Ballkan në përgjithësi emri kompromis ka konotacion apo domethënie të keqe. Ai thotë se fjala kompromis në SHBA është fjalë e mirë, “...do të përlahemi dhe ikim në dhoma të ndryshme, diskutojmë për atë çështje dhe dalim me zgjidhje. Arritëm kompromis dhe të gjithë thonë se ajo është shumë e bukur. Në Ballkan, kompromisi është punë e keqe. Askush nuk fiton.”¹³⁹

Ai kujton edhe kohën kur ka qenë i emëruar për zgjidhjen e kontestit të emrit, kur të gjithë rreth tij kanë menduar se ajo është e lehtë “...ulu në tavolinë, gjej emër. Por nuk ishte ashtu.”¹⁴⁰ gjë që mund të dëshmohet shumë lehtë duke i pasur parasysh të gjitha konstatimet e më hershme mbi propozimet emrit që janë dhënë nga ana e tij, por ai kujton “fat që ajo nuk ka qenë puna ime e vetme. Sikur të ishte ashtu dhe të duhej të ulesha në zyre me muaj pa bërë asgjë të vetme, do të ishte shumë depresionuese.”¹⁴¹ Ai është shprehur edhe për referencën e përkohshme që ka pasur Maqedonia e Veriut në OKB, që sipas tij aspak ajo nuk ishte emër vendi, por ajo ka qenë referencë e përkohshme në pritje të një emri. Ai këtë e krahason me lindjen e foshnjës “...sikur unë dhe gruaja ime të lindim në djalë dhe në spital t’ia shkruajmë “djali i zotërisë dhe zonjës Nimic. Edhe pse djali 20 vjeçar shëtit pa emër, ai/ajo do të rritet në një situatë të pakëndshme...” kështu ka qenë edhe vendi jonë i bllokuar nën atë referencë e cila

¹³⁸ Никовски, Ристо, Кој е и за кого работи Метју Нимиц?, МКД, 18 јануари 2013, линку në dispozicion: <https://www.mkd.mk/91079/kolumni/koj-e-i-za-kogo-raboti-metju-nimic>, (10.05.2020).

¹³⁹ Нимиц: Зборот компромис на Балканот има лошо значење, Нова Македонија, 26.05.2019, линку në dispozicion: <https://www.novamakedonija.com.mk/makedonija/politika/%d0%bd%d0%b8%d0%bc%d0%b8%d1%86-%d0%b7%d0%b1%d0%be%d1%80%d0%be%d1%82-%d0%ba%d0%be%d0%bc%d0%bf%d1%80%d0%be%d0%bc%d0%b8%d1%81-%d0%bd%d0%b0-%d0%b1%d0%b0%d0%bb%d0%ba%d0%b0%d0%bd%d0%be%d1%82-%d0%b8%d0%bc/>, (10.05.2020).

¹⁴⁰ Нимиц: Требаше да го напишам Преспанскиот договор на кинески, DW, 23.05.2019, линку në dispozicion: <https://www.dw.com/mk/%D0%BD%D0%B8%D0%BC%D0%B8%D1%86-%D1%82%D1%80%D0%B5%D0%B1%D0%B0%D1%88%D0%B5-%D0%B4%D0%B0-%D0%B3%D0%BE-%D0%BD%D0%B0%D0%BF%D0%B8%D1%88%D0%B0%D0%BC-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%81%D0%BF%D0%B0%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%B8%D0%BE%D1%82-%D0%B4%D0%BE%D0%B3%D0%BE%D0%B2%D0%BE%D1%80-%D0%BD%D0%B0-%D0%BA%D0%B8%D0%BD%D0%B5%D1%81%D0%BA%D0%B8/a-48836835>, (10.05.2020).

¹⁴¹ По ату.

ishite denigruese për vetë shtetin, e cila hapi dhe thelloi probleme, ku e vendosi në pikëpyetje legjitimitetin e saj.¹⁴²

Në 20 vitet e kaluara pasi ka qenë i emëruar si ndërmjetësues i OKB-së në lidhje me kontestin me emrin nga ana e ish Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Kofi Anan, Nimici ka punuar vetëm një 1 dollarë në muaj. Një shumë simbolike e parave, të cilët nuk i ka marrë asnjëherë,¹⁴³ edhe pse është ankuar që t'i kompenzohen, por në realiteti ai ka marrë një njoftim nga reparti i financave të OKB-së, se harxhimet e rrugës ia kanë kompenzuar dhe i kanë paguar 12 dollarë e 50 cent për dy vjet paraprakisht, "...ju thashë qo do t'ua kthej paratë. Por nuk ma paguan rrogën prej një dollari në muaj, por ju thashë që është në rregull."¹⁴⁴

2.5.2. Aspektet kritike të zgjidhjeve të ofruara nga Metju Nimic

Siç e pamë deri më tani asnjëra prej propozimeve rreth emrit nuk u pranua nga asnjëra palë, përkatësisht Greqia u përcaktua për përcaktimin gjeografik "e Epërme", ndërkaq kjo e fundit isha e papranueshme për Maqedoninë. Si pasojë e kësaj, propozimet e ndërmjetësuesit Nimic, në opinionin maqedonas si duket u krijuan tri tabore të ndryshme, të parët atë e vlerësuan si bazë të mirë për vazhdimin e negociatave, të dytët dhanë komente të llojit se të gjitha propozimet rreth emrit i rrezikon maqedonasit si popull, përkatësisht fshihet gjithçka që është maqedonase, duke nënvizuar se ajo është tradhëti ndaj popullit maqedonas, ndërkaq të tretët jepnin këshilla që mos të kërkojnë "qime në vezë".¹⁴⁵

Propozimet e ndërmjetësuesit Nimic për emrin e Republikës së Maqedonisë, e cila prej vitit 1993 një pjesë e madhe e shteteve e kanë njohur nën referencën e përkohshme Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, e njëjta duke filluar nga viti 2006 e deri më 2008 në të gjitha marrëveshjet multilaterale, në komunikata, rezoluta formale e kështu me radhë, emri i

¹⁴² Нимиц: Требаше да го напишам Преспанскиот договор на кинески, DW, 23.05.2019, linku në dispozicion: [¹⁴³ По ату.](https://www.dw.com/mk/%D0%BD%D0%B8%D0%BC%D0%B8%D1%86-%D1%82%D1%80%D0%B5%D0%B1%D0%B0%D1%88%D0%B5-%D0%B4%D0%B0-%D0%B3%D0%BE-%D0%BD%D0%B0%D0%BF%D0%B8%D1%88%D0%B0%D0%BC-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%81%D0%BF%D0%B0%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%B8%D0%BE%D1%82-%D0%B4%D0%BE%D0%B3%D0%BE%D0%B2%D0%BE%D1%80-%D0%BD%D0%B0-%D0%BA%D0%B8%D0%BD%D0%B5%D1%81%D0%BA%D0%B8/a-48836835, (10.05.2020).</p></div><div data-bbox=)

¹⁴⁴ Нимиц: Не ме ни исплатија, Нова Македонија, 04.03.2019, linku në dispozicion: [¹⁴⁵ Për më tepër shih: Велковска, Зорица; Патчев, Владимир, Критика на „предлогот на Нимиц“, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 423.](https://www.novamakedonija.com.mk/makedonija/politika/%d0%bd%d0%b8%d0%bc%d0%b8%d1%86-%d0%bd%d0%b5-%d0%bc%d0%b5-%d0%bd%d0%b8-%d0%b8%d1%81%d0%bf%d0%bb%d0%b0%d1%82%d0%b8%d1%98%d0%b0/, (10.05.2020).</p></div><div data-bbox=)

Maqedonisë të figurojë si “Republika Makedonija”. Në marrëdhënie zyrtare ndërkombëtare, përkatësisht në përdorim ndërkombëtar të figurojë si “Republic of Macedonia”, kurse nga ana e Greqisë si “Republika Makedonija – Skopje”. Duke filluar nga viti 2009 e më tutje, sekretariati në kuadër të OKB-së, të vazhdojë ta përdor emrin “Republic of Macedonia”. Sipas Zorica Velkovskës dhe Vladimir Patçevit, kjo është vetëm një uvertyrë e bukur për Maqedoninë, kurse për Greqinë një paralojë e keqe.¹⁴⁶

Ndërmjetësuesi Nimic, në draftin e rezolutës së Këshillit të Sigurimit, posaçërisht në pikën 7 ka parasysh se termi “Maqedonia” shfrytëzohet në kuptim të markimit të nocioneve të rajoneve gjeografike e cila i përfshin pjesët e më tepër shteteve në rajonin e Evropës Juglindore, duke përfshirë edhe IRJM-në si dhe Greqinë, por jo vetëm ato, termi “Maqedonia” është e rëndësishme për trashëgim të historisë dhe kulturës e më tepër shteteve. Në pikën 8, draft rezoluta propozon se asnjë shtet nuk do të pretendojë se ka të drejtë ekskluzive mbi termin “Maqedonia” ose “maqedonase” në kuptim historik, gjeografik apo atë komercial. Interesante gjithashtu është edhe pika 13 e cila thotë se në vitin 2021 Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, do të vendos përfaqësues i cili do të sugjerojë për atë se a do të ketë ndryshime në përdorimin e emrit mes palëve të tanguara.¹⁴⁷ Duke pasur në konsideratë vullnetin e mirë për tejkalimin e kësaj çështjeje, nuk besoj se edhe ky propozim do të ishte ideale të aplikohesh në rastin konkret në lidhje me kontestin e emrit mes Maqedonisë dhe Greqisë dhe nuk do të jepte rezultate afagjata sa i përket tejkalimit të krizës së këtyre dy vendeve, por kjo variantë e tipit “stand by”, më tepër e prolongon problemin në fjalë për të mos thënë dërgon në drejtim të lidhjes më të madhe të nyjes tashmë të lidhur, për të ardhur deri te momentum i zgjidhjes përfundimtare të kontestit të emrit.

Vlerësimet janë pozitive për ato të cilët vlerësojnë se duhet të vazhdojnë negociatat për zgjidhjen e kontestit deri në zgjidhjen përfundimtare të saj, ndërkaq të dytët nuk pajtohen por më tepër zgjidhjen e saj e shohin si satisfaksion para botës se çështja e emrit u zgjidh por nga ana tjetër ajo do të krijojë dyfish probleme “në shtëpi”. Andaj, “rrobaqepësit” e fatit të Maqedonisë, si do të ballafaqohen dhe si do ta implementojnë një marrëveshje të tillë në

¹⁴⁶ Velkovska, Zorica; Patçev, Vladimir, Kritika na „предлогот на Нициц“, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 423.

¹⁴⁷ По ату, fq. 424.

shtetin maqedonas.¹⁴⁸

Sipas Momirovskit, propozimi përmban më tepër propozime të cilët vetëm se qarkullojnë viteve të fundit në Maqedoni, me këto propozime modifikimi i paralajmëruar i “formulës së dyfishtë të emrit” sipas tij bjen në ujë dhe se opcioni i vetëm është Republika e Maqedonisë – Skopje i cili për pak do të diskutohej edhe në Kuvendin e RM-së. Ndërkaq, për akademikun Blazhe Ristovski çështja e identiteti kulturor e nacional dhe historik është më e rëndësishme se vet emri i shtetit i shkruar në latinisht. Këtë akt e sheh si kurorë të tendencave historike për mohim të vet popullit maqedonas. Sipas tij, emri do të jetë determinues për fatin e popullit maqedonas, “se nesër a do të jemi vetëm republikomaqedonas. Le të jemi edhe FYROM në BE, por mos të rilindemi.”¹⁴⁹

Sipas profesorit Svetomir Shkariq, propozimi i Nimitit është vazhdim i një gjeopolitike të rrezikshme të OKB-së për Maqedoninë, e cila ka filluar me Marrëveshjen Kornizë. Afatet kohore për shqyrtim të marrëveshjeve i sheh si destabilizuese për Greqinë si dhe për Maqedoninë por edhe për rajonin. Sugjerimi i Shkariqit si dhe Ristovskit konsiston në mos shpejtimin e Qeverisë për mbylljen e kësaj çështjeje pas propozimeve të pavalitshme të Nimitit, të cilët konsistojnë në marrjen e identitetit maqedonas. Vlerësimi i tyre është “më mirë është të pritët me vjet, sesa pa menduar të pranohen zgjidhje të dëmshme për identitetin nacional maqedonas.”¹⁵⁰

Sipas profesoreshës Biljana Vankovska “...maqedonas do të mundemi të jemi vetëm në shtëpi, por jashtë nuk do të mundemi ashtu të identifikohemi.” Sipas Irena Çaushevaska, propozimet shihen me optimizëm për shkak se definitivisht ato e përmbajnë emrin “Maqedonia”. Ato i japin hapësirë RM-së të vendos se cilën prej 7 varianteve do ta përdorë në komunikim ndërkombëtar, kurse Greqia të vendos se me cilën prej varianteve do t’i adresohet Maqedonisë në komunikim bilateral. Kjo edhe sipas gazetës greke “Etnos” do të thotë pranim i RM-së për përdorim të formulës së dyfishtë të emrit.¹⁵¹

Për Qeverinë propozimet e ndërmjetësuesit Nimit janë pozitive për Maqedoninë dhe

¹⁴⁸ Për më tepër shih: Велковска, Зорица; Патчев, Владимир, Критика на „предлогот на Нимиц“, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр.425.

¹⁴⁹ Për më tepër shih: Костовска, Вера; Ангеловска, Ивана; Блажевска, Марија; Димиќ, Емилија и Кипријановска, Димиќ, Состојби, решенија и мислења за предлогот на Нимиц, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 433.

¹⁵⁰ По ату, fq. 433.

¹⁵¹ По ату, fq. 435.

përbën bazë të mirë për zgjidhjen e kontestit me Greqinë, mirëpo pengesë kryesore për zgjidhjen e saj është opozita maqedonase, e cila në takimin e organizuar te presidenti Branko Crvenkovski kanë qenë të prezantuara argumentet e Qeverisë si dhe janë dëgjuar sugjerimet e partisë opozitare si dhe vërejtjet e tyre. Por, kjo nuk dha rezultate për arritjen e konsensusit politik nga partitë më të mëdha në vend. Edhe përkaj 5 orëve të kaluara në diskutim, Crvenkovski si dhe Buçkovski nuk kanë arritur ta bindin liderin e VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevskin që t'ju jep përkrahje të parezervë. Për Nikolla Gruevskin, porpozimet ngërthejnë paqartësi të caktuara të cilët edhe Qeveria s'ka përgjigje. Ai qëndron në qëndrimin se nuk ka përse të përshpejtohet në dhënien e qëndrimit shtetëror rreth kësaj çështjeje pa bërë analiza të hollësishme paraprake për të cilën është ofruar dhe të kryejë konsultime të zgjeruara dhe se ky përshpejtim është i kot kur tanimë Greqia ka kundërshtuar çdo propozim të Nimicit rreth zgjidhjes së emrit.¹⁵²

Më optimist në drejtim si duket kanë qëndruar profesori Denko Malevski si dhe profesori Lubomir Frçkoski ndaj propozimeve rreth emrit. I pari konsideron se Maqedonia duhet të tregojë konstruktivitet se këto janë bazë e mirë për zgjidhje dhe të vazhdojë edhe më tutje ta vajos nyjen e cila po zgjat shumë dhe vetëm më tepër e shteron shtetin në çdo pikëpamje dhe i pengon raportet e mira me Greqinë. Ndërsa, sipas Frçkoskit, propozimet përbëjnë ndyshim drastik të faktorëve të jashtëm që janë në favor të Maqedonisë. Mendimi i tij personal është që propozimet do t'i japin fund kontestit me emrin pavarësisht refuzimit ekspres të Athinës, Maqedonia nuk duhet të jetë pa qëndrim për propozimet e reja të Nimicit.¹⁵³

Për faktorin shqiptar në Maqedoni, emri i ri shtetit duhet të pasqyrojë realitetin kulturor, historik dhe shumëetnik të Maqedonisë. Një emër ekskluziv që do t'i përjashtonte shqiptarët do të ishte i papranueshëm për shqiptarët. Këtë qëndrim e kanë mbajtur përmes një deklaratë intelektualët shqiptar lidhur me propozimet e fundit për zgjidhjen e kontestit të emrit, sidomos rreth përcaktimeve gjeografike të emrit të ri. Njëri nga drejtuesit e Forumit Shqiptar, Shpëtim Pollozhani, grupi i intelektualëve ka punuar rreth hartimit të memorandumit me iniciativë, i panxitur dhe i pakontrolluar nga askush. Sipas tyre, propozimet e ndërmjetësuesit të OKB-së,

¹⁵² Për më tepër shih: Костовска, Вера; Ангеловска, Ивана; Блажевска, Марија; Димик, Емилија и Кипријановска, Димик, Состојби, решенија и мислења за предлогот на Нимиц, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 436.

¹⁵³ По ату, fq. 436-437.

Metju Nimic janë të papranueshme, përveç emrave Maqedonia e Re si dhe Republika e Maqedonisë – Shkupi që deri diku janë të pranueshme si dhe të diskutueshme, ndërkaq të tjerat do t'i pranojnë në rast se përfshijnë në vete edhe legalitetin historik, kulturor dhe etnik të shqiptarëve. Së këndejmi, sipas njohësit të çështjeve politike, Nijazi Muhamedit, ky reagim tregon shumë për shqiptarët të cilët janë bashkuar për të definuar një pozicion kombëtar dhe një çështje që kërcënon të ardhmen e shqiptarëve jo vetëm në vend.¹⁵⁴

Sipas profesorit Igor Janev, shkurt e qartë thënë negociatat që i ka udhëhequr Metju Nimic në një moment kanë hyrë në qorrsohak. Ai niset nga aktgjykimi që ka sjellur gjykata e Hagës në favor të Maqedonisë, që maqedonasit nuk “bisedojnë”, por siç thuhet edhe në vet aktgjykimin “negociojnë” për emrin, pra në aktgjykim përdoret termi “negotiations” dhe jo “talks”. Sipas tij, në vend nuk mundet asnjëherë të arrihet kompromis për përcaktimet shtesë gjeografike të emrit si “e Epërme” ose “Veriore” si dhe gama “erga omnes” për Greqinë është *Conditio sine qua non* (kushti pa të cilin nuk mundet). Pra, ai niset nga e drejta ndërkombëtare si rregull të përgjithshëm që përmes një mekanizmi të tillë të negociatave nuk është e mundur të tejalohet kjo çështje, duke pasur parasysh se një vend i cili në princip nuk e njeh vendin tjetër në elementin esencial të subjektivitetit, përafrohet me njohjen ndërkombëtare të shtetit të njëjtë me atë element, duke aluduar në faktin se Maqedonia është anëtarësuar me dy kushte jolegale në OKB, me çka gjeneruese është situata me të cilin i mundësohet Greqisë që ta kushtëzojë Maqedoninë më një sërë çështjesh të identitetit të cilët Republika e Maqedonisë asnjëherë nuk do t'i pranojë.¹⁵⁵

Në një peticion të publikuar me emra dhe mbiemra në gazetën ditore angleze “Elefterotipija” (09.03.2006), 56 intelektual me orientim majtist grek, kanë deklaruar se kanë vendosur që Republikën e Maqedonisë ta thërrasin me emrin e saj kushtetues, pavarësisht qëndrimit të Athinës zyrtare. Me këtë peticion thonë se Maqedoninë nga tani e tutje do ta thërrasin “Republika e Maqedonisë” duke u thirrur në atë se ajo tanimë është e njohur me dhjetëra vende dhe më e rëndësishmja “...është etabluar me këtë emër në përdorim lingvistik

¹⁵⁴ Çështja e emrit: Pikëpamje të ndryshme për kontestin, Klan Macedonia, 20.02.2018, linku në dispozicion: <http://klanmacedonia.mk/ceshtja-e-emrit-pikepamje-te-ndryshme-per-kontestin/>, (01.06.2020).

¹⁵⁵ Për më tepër shih: Интервју со проф. Игор Јанев за спорот за името со Грција, Весник Македониум, Се за Македонците во Албанија, 14.01.2014, linku në dispozicion: <http://makedonium.net/?p=1301>, (01.06.2020).

dhe në vetëdijen e të gjithë njerëzve gjithkund në botë, përveç te nacionalistët grek...”.¹⁵⁶

2.6. Vetoja greke në Samitin e NATO-s në Bukuresht

Punët ishin të qarta që në fillim se Republika e Maqedonisë nuk do të pranohej në NATO, për shkak se deri në këtë periudhë nuk ishte bërë asnjë hap përpara sa i përket zgjidhjes së çështjes së emrit edhe pse kishte shpresa se kjo çështje do të tejkalohet dhe se Republika e Maqedonisë do të pranohej në samitin e ardhshëm të NATO-s në Bukuresht edhe atë duke mbajtur shpresa në përkrahjen si dhe ndikimin amerikan të administratës së Bush-it. Por, në këtë drejtim i qartë ishte edhe qëndrimi zyrtar i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë se është e “pamundur t’i lejohet IRJM-së hyrje në BE dhe NATO me emrin Republika e Maqedonisë” dhe se “sllavomaqedonasit e IRJM-së insistojnë edhe më tutje qëndrimin e tyre këmbëngulës negativ në drejtim të zgjidhjes së çështjes së emrit.”¹⁵⁷ Sipas ministrit të punëve të jashtme të Greqisë, Dora Bakoјani, emri “Republika e Maqedonisë” vetvetiu nënkupton pretendim territorial ndaj Greqisë dhe se emri ka identitet grek më shumë se tre mileniume dhe e njëjta është e ndërlidhur me shumë dhembje dhe sakrificë të popullit grek.¹⁵⁸ Por, si kundërpërgjigje ndaj saj, dhe nga ana tjetër për ta kënaqur kujdesin si dhe ankesat greke e cila gjithmonë për pretekst e përdorte implikimin e tendencës së përvetësimit të territorit grek me anë të përdorimit të emrit Maqedonia, Republika e Maqedonisë miratoi dy amadamente kushtetuese, ku theksohej se Maqedonia nuk ka tendenca territoriale kundër asnjë shteti fqinj dhe se kufijt e saj mund të ndryshohen vetëm në pajtim me Kushtetutën dhe normat e përgjithshme ndërkombëtare të pranuar dhe se në kujdesin për pozitën e të drejtave të qytetarëve të saj dhe pakicës për shtetet fqinje ajo nuk do të merr pjesë në të drejtën sovranë të shteteve tjera dhe të çështjeve ndërkombëtare të tyre. Maqedonia i pranon kufijtë ekzistues dhe nuk ka tendenca territoriale kundër askujt ndaj fqinjëve të saj edhe përkaj pretendimit të nacionalistëve ekstrem maqedonas të cilët ëndërrojnë ose flasin për Maqedoni të Madhe, realisht shteti nuk posedon kurrfarë mjetesh apo instrumente të cilët do të ishin të rrezikshme

¹⁵⁶ Për më tepër shih: Костовска, Вера; Ангеловска, Ивана; Блажевска, Марија; Димиќ, Емилија и Кипријановска, Димиќ, Состојби, решенија и мислења за предлогот на Нилиц, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008, стр. 438.

¹⁵⁷ Veto Maqedonisë fitore e nacionalizmit grek dhe si më tutje, analizë e shkurtër nr.17, Qendra për Hulumtim dhe krijim të politikave, Prill, 2008, fq. 3; cituar sipas: <http://ëëë2.mfa.gr/ëëë.mfa.gr/en/US/Policy/Geographic+Regions/SouthEastern+Europe/Balkans/Bilateral+Relations/FYROM/FYROM+THE+NAME+ISSUE.htm>.

¹⁵⁸ Po aty, fq.3; cituar sipas: <http://ëëë.iht.com/articles/2008/03/31/opinion/edbakoy.php>;

për fqinjët e vet.¹⁵⁹

Por e çuditshme ishte fakti se më 27 Dhejtor, vetëm për katër muaj nga ardhja në pushtet e partisë maqedonase VMRO-DPMNE, me kryeministër Nikolla Gruevskin, dha sinjalet e para se kjo qeveri nuk ishte e interesuar për zgjidhjen e kontestit të emrit, e aq më tepër për integrimin e Republikës së Maqedonisë në strukturat evropatlantike, e cila shihej me zhvillimin e strategjisë nacionaliste që udhëhiqej kjo parti në mbështetje të ortodoksizmit të padefinuar, me tendencë për trajtim të historisë në bazë të gojëdhënave dhe voluntarizmave shkencor të njerëzve që sakrifikojnë çdo gjë. Kjo strategji destruktive, jociwilizuese dhe antiperëndimore e Qeverisë së VMRO-DPMNE-së vendosi ta pranojë statusin e ndryshuar të ndërmarrjes për aviotransport me të cilin aeroporti i Shkupit u pagëzua “Aleksandar Veliki” (Leka i Madh), ndërsa aeroporti i Ohrit me emrin “Sveti Apostoll Pavle” (Shën Apostull Pavli). Dhe siç e kemi parë, kjo Maqedonisë i kushtoi shtrenjtë duke i dhënë alibi Greqisë për pretendimet e saja për çështjen e emrit, e që do të bëhet një nga pengesat serioze për zgjidhjen e kontestit me Greqinë.¹⁶⁰

Pra, gjatë dhjetë viteve të fundit, në Maqedoni ndodhi një nga ndryshimet më radikale të identiteti të një populli në Evropë, majde edhe në botë, të cilën ne, si dëshmitarë të historisë bashkëkohore të gjithë e dijmë se populli maqedonas që i përket grupit sllav të popujve, përnjëherë me ardhjen e Gruevskit u shndërrua në maqedonas antik! Në një popull të veçantë, ekskluziv që nuk ka lidhje me asgjë në botë. Thjeshtë, ai thurri një përrallë të bukur, të cilën për fat të keq, shumica filluan ta besojnë. Ndërsa, ata që ishin sajues dhe bartës së kësaj ideje, i keqpërdorën për marketing politik në zgjedhje.¹⁶¹

Megjithatë, para samitit të Bukureshtit, ndërmjetësuesi Metju Nimic bëri përpjekjen e fundit për të arritur një marrëveshje. Ai i thirri dy negociatorët, Nikolla Dimitrovin si dhe Adamantios Vassilakis në New York. Këto negociata dështuan, zgjidhja për emrin ishte larg. Ndërmjetësuesi Nimic edhe njëherë paralajmëroi që mos zgjidhja e kontestit për emrin mund të ketë pasoja për stabilitetin rajonal pas pavarësisë së Kosovës. E qartë gjithashtu ishte se të dy negociatorët nuk kishin asnjë mosmarrëveshje në lidhje me identitetin etnik të dy kombeve, por

¹⁵⁹ Veto Maqedonisë fitore e nacionalizmit grek dhe si më tutje, analizë e shkurtër nr.17, Qendra për Hulumtim dhe krijim të politikave, Prill, 2008, fq. 6.

¹⁶⁰ Për më tepër shih: Nesimi, Mahi, Shqiptarët e Maqedonisë dhe Ardhmëria e Shtetit, Focus Print, Tetovë, 2019, fq. 33.

¹⁶¹ Për më tepër shih: Georgievski, Ljubčo, Identiteti “Antik” na grindi me fqinjët dhe me bashkësinë ndërkombëtare!, Humbje e identitetit ose...?, CIVIL – Qendra për liri, Shkup, 2018, fq. 40.

kjo nuk kishte qenë e mjaftueshme për t'i tejkaluar këto çështje dhe se Dimitrov theksoi se Maqedonia dëshiron të anëtarësohet në NATO, por nuk mund ta pren degën ku qëndron ajo dhe të luajë me identitetin e saj kombëtar.¹⁶²

Se Maqedonia nuk ishte e angazhuar seriozisht në ndërmarrjen e masave për zgjidhjen e kontestit të emrit me Greqinë dhe se ishte e anagzhuar për një agjendë tjetër politike, dëshmojnë takimet që janë zhvilluar një javë para Bukureshtit. Nikolla Gruevski ka kërkuar nga presidenti maqedonas, Branko Crvenkovski, që të jep një sugjerim rreth emrit për t'ua dhënë amerikanëve, sepse ata gjithmonë janë ankuar se maqedonas nuk pajtohem për asnjë lloj të emrit. Me IRJM-në ishte e qartë se Maqedonia nuk kishte perspektivë dhe të gjitha përpjekjet për mbrojtjen e një emërtimi të tillë kishin dështuar si pasojë e refuzimeve të grekëve. Gruevski më në fund është pajtuar për përcaktimin “Shkupi” në kllapa edhe pas një takimi të zhvilluar në katër sy me presidentin Crvenkovski me çka ishin pajtuar që edhe një formulim i tillë të përfshihet në procesverbal që “Presidenti dhe Kryeministri ranë dakord të shkojnë me emrin Republika e Maqedonisë (Shkup) si propozimi i ynë.”¹⁶³ Por siç do të shihet më vonë edhe nga vetë rrëfimi i Crvenkovsit se kjo ide e Gruevskit ka qenë “një tullumbace provë, për të mos thënë që ne nuk jemi pro-aktiv, por të lutem askush nuk duhet ta dijë për këtë. As mediat, as askush”,¹⁶⁴ edhe pse këtë qëllim të tij e kishte kuptuar edhe vetë shefi i diplomacisë greke, Nikos Kocijas i cili deklaronte se Gruevski ka aktruar se ka dëshiruar zgjidhje për kontestin e emrit.¹⁶⁵, e nga ana tjetër përpara opinionit maqedonas paraqitej gjithmonë krenar dhe patriot se nuk dëshiron ndryshim të emrit kushtetues të RM-së, por kjo gjë u demaskua nga bombat e ish lideri të opozitës, Zoran Zaev, ku ish kryeministri Gruevski së bashku me Antonio Milloshovski dhe drejtorin e shërbimit për siguri dhe kudërzbulim, ishin përcaktuar për ndryshim të emrit në kllapa, apo me shtesat “e Epërme”, “e Poshtme” siç thotë Gruevski, por gjithmonë duke dhënë propozime që do t'i kundërshtonte pala greke, që më pas këtyre të mos “ua çanin kokën” duke u dhënë alibi grekëve si dhe ndërkombëtareve se maqedonasit janë ata

¹⁶² Për më tepër shih: Popovski, Ljupčo, Nga Bukureshti deri në Prespë: Kur Amerika hoqi duart nga Gruevski, Nga Bukureshti në Prespë, Dëshmi të një kohe Maqedoni 2008-2018, Fondacioni Shoqëria e hapur-Maqedonia, fq. 104.

¹⁶³ Po aty, fq. 108, 110.

¹⁶⁴ Po aty, fq. 108.

¹⁶⁵ Косијас: Груевски глумел дека сака решение за името, Нова Македонија, 04.09.2018, linku në dispozicion: <https://www.novamakedonija.com.mk/makedonija/politika/%D0%BA%D0%BE%D1%95%D0%B8%D1%98%D0%B0%D1%81-%D0%B3%D1%80%D1%83%D0%B5%D0%B2%D1%81%D0%BA%D0%B8-%D0%B3%D0%BB%D1%83%D0%BC%D0%B5%D0%BB-%D0%B4%D0%B5%D0%BA%D0%B0-%D1%81%D0%B0%D0%BA%D0%B0-%D1%80%D0%B5%D1%88/>, (10.06.2020).

që nuk dëshirojnë ndryshim të emrit.¹⁶⁶

Në Janar të vitit 2008 kryeministri grek Kostas Karamanlis kishte një takim me ambasadorin e atëhershëm të SHBA-së në Athinë, Daniel Speckard, për të diskutuar për samitin e Bukureshtit si dhe për çështjen e pranimit të Maqedonisë në NATO. Dihej se ky samit ishte i parapërcaktuar për zgjerimin dhe hapjen e perspektivave atlantike për Ukrainën dhe Gjeorgjinë dhe se administrata amerikane e George W. Bush-it ka bërë përpjekje të jashtëzakonshme për ta ftuar në anëtarësim në NATO, Kroacinë, Shqipërinë si dhe Maqedoninë. Nëse këto takime shihen nga perspektiva e sotme e periudhës post Marrëveshjes së Prespës duken kushte jashtëzakonisht të mira për Maqedoninë, duke pasur parasysh se propozimet në tavolinë kanë qenë për emër më të ndërlikuar siç është “e Re, e Epërme, e Veriut”, apo formula e dyfishtë e emrit, por atëherë siç dihet kanë qenë të papranueshme dhe jo të negociueshme për autoritetet e Shkupit dhe se fati i saj për samitin e Bukureshtit ishte i përcaktuar që më parë kur në këtë takim ish kryeministri grek kishte deklaruar se “pa zgjidhje, Greqia nuk do të mund ta aprovonte hyrjen e Shkupit në institucionet euro-atlantike”.¹⁶⁷

Delegacioni i madh maqedonas në Bukuresht shkoi me unitet artificial. Siç kujtohet Stevo Pendarovski, në të vërtetë atje kishte dy delegacione, njëra e kryesuar nga ish presidenti Branko Crvenkovski dhe tjetra edhe më e madhe e udhëhequr nga ish kryeministri Nikolla Gruevski.¹⁶⁸ Në mëngjesin e 2 Prillit, puna dukej so të përfundonte mirë për Maqedoninë kur ish presidenti amerikan George W. Bush mbajti një fjalim rasti para samitit, i cili ishte i qartë për anëtarësimin e Maqedonisë, Kroacisë si dhe Shqipërisë, me ç’rast u dha mbështetje të fuqishme për anëtarësim për në NATO duke i komentuar reformat e zhvilluara tanimë në këto shtete demokratike.¹⁶⁹ Por, në minutën e fundit duke e parë që samiti ka të ngjarë që të mund të dështojë anëtarësimi i vendit, liderët maqedonas u përpoqën të dilnin me një propozim kompromisi që mund ta shpëtonte ftesën. Atje u shfaq propozimi “Republika e Maqedonisë (Shkup), por siç thamë kjo ishte një lojë alibi e Gruevskit, i krijuar apostafatë për këtë situatë dhe ishte e qartë që në fillim se ky propozim nuk do të merrte ngjyrë jeshile, sepse nuk ishte si

¹⁶⁶ Për më tepër shih: Прислушувани разговори-сет 33: Преговори за името, Вистиномер, 29.01.2016, linku në dispozicion: <http://vistinomer.mk/prislushuvani-razgovori-set-33-pregovori-za-imeto/>, (10.06.2020).

¹⁶⁷ Popovski, Ljupčo, Nga Bukureshti deri në Prespë: Kur Amerika hoqi duart nga Gruevski, Nga Bukureshti në Prespë, Dëshmi të një kohe Maqedoni 2008-2018, Fondacioni Shoqëria e hapur-Maqedonia, fq. 104, 105.

¹⁶⁸ Po aty, fq. 107.

¹⁶⁹ Po aty, fq. 111.

rezultat i një bisedimi të përbashkët dhe i kordinuar me Athinën. Ky propozim në minutën e fundit, ishte konfirmim i shanseve të humbura në 15 vitet e kaluara dhe i themeleve të këqija mbi të cilën u ndërtua strategjia e politikës së jashtme të Maqedonisë. Maqedonia në këtë samit e kuptoi gabimin e saj se në Bukuresht kishte shkuar në therrtoren e vet politike, prej së cilës mezi mbijetuan.¹⁷⁰

Se administrata amerikane Bush ishte për Maqedoninë në NATO dhe për këtë gjë u përpoqën shumë por nuk arritën që ndikimin e tyre ta ushtrojnë në mënyrë të dhunshme. Për këtë dëshmon edhe takimi që është mbajtur menjëherë pas samitit të NATO-s pas pranimit të Kroacisë, Shqipërisë por që ishte e ftuar edhe Maqedonia. Bush në atë takim kishte thënë me vendosmëri “...shfrytëzoni këtë administratë amerikane. Ne po largohemi. Bëni atë që do të bëni, nëse bëni kompromis është më mirë ta bëni përpara se të jetë pushimi në Kongres. Kur Kongresi do të kthehet, ne do të hyjmë në fushatë zgjedhore. Gjithçka bllokohet. Përfitoni nga kjo administratë në largim...”. Bush, në atë takim, u sugjeroi që mos shpenzojnë shumë energji në organizimin e zgjedhjeve, por përkundrazi ta shfrytëzojnë Amerikën deri në fund të vitit. Por, si duket Gruevski kishte hartuar një plan tjetër në kokën e tij, i cili ishte organizimi i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare,¹⁷¹ dhe kjo qartë reflektohet përmes një sms mesazhi që ish lideri i VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski ia kishte dërguar një funksionari partiak në vitin 2018, gjatë fazës më të vështirë të negociatave maqedonase-greke për zgjidhjen e kontestit me emrin, “Tani e shoh sesa e rënde është të zgjidhet kjo çështje. Unë dy vite kam dhënë çdo gjë nga vetja të gjendet një zgjidhje dhe të hyjmë në NATO dhe kam pasur kujdes të mos i shqetësoj grekët (2006-2008). Pastaj, pas Bukureshtit kuptova se sido që të veprojmë, do të jetë e njëjtë. Kështu që thash, së paku të bëjmë si të duam”. Me këtë mesazh privat, Gruevski në mënyrë të thjeshtë “së paku të bëjmë si të duam”, post-festum i zbulon motivet për të gjitha hapat politike që i ka bërë pas samitit të NATO-s në Bukuresht deri në mbarimin e qeverisë së tij të fundit.¹⁷²

Dështimin që e përjetoi në Bukuresht, Republika e Maqedonisë, Gruevski e quajti atë si fitore të madhe në mbrojtje të interesave kombëtare, sepse heroikisht kishin arritur ta mbrojnë

¹⁷⁰ Popovski, Ljupço, Nga Bukureshti deri në Prespë: Kur Amerika hoqi duart nga Gruevski, Nga Bukureshti në Prespë, Dëshmi të një kohe Maqedoni 2008-2018, Fondacioni Shoqëria e hapur-Maqedonia, fq. 107.

¹⁷¹ Po aty, fq. 114.

¹⁷² Blazhevska, Katerina, Dekadë e gërryer nga ndarje dhe rilindje të dështuara, Nga Bukureshti në Prespë, Dëshmi të një kohe Maqedoni 2008-2018, Fondacioni Shoqëria e hapur – Maqedonia, fq. 74, 75.

emrin kushtetues të shtetit. Megjithëse opinioni maqedonas i traumatizuar gjatë kësaj periudhe askush me saktësi nuk dinte se çka realisht ndodhi në Bukuresht, pasi deri më atëherë nga ana e Qeverisë nuk kishte shumë detaje, për shkak se Gruevski me mjeshtëri kishte arritur t'i ruaj këto detaje, që mos të shpalosej veprimi i tij destruktiv politik që kishte ndodhur gjatë kësaj periudhe, ku do të dilte në shesh edhe sakrifikimi i emrit kushtetues që e bëri në Bukuresht në moment të fundit. Për ta shpëtuar Gruevskin prej këtij sikleti se duhej të jepte shpjegime për mospranimin e Maqedonisë në NATO, Ali Ahmeti kërkoi zgjedhjet të parakohshme parlamentare edhe përkundër sugjerimeve të presidentit Bush. Vetëm katër ditë pas samitit të Bukureshtit dhe dy ditë pas kthimit nga takimi i Gruevskit me presidentin amerikan, George W. Bush, BDI dorëzoi propozim për zgjedhje të parakohshme dhe shpërndarje të Parlamentit edhe pse këtë gjë nuk e dëshironin as Amerika, BE e askush tjetër. Të gjithë ishin në mënyrë kategorike se zgjedhjet nuk janë zgjidhje për problemin me emrin, por duhet vazhduar negociatat me Greqinë dhe se çdo gjë tjetër është humbje kohe.¹⁷³

¹⁷³ Për më tepër shih: Nesimi, Mahi, Shqiptarët e Maqedonisë dhe Ardhmëria e Shtetit, Focus Print, Tetovë, 2019, fq. 50.

KAPITULLI I TRETË
RATIFIKIMI I MARRËVESHJES SË PRESPËS
3.1. Natyra dhe statusi juridik i marrëveshjeve paqësore

Çfarë nënkuptohet me marrëveshje paqësore apo me marrëveshje ndërkombëtare? Në skenën ndërkombëtare “marrëveshjet” ndërmjet dy ose më tepër shteteve, rëndohem quhen “marrëveshje” ose “konventa”.¹⁷⁴ Marrëveshjet ndërmjet njerëzve mund të lidhen për tema të ndryshme të rëndësishme, ato si të tilla, mund të jenë të shkurtëra, të gjata, të kufizuara ose të pakufizuara në kohë dhe më së shpeshti përmbajnë dispozita të rëndësishme për ekzekutimin e tyre, zgjidhjen e kontesteve, suspendimin apo ndërprerjen e marrëveshjeve. Rregullat bazë për marrëveshjet ndërkombëtare, nuk mund të gjenden në legjislacionet nacionale, por ato gjenden në vetë të drejtën ndërkombëtare.¹⁷⁵

Neni 2 i Konventës së Vjenës për të drejtën e marrëveshjeve, marrëveshjet i definojnë si marrëveshje ndërkombëtare të formës së shkruar, të lidhura ndërmjet shteteve dhe të udhëhequra nga e drejta ndërkombëtare, shpesh herë të bazuar në një instrument të vetëm ose në dy ose më tepër instrumente të ngjashme, çfarëdo që të jetë qëllimi i saj i specializuar. Në këtë mënyrë, Konventa e Vjenës për të drejtën e marrëveshjeve ka të bëjë me marrëveshje të shkruara dhe të lidhura mes shteteve. Sidoqë të jetë, e drejta ndërkombëtare e përgjithshme pranon që mund të ekzistojnë marrëveshje gojore (orale) të detyrueshme ndërmjet shteteve edhe pse ato rrallë herë paraqiten. E drejta ndërkombëtare gjithashtu pranon që ekzistojnë marrëveshje të detyrueshme ndërmjet shteteve dhe organizatave ndërkombëtare ose ndërmjet dy ose më tepër organizatave ndërkombëtare. Definicioni i Konventës së Vjenës për të drejtën e marrëveshjeve njih që një marrëveshje mund të përbëhet jo vetëm nga një instrument i shkruar, por, nga më tepër instrumente, për shembull, këmbimi i notave diplomatike ndërmjet dy shteteve. Definicioni gjithashtu njih që një marrëveshje duhet patjetër të jetë e udhëhequr nga e drejta ndërkombëtare.¹⁷⁶

Në kuadër të studimeve më të reja që janë bërë për proceset paqësore dhe marrëveshjet që dalin nga to, studiuesit konstatojnë sesa më shumë që evoluojnë dhe

¹⁷⁴ Marfi, Shon D., Principet e së drejtës ndërkombëtare, Ars Lamina, 2012, fq. 66, cituar sipas: Statusi i Gjykatës ndërkombëtare të së drejtës, neni 38, 26 Qershor 1945.

¹⁷⁵ Po aty, fq. 66.

¹⁷⁶ Po aty, fq. 67; cituar sipas: Konventa e Vjenës për të drejtën e kontratave në mes shteteve dhe organizatave ndërkombëtare ose në mes organizatave ndërkombëtare, 21 Mars 1986, 25 I.L.M.543.

profilizohen nën-fushat për këto lloj studimesh, aq më shumë rritet llojllojshmëria e dokumenteve që krijohen si marrëveshje të paqes.¹⁷⁷ Një domosdoshmëri gjithnjë e në rritje për ta studiuar rolin e marrëveshjeve paqësore, si instrumente për përfundimin e konflikteve, erdhi në fund të viteve 90-ta. Kjo domosdoshmëri ka qenë e lidhur ngushtë me kontekstin e diversifikimit gjithnjë e më të madhe të natyrës së konflikteve në skenën ndërkombëtare, për faktin se gjatë kësaj periudhe, konfliktet me natyrë brenda shtetërore kishin filluar të bëheshin mjaft të përhapura.¹⁷⁸ Kjo kishte imponuar nevojën e ndërmarrjes konkrete të paqes, kryesisht në formë të traktateve të paqes. Në kuadër të debateve ndërmjet autorëve të së drejtës ndërkombëtare të traktateve dhe të politologëve, edhe për faktin e “mbizotërimit të dokumenteve që mund të përshkruhen si marrëveshje paqeje...termi “marrëveshje paqeje” mbetet kryesisht i papërcaktuar dhe i pashpjeguar qartë.¹⁷⁹ Me gjithë këtë, një qartësi më e madhe për marrëveshjet e paqes ofrohen përmes: a) definimit terminologjik të nocionit të tyre, b) kategorizimit të të gjitha llojeve të tyre në disa grupe kryesore, në bazë të kriterit të përmbajtjes së dispozitave të tyre dhe c) sqarimit se si deri në çfarë niveli ato marrin formë të njohura juridike, përkatësisht, “legalizohen”.¹⁸⁰

Në një vështrim më të përgjithshëm, konsiderohet se marrëveshjet e paqes ofrojnë një lloj qasje të bazuar në rregulla dhe manifestohen si vendosje e një paqeje me anë të një dokumenti shumë formal.¹⁸¹ Pra, për dallim nga paktet politike që mund të lidhin aktorët ndërkombëtarë ose thjesht dokumentet me natyrë deklaruese, traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare janë instrumente ligjërish të detyrueshme dhe që kanë mekanizma konkrete të implementimit të tyre.¹⁸² Siç mund të shihet, termi marrëveshje ndërkombëtare dhe traktat ndërkombëtar, përdoren ndërkëmbjeshëm, duke aluduar pak a shumë në të njëjtin lloj të dokumentit. Edhe pse marrëveshjet e paqes janë dokumente të legalizuara qartë, prap se prapë është mjaftë e vështirë për t’i vendosur ato brenda kategorive ekzistuese juridike të

¹⁷⁷ Për më tepër shih: Marrëveshja e Paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë: Mundësitë dhe Sfidat, Instituti Demokratik i Kosovës, Kondrad Adenauer Stiftung, Dhjetor 2019, Prishtinë, fq. 8; cituar sipas: Ghassem Bohloulzadeh, “The Nature of Peace Agreement in International Law”, *Journal of Politics and Law*; Vol. 10, No. 2; 2017, p. 208; Christine Bell: Peace Agreements: Their Nature and Legal Status, *The American Journal of International Law* – May 2008, f. 373-385.

¹⁷⁸ Po aty, fq. 8; cituar sipas: Paul R. Hensel (2001): *The More Things Change: Recognizing and Responding to Trends in Armed Conflict*: Florida State University, 2001, fq. 4.

¹⁷⁹ Po aty, fq. 8; cituar sipas: Peace Agreements, 2008, fq. 374.

¹⁸⁰ Po aty, fq. 8.

¹⁸¹ Po aty, fq. 8; cituar sipas: Bohloulzadeh, 2007, fq. 208.

¹⁸² Po aty, fq. 8; cituar sipas: Antonio Cassese (2005): *International Territorial Law* 63.

marrëveshjeve ndërkombëtare, kjo për faktin që ka një diversifikim të përmbajtjes dhe llojit të subjekteve që i nënshkruajnë ato.¹⁸³ Për ta kuptuar më mirë, studiuesit kanë vendosur disa kritere përmbajtësore që tregojnë nivelin e “legalitetit” të tyre, edhe atë: sa “juridike” është natyra e dokumentit, saktësia me të cilën është hartuar dhe sa ka përcaktuar autoritet për një palë të tretë në lidhje me interpretimin dhe implementimin e saj.¹⁸⁴

Ekzistojnë studime të ndryshme rreth nivelit të mos respektimit të marrëveshjeve paqësore në kohërat moderne, e cila rezulton të jetë shumë e lartë. Sipas një studimi, tregohet se në periudhën ndërmjet viteve 1975-2011, më shumë se 35% e marrëveshjeve paqësore të arritura, të njëjtat asnjëherë nuk janë implementuar.¹⁸⁵ Ky fakt, nxjerrë në pah dobësinë e normave dhe mekanizmave ndërkombëtare për të imponuar rregulla të sjelljes për shtetet dhe palët e tjera kontraktuese dhe tregon se në pjesën më të madhe të rasteve, çështja e implementimit të marrëveshjeve paqësore mbetet krejtësisht në diskrecion të vullnetit politik të shteteve dhe në suaza të mirëbesimit. Pavarësisht një rregulli të njohur në të drejtën ndërkombëtare, siç është *pacta sunt servanda* (marrëveshjet duhet respektuar), Karta e OKB-së (neni 2, paragrafi 2) dhe Konventa e Vjenës e vitit 1969 (neni 26) kanë paraparë dispozita që theksojnë detyrueshmërinë e palëve për t’i respektuar marrëveshjet, përkatësisht, tregimin e mirëbesimit në implementimin e tyre.¹⁸⁶

Kësisoj, duke pasur parasysh post periudhën e Bukureshtit të vitit 2008, Republika e Maqedonisë së Veriut, u fut kushtimisht thënë në një izolim ndërkombëtar, pa perspektivë të qartë evropiane si dhe ndërkombëtare, andaj nevoja për zgjidhjen e kontestit të emrit ishte nevojë imanente e vetë shtetit për të dalë nga gremina në të cilën ishte futur vite me radhë, për t’u rikthyer përsëri në skenën ndërkombëtare, më e fuqishme, më stabile dhe me perspektivë të qartë evropiane. Është e rëndësishme të jepen shpejgime mbi marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe statusin e tyre në sistemin juridik të shtetit përkatës, për shkak të kronologjisë së ngjarjeve që do të rrjedhin në Maqedoninë e Veriut, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Prespës si dhe mbi polemikat e hapura ndaj saj, kontestimi i statusit legal, juridik-kushtetues të marrëveshjes si

¹⁸³Marrëveshja e Paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë: Mundësitë dhe Sfidat, Instituti Demokratik i Kosovës, Kondrad Adenauer Stiftung, Dhjetor 2019, Prishtinë, fq. 9; cituar sipas: Bell, p.379.

¹⁸⁴Po aty, fq. 9; cituar sipas: ibid, p. 385.

¹⁸⁵Po aty, fq. 9; cituar sipas: Peace Agreements 1975-2011, f.53.

¹⁸⁶Po aty, fq. 9, 10.

dhe dhënia e statusit të qartë dhe karakterit të saj në sistemin juridik maqedonas, duke i dhënë cilësim dukshëm asaj në drejtim të konsiderimit si burim formal “sui generis” i së drejtës kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Së këndejmi, Marrëveshja e Prespës e 17.06.2018, që është edhe vet objekt i elaborimit të kësaj teme, cilësohet si marrëveshja më e rëndësishme në historinë e vendit, përkatësisht si dokumenti që ka hapur rrugën e perspektivës evro-atlantike të vendit, gjë që do të flasim më tepër në ngjarjet në vijim.

Ngjashëm si Marrëveshja e Prespës, në të drejtën ndërkombëtare të krahasuar, ekzistojnë katër shembuj të marrëveshjeve që kanë pika të përbashkëta me këtë marrëveshje: Good Friday Agreement (10 Prill 1998), Treaty of Guarantee (1960), Marrëveshjet e Osmos si dhe Oslo Agreement (1993). Këto marrëveshje kanë pika të përbashkëta me Marrëveshjen e Prespës të cilët e kanë relevancën e vet në kuptimin metodologjiko-indoktrinuar. Të gjitha këto shembuj kanë dimensionin kohor, përkatësisht, faktin notor historik të vërtetuar se për arritjen e zgjidhjeve të tilla komplekse janë të nevojshme përpjekje të mëdha diplomatike si dhe kohë. Të gjitha këto marrëveshje të arritura dhe zgjidhjet e tyre në krahasim me Marrëveshjen e Prespës kanë përfundim të pakontestuar, sepse për çështje të tilla koha për negociim si dhe për lidhjen e marrëveshjeve matet me decenie, si dhe në raste të tjera me shekuj.¹⁸⁷ Megjithatë, Marrëveshja e Prespës ngelet një ndër marrëveshjet më specifike në sferën ndërkombëtare, duke u konsideruar si burim formal “sui generis” i së drejtës kushtetuese të RMV-së ashtu siç është Marrëveshja Kornizë e Ohrit (MKO) e 13.08.2001 apo siç është Marrëveshja e Dejtonit e vitit 1995 si burim formal i së drejtës kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës, Rezoluta 1244 e KS të OKB-së e vitit 1999 me të cilën përcaktohej përkohësisht statusi i Kosovës apo Marrëveshja e Cyrihut e vitit 1960 e cila konsiderohet si burim formal i së drejtës kushtetuese të Qipros, Pakoja e Ahtisarit e vitit 2007 si burim formal i së drejtës kushtetuese të Republikës së Kosovës, etj.¹⁸⁸ Pra, siç shihet të gjitha këto marrëveshje përbëhen prej normave ndërkombëtare jus cogens (imperative), si pasojë e të cilave të gjitha shtetet kanë

¹⁸⁷ Për më tepër shih: Во Преспанската спогодба пресликани и „Велики петок,,, „Кипар,,, „Осло,,, „Дејтон,,, Елисејскиот договор..., Нова Македонија, 29.01.2019, linku në dispozicion:

<https://www.novamakedonija.com.mk/makedonija/politika/%D0%B2%D0%BE-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%81%D0%BF%D0%B0%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D1%81%D0%BF%D0%BE%D0%B3%D0%BE%D0%B4%D0%B1%D0%B0-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%81%D0%BB%D0%B8%D0%BA%D0%B0%D0%BD%D0%B8/>, (25.06.2020).

¹⁸⁸ Për më tepër shih: Shasivari, Dr., Jeton, E drejta kushtetuese, Libri I, (Botimi i parë), Furkan ISM, Shkup, 2015, fq. 57, 58.

detyrueshmëri juridike për zbatimin e tyre.

3.2. Procesi i normalizimit të marrëdhënieve mes Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë

Pas humbjes që e përjetoj Maqedonia e Veriut në Bukuresht, pozita e saj shtetërore tashmë ishte e qartë në krye me ish kryeministrin e saj, Nikolla Gruevski, pas taktizimeve që i bëri në lidhje me zgjidhjen e çështjes së emrit. Edhe pse gjatë asaj periudhe, Maqedonia parashtrojë padi ndaj Greqisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, konform Marrëveshjes së Përkohshme mes Greqisë, mbi përdorimin e vetos në Samitin e Bukureshtit, gjë që kemi folur në kapitujt më lartë. Gjykata vendosi në favor të Maqedonisë së Veriut, për shkak të shkeljes së Marrëveshjes së Përkohshme nga ana e Greqisë dhe kjo më tepër ua ledhatoi “sedrën” maqedonasve duke ju dhënë të drejtë në insistimin e tyre për pranim në organizatat ndërkombëtare pa zgjidhur çështjen e emrit dhe kështu duke fajësuar Greqinë për përdorimin e vetos dhe bllokimin e Maqedonisë së Veriut në integrimin në strukturat evro-atlantike.

Edhe përkaj bisedimeve të Nikolla Gruevskit në Uashington me zëvendës presidentin e atëherëshëm të SHBA-së Xhon Bajden dhe sekretarin e shtetit, Hillari Klinton në shkurt të vitit 2011, u bë e qartë se Gruevski nuk e kishte ndërmend zgjidhjen e kontestit, me çka rezultoi në shkrirjen e mbështetjes amerikane ndaj kësaj çështjeje si dhe ndaj qeverisë së Maqedonisë së Veriut në krye me kryeministrin e saj. Vlen të përmendet se në atë kohë, Gruevski po realizonte projektin faraonik “Shkupi 2014”, duke krijuar një histori të rremë të Maqedonisë, duke pretenduar në një lashtësi të pakuptimtë, tendeca e së cilës ishte instalimi i një identiteti të ri të maqedonasve, me çka edhe më tepër i acarroi marrëdhëniet mes Greqisë si dhe fqinjit të saj lindor, Bullgarisë dhe më tragjikja gjatë regjimit të tij autoritarë, mbështetja e ndërkombëtare sa vinte e zbehej.¹⁸⁹ Në këtë krahurë politike dhe mosperspektivës së Maqedonisë drejt strukturave evro-atlantike, prodhuan kriza të ndryshme në shtet që dërguan drejt destabilizimit të saj dhe pas publikimit të bombave nga opozita e atëherëshme maqedonase, LSDM, qytetarët maqedonas shpresën e vetme për shpëtimin e këtij shteti ia besuan kryetarit të saj, Zoran Zaev.

Zoran Zaevi, gjatë kësaj periudhe pas marrjes së pushtetit e deri te nënshkrimi i Marrëveshjes së Prespës, ka qenë ashpër i sulmuar nga opozita maqedonase, VMRO-DPMNE,

¹⁸⁹ Për më tepër shih: Popovski, Ljupço, Nga Bukureshti deri në Prespë: Kur Amerika hoqi duart nga Gruevski, Nga Bukureshti në Prespë, Dëshmi të një kohe Maqedoni 2008-2018, Fondacioni Shoqëria e hapur – Maqedonia, fq. 117.

për shkak të mos realizimeve të premtimeve që i dha gjatë fushatës parazgjedhore, por për hir të së vërtetës duhet thënë se politika e tij qeveritare më tepër u fokusua në politikë të jashtme, gjë që i shpenzoi mjaftë energji për të zgjidhur marrëdhëniet ndër-fqinjësore si dhe zgjidhjen e kontestit të emrit.

Në atë krahurë politike, mospërfundimi i traktatit me Bullgarinë, kriza e madhe që e kishte kapluar vendin nga shpallja e “bombave” të opozitës, negociatat dramatike pragmatike, qeveritë teknike, vonesat në zgjedhje, rezultati i pasigurtë i votës, bllokimi i Parlamentit dhe ndërhyrja e përgjakshme e 27 prillit e vitit 2017, kur u bë kryeministër Zoran Zaevi më 1 Qershor 2017, askush nuk e priste që ditën e nesërme të dilte me traktat paqeje, me fqinjët e tij për të hequr dy problemet më të mëdha të politikës së jashtme, nga të cilët do të varej e ardhmja evropiane e shtetit. Nga struktura të caktuara, e sidomos nga partia maqedonase, VMRO-DPMNE, ai fitoi epitetin “tradhtar kombëtar”, kurse për të tjerët si njeri me guxim të jashtëzakonshëm dhe vizionar. Fakti më i rëndësishëm në lidhje me Zaevin është se në Sofje dhe Athinë ishin dy njerëz që ishin të gatshëm të linin mënjane mitet dhe paragjykimet historike nacionale dhe të formësonin trekëndëshin vizionar që do të hapte një derë të re në rajon, të forcojë sigurinë dhe të vendos horizonte të reja për perspektivat. Nëse nuk do të ishte Bojko Borisovi dhe Aleksis Ciprasi, asnjë nga planet e Zoran Zaevit nuk do të realizoheshin.¹⁹⁰

Pas përmirësimit të marrëdhënieve mes shtetit bullgar rreth çështjeve historike, me ç’rast rezultoi me marrëveshje bilaterale mes dy shteteve, Zoran Zaevi kujtohet se ka biseduar me Bojko Borisovin dhe e ka nxitur atë të bisedojë me Aleksis Ciprasin i cili më pas të njëjtin e ka nxitur që të jetë i hapur për zgjidhjen e kontestit me dekada me Maqedoninë dhe se tani ekziston një shans i madh në këtë drejtim dhe nuk dihet se a do të ketë mundësi të tjera në të ardhmen. Ai bisedoi me Ciprasin në disa raste për ta inkurajuar dhe duke qenë se ai ka qenë i afërt me kancelaren gjermane Angela Merkel, edhe ajo ka ndihmuar mbi këtë çështje në këtë drejtim. “Me mua dhe besoj te populli ynë, ndihma e tij do të mbahet mend për marrëveshjet që kemi lidhur me Bullgarinë dhe Greqinë”, kujtohet kryeministri maqedonas Zaev.¹⁹¹

Zoran Zaevi, thotë se gjithçka në të vërtetë është zgjidhur në takimin e tij të parë me

¹⁹⁰ Popovski, Ljupço, Nga Bukureshti deri në Prespë: Kur Amerika hoqi duart nga Gruevski, Nga Bukureshti në Prespë, Dëshmi të një kohe Maqedoni 2008-2018, Fondacioni Shoqëria e hapur – Maqedonia, fq. 130, 131.

¹⁹¹ Po aty, fq. 132.

Ciprasin në Davos më 24 Janar 2018, gjatë Forumit Ekonomik Botëror. Në atë takim është vendosur që të gjindet një zgjidhje, që të dyja vendet të bëhen partnerë dhe miq dhe se negociatat e mëtutjeshme të udhëhequr ministrat e jashtëm, kishin për qëllim vetëm të rivendosnin rrugën që kishin përcaktuar të dy kryeministriat. Ky fakt i paralajmëruar nga Zaev, hedh një dritë krejt të re në tërë procesin dhe përfundimin e tij në Prespës. Ai tregon gjithashtu, se në rajonin e mbushur me mosbesim, dyshim, zgjim, shtrembërim, përvetësim, urrejtje, nacionalizëm dhe hijet e errëta të së kaluarës, dy udhëheqësit e rinj, të pa ngarkuar nga mitet nacionale, në një çast mund të vendosnin mbi të ardhmen e të dy kombeve, përderisa në shpinë mbajnë kamxhikët e tradhtisë kombëtare. Sigurisht, për të marrë vendime të tilla në Davos duhej të ndodhnin edhe mposhtje edhe fitore dhe qorrsoqatet dhe perspektivat, duhej të vizatoheshin ai rreth i marrëzive për të provuar absurditetin e tij. “I hapëm shpirtërat dhe besoj se këtu është arritur një marrëveshje.”, kujtohet Zaev. “Në ato dy orë kur ishim vetëm, thashë atë që ishte e rëndësishme për ne – çështjen e identitetit, gjuhës, bashkëpunimit dhe më pas kërkoja një parnteritet...” Aleksis Cripas, ka kërkuar tri gjëra të rëndësishme për Greqinë, një emër të përbërë me një përcaktim gjeografik dhe “erga omnes”. Këtu kanë hasur në dallime në lidhje me çështjen e identitetit dhe në vërejtjet e tyre. “Unë atëherë kuptova se çdo zgjidhje që nuk është një “erga omnes” nuk është përfundimisht një zgjidhje. Do të shkaktojë probleme të reja, veçanërisht me anëtarësimin në BE dhe NATO. Është vështirë të bëhet dallimi midis përdorimit domestik dhe përdorimit të jashtëm. Këto janë grindje të reja. Këtu ishin shkeljet.” – thotë Zaev.¹⁹² Për të sqaruar më mirë se si ka ardhur deri te zgjidhja e kontestit të emrit, zbulohet përmes bisedës që e ka zhvilluar Zaev me Ciprasin.

Ai e ka pyetur se “Aleksis, çfarë je ti?”, ai është përgjigjur se është “grek”. “A je me të vërtetë grek apo ke ndonjë rrënjë tjetër?” ka pasuar pyetja e Zaevit. Në këtë pyetje, Ciprasi është përgjigjur: “Gjyshi im në anën e nënës sime, kështu që babai i saj është nga Kavala dhe ishte maqedonas.” Zaev i ka thënë se “Epo, ti do të thuash se je maqedonas?” Ai thotë: “Jo, unë jam grek.” “Epo të paktën ju jeni gjysma maqedonas” ka vazhduar Zaev. “Jo Zoran, unë jam grek”, është përgjigjur ai gjatë gjithë kohës. Më në fund, Zaevi ka vazhduar se “Në rregull, je grek, por më lër të jem maqedonas. Ajo ndjenjë e përkatësisë kombëtare nuk zgjidhet me asnjë

¹⁹² Për më tepër shih: Popovski, Ljupço, Nga Bukureshti deri në Prespë: Kur Amerika hoqi duart nga Gruevski, Nga Bukureshti në Prespë, Dëshmi të një kohe Maqedoni 2008-2018, Fondacioni Shoqëria e hapur – Maqedonia, fq. 134, 135.

marrëveshje.” Këtu është përckatuar e drejta e vetëvendosjes. Kundërshtimi i tyre ka qenë që gjuha maqedonase duhet të dallohet qartë, siç është regjistruar nga Kombet e Bashkuara më 1977, se ajo është pjesë e gjuhëve sllave. “Këtu kemi zgjidhur pjesën e çështjeve të identitetit. Në rrethana të tilla, unë atëherë kuptova se ne mund të kërkonim atë që donim, por që të kalonte traktati, zgjidhja duhet të jetë e përhershme dhe për çdo përdorim, sepse, për shembull, nëse Komuna e Dojranit i drejtohet Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale me një kërkesë për një projekt specifik që përfshin paratë evropiane, si do të komunikojmë, me emrin për përdorim vendas apo ndërkombëtar? Është një problem sepse nuk mundesh, kur të bëhesh anëtarë i BE-së, të dallosh atë që është në shtëpi, çfarë është jashtë dhe ne do të kishim përsëri probleme, ndërsa Greqia ka të gjitha mjetet për të na bllokuar edhe më tutje. Kështu që, gjithçka do të prisheshte këtu. Biseda aktuale që dërgoi në marrëveshje u zhvillua në Davos.”, kujtohet Zaevi.¹⁹³ Pra, nga biseda më sipër siç shihet, ai është treguar tepër i kujdesshëm duke pasur parasysh pranimin e një zgjidhjeje të emrit “erga omnes”, e cila do të dërgonte në zgjidhje përfundimtare të problemit që nesër në të ardhmen mos të lindin konflikte të reja, nëse do të aplikohet “formula e dyfishtë e emrit” që e kemi konsumuar në kaptujt më herët.

Zoran Zaev, pretendon se nuk ka pasur ndonjë ndihmë nga miqtë dhe partnerët nga jashtë dhe as që ka pasur presion të rëndësishëm për të nënshkruar marrëveshjen. Sipas tij, nuk ishte as më shumë e as më pak se ajo që i ishte ofruar Gruevskit. “Nuk kishte negociator të fshehtë që shkonte tek ai, e pastaj te unë që të dërgonte mesazhe.” Marrëveshja ka lindur në të vërtetë në bisedimet bilaterale midis dy vendeve dhe “Metju Nimic me të gjithë ekspertët juridik rreth tij i ka bërë formulimet ligjore ndërkombëtare që janë sot në marrëveshje. Por, dikush duhej t’ia tregonte thelbin e asaj për të cilën u dakorduam.” Ai nuk e mohon as që SHBA-të, Gjermania dhe Britania e Madhe në mënyrë të vazhdueshme i kanë inkurajuar të arrijnë një marrëveshje, por kjo nuk ka qenë presion sipas tij. “Kam pasur biseda të gjata me Wes Mitchell (asistent sekretari i shtetit), i cili më inkurajoi që ta bëja këtë veprim dhe unë e di se ai kishte të njëjtat biseda me Ciprasin.¹⁹⁴

Zaev thotë se ka pasur në tavolinë edhe shumë propozime tjera për emrin e Maqedonisë

¹⁹³ Për më tepër shih: Popovski, Ljupço, Nga Bukureshti deri në Prespë: Kur Amerika hoqi duart nga Gruevski, Nga Bukureshti në Prespë, Dëshmi të një kohe Maqedoni 2008-2018, Fondacioni Shoqëria e hapur – Maqedonia, fq. 135.

¹⁹⁴ Po aty, fq. 136.

së Veriut si ajo e Ilindenit, Veriore, E Epërme, E Re apo emër të ngjitur si “Maqedonia-e-re” apo “Verimaqedoni”. Por, sipas tij këto kanë qenë të papërdorshme dhe se pjesën më të madhe të kohës e kanë kaluar duke biseduar për linjën e identitetit, të emrit të ri. “Kulmi i negociatave ishte kur konfirmuam se me marrëveshje do të bëhem Kryeministër i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Do të flas në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, por do të flas për ekonominë maqedonase, do të flas për një vajzë maqedonase, një hero maqedonas, një fshat maqedonas. Ka të bëjë me identitetin. Do të jetë një Ministri e Shëndetësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, por do të ketë Shëndetësi në Maqedoni.” Gjithashtu në këtë takim është rënë dakord që ata shoqata që nuk kanë lidhje me financimin e shtetit, pra buxhetit, atëherë shteti nuk do të përzihet në identitetin e tyre është e drejtë e tyre. Këtu pra, kanë qenë formulat e demarkacionit. Andaj, siç thotë Zoran Zaev, “Unë besoj se kjo marrëveshje me të vërtetë mund të jetë një mjet për rajone tjera të botës për të adresuar çështje të tilla.” Dhe së fundmi, kur është hapur tema mbi nënshkrimin e marrëveshjes, janë pajtuar që ajo të nënshkruhet në Prespës, në pjesën greke, sepse për Ciprasin kjo ka qenë me rëndësi për shkak të historisë së tyre që ka të bëjë me atë maqedonase mbi komunistët dhe socialistët që kanë luftuar kundër fashizmit,¹⁹⁵ dhe këtu shihet qartë se pala greke është e prirur ndaj luftëtarëve të luftës antifashiste dhe nacional-çlirimtare të udhëhequra nga Maqedonia. Ajo d.m.th, që partia e Ciprasit SIRIZA i respekton luftëtarët e ELAS dhe DAG, në radhët e së cilëve kanë luftuar edhe një numër i madh i maqedonasve. Këtë e vërteton edhe Aleksis Cipras në fjalimin e tij që e ka mbajtur më 25 Janar 2019 në Parlamentin grek përpara se të mbahet votimi mbi ratifikimin e Marrëveshjes së Prespës.¹⁹⁶

Përpara se të përcaktohet emri i Maqedonisë në atë të Maqedonisë Veriore, një ndër emrat që u bisedua me të madhe në opinion dhe pati reagime të ndryshme ishte propozimi mbi emrin “Republika e Maqedonisë Ilinden”. Ky emër ka rezultuar në bisedime se vështirë mund të përkthehet në gjuhën angleze dhe siç thuhet ishte një tullumbace për provë për ta ndejtur pulsën e popullatës. Këtë propozim e ka dhënë Nikolla Dimitrov, gjë që edhe Ciprasi e ka pranuar këtë emër. Refuzimi i këtij emri më pas u bë shkas për përcaktimin e parashtresës gjeografike

¹⁹⁵ Për më tepër shih: Popovski, Ljupço, Nga Bukureshti deri në Prespë: Kur Amerika hoqi duart nga Gruevski, Nga Bukureshti në Prespë, Dëshmi të një kohe Maqedoni 2008-2018, Fondacioni Shoqëria e hapur – Maqedonia, fq. 137.

¹⁹⁶ Për më tepër shih: Шкарик, Светомир, Уставните амандмани се политичко а не стручно дело, Respublica, 12 февруари 2019, linku në dispozicion: <https://respublica.edu.mk/mk/blog/2019-02-12-08-41-03>, (25.06.2020).

“Veriore”. Zaeu këtë moment e përkujton me fjalët “Atëherë u dukë se negociatat do të dështonin. Më duhet të them që ishte një dramë e vërtetë disa herë, kur kishim lot këtu në Shkup, kur u dukë se dështimi i negociatave ishte i pashmangshëm. Ishte shumë e vështirë. Kishte një kohë kur së pari shkruanin për marrëveshjen e mundshme dhe ne u kthyem me tekstin tonë brenda një ore. Tekstet ishin ekstreme. Dhe ato janë ndoshta pozicionet e para të shkruara të të dyja vendeve...Kur rra “Maqedonia e Ilindenit” kishte periudha të vështira, por më pas doli në sipërfaqe dëshira për të gjetur një zgjidhje dhe si ta arrinim atë. Përcaktimi mbi propozimin “Republika e Maqedonisë së Veriut” është bërë më tepër për shkaqe pragmatike edhe pse ka pasur sugjerime edhe mbi propozime tjera si “E Epërme”, “Vardarit”, “E Re”, andaj përcaktimi mbi këtë emër ka qenë një zgjidhje shumë e matur dhe shumë progresive. Nuk ka dëmtuar asnjërën palë, përveç nacionalistët.¹⁹⁷

Marrëveshje e Prespës përveçse ka krijuar një miqësi të jashtëzakonshme midis dy politikanëve, të cilët deri atëherë jo vetëm që nuk e kuptonin njëri-tjetrin, por nuk kishin as dëshirë të kuptoheshin. Kështu, lindi një partneritet të ri në Ballkan midis të dyjave vendeve deri më tani të tjetërsuara dhe kjo është ndoshta një nga përfitimet më të mëdha mes të dyja vendeve përmes kësaj marrëveshjeje. Cipras gjatë asaj periudhe ka informuar Zaeuin në samitin e Ballkanit Perëndimor në Londër se ai ka dëshiruar t’i dëbojë dy diplomatë rusë “sepse ata duan të prishin marrëveshjen time me juve. Ata kanë kapërcyer kufirin e kuq me përzierjen”.¹⁹⁸ Pra, kjo situatë pasqyron qartë gjendjen që ka mbizotëruar në atë kohë kur edhe forcat ruse janë implikuar dhe janë munduar me çdo kusht të krijojnë obstrukcione për parandalimin e arritjes së një marrëveshjeje që do të zgjidhte kontestin me emrin. Por, këtu vjen në pah edhe sinqeriteti dhe vullneti i mirë mes të dyja palëve për arritjen e marrëveshjes, duke treguar konsistencë përpara këtyre forcave dhe specifikën e marrëdhënieve që kanë ekzistuar mes të dy kryeministrave të vendeve nënshkruese.

Përpjekje të tilla në vendin tonë të cilët janë angazhuar për dështimin e arritjes së marrëveshjes me Greqinë ka pasur nga nacionalistët e mbledhur rreth partisë opozitare maqedonase VMRO-DPMNE si dhe parti të tjera të vogla, të cilët shquhen për orientimin e tyre

¹⁹⁷ Për më tepër shih: Popovski, Ljupço, Nga Bukureshti deri në Prespë: Kur Amerika hoqi duart nga Gruevski, Nga Bukureshti në Prespë, Dëshmi të një kohe Maqedoni 2008-2018, Fondacioni Shoqëria e hapur – Maqedonia, fq. 138, 139.

¹⁹⁸ Po aty, fq. 141.

të pastër pro lindor, rrjedhimisht pro rus, u paraqitën që në fillim të procesit e veçanërisht pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Prespës më 17 Korrik 2018, kur radikalët e partive në fjalë organizuan disa protesta të dhunshme, me qëllim t'u kundërshtohen përpjekjeve të Qeverisë për tejkalimin e kontestit.

Hapi i parë që solli drejt arritjes së Marrëveshjes së Prespës, ishte Marrëveshja e Përkohshme me Greqinë e 13 shtatorit të vitit 1995, por kjo nga vet emri mund të kuptohet se ishte marrëveshje e përkohshme deri në arritjen e zgjidhjes së emrit, por siç e kemi parë kjo marrëveshje nuk u respektua as nga ana e Greqisë e as nga ana e Maqedonisë së Veriut edhe pse përmes presioneve diplomatike rritej numri i njohjeve nën emrin kushtetues të vendit, me qëllim që në këtë mënyrë të ushtrohej presion mbi Greqinë. Por, kjo politikë problematike nuk arriti t'i zgjidh problemet, posaçërisht duke pasur parasysh bllokimin e vendit në NATO dhe BE dhe u thellua edhe më tepër mosbesimi i ndërsjellë. Kulminacionin konflikti e arriti në kohën e partisë VMRO-DPMNE, dhe që nga atëherë kontesti me emrin u shndërrua në kontest të ndjejtshëm të identitetit, sepse gjenerata e re e njerëzve u rrit dhe u edukua me mitin se ata janë pasardhës të drejtpërdrejtë të Lekës së Madh, gjë që dëshmohet me vendosjen e përmendorës në sheshin kryesor të Maqedonisë në Qendrën e Shkupit. Problematike gjithashtu për Greqinë ka qenë shfaqja e simboleve, flamuri i Vergjinës, përmendorja e Aleksandrit dhe Filipit, emërtimi i rrugëve, shkollave, autostradave, objekteve sportive dhe objekteve tjera në bazë të emërtimeve të mbretërve të lashtë si Aleksandri, Filipi, Aminta II, tendenca e së cilës ishin përvetësimi i historisë dhe krijimi i një historie të re, për të treguar origjinën e maqedonasve si të lashtë helene dhe në këtë mënyrë pretendimin e tyre për territorin e Maqedonisë së Egjeut, që për Greqinë ishte absolutisht e papranueshme. Kjo politikë të “madhe maqedonase” u mbështetën nga persona të ndryshëm të cilët kishin interesa personale, si për shembull, sipas Mirjana Maleskës, një nga këshilltarët e kryetarit të shtetit, kishte thënë “Do të bëjmë këmbim me Greqinë – ne do t'ua kthejmë antikën, kur të vjen momenti, e ata ne – emrin e shtetit”. Gjithashtu, një funksionar tjetër në pushtetin e kaluar të VMRO-DPMNE-së, me gjasë projektin “Shkupi 2014” e kanë bërë me qëllim tërheqjen e turistëve dhe për përfitim të parave. Duke qenë albanofob, ka besuar në njëfarë bashkimi mes Greqisë dhe Maqedonisë, e cila sipas tij do të ndihmonte që të çlirohej nga shqiptarët, të cilët, sipas tij janë “gurë në qafë” dhe se

profesorët me kënaqësi do të ligjëronin në Selanik! Pra, siç shihet asnjë nga intelektualët dhe profesorët maqedonas të cilët janë angazhuar rreth idesë së Gruevskit nuk kanë menduar për çmimin që duhet paguar për një politikë të tillë, të rrezikshme dhe sipërfaqësore. Ata ishin me pushtetin, arkën shtetërore e kishin në dispozicion si dhe shpërblime të caktuara si pozita ambasadorësh dhe privilegje të tjera. Sipas Mirjana Malekës, në bisedë në lidhje me këtë temë me një diplomatë të lashtë grek në një atmosferë miqësore ka thënë se Greqia nuk ka problem me njerëz të matur dhe të mençur, “Ne duam të nxjerrim në pah irredentizmin dhe nacionalizmin tuaj ekstrem”.¹⁹⁹

Sipas Ljubço Georgievskit, në nivel psikologjik, kombi maqedonas u ngrit mbi të gjithë, duke hyrë në filma se ata janë qendra e botës, se çdo gjë rrotullohet rreth tyre, se askush nuk mundet nga maqedonasit, por që sipas tij, bota gjallnon edhe pa prezencën e tyre, e aq më tepër pa kuazi shkencëtarë që shkruanin libra dhe xhironin filma dokumentar mbi këtë temë. E gjithë kjo, sipas tij, ishte një kauzi-shkencë e cila thjeshtë i bombardoi dhe u shkaktoi pasoja afatgjate e cila u zvarrit shumë vite pas këtyre ngjarjeve.²⁰⁰

Sipas Gordana Siljanovska – Davkova, “Maqedonia e Veriut” ka qenë propozim gjerman i vitit 1944 sipas njoftimeve që i kanë bërë mediumet greke. D.m.th., ministri i punëve të jashtme i Republikës Socialiste të Gjermanisë, z. Klaus Kinkel, së bashku me planin gjashtë pikësh për zgjidhjen e kontestit, ka propozuar dy emra të mundshëm: Maqedonia e Re dhe Maqedoni e Veriut.²⁰¹

James Petiffer, profesori i Oksfordit mbi arritjen e Marrëveshjes së Prespës, thotë që 27 vjet më pas, fatkeqësisht BE dhe NATO kanë përjetuar bankrot moral në rastin e Republikës së Maqedonisë me imponimin e Marrëveshjes së Prespës dhe se çdo qytetar i dinjitetshëm i Republikës së Maqedonisë do të duhej ta refuzon.²⁰² Profesoresha maqedonase, Gordana Siljanovska – Davkova e sheh këtë marrëveshje si të padrejtë si dhe emrin e shtetit si element esencial për personalitetin juridik si e drejtë esenciale dhe si e tillë, ajo është *stricto sensu* dhe

¹⁹⁹ Për më tepër shih: Maleska, d-r, Mirjana, *Rruga drejt normalizimit të marrëdhënieve me Greqinë është e hapur!*, Humbje e identitetit ose...?, CIVIL – Qendra për liri, Shkup, 2018, fq. 28, 29, 30.

²⁰⁰ Georgievski, Ljubço, *Identiteti “Antik” na grindit me fqinjët dhe me bashkësinë ndërkombëtare!*, Humbje e identitetit ose...?, CIVIL – Qendra për liri, Shkup, 2018, fq. 41.

²⁰¹ Давкова – Сиљановска, Гордана, За „Преспанскиот договор,“ и пошироко, стр.б; cituar sipas: Мишо Докмановиќ., *Политиката на соседните земји во однос на осамостојувањето на Република Македонија, Годишник на Правниот факултет „Јустинијан Први“*, Скопје, том 42, 2006, стр. 679.

²⁰² По ату, fq. 9; cituar sipas: James Petiffer., *Time for Macedonia to Put End to Negotiations with Greece.*

është kompetencë e saj e brendshme dhe jo e drejtë e shtetit tjetër apo ndonjë organizate multilaterale siç është OKB-ja²⁰³, këtu duke nënvizuar një shembull se deri më 1988, Greqia asnjëherë në asnjë formë zyrtare nuk e ka përdorur emrin Maqedoni. Provinca e saj veriore është quajtur Greqia Veriore dhe jo Maqedoni. Kjo provincë e ka ndryshuar emrin madje në vitin 1988 edhe atë me dekret të ministri të parë dhe jo me ligj ose me vendim të Parlamentit. Interesi grek për Maqedoninë rritet në vitin 1977 me zbulimin e varrit të Filipit në vendin Kutlesh (Vergjina) në pjesën e Maqedonisë së Egjeut nga ana e profesorit prej Selaniku për arkeologji dhe art, Manolis Andronikos. Sot fjala Maqedoni, dominon absolutisht në fjalimet politike dhe në mediumet publike në Greqi. Interesante është fakti se në Shkup një kohë të gjatë ka punuar një konzul i Republikës së Greqisë i cili asnjëherë nuk i ka ikur emrit zyrtar të Republikës së Maqedonisë. Për herë të parë, Republika e Greqisë fillon ta konteston emrin Maqedoni, që nga fillimi i vitit 1992, përkatësisht, në kohën kur Republika e Maqedonisë definitivisht pavarësohet si shtet i pavarur dhe sovran.²⁰⁴

Pëfundimisht me arritjen e Marrëveshjes së Prespës, zhduket emri i përkohshëm “IRJM” që ka gravituar dhe ka qenë e njohur nga 137 shtete në botë, gjë që sipas profesorit maqedonas Svetomir Shkariç ajo nuk ka qenë emër në esencë, por referencë e cila nuk ka treguar asgjë tjetër, përveç se shteti maqedonas dikur ka qenë njësi federative në Federatën Socialiste të Republikës së Jugosllavisë. Referenca si e tillë ka qenë qesharake, por ja që pa atë shteti maqedonas nuk ka mundur të pranohej në OKB.²⁰⁵

Në këtë kontekst, këtu vjen në shprehje koncepti i real-politikës të cilin për herë të parë e ka zhvilluar shkrimtari dhe politikani gjerman Ludwig Von Rochau në vitin 1853. Akoma edhe më i njohur është punimi i vitit 1948 i amerikanit Hans Morgenthau, të cilëve më vonë u bashkangjitet edhe një amerikan tjetër, Kenneth Thompson. Sipas tyre, një shtet nuk e ka “luksin” e individëve që ta viktimizojnë shtetin për interesa personale ose ta viktimizojnë vetën për shtetin, për shkak se aksioni i suksesshëm politik duhet para së gjithash dhe mbi të gjitha të

²⁰³ Давкова – Сиљановска, Гордана, За „Преспанскиот договор,, и пошироко, стр. 6; cituar sipas: Henkin, Pugh, Scharter, Smit, International Law, Cases and Materials, Third Edition (Minnesota 1993): p.253.

²⁰⁴ По ату, fq. 15; cituar sipas: Светомир Шкариќ., Национални извештаи за Четвртиот Светски конгрес на Меѓународното здружение за Уставно право, Скопје, 1995, „Името Македонија во грчко-македонските односи,, стр. 96-97.

²⁰⁵ Шкариќ, Светомир, Без Договорот со Грција, Македонија и натаму ќе остане без државно име на меѓународен план, Respublica, 22 август 2018, linku në dispozicion: <https://respublica.edu.mk/mk/blog/2018-08-22-08-12-53>, (25.06.2020).

bazohet në principin e mbijetesës nacionale.²⁰⁶ Maqedonia e Veriut, ka qenë e penguar përpara dilemës: dëshirës për “një shtet” dhe real-politikës (sikur thënia popullore: “bishtin ndër shalë”), që nga largësia e vitit 1936, atëherë kur paraardhësit e maqedonasëve e kanë zgjidhur në mënyrë të drejtë dhe pragmatike këtë çështje. Gjatë rrugës së gabimit të qëllimshëm ose “pars pro toto” si fikcion juridik dhe politik, ata e kanë ditur se kjo pjesë e Maqedonisë nuk është e njëjta me krejt Maqedoninë. Vendimi i tyre është dëshmuar si i drejtë. Fundi fundit, nëse është pritur ose pranuar një variantë ekstreme, ndoshta edhe sot nuk do të kishim shtet nacional të maqedonasëve. Del se që nga ai moment, si edhe shumë herë më parë, si edhe në të ardhmen, maqedonasit kanë qenë në situatë që ta ruajnë identitetin e tyre në korniza të mundësisë aktuale dhe momentit aktual të politikës ndërkombëtare. Absolutisht është hipotetike pyetja se, a është dashur që atëherë Maqedonia të thirret si Veriore ose Vardarit ose Maqedonia e Epërme, për shkak se duke i shfrytëzuar edhe fjalët e tyre si “territor popullor” është nocion më i gjerë nga territori ku është formuar shteti nacional maqedonas.²⁰⁷

3.3. Marrëveshja e Prespës: parimet dhe elementet kyçe të marrëveshjes

Emri i plotë i Marrëveshjes mes Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Greqisë, e njohur si “Marrëveshja e Prespës” është: “Marrëveshja përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve të përshkruara në rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për shfuqizimin e Marrëveshjes së Përkohshme të vitit 1995.”²⁰⁸

Struktura (përbërja) e marrëveshjes – përbëhet prej preambulës dhe tekstit normativ e cila përbëhet gjithsej prej 20 neneve dhe ndahet në tri pjesë, edhe atë: Pjesa e parë (Zgjidhja e dallimit rreth emrit, çështjet e papërfunduara lidhur me të njëjtin dhe përforcimi i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë), pjesa e dytë përfshin (intensifikimin dhe pasurimi i bashkëpunimit ndërmjet dy palëve) dhe pjesa e tretë (zgjidhja e kontesteve).²⁰⁹

Preambula e Marrëveshjes së Prespës tingëllon si në vijim:

Pala e parë, Greqia (“Pala e parë”) dhe Pala e dytë, e cila ishte e pranuar në Kombet e Bashkuara

²⁰⁶ Për më tepër shih: Тодоровски, Сашко, Преспанската спогодба, името идентитетот и ризиците, Дипломатски летопис, година III, број 6, Декември 2018, Скопје, РИ-ГРАФИКА, Скопје, стр. 9, cituar sipas: Politics Among Nations, 6th edition (New York: McGraw-Hill, 1985), p. 166.

²⁰⁷ Po aty, fq. 9.

²⁰⁸ Final agreement for the settlement of the differences as described in the United Nations Security Council Resolution 817 (1993) and 845 (1993), the termination of the Interim Accord of 1995, and the establishment of a strategic partnership between the parties.

²⁰⁹ Po aty.

në pajtim me rezolutën 47/225 të 8 prillit 1993 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (“Pala e dytë”), të emërtuar së bashku si “Palët”,

Duke u thirrur në parimet dhe qëllimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, Dokumentit përfundimtar të Helsinkit i vitit 1975, akteve relevante të Organizatës së për siguri dhe bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe vlerat dhe parimet e Këshillit të Evropës,

- Të udhëhequra nga fryma dhe parimet e demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe dinjitetit,
- Duke iu përmbajtur dispozitave të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe veçanërisht atyre të cilat kanë të bëjnë me obligimin e shteteve në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare të përmbahen nga kërcënimi apo përdorimi i forcës kundër integritetit territorial ose pavarësisë politike të cilitdo shtet,
- Duke theksuar angazhimin e tyre të plotë për parimet për mos-cenimin e kufijve dhe integritetit territorial të shteteve, të pëfshirë në Dokumentin Përfundimtar të Helsinkit të vitit 1975,
- Duke e vërtetuar kufitin ekzistues ndërmjet tyre si kufi ndërkombëtar i përhershëm,
- Të pajtuar plotësisht për nevojën e përforcimit të paqes, stabilitetit, sigurisë dhe avancimit të mëtutjeshëm të bashkëpunimit në Evropën Juglindore,
- Me dëshirë që ta përforcojnë atmosferën e besimit dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore në Rajon dhe t’i ndërpresin në mënyrë të përhershme të gjitha qëndrimet armiqësore, të cilat do të mund të qëndrojnë ende dhe duke u pajtuar për nevojën e përmbajtjes nga irredentizmi dhe revizionizmi në cilëndo formë,
- Duke u thirrur në obligimin e tyre, në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe të drejtën ndërkombëtare, nën çfarëdo preteksti dhe në çfarëdo forme, të mos përzihen në punët e brendshme dhe kompetencat e Palës tjetër,
- Duke e nënvizuar, gjithashtu, vlerën e zhvillimit të marrëdhënieve miqësore ndërmjet shteteve dhe nevojën kontestet të zgjidhen në mënyrë të qetë, në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara,
- Duke i zgjidhur dallimet në pajtim me Rezolutën 817 (1993) të 7 prillit 1993 dhe Rezolutën 845 (1993) të 18 qershorit 1993, të Këshillit të Sigurimit, si dhe nenin 5 të

- Marrëveshjes së Përkohshme të 13 shtatorit 1995 në mënyrë dinjitoze dhe të qëndrueshme, duke i pasur parasysh vlerën e çështjes dhe ndjeshmërisë së secilës Palë,
- Duke e marrë parasysh Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 47/225 të 8 prillit 1993,
 - Duke e pasur parasysh Marrëveshjen e përkohshme, Memorandumin e 13 tetorit 1995 për masat praktike të lidhura me Marrëveshjen e përkohshme, Memorandumin për vendosje të ndërsjellë të zyrave për lidhje në Shkup dhe Athinë të 20 tetorit 1995, si dhe procesin e Masave për ndërtimin e besimit,
 - Duke e nënvizuar dëshirën e tyre të fuqishme për miqësi të ndërsjellë, fqinjësi të mirë dhe partneritet për bashkëpunim,
 - Me angazhim t'i përforcojnë, zgjerojnë dhe thellojnë marrëdhëniet e tyre bilaterale dhe të vendosin themele të forta për përforcimin dhe respektimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe për zhvillimin e bashkëpunimit të tyre bilateral,
 - Duke kërkuar që ta përforcojnë dhe zgjerojnë bashkëpunimin e vet bilateral dhe ta mbindërtojnë në nivel të partneritetit strategjik, në sferën e bujqësisë, mbrojtjes civile, mbrojtjes, ekonomisë, energjisë, mjedisit jetësor, industrisë, infrastrukturës, investimeve, marrëdhënieve politike, turizmit, tregtisë, bashkëpunimit tej kufitarë dhe transportit, duke i shfrytëzuar pastaj përfitimet nga Masat ekzistuese për ndërtimin e besimit,

U dakorduan si vijon:²¹⁰

Në nenin 1, paragrafi 1 i marrëveshjes, theksohet se kjo marrëveshja është përfundimtare dhe me hyrjen e saj në fuqi shfuqizohet Marrëveshja e Përkohshme mes palëve, e nënshkruar në Nju Jork, më 13 Shtator 1995, ndërkaq, në paragrafin 2, palët e pranuan si obligues rezultatin nga negociatat, të cilat u zhvilluan nën patronazhin e Kombeve të Bashkuara, e të cilat palët ishin të obliguara t'i udhëheqin në pajtim me Rezolutën 817 (1993) dhe Rezolutën 945 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, si dhe në pajtim me Marrëveshjen e Përkohshme të vitit 1995.

Në paragrafin 3, rregullohet çështja e emrit edhe atë në alinejën a: "Emri zyrtar i Palës së

²¹⁰ Për më tepër shih: Final agreement for the settlement of the differences as described in the United Nations Security Council Resolution 817 (1993) and 845 (1993), the termination of the Interim Accord of 1995, and the establishment of a strategic partnership between the parties, Preamble.

dytë do të jetë “Republika e Maqedonisë së Veriut”, i cili do të jetë emri kushtetues i Palës së dytë dhe do të përdoret erga omnes, siç është paraparë me këtë marrëveshje. Emri i shkurtër i palës së dytë do të jetë “Maqedonia e Veriut”.

Në alinejën b), rregullohet çështja e shtetësisë, me ç’rast “shtetësia e palës së dytë do të jetë maqedonase/qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut, siç do të shënohet në të gjitha dokumentet e udhëtimit.

Në alinejën c), rregullohet gjuha zyrtare “gjuha zyrtare e palës së dytë do të jetë “gjuha maqedonase”, siç është pranuar në Konferencën e tretë të Kombeve të Bashkuara për standardizimin e emrave gjeografikë, e mbajtur në Athinë në vitin 1977 dhe siç është e përshkruar në nenin 7, paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i kësaj marrëveshjeje.

Në alinejën d), termet “Maqedonia dhe “maqedonase” e kanë domethënien e dhënë në nenin 7 të kësaj marrëveshjeje.

Alineja e), “kodi i vendit në targa e regjistrimit të automjeteve të palës së dytë do të jetë NM ose NMK. Për të gjitha qëllimet tjera, kodi i vendit mbetet MK dhe MKD, siç është e përcaktuar zyrtarisht nga Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit (ISO).

Alineja f), “mbiemri lidhur me shtetin, organet e tij zyrtare dhe institucionet tjera publike do të jenë në pajtim me emrin zyrtar të palës së dytë ose me emrin e tij të shkurtër, përkatësisht “të Republikës së Maqedonisë së Veriut” ose “të Maqedonisë së Veriut”. Përdorime të tjera të mbiemrit, duke përfshirë edhe ato lidhur me entitetet dhe akorët privat, të cilët janë të lidhur me shtetin dhe entitetet publike, por që nuk janë të themeluara me ligj dhe nuk marrin mbështetje financiare nga shteti për aktivitete jashtë shtetit, mund të jenë në pajtim me nenin 7, paragrafi (3) dhe paragrafi (4). Përdorimi i mbiemrit për aktivitete mund të jetë në pajtim me nenin 7, paragrafi (3) dhe paragrafi (4). Kjo nuk ndikon në procesin e përcaktuar sipas nenit 1, paragrafi 3 (h) dhe në emrat e përbërë të qyteteve që ekzistojnë në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

Alineja g), përfshin ndryshimet kushtetuese, “pala e dytë do ta pranojë emrin “Republika e Maqedonisë së Veriut”, si emër të saj zyrtar, si dhe termet e cekura në nenin 1, paragrafi (3), duke e zbatuar procedurën e brendshme e cila është e obligueshme dhe e përvokueshme, që do të përfshijë miratimin e amendamentit të Kushtetutës, siç është përcaktuar me këtë

marrëveshje.

Alienja (h), lidhur me emrin e lartpërmendur dhe terminologjinë në emrat komercial, markat tregtare dhe emrat e markave, palët pajtohen që t'i mbështesin dhe inkurajojnë komunitetet e tyre afariste që të vendosin dialog të sinqertë, të strukturuar dhe të mirë, në kuadër të të cilit do të kërkojnë dhe do të arrijnë zgjidhje të përbashkëta për çështje të cilat dalin nga emrat komercial, marka tregtare dhe emrat e markave dhe për të gjitha çështjet relevante, në nivel bilateral dhe ndërkombëtar. Për zbatimin e dispozitave të lartpërmendura, do të formohet grup ndërkombëtar i ekspertëve, të cilin do ta përbëjnë përfaqësues të të dyja vendeve, në kontekst të Bashkimit Evropian me kontributin përkatës të Kombeve të Bashkuara dhe ISO. Ky grup i ekspertëve do të formohet në vitin 2019 dhe do ta përfundojë punën e vet brenda tre viteve. Asnjë dispozitë e neni 1, paragrafi 3 (h) nuk do të ndikojë mbi përdorimin e tanishëm komercial derisa nuk arrihet pajtim i ndërsjellë, siç është paraparë në këtë aline.

Në paragrafin 4, pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, palët do t'i marrin hapat në vijim:

Alineja a), Pala e dytë, pa prolongim, do t'ia paraqes Marrëveshjen Kuvendit për ratifikim.

Alineja b), Pas ratifikimit të Marrëveshjes në Kuvendin e palës së dytë, pala e dytë do ta njoftojë palën e parë se Kuvendi i palës së dytë e ka ratifikuar marrëveshjen.

Alineja c), Pala e dytë, nëse vendos ashtu, do të mbaj referendum.

Alineja d), Pala e dytë, do të fillojë procesin për miratimin e amendamenteve kushtetuese, siç është paraparë në këtë marrëveshje.

Alineja e), Pala e dytë, në tërësi do t'i miratojë amendamenteve kushtetuese deri në fund të vitit 2018.

Alineja f), Pas njoftimit të palës së dytë për përfundimin e procedurës për miratimin e amendamenteve të lartpërmendura të Kushtetutës dhe për përfundimin e të gjitha procedurave të brendshme juridike për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, pala e parë menjëherë do ta ratifikojë këtë marrëveshje.

Paragrafi 6, parashikon njoftimin e të gjitha organizatave ndërkombëtare, multilaterale dhe rajonale, institucionet dhe forumet, anëtare e të cilave është, për hyrjen në fuqi të kësaj

marrëveshjeje dhe pastaj do të kërkojë nga të gjitha ato, ta pranojnë dhe përdorin emrin dhe terminologjitë e përmendura në nenin 1, paragrafi 3 të kësaj marrëveshjeje për të gjitha përdorimet dhe qëllimet. Gjithashtu, parashihet që të njoftojë edhe të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara për hyrjen e kësaj marrëveshjeje në fuqi dhe do të kërkojë nga të njëjtit ta pranojnë dhe ta shfrytëzojnë emrin dhe terminologjitë e përmendura në nenin 1, paragrafi 3 nga kjo marrëveshje për të gjitha përdorimet dhe qëllimet, duke përfshirë edhe në të gjitha marrëdhëniet e saj bilaterale dhe në komunikim.

Në lidhje me rëndësinë e dokumenteve që parashihet në nenin 10 tashmë ekzistuese të lëshuara nga autoritetet e palës së dytë, palët dakordohen të ketë dy periudha kalimtare, një “teknike” dhe tjetra “politike” dhe të gjitha këto do të implementohen më së vonë në afat prej pesë vitesh pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Neni 11, gjithashtu sqaron se “Procedurat për miratimin e shpejtë të amendamenteve kushtetuese të palës së dytë, e me qëllim të zbatimit të plotë të dispozitave të kësaj marrëveshjeje, do të fillojnë pas ratifikimit të kësaj marrëveshjeje nga Kuvendi i saj ose pas referendumit, nëse pala e dytë vendos të mbajë referendum. Gjithashtu, në nenin 12 thuhet se “Emri dhe terminologjitë e përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje do të përfshihen në Kushtetutën e palës së dytë. Ky ndryshim do të bëhet menjëherë me një amendament. Sipas këtij amendamenti, emri dhe terminologjitë do të ndryshohen në të gjitha nenet e Kushtetutës. Më tej, pala e dytë do të fillojë procedurën për miratimin e amendamenteve përkatëse të Preambulës, neni 3 dhe neni 49 të Kushtetutës, gjatë procedurës për ndryshimin e Kushtetutës.”²¹¹

Neni 2 i Marrëveshjes, parashikon mbështetjen e Greqisë mbi integrimin e Maqedonisë së Veriut në BE dhe NATO edhe atë: “Pala e parë pajtohet që të mos i kundërshtojë kërkesat për anëtarësim ose anëtarësimin e palës së dytë, me emrin dhe terminologjitë nga neni 1, paragrafi 3 i kësaj marrëveshjeje në organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, multilaterale dhe rajonale në të cilat pala e parë është anëtare. Paragrafi 2 i neni 2, parasheh që: “Pala e dytë do të kërkojë pranimin në organizata dhe institucionet ndërkombëtare, multilaterale dhe rajonale me emrin dhe terminologjitë nga neni 1, paragrafi 3 i kësaj marrëveshjeje. Paragrafi 3 i neni 2

²¹¹ Për më tepër shih: Final agreement for the settlement of the differences as described in the United Nations Security Council Resolution 817 (1993) and 845 (1993), the termination of the Interim Accord of 1995, and the establishment of a strategic partnership between the parties, Article 1.

thotë: “Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, e në pajtim me nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, pala e parë do të ratifikojë çfarëdo marrëveshje për aderimin e palës së dytë në organizatat ndërkombëtare, në të cilat pala e parë është anëtare. Në paragrafin 4 edhe më drejtpërdrejtë sqaron rolin e mbështetjes së Greqisë mbi intergrimin e Maqedonisë së Veriut edhe atë: “Në veçanti, sa i përket procesit të integritit të palës së dytë në Bashkimin Evropian (BE) dhe Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), do të aplikohen: pala e dytë do të kërkojë anëtarësim në NATO dhe BE me emrin dhe terminologjitë nga neni 1 i kësaj marrëveshjeje. Anëtarësimi në NATO dhe BE do të bëhet me të njëjtin emër dhe terminologji. Pas marrjes së njoftimit se Kuvendi i palës së dytë e ka ratifikuar këtë marrëveshje, pala e parë menjëherë do ta njoftojë kryetarin e Këshillit të Bashkimit Evropian se e mbështet fillimin e negociatave për anëtarësimin e palës së dytë në Bashkimin Evropian, me emrin dhe terminologjitë nga neni 1 i kësaj marrëveshjeje, do ta njoftojë sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s se e mbështet ftesën për anëtarësimin e palës së dytë. Mbështetja e tillë e palës së parë kushtëzohet, së pari, me rezultatin e referendumit, nëse pala e dytë vendos të mbajë referendum në pajtim me këtë marrëveshje dhe së dyti, me miratimin e plotë të amendamenteve kushtetuese, siç është e paraparë në këtë marrëveshje. Pas marrjes së njoftimit nga pala e dytë se i ka përfunduar të gjitha procedurat e saj të brendshme juridike të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, duke përfshirë edhe referendum të mundshëm nacional me një rezultat në përputhje me këtë marrëveshje dhe pas përfundimit të procedurës për miratimin e amendamenteve kushtetuese të palës së dytë, pala e parë do ta ratifikojë Protokollin për anëtarësimin e palës së dytë në NATO. Kjo procedurë e ratifikimit do të përfundojë së bashku me procedurën e ratifikimit të kësaj marrëveshjeje.”²¹²

Neni 3 i marrëveshjes edhe atë paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 si dhe neni 4, paragrafët 1, 2 dhe 3 objekt rregullimi kanë pretendimet territoriale me çka “Palët me këtë e vërtetojnë kufirin e tyre të ndërsjellë ekzistues si kufi ndërkombëtar i pacenueshëm dhe i përhershëm. Asnjëra nga palët nuk do të mbrojë ose mbështesë kurrfarë pretendimesh ndaj cilësdo pjesë të territorit të palës tjetër, e as pretendimet për ndryshim të kufirit të tyre të ndërsjellë ekzistues. Përveç kësaj,

²¹² Për më tepër shih: Final agreement for the settlement of the differences as described in the United Nations Security Council Resolution 817 (1993) and 845 (1993), the termination of the Interim Accord of 1995, and the establishment of a strategic partnership between the parties, Article 2.

asnjëra nga palët nuk do të mbështesë çfarëdo lloj pretendimesh të tilla të cilat mund t'i shprehin palët e treta.", përkatësisht "Secila nga palët me këtë obligohet dhe deklaron në mënyrë solemne se asnjë dispozitë nga Kushtetuta e saj, siç është në fuqi ose siç do të ndryshohet në të ardhmen, nuk mund dhe nuk duhet të interpretohet si mënyrë, e cila paraqet ose kurdoqoftë do të paraqesë bazë për çfarëdo pretendimi ndaj të cilësdo sferë e cila nuk është në kuadër të kufijve të saj ndërkombëtare ekzistuese" si dhe "Secila nga palët me këtë obligohet dhe deklaron solemnisht se asnjë dispozitë nga Kushtetuta e saj, siç është në fuqi ose siç do të ndryshohet në të ardhmen, nuk mund dhe nuk duhet të interpretohet në mënyrë e cila paraqet ose kudoqoftë do të paraqesë bazë për përzjerje në punët e brendshme të palës tjetër, në cilëndo formë ose për cilëndo qoftë arsye..."²¹³

Neni 7 i marrëveshjes është me interes të veçantë duke pasur parasysh se në këtë nen bëhet interpretimi i shprehjeve "Maqedoni" si dhe "maqedonas" edhe atë: "Palët pranojnë se kuptimi i tyre përkatës i termeve "Maqedoni" dhe "maqedonas" i referohet kontekstit të ndryshëm historik dhe trashëgimisë kulturore. Kur i referohemi palës së parë, këto terme shënojnë jo vetëm sferën e popullit të rajonit të veriut të palës së parë, por gjithashtu edhe karakteristikat e tyre, si dhe civilizimin helen, historinë, kulturën dhe trashëgiminë në atë rajon që nga antika e deri më sot. Kur i referohemi palës së dytë, këto terme e shënojnë territorin e saj, gjuhën, popullin dhe karakteristikat e tyre me historinë e tyre, kulturën dhe trashëgiminë të cilat janë të ndryshme nga ato të përmendura në Nenin 7 paragrafi (2). Pala e dytë deklaron se gjuha e saj zyrtare, gjuha maqedonase, bën pjesë në grupin e gjuhëve të sllavëve të jugut. Të dyja palët deklarojnë se gjuha zyrtare dhe karakteristikat tjera të palës së dytë nuk janë të lidhura me civilizimin helen, historinë, kulturën dhe trashëgiminë e rajonit të veriut të palës së parë. Asnjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje nuk ka për qëllim të diskreditojë në çfarëdo lloj mënyre, ndryshojë ose ndikojë në përdorimin nga qytetarët e të dyja palëve."²¹⁴

Neni 8 i marrëveshjes parasheh se "Në afat prej gjashtë muajsh nga hyrja e kësaj marrëveshjeje në fuqi pala e dytë do ta shqyrtojë statusin e përmendoreve, ndërtesave publike dhe infrastrukturës së territorit të saj dhe nëse ato në çfarëdo lloj mënyre referojnë në historinë

²¹³ Final agreement for the settlement of the differences as described in the United Nations Security Council Resolution 817 (1993) and 845 (1993), the termination of the Interim Accord of 1995, and the establishment of a strategic partnership between the parties, Article 3 and 4.

²¹⁴ Po aty, neni 7.

dhe civilizimin helen antik që përbën pjesë përkatëse të trashëgimisë historike dhe kulturore të palës së parë do të ndërmarrë veprime korigjuese përkatëse me qëllim që në mënyrë efektive ta shqyrtojë çështjen dhe të sigurojë respektimin e trashëgimisë së tillë.” Në paragrafin 3 parashihet se “Pala e dytë nuk do ta përdorë përsëri në çfarëdo lloj mënyre dhe në çfarëdo forme simbolin e paraqitur në flamurin e saj shtetëror. Në afat prej gjashtë muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje, pala e dytë do të fillojë procedurën për heqjen e simbolit të paraqitur në flamurin e saj të mëparshëm shtetëror nga të gjitha vendet publike dhe nga përdorimi publik në territorin e saj. Artefaktet arkeologjike nuk janë të përfshira në këtë dispozitë.” Gjithashtu në paragrafin 5 të nenit 8 të kësaj marrëveshjeje thuhet se “Në afat prej një muaji nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje, palët nëpërmjet këmbimit të notave diplomatike, në bazë të paritetit, do të formojnë Komitet të përbashkët interdisiplinar të ekspertëve për çështje historike, arkeologjike dhe arsimore, i cili do ta shqyrtojë interpretimin shkencor objektiv të ngjarjeve historike të bazuara në dëshmi autentike dhe në burime të qëndrueshme historike dhe shkencore dhe gjetjeve arkeologjike... Komiteti do të shqyrtojë edhe nëse mendon se është e përshtatshme, do të kryej revizion mbi cilindo libër shkollor dhe material mësimor ndihmës siç janë hartat, atlaset historike, udhëzimet mësimore... Komiteti do të caktojë korniza kohore konkrete për të siguruar se në secilën palë asnjë libër shkollor ose material mësimor ndihmës që shfrytëzohet në vitin pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje nuk përmban çfarëdo lloj referencash revizioniste/irredentise. Komiteti gjithashtu, do t’i studiojë edhe botimet e reja të librave shkollorë dhe materialeve mësimore ndihmëse...”²¹⁵

Në nenin 10 të marrëveshjes parashihet që pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes pala e parë si dhe e dytë, do të ngritin nivelin e zyreve ekzistuese për lidhjen e kryeqyteteve në nivel të ambasadës, si dhe zyre tjera për çështje konsullore, ekonomike dhe tregtare. Ndërkaq, neni 13 i marrëveshjes, pala e dytë do të mund të udhëhiqet nga dispozitat relevante të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtën në det, për aq sa është e zbatueshme në praktikë, duke pasur parasysh se Maqedonia e Veriut nuk ka dalje në det.²¹⁶

Zgjidhja e kontestit të emrit me Greqinë, te disa maqedonas ngjalli ndjenja triumfaliste,

²¹⁵ Për më tepër shih: Final agreement for the settlement of the differences as described in the United Nations Security Council Resolution 817 (1993) and 845 (1993), the termination of the Interim Accord of 1995, and the establishment of a strategic partnership between the parties, Article 8.

²¹⁶ Po aty, neni 10 dhe 13.

se çështje me emrin përfundimisht morri fund pas më shumë se 27 viteve, dhe vendi u pozicionua në rrugën e duhur duke iu hapur perspektiva në strukturat evropianë si dhe duke fituar një partneritet të rëndësishëm, i cili do të llojë dhe do ta përkrahë Maqedoninë e Veriut për anëtarësim në këto organizata ndërkombëtare. Mirëpo, nga një pjesë e popullatës maqedonase nuk u mirëprit mirë kjo marrëveshje pakënaqësinë e të cilëve me sukses po e kanalizonte partia opozitare maqedonase VMRO-DPMNE, të cilët të prekur nga ndryshimi i emrit kushtetues me Marrëveshjen e Prespës, mbizotëronte perceptioni se me atë de facto është ndryshuar edhe identiteti maqedonas si dhe trashëgimia e tyre historike së bashku me gjuhën dhe kulturën. Këtë marrëveshje ata e vlerësojnë si “tradhti kombëtare si dhe shtetërore” dhe se ata në të ardhmen do të angazhohen që e njëjta të anulohet dhe të rikthehet emri kushtetues i vjetër.

Së këndejmi, parashtrohet pyetja se a është ideale Marrëveshja e Prespës? Nuk është. Por, a mundet të arrihet një marrëveshje më e mirë dhe më e drejtë pas 27 viteve harxhuara kot dhe i izoluar nga faktorët ndërkombëtar? Sigurisht, që ka mundur. Por, e rëndësishme është që kjo marrëveshje “theu akullin” për herë të parë pas pavarësisht të Maqedonisë së Veriut që të ulet me Greqinë dhe me vullnet të mirë t’i negociojë çështjet e hapura që më tepër ishin të ngarkuara me mite dhe histori, se sa çështje reale politike, andaj që në fillim të këtij procesi ishte e qartë se njëra nga palët do të duhet të sakrifikojë deri në pafundësi që kjo çështje të mbyllet me sukses njëherë e përgjithmonë. Mirëpo nuk ndodhi ashtu, duhej thjeshtë një bisedë miqësore, ca sqarime që të qetësohen “gjakrat” dhe me këtë aludoj në kompromisin e arritur mes Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut, cili ka qenë i jashtëzakonshëm, sado që ky kompromis nuk vlerësohet nga një pjesë tjetër e popullatës së të dyja vendeve.

Nëse i kushtohet vëmendje titullit të marrëveshjes, nuk është e rastësishme që teksti i Marrëveshjes së Prespës fillon me rezolutën e Parlamentit të Përgjithshëm të OKB-së. Në marrëveshje, pala e parë e ka emrin e saj shtetëror (Republika e Greqisë), kurse pala e dytë një emër të tillë nuk ka, nga shkak se nuk është e pranuar me emrin e saj kushtetues në OKB. Pra, Maqedonia deri më tani ka qenë shtet pa emër në skenën ndërkombëtare dhe se një emër të tillë përsëri është dashur të zgjedhet, së pari në referendum të 30 shtatorit 2018, më pas edhe me miratimin e amendamenteve kushtetuese në Kuvend dhe në fund me ratifikimin e

marrëveshjes në Parlamentin e RMV-së si dhe atë të Greqisë.²¹⁷

Konfuzioni që u krijua në mesin e popullatës maqedonase rreth identitetit, se çfarë realisht do të thotë të jesh maqedonas, pasqyrohet më mirë se ajo u nda në patriotë dhe tradhtarë. Në këtë proces, vazhdimisht janë implikuar edhe shqiptarët të cilët për shkak të interesave personale të politikanëve maqedonas nuk po gjenin gatishmëri si dhe vullnet politik ta zgjidhnin këtë kontest dhe se me këtë ata po ua mohonin ardhmërinë evropiane të vendit. Nga kjo pakënaqësi lindën kërkesa radikale dhe u mpreh tehu deri në prag të konfliktit, ndarjes së brendshme së forcave pro-perëndimore që në emër të ardhmërisë janë të gatshëm për kompromis me Greqinë dhe ata që luftojnë për status-quo dhe kanë mbështetjen e Rusisë. E gjitha kjo ndodhi kur vendi akoma ishte larg anëtarësimit në NATO, duke e sjellur në pikëpyetje sigurinë e saj në momente kur në Ballkan mbizotërojnë politika që konsiderojnë ndryshim kufijsh.²¹⁸

Megjithatë ekziston vetëdije te pjesa tjetër e maqedonasve se me këtë marrëveshje nuk e humbin maqedonasit identitetin, por, përkundrazi e forcojnë. Pra, kemi qenë në një situatë kur Greqisë nuk i ka konvnuar përafrimi i tepërt me Bullgarinë dhe se ish ministri për punë të jashtme, Nikos Kocijas, këtë e ka thënë të hapur para opinionit grek. Është e qartë, se Ciprasi dhe SIRIZA e kanë ofruar dorën e bashkëpunimit, sa nga bindja aq edhe nga presioni ndërkombëtar. “Ju jeni maqedonas, siç pretendoni, me shtetin tuaj për të cilin u kuptuam të quhet Maqedoni e Veriut, kemi historinë tonë, kulturën dhe trashëgiminë, të cilat janë të ndryshme nga civilizimi, historia dhe kultura helene në rajonin Maqedoni në Greqi nga antika deri sot, ndërsa gjuha juaj zyrtare është maqedonishtja, e cila i takon grupit të gjuhëve sllavo-jugore dhe nuk është e lidhur me civilizimin helen, historinë dhe kulturën nga rajoni verior i Greqisë. Nën termet Maqedonia dhe maqedonas, ne dhe ju kuptojmë kontekst të ndryshëm historik, këtë e njohim dhe e pranojmë. Pre tani e tutje do të jemi miqtë tuaj, do t’u ndihmojmë për çdo gjë dhe do t’u mbështesim...”²¹⁹

Profesoresha maqedonase e së drejtës kushtetuese, Gordana Siljanovska-Davkova,

²¹⁷ Për më tepër shih: Шкариќ, Светомир, Без Договорот со Грција, Македонија и натаму ќе остане без државно име на меѓународен план, Respublica, 22 август 2018, linku në dispozicion: <https://respublica.edu.mk/mk/blog/2018-08-22-08-12-53>, (05.07.2020).

²¹⁸ Për më tepër shih: Maleska, d-r, Mirjana, Rruga drejt normalizimit të marrëdhënieve me Greqinë është e hapur!, Humbje e identitetit ose...?, CIVIL – Qendra për liri, Shkup, 2018, fq. 30.

²¹⁹ По ату, fq. 31, 32.

vlerëson se “Me Marrëveshjen e Prespës, përkrah “greqizimit”, ushqehet edhe Megali ideja dhe përforcohet edhe “maqedonizmi grek” edhe pse është *contradictio in adjecto*”. Për atë, nuk është logjike të kufizohet shteti nga rajoni, nëse vendi quhet Republika e Maqedonisë së Veriut dhe nuk ka Republika e Maqedonisë së Jugut, atëherë nga kush duhet të kufizohet? Sipas saj, kufizimi do të ishte i logjikshëm nëse behet rajon me rajon jo edhe shtet me rajon, me përparësi të emrit të rajonit.²²⁰ Sipas profesoreshës, mbi termet “Maqedonia” dhe “maqedonase” është kryqëzim i shtetit me territorin dhe popullin. Pra, për të emri është rezultat i procesit historik, të lindur si maqedonas, flasin gjuhën maqedonase dhe se identitetet alternativ për të zgjedhur nuk kanë. Rrjedhimisht, edhe nëse termi “maqedonase” është pasqyrim i popullit maqedonas jo vetëm si etnos, por edhe si demos, atëherë thotë ajo, përse fshihet mbiemri para institucioneve nacionale, dhe si pasojë e kësaj nuk ka ASHAM, teatër maqedonas, televizion maqedonas, radio maqedonase, baletë maqedonas, siç ka në Greqi ose gjetiu, duke marrur shembuj se ata janë institucione shtetërore por edhe nacionale që reflektojnë demosin.²²¹

Siç thotë edhe Petar Todorov, nëse pranojmë se historia e Maqedonisë antike nuk është pjesë e historisë së popullit maqedonase dhe se maqedonasit etnik nuk janë pasardhësit e drejtpërdrejtë të maqedonasve antik, atëherë “nuk heqim dorë nga historia jonë, por heqim dorë prej një miti historik dhe lajthitje, e cila u tregua si shumë destruktiv për identitetin maqedonas.” Sipas tij, kjo krizë identitare bëri që shpesh të parashtrohet pyetja “cilët jemi tani, antikët apo sllovenët?”²²²

Nuk mund të mohohet se Marrëveshja e Prespës ka shkaktuar tërmete serioze politike dhe shoqërore në të dyja shtetet pa dallim. I gjithë debati është zhvilluar në dy paralele të kundërta, “për” dhe “kundër” marrëveshjes, me çka u krijuan dy këndvështrime kyçe dhe kundërthënëse. Njëra palë, pretendon se marrëveshja është “kapitulluese”, ndërkaq pala tjetër, si marrëveshje “historike”. Të dyja kualifikimet kanë konotacion historik, megjithatë marrëveshja nuk është “kapitulluese”, kurse shfrytëzimi manipulativ i këtij termi duhet të tregojë anën tjetër më të ndjejshme, madje edhe të tradhëtisë në raport me Greqinë dhe t’i kall emocionet dhe frikën te maqedonasit etnik se marrëveshje i humb elementet themelore të shtetësisë dhe

²²⁰ Për më tepër shih: Давкова – Сиљановска, Гордана, За „Преспанскиот договор“, и пошироко, стр. 6, 7, 8;

²²¹ По ату, fq. 38, 39.

²²² Тодоров, Петар, Анализа на спогодбата со Грција од историски и идентитетски аспект, Скопје, август 2018 година, стр. 5.

identitetit maqedonas edhe pse ajo është plotësisht në kundërshtim me dispozitat e marrëveshjes. Njëkohësisht këto kualifikimet dhe interpretime të ndryshme mbi humbjen e emrit dhe identitetit, lënë hapësirë si dhe mundësi për krijim të frustracioneve të reja nacionale dhe politike te maqedonasit etnik. Siç dihet, këto janë tendenca nacionaliste qëllimi i së cilës është shtyerja në valë të re të retorikës nacionaliste dhe krijimin e perceptcionit dhe besimit te maqedonasit se ata janë viktimë e fqinjëve futja e urrjetjes te garnitura politike e cila ka ndërmarrë hapa serioz për arritjen e marrëveshjes, të kontaminohen dhe të anatemoen se ata e “shitën emrin, shtetin, flamurin, gjuhën” duke u bërë parolla nacionale apo se marrëveshja e ka anuluar/shfuqizuar historinë maqedonase, kombin maqedonas, Maqedonia fiton emër të ri, se maqedonasit nuk do të ekzistojnë, historia është shitur, është varrosuar identiteti nacional maqedonas, mohohet shtetësia maqedonase ose termet “Maqedonia” dhe “maqedonase” do të fshihen nga përdorimi i gjithçkaje etj.²²³ Kështu, kryetari i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickovski ka luajtur në këtë kartë, i cili në intervistë për “360 shkallë” në Alsat-M, përgjigjeshte për gjuhën maqedonase e cila është e rregulluar me Marrëveshjen e Prespës, duke theksuar se gjuha maqedonase ka qenë e njohur zyrtarisht në BE, por dallimi atëherë dhe tani konsiston në fusnotën e marrëveshjes mbi gjuhën edhe pse nuk ekziston një gjë e tillë. Kur gazetari insiston që t’ia tregojë se ku ekziston fusnota dhe të mos i manipuloj qytetarët, ai thotë se ajo ekziston te Marrëveshja e Prespës dhe nuk mund të jep sqarim më të detajuara sepse nuk e kishte marrëveshjen me vete dhe në fund pajtohet që këtë çështje t’ia lë qytetarëve se kush i manipulon ata.²²⁴ Pra, ky shembull qartë ilustron qasjen e partisë opozitare përball marrëveshjes dhe në këtë rast, manipulimit që u bëhet qytetarëve jo vetëm nga partia e tij, por, edhe nga qarqet e ndryshme, tendenca e të cilëve është sajimi i një pasqyre të rrjeshme dhe ndryshimi i bindjes dhe perceptcionit të qytetarëve përball Marrëveshjes së Prespës. Kjo qasje, njëkohësisht tregon se tek maqedonasit ekziston bindja se mbrojtja e emrit kushtetues ndërlihet me identitetin maqedonas dhe prekja e njërit prek edhe tjetrën dhe anasjelltas.

Prandaj, në periudhën e kaluar, kundërshtarët e marrëveshjes, çdo herë në debate të

²²³ Për më tepër shih: Тодоров, Петар, Анализа на спогодбата со Грција од историски и идентитетски аспект, Скопје, август 2018 година, стр. 5, 6, 7.

²²⁴ Për më tepër shih: Мицкоски: Во Договорот од Преспа има фуснота за македонскиот јазик, 360степени, 3 јули 2020, линку në dispozicion: <https://360stepeni.mk/video-mitskoski-vo-dogovorot-od-prespa-ima-fusnota-za-makedonskiot-jazik/>, (05.07.2020).

ndryshme rreth marrëveshjes, refuzonin në mënyrë të drejtpërdrejtë t'i diskutojnë pikat e nenit 7 të Marrëveshjes së Prespës, e cila qartë tregon se të dyja palët kanë të drejtë ta shfrytëzojnë termin në mënyrën e tyre. Kjo nënkupton se ata janë të lirë t'i japin domethënie të veta për historinë e tyre, për trashëgiminë kulturore si dhe për gjuhën si pjesë e identitetit apo me fjalë të tjera, neni 7 u mundëson palëve interpretim të lirë të termit, duke i vendosur atyre domethënie personale. Kjo don të thotë, më thjeshtë i lë në dorë palës vetëpërcaktimin e identitetit. Kjo është e pika më pozitive e marrëveshjes për shkak se për herë të parë Maqedonia e Veriut me fqinjët, madje edhe para Bullgarisë, ka pranuar njohje të vetëpërcaktimit të identitetit nga ana e Greqisë me anë të marrëveshjes së nënshkruar. Kjo marrëveshje, u ka mundësuar që identiteti kombëtar të ndahet në terme të pastra politike, pa atavizma historike-romantike, përkatësisht të përcaktohet mbi parimin e përcaktimit të vetënjohjes.²²⁵

Sipas politikanit maqedonas, Ljubčo Georgievskit, identiteti maqedonas, nuk është rrezikuar nga përcaktimi "e Veriut" ose "e Epërme" para emrit të shtetit, por nga qasje e maqedonasve etnikë ndaj identitetit të vet. Madje, ai shkon edhe më tutje në histori me identifikimin e masës më të madhe si bullgarë maqedonas. Ai thotë se ideja revolucionare e VMRO-së historike në dokumentet e saj në fillim, është mbështetur vetëm te maqedonasit të cilët janë deklaruar si bullgarë. Prandaj dhe në vitin 1902, në librin e Krste Petkov Misirkovit "Për çëshjet maqedonase" në mënyrë të qartë dhe pa dyshime tregon se deri dje nuk ka pasur komb maqedonas. Ideja e tij konsiston në deklarimin e të gjithë sllavëve në Maqedoni, serb, grekë, bullgarë ose turq të quhen maqedonas. Kjo, sipas tij është baza e tregimit etnik maqedonas, e identiteti nacional të cilin thjeshtë, qoftë edhe në mënyrë propaganduese apo politike është ajo që maqedonasit nuk mund të përballen me realitetin, por thjeshtë duan ashtu ta kalojnë. Andaj, ai ruajtjen e identiteti e sheh përmes kulturës dhe traditës siç e kanë arritur ta ruajnë maqedonasit nën sundimin osman. Pra, çështja e identitetit është diçka që ata vetë duhet ta mbrojnë dhe vetë ta mbartin, si p.sh. rasti i Kosovës, populli është shqiptar, pjesërisht serb, mirëpo gjithkush e sheh shqiptarin si bartës të saj, në asnjë moment nuk mendojnë se emri Kosovë është problem për identitetin e tyre. Gjithashtu edhe me Serbinë kur të gjitha republikat

²²⁵ Për më tepër shih: Kollozova, d-r, Katerina, Marrëveshja me Greqinë e mundëson përcaktimin politik të identitetit, Humbje e identitetit ose...?, CIVIL – Qendra për liri, Shkup, 2018, fq. 36.

u shkatërruan, vetëm ajo mbeti Jugosllavi dhe 6 apo 7 muaj emri i saj ka figuruar si Jugosllavi edhe pse populli ka qenë serb. Është shumë burimore, ndjenjë të cilën askush nuk mund ta rrezikojë nëse e ke shtetin tënd. Në Maqedoninë e Veriut pyetja që mund të parashtrohet nga të gjitha pakicat, jo vetëm nga populli maqedonas është se a është mjaft i mbrojtur identiteti ose a kujdeset shteti për këtë identitet, a ka asimilim politik, pra të gjitha këto e karakterizojnë çështjen e identitetit.²²⁶

Ta rezymojmë, Marrëveshja me Greqinë ofron emër të balansuar, me mundësi të shfrytëzimit të fjalës “Maqedoni” nga të dyja palët, por me përkufizime gjeografike, historike dhe kulturore të të dyja pjesëve të rajonit Maqedoni. Pjesa greke, i përfshin rajonin dhe njerëzit e rajonit verior të Greqisë, karakteristikat e tyre, civilizimin helen, historinë dhe kulturën si dhe trashëgiminë e atij rajoni nga antika e deri më sot. Pjesa maqedonase është e vendosur në pjesën veriore të pjesës gjeografike të Maqedonisë, si shtet i vetëm, me emër zyrtar “Republika e Maqedonisë së Veriut”, me shtrirje të territorit të saj, gjuhës, njerëzve, kulturës dhe trashëgimisë, të cilët dallojnë nga atyre të pjesës greke të Maqedonisë. Propozimi themelohet mbi principin e “drejtësisë gjeografike”. Si i tillë, mund të jetë i qëndrueshëm dhe i dinjitetshëm, nëse të dyja palët tregojnë vullnet të mirë, nëse zhvillojnë bashkëpunim të frytshëm dhe shikojnë nga e ardhmja. Greqia, mundet shtetin tonë ta sheh si mik dhe partner strategjik, kurse shteti maqedonas do të fitojë emër shtetëror, identitet kombëtar të pakontestuar si dhe gjuhë dhe kulturë.²²⁷

Marrëveshja si tërësi është e mirë për të dyja palët, pavarësisht se kanë forma asimetrike. Edhe njëra palë edhe tjetra e fitojnë atë që më së shumti e dëshirojnë dhe që u takon, sipas principit të drejtësisë dhe posedimit. Asnjëra prej tyre nuk kanë arsye të ndjehen të poshtëruara përpara popullit të tyre, e as të konsiderohen si palë e humbur. E aq më pak, se ka kapitulluar përpara palës së fortë dhe faktorit ndërkombëtar. Historike paraqet pajtimi i Greqisë që në emrin e ri të shtetit maqedonas të përmbajë emrin “Maqedonia”. Kjo ishte dhe është më domethënëse dhe përfitimi më i madh i palës maqedonase si dhe vërtetimi i gjuhës

²²⁶ Për më tepër shih: Georgievski, Ljubčo, Identiteti “Antik” na grindu me fqinjët dhe me bashkësinë ndërkombëtare!, Humbje e identitetit ose...?, CIVIL – Qendra për liri, Shkup, 2018, fq. 42, 43, 44, 45.

²²⁷ Për më tepër shih: Шкарик, Светомир, Без Договорот со Грција, Македонија и натаму ќе остане без државно име на меѓународен план, Respublica, 22 август 2018, linku në dispozicion: <https://respublica.edu.mk/mk/blog/2018-08-22-08-12-53>, (10.07.2020).

maqedonase si gjuhë zyrtare, njohja e shtetësisë, vlera kombëtare që së bashku nën emrin “Maqedoni” përfaqësojnë tri themelet e identiteti maqedonas, këtë herë të njohura nga ana greke, që nuk ishte rast deri më tani. E rëndësishme është se Marrëveshja e Prespës ka paraparë një zgjidhje origjinale të çështjes së shtetësisë edhe më mirë se kushtetuta e mëparshme e vitit 1991, ku qytetarët e RM-së kanë shtetësi të RM-së (neni 4), kurse me Marrëveshjen e Prespës nacionaliteti i palës së dytë do të jetë maqedonase/qytetarë të RMV-së (neni 1, pika 3). Kjo d.m.th., se maqedonasit u bënë sinonim i shtetësisë të të gjithë qytetarëve të shtetit maqedonas, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike. Zgjidhje që sipas profesorit të së drejtës kushtetuese, Svetomir Shkariç, deri më tani nuk mundeshim as ta paramendonim, e lëre më ta arrinim.²²⁸ Por, siç do të shihet në ngjarjet më vonë, kur të bëhet fjalë mbi ndryshimet kushtetuese përmes amendamenteve kushtetuese të parapara në Marrëveshjen e Prespës, shqiptarët nuk u pajtuan për këtë përcaktim.

3.4. Organizimi dhe realizimi i Referendumit për ndryshimin e emrit kushtetues të 30.09.2018 dhe aspektet juridike të tij

Kuvendi i RM-së në seancë parlamentare e votoi ligjin për ratifikim për Marrëveshjen Përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve të përshkruara në rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për ndalim të vlefshmërisë së Marrëveshjes së Përkohshme të vitit 1995 dhe për vendosje të partneritetit strategjik mes palëve. Për ratifikimin e Marrëveshjes me Greqinë votuan 69 deputetë. Deputetët e VMRO-DPMNE-së nuk morrën pjesë në seancë.²²⁹

Kryetari i shtetit të RM-së, Gjorge Ivanov solli vendim që të mos e nënshkruajë dekretin për shpallje të Ligjit për ratifikim të Marrëveshjes Përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve të përshkruara në rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për ndalim të vlefshmërisë së Marrëveshjes së Përkohshme të vitit 1995 dhe për vendosje të partneritetit strategjik mes palëve. Si gjithmonë ai u thirr në dispozitat kushtetuese duke u justifikuar se gjithmonë vepron me përgjegjësi dhe të drejtat dhe detyrimet e veta i kryen në baza dhe korniza kushtetuese si dhe në bazë të ligjeve e mbi të gjitha interesave të RM.

²²⁸ Për më tepër shih: Шкариќ, Светомир, Без Договорот со Грција, Македонија и натаму ќе остане без државно име на меѓународен план, Respublica, 22 август 2018, linku në dispozicion: <https://respublica.edu.mk/mk/blog/2018-08-22-08-12-53>, (10.07.2020).

²²⁹ Собранието го ратификуваше договорот со Грција, Академик, 20 јуни 2018, linku në dispozicion: <https://akademik.mk/sobranieto-go-ratifikuvashe-dogovorot-so-grtsija/>, (10.07.2020).

Vendimi e tij e arsyetoi se: nuk ka mandat për ta nënshkruar dekretin për shpalljen e ligjit për ratifikim të kësaj marrëveshjeje. Për shkak se edhe politika e tij në programin zgjedhor i vitit 2014 ka qenë se “nuk do të pranoj ndryshim të Kushtetutës me qëllim të ndryshimit të emrit kushtetues. Nuk do të pranoj ide dhe propozime që do të rrezikonte identitetin nacional maqedonas, veçantitë e kombit maqedonas, gjuhës maqedonase dhe modelit të bashkëjetesës maqedonase”..., Marrëveshja sipas tij, del jashtë pranimin të rezolutave 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për shkak se në to bëhet fjalë për “dallime rreth emrit të shtetit” dhe jo për “dallime” siç bëhet fjalë në marrëveshjen në fjalë. Gjithashtu, u justifikua se marrëveshja nuk ka bazë kushtetuese dhe nuk është ratifikuar në përputhje me kushtetutën, Ligji për ratifikim të marrëveshjes nuk është në përputhje me nenin 51, nenin 118 dhe nenin 119 të Kushtetutës së RM-së, dhe se Marrëveshja e sjell RM-në në pozitë të nënshtruar dhe të varësisë kundrejt shtetit tjetër, përkatësisht Republikës së Greqisë.²³⁰

Partia maqedonase VMRO-DPMNE vlerëson se zgjidhja e çështjes së emrit me Greqinë nuk mund të jetë në pronësi ekskluzive e politikanëve të caktuar për ta zgjidhur dhe as e shumicës së Parlamentit, andaj ata vlerësonin se për ndryshimin e emrit duhet të konsultohen me qytetarët dhe kjo të bëhet përmes referendumit.²³¹ Mirëpo, kjo çështje u bë mollë shërr dhe solli takime maratone mes kryetarëve të partive politike maqedonase dhe nuk arritën një marrëveshje përfundimtare për referendumin. Zoran Zaevi akuzoi kryetarin e VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickovskin i cili u bë “pishman” për referendumin se ai nuk dëshiron që Maqedonia të bëhet anëtare e BE-së dhe e NATO-së. Pas takimeve partitë dekaronin se qëndrimet e tyre janë të kundërta lidhur me pyetjen e referendumit, por edhe të karakterit të tij se a duhet të jetë i detyrueshëm apo konsultativ. Në këtë drejtim, qeveria Zaev insistonte që pyetja kryesor e referendumit të jetë e lidhur me procesin e integritimeve evro-atlantike të vendit, apo më konkretisht të jetë në formën “a jeni për anëtarësim e Maqedonisë në NATO dhe BE me pranimin e Marrëveshjes me Greqinë”. Qëndrim të kundërt kishte Mickovski i cili theksonte se

²³⁰ Për më tepër shih: Претседателот Иванов донесе одлука да не го потпише указот за Законот за ратификација на договорот со Грција, Академик, 26 јуни 2018, linku në dispozicion: <https://akademik.mk/pretsedatelot-ivanov-donese-odluka-da-ne-go-potpishe-ukazot-za-zakonot-za-ratifikatsija-na-dogovorot-so-grtsija/>, (10.07.2020).

²³¹ VMRO kërkon që qytetarët të deklarohen për referendum për çështjen e emrit, НЕЗАВИСЕН ВЕШНИК, 17.12.2017, linku në dispozicion: <https://nezavisen.mk/vmro-kerkon-qe-qytetaret-te-deklarohen-per-referendum-per-ceshtjen-e-emrit/>, (10.07.2020).

qytetarët në referendum duhet të deklarohen vetëm për një çështje edhe atë përmes pyetjes së përcaktuar qartë dhe të kuptueshme. Ai iu përgjigj akuzave të Zaevit se opozita është për integrimin evrop-atlantik të vendit, por jo me manipulime, “ne nuk heqim dorë nga normat kushtetuese, shumica parlamentare është ajo që shpall referendum dhe e përcakton pyetjen. Pozicioni ynë është i qartë, pyetja e referendumit duhet të jetë për një çështje dhe jo e lidhur me aspekte të tjera. Këtu është dallimi!”²³²

Në prag të realizimit të referendumit Maqedonia e Veriut u vërshua nga ndërkombtarët, të cilët vinin për t’i dhënë kurajo Maqedonisë për referendum të suksesshëm dhe intergrim sa më të shpejtë në strukturat evrop-atlantike, kështu ministri shtetëror përgjegjës për Evropën në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Michael Roth, kur po qëndronte për vizitë në Maqedonia, deklaroi se Maqedonia ka bërë arritje historike dhe do të ishte tragjike nëse rruga e mëtejshme drejt BE-së do të pengohej. Ai theksoi se duhet të ketë bashkëpunim konstruktiv në këtë drejtim si dhe përgjegjësi të veçantë mban qeveria, por edhe opozita.²³³

Një grup i deputetëve të shumicës parlamentare më 30.07.2018, me numër 08 4644/1 dorëzuan propozim-vendim për miratim të referendumit duke u thirrur në dispozitat e Ligjit për referendum dhe formave tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve. Si datë, u propozua 30 shtatori 2018 dhe ajo të zbatohet nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor. Pyetja e referendumit të jetë: “A jeni për anëtarësim në BE dhe NATO me pranim të Marrëveshjes mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë?”²³⁴ Që në fillim dihej se, partia opozitare VMRO-DPMNE, nuk do ta mbështet iniciativën për referendum për shkak të pyetjes së referendumit për të cilën për ato nuk është e pranueshme edhe pse deklaruan se do të marrin pjesë në seancën dhe në votimin e propozim-vendimit.²³⁵

Në seancën e mbajtur më 30 Korrik 2018, mbi bazën e nenit 73 paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, Kuvendi i RM-së, solli vendim për shpallje të referendumit për

²³² Maqedoni: Çështja e referendumit mollë sherri, DW, 24.07.2018, linku në dispozicion: <https://www.dw.com/sq/maqedoni-%C3%A7%C3%ABshtja-e-referendumit-moll%C3%AB-sherri/a-44803890>, (10.07.2020).

²³³ По ату;

²³⁴ Предлог на одлука за распишување на референдум, Скопје, јули 2018 година, со архивски бр. 08 - 4644/1, linku në dispozicion: <https://akademik.mk/predlog-odlukata-za-referendum-za-konsultirane-na-graganite-podnesena-od-grupa-pratenitsi/>, (10.07.2020).

²³⁵ Предлог-одлука за референдум за консултирање на граѓаните поднесена од група пратеници, Академик, 30 јули 2018, linku në dispozicion: <https://akademik.mk/predlog-odlukata-za-referendum-za-konsultirane-na-graganite-podnesena-od-grupa-pratenitsi/>, (10.07.2020).

konsultim të qytetarëve në tërë territorin e RM-së. Në referendum qytetarët do të shprehen në pyetjen: “A janë për anëtarësim në BE dhe NATO me pranim të Marrëveshjes mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë?” Referendumi u vendos të mbahet më 30 Shtator 2018 dhe të njëjtën do ta zbatojë KSHZ.²³⁶ Këtë vendim, Kuvendi i RM-së e votoi me 68 vota. Deputetët e VMRO-DPMNE-së paraprakisht e lëshuan sallën dhe nuk morrën pjesë në votim, pikërisht për shkak të pyetjes së referendumit.²³⁷

Partia politike “E majta” dorëzoi iniciativë për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së vendimit për shpallje të referendumit të sjellur nga ana e Kuvendit të RM-së. Vendimi, sipas tyre në disa pika nuk është në përputhje me Kushtetutën, Ligjin për referendum si dhe me standardet e vendosura evropiane dhe praktikës për referendum të mirë të theksuar nga ana e Komisionit të Venedikut. E majta, kërkonte nga Gjykata Kushtetuese ta shfuqizojë vendimin për referendum, me efekt juridik retroaktiv. Në aspektin material, E majta, kërkon që të shfuqizohet vendimi, për shkak se referendumi konsultativ është i pamundur që të shpallet për anëtarësim në aleancë ose në bashkësi me shtete të tjera, siç është rasti me BE. Neni 120 i Kushtetutës së RM-së, parasheh referendum obligativ si dhe të detyrueshëm, duke theksuar se sipas analizave (hulumtimeve) të tyre, Republika e Maqedonisë në asnjë mënyrë nuk ka sjellur vendim për anëtarësim në BE. Gjithashtu, Apasiev thotë se marrëveshja e cila futet në referendum për deklaram, nuk është i ratifikuar dhe nga këtu, Kuvendi e ka futur vetveten në pozicion të pazgjydhur juridik.²³⁸

Çështja e referendumit në Marrëveshjen e Prespës përmendet në dispozitën e nenit 1 paragrafi 4 alineja c), që parashihet se pas nënshkrimit të marrëveshjes pala do ta ratifikojë marrëveshjen dhe pas ratifikimit të Marrëveshjes në Kuvendin e palës së dytë, pala e dytë do ta njofton palën e parë se Kuvendi i palës së dytë e ka ratifikuar marrëveshjen, dhe “pala e dytë, nëse vendos ashtu, do të mbaj referendum.”, dhe neni 2 paragrafi 3, në të cilin bëhet fjalë për mbështetjen që do t’ia jep Greqia, Maqedonisë së Veriut në organizatat ndërkombëtare,

²³⁶ Одлука за распишување на референдум, бр. 08 – 4666/1, 30 јули 2018, Скопје, линку në dispozicion: <https://akademik.mk/izglasana-odlukata-za-referendum-za-konsultirane-na-graganite/>, (10.07.2020).

²³⁷ Изгласана Одлуката за референдум за консултирање на граѓаните, Академик, 31 јули 2018, линку në dispozicion: <https://akademik.mk/izglasana-odlukata-za-referendum-za-konsultirane-na-graganite/>, (10.07.2020).

²³⁸ Одлуката за референдум пред Уставниот суд, Нова Македонија, 09.08.2018, линку në dispozicion: <https://www.novamakedonija.com.mk/makedonija/politika/%D0%BE%D0%B4%D0%BB%D1%83%D0%BA%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-%D1%80%D0%B5%D1%84%D0%B5%D1%80%D0%B5%D0%BD%D0%B4%D1%83%D0%BC-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%B4-%D1%83%D1%81%D1%82%D0%B0%D0%B2%D0%BD%D0%B8%D0%BE/>, (10.07.2020).

“Mbështetja e tillë e palës së parë, kushtëzohet, së pari, me rezultatin e referendumit, nëse pala e dytë vendos të mbajë referendum në pajtim me këtë marrëveshje dhe së dyti, me miratimin e plotë të amendamenteve kushtetuese, siç është e paraparë në këtë marrëveshje.” Situata është e qartë, Maqedonia e Veriut, mund të mbajë referendum nëse ata vendosin ose vlerësojnë se duhet të mbahet referendum, por jo detyrimisht! Pra, bëhet fjalë për referendum jo të detyrueshëm ose fakultativ.

Referendumi, sipas profesoreshës së të drejtës kushtetuese, Gordana Siljanovska-Davkova, “nuk ka status” të “conditio sine qua non”, për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, për shkak se, sipas vlerësimit të saj, ajo është kundërkushtetuese dhe joligjore dhe si e tillë është e kualifikuar si “konsultativ”, por rezultati “mund”, por “nuk është patjetër”, të jetë i pranuar nga Kuvendi, kurse kushtet kushtetuese nga anëtarët e 73 dhe 120 relativizohen/suspendohen! Në këtë drejtim, ajo parashtron pyetjen se “a mundet që referendumi konsultativ për çështje që duhet të jetë i detyrueshëm të jetë historik?” Ajo shërbëhet me përvojën e pasur franceze të referendumit, me ç’rast përmend se edhe pse kushtetuta franceze në mënyrë eksplicite nuk e përmend që rezultati i referendumit është i detyrueshëm, Këshilli Kushtetues (Gjykata Kushtetuese), e cila e ka rolin kryesor në organizimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e referendumit, si arbitër vendimtar dhe interpretimin: “askush nuk ka të drejtë ta kontestojë vendimin dhe vullnetin e popullit sovran!!” Sipas saj, Kushtetuta e RM, parasheh që referendumi për BE dhe NATO është i detyrueshëm dhe vendimtar (deçiziv), kurse sipas Ligjit për referendum dhe formave tjera të drejtpërdrejta të shprehjes së qytetarëve nuk ka asnjë bazë juridike që ky referendum të jetë konsultativ. Ajo merr shembull edhe kryeministrin maqedonas i cili përpara Parlamentit Evropian, ka folur në emër dhe për Maqedoninë e Veriut si zgjidhje të miratuar, atëherë referendumi është bërë i pa lëndë dhe i pakuptueshëm, për shkak se për qeverinë, rezultati është i njohur edhe përpara se ajo të mbahet.²³⁹Prof. Siljanovska – Davkova, niset nga ajo se referendumi bëhet me qëllim se kreatori i saj llogarit në efektin juridik të dispozitës kushtetuese të nenit 118 se “marrëveshjet ndërkombëtare të cilët janë ratifikuar në përputhje me Kushtetutën janë pjesë e brendshme e rendit juridik dhe nuk mund të ndryshohet me ligj.” Ajo përmend se ligji për ratifikim të Marrëveshjes së Prespës nuk ka qenë i

²³⁹ Давкова – Сиљановска, Гордана, За „Преспанскиот договор,, и пошироко, стр. 19, 20.

votuar në përputhje me Kushtetutën, Kryetari i Shtetit nuk e ka nënshkruajtur dekretim për miratim të saj dhe e njëjta nuk ka hyrë në fuqi. Në kushtetutën tonë nuk ekziston as kompetencë e Kuvendit e as procedurë për ndryshimin e emrit. Ajo vlerëson se emri i Maqedonisë është i imponuar natyrshëm, i pandashëm nga populli maqedonas, nacionalitetit maqedonas dhe luftës shekullore për shtet nacional.²⁴⁰

Kryetari i partisë politike maqedonase, E majta, Apasiev, vlerëson se vendimi për shpallje të referendumit, përkatësisht pyetja e referendumit, fjalpërfjalshëm “A jeni për anëtarësim në BE dhe NATO me pranim të Marrëveshjes mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë?” nuk i plotëson parakushtet juridike të kërkuara ligjore për deklarim të drejtpërdrejtë. Në pyetjen e referendumit veçmë fshihet përgjigjja e dëshiruar ose mënyra e duhur se si të përgjigjesh ose siç duhet “me rregull” të përgjigjesh edhe atë duke e përfshirë pyetjen në pako, përkatësisht “në treshe”. Nëse jeni PËR prej njëren prej tre pyetjeve të parashtruara, automatikisht jeni të detyruar të jeni PËR edhe për dy të tjerat edhe përskaaj faktit se ajo ndoshta nuk është vullneti i vërtetë i juaji. Dhe e kundërta, nëse jeni KUNDËR prej cilido prej tre pyetjeve, automatikisht rrjedhë se jeni kundër të treve, që realisht nuk domethënë ashtu! Sipas Apasievit, pyetjet e tilla të pakuptimta, sugjeruese dhe ekzekutive janë të ndaluara në procedurën tonë.²⁴¹ Për më tepër, ato janë të ndaluara edhe në nenin 1, paragrafi 3 dhe alineja 1, pika 3 dhe në nenin III, paragrafi 2 i Kodeksit për praktika të mira të referendumit (Code of Good Practice on Referendum/2007) i respektuar nga Komisioni i Venedikut, si trup ekspertësh i Këshillit të Evropës. Këtu, gjithashtu është vërtetuar se praktika primare e detyrueshme për pushtetet publike në vendet anëtare të KE-së, mes të cilëve edhe e jona, në zbatimin e referendumit të parashtrojnë pyetje të shkurtëra, të qarta dhe jo të dykuptimta në pyetjet e referendumit.²⁴² Ai shërbëhet edhe me rastin protugez, nga e drejta kushtetuese e krahasuar, kur atje është bërë përpjekje që të zbatohet një referendum i tillë i kombinuar, i dyshuar dhe

²⁴⁰ Давкова – Сиљановска, Гордана, За „Преспанскиот договор„ и пошироко, стр. 21.

²⁴¹ Апасиев, Димитар, Правните Аспекти на референдумот за т.н. Преспанскио договор меѓу Република Грција и „Втората страна„, Case study, Годишен зборник на Правен факултет бр.8, година 2018, Универзитет „Гоце Делчев„ – Штип, стр. 6; cituar sipas: Закон за парнична постапка (Сл. весник на РМ – 79/2005 и 110/08, 83/09, 116/10, 7/11 ПТ). и Закон за кривична постапка (Сл. весник на РМ – 150/2010 и 100/12, 142/16).

²⁴² По ату, fq. 6, cituar sipas: Code of Good Practice on Referendums – I, 3, 1, c & III, 2; Council of Europe, European Commission for Democracy through Law (Venice Commission) – CDL-AD(2007)008, Study. No 371/2006, Council of Democratic Elections – 19th Meeting (Venice, 16 December 2006) & Venice Commission – 70th Plenary Session (Venice, 16-17 March 2007), Strasbourg, 2007. Целосната верзија на следниов линк: [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=cdl-ad\(2007\)008-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=cdl-ad(2007)008-e).

ambivalent, e cila do t'i përmbajë tre pyetje në një ("3 in 1"), por e njëjta ka qenë në mënyrë eksprese i sanksionuar nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Portugalisë. Pyetja e trefishtë atje e parashtruar si te ne, post festum, përkatësisht, pas lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare për të a.q. kushtetutë evropiane, tingëllonte: "A pajtoheni për Kapitullin për të drejtat themelore, me rregullin për kualifikim të votimit dhe me institucionin e ri në korniza të Unionit Evropian të paraparë me Kushtetutën e Evropës?" Gjykata Kushtetuese pyetjen e tillë të referendumit e shpalli si kundërkushtetuese.²⁴³ Ai pretendon se pyetjet e referendumit janë dinake, manipuluese dhe sugjестive. Pyetja e referendumit gabimisht dhe qëllimkeq fillon nga supozimi jo i saktë se populli e ka pranuar një gjë që nuk e njeh. "Ajo është shumë e ngjashme si ajo pyetje që ua japim studentëve të drejtësisë kur i mësojmë me teknikat e "pyetjes së tërthortë", i cili ia ka parashtruar një dëshmitar gjykatësit arogant gjerman: "Ju zotëri gjykatës, a jeni ndaluar së rrahuri gruan tuaj? (sikur gjyqtarit, më parë e ka pranuar se e ka rrahur gruan)." Sipas tij, qytetarëve u imponohet se ato e kanë pranuar ekzistimin e të a.q. Marrëveshje e Prespës edhe pse ai de jure nuk ekziston, por është vetëm fikcion juridik (fictio iuris), për shkak se është i nënshkruar nga personi jo i autorizuar. Pyetjet sipas tij, gjithashtu janë të pasakta, tendencioze, paliative, e panjohur dhe kapcioze, për shkak se në përgjithësi nuk ekziston vendim për anëtarësim ose thirrje (ftesë) të fundit për anëtarësim në BE, por ajo është në të ardhmen, e paraqartë deri në pafundësi.²⁴⁴

Kjo situatë është e rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, me dispozitën e nenit 120, paragrafët 1, 2 dhe 3, në të cilën shkruan se: "Propozim për asocim në bashkim ose në bashkësi me shtetet të tjera ose për dalje nga bashkimi ose nga bashkësia me shtete të tjera mund të paraqesë Kryetari i Republikës, Qeveria ose së paku 40 deputetë. Vendimin për asocim ose për dalje nga bashkimi ose nga bashkësia me shtetet e tjera e merr Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Vendim për asocim ose për dalje nga bashkimi ose nga bashkësia me shtetet tjera është miratuar, nëse në referendum për të ka votuar shumica nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve." Ndërkaq, dispozita e nenit 121 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë parasheh se "Vendim për

²⁴³ Апасиев, Димитар, Правните Аспекти на референдумот за т.н. Преспанскио договор меѓу Република Грција и „Втората страна,,, Case study, Годишен зборник на Правен факултет бр.8, година 2018, Универзитет „Гоце Делчев,, – Штип, стр. 6; cituar sipas: <https://www.venice.coe.int/files/Bulletin/B2004-3-e.pdf>.

²⁴⁴ По аty, fq. 7, 8.

asocim në antarësi ose për dalje nga anëtarësia në organizatat ndërkombëtare merr Kuvendi me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve në bazë të propozimit të Kryetarit të Republikës, Qeverisë ose së paku 40 deputetëve.”²⁴⁵ Pra, në aspektin juridik, sipas Kushtetutës së RMV-së, referendum i detyrueshëm shpallet vetëm në tri raste, edhe atë: i pari, Parlamenti është i detyruar që të shpall referendum kur propozim do të paraqesin së paku 150.000 zgjedhës; i dyti, kur duhet të merret vendimi për ndryshimin e kufijve të RMV-së; dhe i treti, kur duhet të merret vendimi për asociim ose për dalje nga bashkimi ose nga bashkësia me shtetet e tjera. Dy rastet e para janë plotësisht të qarta, pra nuk ekziston propozimi për referendum i së paku 150.000 zgjedhësve si dhe anëtarësimi i shtetit në NATO dhe BE dhe miratimi i Marrëveshjes ndërkombëtare me Greqinë nuk nënkupton edhe ndryshimin e kufijve të shtetit.²⁴⁶ Siç shihet nga dispozitat e mësipërme kushtetuese, ky vendim nuk merret as me shumicën e dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve e as që miratohet më pas, me referendum nëse për të votojnë shumica nga numri i përgjithshëm i qytetarëve, gjë që përndryshe kërkohet me rastin e asociimit të RM-së në bashkime (konfederata) ose në bashkësi (federata) me shtetet e tjera ose për dalje nga bashkimi ose nga bashkësia me shtetet e tjera sipas dispozitës kushtetuese të nenit 120. Në aspektin juridik krahasues, në pjesën dërmuese të kushtetutave të kohës, në mënyrë të qartë përjashtohet mundësia e të qenit objekt referendumi i detyrimeve që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare. Në këtë drejtim, lidhur me rastin e tretë, pyetja që shtrohet dhe që kërkon arsyetim konsiston në atë se, çështja me të cilën u përball RMV lidhur me anëtarësimin në NATO dhe BE, ishte se a duhet të vendoset nga Parlamenti apo nga qytetarët me referendum? Përgjigjen e kësaj pyetjes, si çështje paraprake shtrohet pyetja, çfarë janë BE dhe NATO? A janë BE dhe NATO shtete, supershtete, federata (bashkësi shtetesh), konfederata (bashkime shtetesh) apo organizata ndërkombëtare?²⁴⁷

Sipas Traktatit të Mastroitit të vitit 1992, BE paraqet një tërësi unifikuese që përmbledh tri shtylla, edhe atë: shtylla e parë (komunitetet evropiane), shtylla e dytë (politika e përbashkët e sigurisë dhe politika e jashtme) dhe shtylla e tretë (punët e brendshme dhe drejtësia). Pra, BE nuk është as shtet e as organizatë ndërkombëtare, por paraqet një entitet sui generis me një

²⁴⁵ Устав на Република Северна Македонија, член 120, 121.

²⁴⁶ Shasivari, Jeton, Referendumi: kuti e votimit apo kuti e Pandorës, PORTALB, 21.07.2018, linku në dispozicion: <https://portalb.mk/543046-referendumi-kuti-e-votimit-apo-kuti-e-pandores/>, (15.07.2020).

²⁴⁷ Po aty.

qeverisje që lëviz midis ndër-qeveritares dhe supranacionales, ku bëjnë pjesë 28-të shtete anëtare. Në të drejtën ndërkombëtare, një organizatë shoqërore (entitet politik) për të qenë shtet, duhet kumulativisht të plotësojë katër kushte, edhe atë: së pari, të ketë territorin e vet; së dyti, të ketë popullatën e përhershme; së treti, qeveria legjitime që efektivisht kontrollon territorin e vet, dhe së katërti, kapaciteti për të hyrë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Pra, nëse analizohen katër kushtet e mësipërme për të qenë shtet, në rastin e BE-së ato kushte mungojnë, përkatësisht, mungon elementi i territorit të shteteve anëtare. Madje edhe kufijtë e brendshëm të Shengenit nuk janë unik. BE nuk plotëson as edhe elementin e dytë, atë të popullit, sepse nuk ka popull të vetin, por përbëhet prej popujve të shteteve antare. Gjithashtu, BE nuk plotëson edhe kushtin e katërt, pra atë të qeverisë nën frymën e parimit të ndarjes së pushtetit, por funksionon në bazë të një modeli të qeverisjes shumë-shtresore me përzjerje të kompetencave ligjvënëse dhe ekzekutive, dhe nëse një ditë BE do të shndërrohej në një shtet federativ atëherë do të funksiononte sipas parimit të ndarjes së pushtetit: Parlamenti evropian dydhomësh si bartës i pushtetit ligjvënës, Komisioni Evropian si qeveri evropiane, përkatësisht bartëse e pushtetit ekzekutiv dhe Gjykata Evropiane e së drejtës si një Gjykatë supreme evropiane përkatësisht bartëse e pushtetit gjyqësor. BE nuk plotëson edhe kushtin e katërt, atë të kapacitetit për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare, sepse BE nuk ka ministrinë e punëve të jashtme, nuk ka ulëse të veten në OKB dhe nuk ka politikë unike të jashtme siç ishte rasti me mospasjen e qëndrimit unik të BE-së gjatë prishjes së ish-RSFJ-së, luftërave në Irak dhe Afganistan, njohjes së Republikës së Kosovës, etj.²⁴⁸ Nga ana tjetër, NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikur Verior), siç kemi thënë më herët në këtë punim është komponentë ushtarako-politike dhe trans-atlantike, që për dallim nga organizatat tjera ndërkombëtare, të cilët përbëhen prej vendve evropiane, kjo organizatë në strukturat e saj përfshin edhe SHBA-të si dhe Kanadanë.²⁴⁹

Meqenëse, siç u morr vesh, BE dhe NATO paraqesin organizatë ndërkombëtare që kanë disa elemente si: shtetet anëtare, marrëveshjet ndërkombëtare, organet, fushëveprimin, statusin dhe personalitetin juridik, etj., dhe nga ana tjetër, meqë RM ka të drejtë që të lidh

²⁴⁸ Shasivari, Dr., Jeton, E drejta kushtetuese, Libri I, (Botimi i parë), Furkan ISM, Shkup, 2015, fq. 24, cituar sipas: Reka, Dr., Blerim, Kushtetuta e UE-së-Rubikoni i supranacionales, Shkup, 2007, fq. 44-47.

²⁴⁹Traktati i Atlantikur të Veriut, Uashington D.C., 4 Prill 1949, (neni 10), linku në dispozicion: https://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_17120.htm?selectedLocale=sq, (04.05.2020).

marrëveshje ndërkombëtare dhe të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare për të realizuar bashkëpunimin ndërkombëtar me synimin e mbrojtjes së paqes, sigurisë, të drejtave të njeriut, zhvillimin ekonomik në kushte të globalizimit, etj. Pra, nga e gjithë kjo situatë e sqaruar nga profesori i së drejtës kushtetuese, Jeton Shasivari, në aspektin juridik, nuk ka asnjë pengesë që për këtë çështje të vendosë vetë Parlamenti me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve (pra, më se paku 61 vota të deputetëve).²⁵⁰

Në aspektin politik, meqë LSDM në fillim e pranoi propozimin e VMRO-DPMNE-së për mbajtjen e referendumit, i cili siç e pamë më vonë u bë “pishman” dhe nuk e votoi iniciativën për shpalljen e referendumit. Situatë të ngjashme për mbajtjen e referendumit kemi pasur nga kryetari malazez, Vujanoviq, siç thotë profesori Shasivari, i cili duke pranuar se edhe pse vite me radhë mendonte se duhet referendum për anëtarësimin e Malit të Zi në NATO, megjithatë ai në fund ndryshoi mendje dhe për këtë gje vendosi vetë Parlamenti i Malit të Zi në vitin 2017, si dhe po ashtu, në rrethana të rrijës së vazhdueshme të ndikimit rus në rajonin e Evropës Jug-Lindore. Prof. Shasivari, gjithashtu thekson se referendumi duhet të jetë instrument ku qytetarët nuk do të shprehin atë që mendojnë, por atë që kërkohet prej tyre të mendojnë, pyetja e referendumit duhet të jetë serioze, e njëkuptimët, e shkurtë dhe e qartë.²⁵¹

Për profesorin e së drejtës kushtetuese, Svetomir Shkariq, Ligji për referendum dhe forma të tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve parasheh edhe mundësinë që edhe marrëveshjes ndërkombëtare të jenë lënde e shprehjes në referendum, por para ratifikimit të tyre në Kuvend. Për atë çështje është paraparë referendum paraprak (ante lege), dhe jo referendum të mëpasshëm (post lege) dhe se për këtë detyrim ligjor, negociatorët maqedonas nuk kanë mbajtur llogari kur është përcaktuar versioni final i Marrëveshjes. Vendimi i sjellur në referendum hyn menjëherë në fuqi pas sjelljes së saj. Ajo ka fuqi më të madhe juridike nga të gjitha aktet tjera të sjellura nga organet përfaqësuese. Si e tillë, ajo është burim i së drejtës kushtetuese me një kohëzgjatje më të gjatë. Për atë, sipas prof. Shkariq, duhet të bëhet kujdes kur qytetarët thirren në referendum, kur duhet të dëgjohet zëri i tyre,²⁵² sepse sipas profesor

²⁵⁰Shasivari, Jeton, Referendumi: kuti e votimit apo kuti e Pandorës, PORTALB, 21.07.2018, linku në dispozicion: <https://portalb.mk/543046-referendumi-kuti-e-votimit-apo-kuti-e-pandores/>, (15.07.2020).

²⁵¹ Po aty.

²⁵² Шкариќ, Светомир, Одлуката на референдумот е налог за пратениците и претседателот Иванов, Respublica, 24 јули 2018, linku në dispozicion: <https://respublica.edu.mk/mk/blog/2018-07-24-08-28-18>, (15.07.2020).

Jeton Shasivarit, një gabim i vetëm serioz gjatë menaxhimit të referendumit mund t'i kushtojë shtrenjtë ardhmërisë së shtetit, në këtë rast, që qytetari shkaku i një neni që e konsideron si të papranueshëm të refuzojë krejt Marrëveshjen ndërkombëtare me Greqinë, për të cilën përndryshe është i bindur se është e mirë dhe progresive ose që të pranojë atë nen që të mos e refuzojë në tërësi Marrëveshjen ndërkombëtare me Greqinë.²⁵³

Në referendumin e organizuar më 30 Shtator 2018, prej 1.806.336 qytetarë nga numri i përgjithshëm i qytetarëve të regjistruar në Listën zgjedhore, të drejtën e votës e kanë shfrytëzuar apo kanë votuar gjithsej 666.344 qytetarë, ndërkaq të drejtën e votës nuk e kanë shfrytëzuar 1.139.992 qytetarë. Prej tyre, fletvotime të vlefshme kanë paur 647.114 fletvotime, ndërsa 19.221 ka pasur fletvotime të pavlefshme. Në pyetjen e referendumit se “A jeni për anëtarësim në BE dhe NATO me pranim të Marrëveshjes mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë?”, “PËR” u deklaruan 609.427 qytetarë, kurse “KUNDËR” 37.687 qytetarë nga numri i përgjithshëm i votuesve. Në raportin e rezultateve të votimeve në Referendum në nivel shtetëror, të 30 shtatorit 2018, Komisioni Shtetëror Zgjedhor në përputhje me rezultate përfundimtare, e shpalli vendimin të pa miratuar për shak se nuk kanë votuar më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të qytetarëve të regjistruar në Listën Zgjedhore.²⁵⁴

Që të konsiderohej i suksesshëm referendumi i 30 shtatorit të vitit 2018, nga numri i përgjithshëm i qytetarëve të regjistruar në Listën Zgjedhore, prej 1.806.336 qytetarë, në referendum është dashur të votojnë “PËR” shumica e këtij numri të përgjithshëm apo 51% i zgjedhësve, që në përkthim do të vinte se “PËR” është dashur të votojnë 921.231 qytetarë nga numri i përgjithshëm i qytetarëve të regjistruar në Listën Zgjedhore të KSHZ-së.

Edhe Ligji për referendum dhe forma të tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve, parasheh se “Vendimi i referendumit në nivel shtetëror konsiderohet i miratuar nëse për të kanë votuar shumica nga numri i përgjithshëm i qytetarëve të cilët kanë votuar, përderisa kanë votuar më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të qytetarëve të regjistruar në Listën Zgjedhore, përveçse në rastet kur për çështje të caktuara me Kushtetutë dhe më këtë ligj nuk është e rregulluar ndryshe.”, atëherë pas kësaj “Kuvendi është i detyruar në afat prej 60

²⁵³ Shasivari, Jeton, Referendumi: kuti e votimit apo kuti e Pandorës, PORTALB, 21.07.2018, linku në dispozicion: <https://portalb.mk/543046-referendumi-kuti-e-votimit-apo-kuti-e-pandores/>, (15.07.2020).

²⁵⁴ Извештај за конечните резултати од гласањето на Референдумот на државно ниво, 30 септември 2018 година, бр. 12 – 2139/2, 03.10.2018, Државна Изборна Комисија.

ditëve pas publikimit të rezultateve të referendumit ta rregullojë çështjen, përkatësisht ligjin që është vendosur në referendum, në përputhje me rezultatet e referendumit.²⁵⁵

Deklarimi në referendum ka edhe peshë morale. Ajo shihet në raportin e qeverisë ndaj vendimeve të sjellura në referendumin konsultativ. Vendimet e tilla respektohen, pavarësisht prej karakterit të tyre këshilldhënëse. Kështu veprohet edhe në raport të kantoneve zviceriane dhe me qeverinë e Norgjevisë. Organi kantonial që e sjell referendumin mban llogari për mendimin e qytetarëve kur e sjell vendimin përfundimtar. Qeveria e Norvegjisë në vitin 1972 solli vendim për mos-hyrje të Norvegjisë në tregun e përbashkët të Bashkësisë evropiane, ku 53.5 për qind e votuesve në referendumin konsultativ votuan kundër. Por, më të rëndësishme janë rastet e mospërputhjes mes vullnetit të shprehur të qytetarëve dhe vullnetit të qeverisë (pushtetit), sepse aty pas këtij procesi mënyrë të pashmangshme shpërthen kriza politike, pavarësisht a bëhet fjalë për të referendum të detyrueshëm apo konsultativ. Dalja gjithmonë kërkohet në dorëheqjen e pushtetit dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja.²⁵⁶

Dhe ashtu ndodhi, VMRO-DPMNE-ja në mbledhjen e Komitetit Qendror dhe Ekzekutiv të partisë, vendosi që të mos e njoh rezultatin e referendumit dhe kërkonte formimin e qeverisë teknike. “Komiteti Ekzekutiv shpalli referendum të pasuksesshëm, duke pasur parasysh se dalja e vetëm 36 për qind e votuesve, tregoi vullneti e qartë të popullit kundër kësaj marrëveshjeje”.

Vendimet që u sollën në këtë mbledhje të VMRO-së ishin:

- Rezultatin e referendumit opozita nuk e njeh. Para shpalljes së zgjedhjeve të formohet Komisioni anketues për parregullsinë në referendum. Të zgjidhet kryeprokurori i ri me propozim nga opozita. Të formohet qeveri teknike me mandat prej 100 ditësh, dhe jo më pak.
- Komiteti ekzekutiv ka vendosur të formohet Shtabi zgjedhor republikan dhe shtabi zgjedhir në kuadër të Qytetit të Shkupit, ku edhe janë caktuar koordinatorët, Igor Janushev dhe Vllado Misajllovski.
- Lidhur me ndryshimet kushtetuese, VMRO-ka vazhdon të besoj se deputetët mbajnë

²⁵⁵ Закон за референдум и други облици на непосредно изјаснување на граѓаните, (Сл. Весник на Р. Македонија бр. 81 од 27.09.2005 година.

²⁵⁶ Шкариќ, Светомир, Одлуката на референдумот е налог за пратениците и претседателот Иванов, Respublica, 24 јули 2018,linku në dispozicion: <https://respublica.edu.mk/mk/blog/2018-07-24-08-28-18>, (15.07.2020).

qëndrimin e partisë dhe nuk do të ndryshojnë mendje.²⁵⁷

Fundi fundit, përfaqësueve të sovranit iu është dhënë vend i spikatur gjatë tërë procesit, pra jo vetëm me rastin e ratifikimit të Marrëveshjes së Prespës, duke e angazhuar si palë mbikëqyrëse dhe në mënyrë transparente vazhden e zbatimit të nenit 4 të Marrëveshjes së Prespës, i cili nen paraqet boshtin dhe vetë esencën e dokumentit. Pra, Shkupi ka bërë koncesione të natyrës tenike dhe të gjestit të vullnetit të mirë, duke marrë përsipër njëanshëm ratifikimin e Marrëveshjes, ndryshimin e kushtetutës dhe mbajtjen e referendumit sa për sy e faqe, meqë nuk ka pasur të bëjë me sovranitetin territorial nacional. Në këtë kuptim dispozitat kushtetuese të dy vendeve, si demokraci kushtetuese parlamentare që në tërësi janë respektuar me përjashtim të çështjes së referendumit. Ai është mbajtur jo pse ka qenë përcaktim kushtetues, por se natyra e kontestit nuk ka shkaktuar domosdonë e organizimit dhe mbajtjes së referendumit detyrues, i cili kërkohet me Kushtetutën e Maqedonisë së Veriut çdo herë kur preken çështjet e sovranitetit nacional territorial. Andaj, në këtë drejtim për ta zgjidhur dilemën kushtetuese se a ka qenë kundërkushtetuese referendumi ose jo, vlen të përmendet një thënie lakonike e Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, e cila thënë se referendumi mund të organizohet, të mbahet dhe të quhet kushtetues vetëm nëse rezultatet e tij nuk janë kundërkushtetuese. Në këtë kontekst, rezultati i referendumit maqedonas vërtetë nuk ka qenë jokushtetues sepse nuk ka prekur asnjë dispozitë kushtetuese për të cilën kërkohet referendum nacional i detyrueshëm.²⁵⁸

3.5. Republika e Maqedonisë së Veriut voton amendamentet kushtetuese, “RMV shteti i ri i Ballkanit”

Amendamentet kushtetuese ishin të paraparë në Marrëveshjen e Prespës, edhe atë në nenin 1 të Marrëveshjes, paragrafi 3 alineja g) që “Pala e dytë do ta pranojë emrin “Republika e Maqedonisë së Veriut”, si emër të saj zyrtar si dhe termet e caktuara në nenin 1, paragrafi (3), duke e zbatuar procedurën e brendshme e cila është e obligueshme dhe e përvokueshme, që të përfshijë miratimin e amendamentit të Kushtetutës, siç është përcaktuar me këtë marrëveshje.” Gjithashtu, edhe në paragrafin 4, pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje pala e

²⁵⁷VMRO-ja kërkon dorëheqjen e Zevit dhe Qeveri teknike, AlsatM, 03.10.2018, linku në dispozicion: <https://alsat-m.tv/vendimet-e-komitetit-qendror-dhe-ekzekutiv-te-vmro-dpmne-se/>, (15.07.2020).

²⁵⁸ Për më tepër shih: Hasani, Enver, Marrëveshja e Prespës dhe copëtimi i Kosovës: dallimet dhe ngjashmëritë, Syri Kosova, 13.05.2019, linku në dispozicion: https://www.syri.net/syri_kosova/op-ed/25710/marreveshja-e-prespes-dhe-copetimi-i-kosoves-dallimet-dhe-ngjashmerite/, (15.07.2020).

dytë duhet të fillojë procesin për miratimin e amendamenteve kushtetuese siç është paraparë në këtë marrëveshje dhe se pala e dytë në tërësi duhet t'i miratojë amendamentet kushtetuese deri në fund të vitit 2018 dhe se mbështetja e Greqisë ndaj procesit evro-integrues do të varet nga miratimi i amendamenteve kushtetuese.²⁵⁹

Marrëveshja në mënyrë të qartë kërkon sjelljen e më së paku të katër amendamenteve kushtetuese. Pra, siç e pamë, Marrëveshja fillon me detyrimin e emrit kushtetues “Republika e Maqedonisë”, të ndryshohet me emrin “Republika e Maqedonisë së Veriut”, përveç në nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë. Në këtë drejtim thuajse është vepruar sikur në vitin 1991, me amendamentin LXXXII të 7 qershorit të vitit 1991, atëherë kur emri “Republika Socialiste e Maqedonisë” është ndryshuar me emrin “Republika e Maqedonisë”. Atëherë, mbiemri “Socialiste” është fshirë nga Kushtetuta e RSM-së dhe në të është vendosur emri më i ngushtë “Republika e Maqedonisë”. Kësaj radhe, nuk u fshi asgjë, por vetëm u inkorporua shtesa gjeografike “Veriore” mes fjalëve “Republika” dhe “Maqedonia”. Ajo nuk e shembi estetikën e Kushtetutës, siç nuk u shemb as në vitin 1991. Mbajtja e emrit “Maqedonia” në nenin 36 të Kushtetutës ka domethënie të madhe, për shkak se tregon se pala greke u përkulet luftëtarëve të Luftës Antifashiste dhe nacional-çlirimtare të udhëhequra nga Maqedonia. Ajo d.m.th., se SIRIZA i respekton luftëtarët e ELAS dhe DAG, në të cilët radha kanë luftuar edhe një numër i madh i maqedonasve. Atë e vërteton (konfirmon) edhe Aleksis Cipras, në fjalimin të cilën e mbajti më 25 Janar 2019 në parlamentin grek përpara se të fillojë votimi për ratifikim të Marrëveshjes së Prespës. Amendamenti i dytë ishte më i vështirë për t'u shkruar, për shkak se i referoheshte Preambulës. Në Marrëveshje, siç e kemi parë, nuk tregohet se çka duhet të ndryshohet konkretisht.²⁶⁰

Ligji kushtetues për zbatimin e amendamenteve, drejtpërdrejtë ka marrur nga dispozitat e marrëveshjes mbi çështjen e shtetësisë maqedonase, ashtu siç është shkruar në vetë marrëveshjen. Ajo njëherit është edhe vërtetim se Marrëveshja e Prespës ka karakter kushtetues dhe paraqet burim të së drejtës kushtetuese. Së këndejmi, shtetësia me

²⁵⁹ Final agreement for the settlement of the differences as described in the United Nations Security Council Resolution 817 (1993) and 845 (1993), the termination of the Interim Accord of 1995, and the establishment of a strategic partnership between the parties, Article 1.

²⁶⁰ Për më tepër shih: Шкарик, Светомир, Договорот со Грција и уставните промени, Respublica, 14 септември 2018, linku në dispozicion: <https://respublica.edu.mk/mk/blog/2018-09-14-08-02-16>, (25.07.2020).

marrëveshjen është maqedonase, me çka përforcohet karakteri maqedonas i rregullimit shtetëror në kuptim juridik, politik dhe kulturor. Ajo është një hap para në raport të zgjidhjeve të tanishme kushtetuese për shtetësinë e cila është ekskluzivisht juridike, jo personale. Nocioni i ri i shtetësisë nuk e përcakton e as nuk e ripërcakton përkatësinë etnike të qytetarëve, por edhe nuk e përjashton as mundësinë e vendosjes së atyre maqedonasve që ndjehen si maqedonas ose kush dëshiron të jenë maqedonas, pavarësisht të përkatësisë etnike të tyre. Më këtë, vjen në pah se autorët e Marrëveshjes së Prespës kanë qasje bashkëkohore ndaj shtetësisë. Me kuptim të tillë të shtetësisë, shoqëria maqedonase shumë shpejt do të transformohet nga shoqëri multietnike në qytetare dhe më sigurt do të afrohet drejt BE-së.²⁶¹

Ndryshimet kushtetuese për zbatimin e Marrëveshjes së Prespës për ndryshimin e emrit, atëherë opozita shqiptare aktualizoi kërkesat e veta, duke e shfrytëzuar momentumin për të përfituar diçka edhe shqiptarët prej kësaj situatë, me ndërhyrje në disa nene të kushtetutës me qëllim për ta favorizuar pozicionin e tyre kushtetues apo për ta avancuar pozitën shqiptare në këtë shtet. Partia shqiptare opozitare, Aleanca për Shqiptarët, kërkoi që amendamentet të mbështeten edhe nga partitë tjera me qëllim që të arrihet një kushtetutë, e cila do të promovojë të drejtat dhe jo t'i sanksionojë ato. "Plani dhe strategjia jonë është që amendamentet të kalojnë dhe ndryshimet kushtetuese ta gjejnë shtetin më të drejtë. Kushtetuta të promovojë të drejta dhe liri e jo të sanksionojë. Kjo është ideja e ASH-së, sepse vetëm kështu ka kuptim anëtarësimi i vendit në NATO dhe BE".²⁶²

Lëvizja Besa e drejtuar nga Bilall Kasami ka hartuar katër amendamente, me të cilat kërkonte që shqiptarët të jenë shtetformues, që gjuha shqipe të përcaktohet si gjuhë zyrtare dhe të hiqet emërtimi si gjuhë që e flasin mbi 20 për qind e popullatës në vend. Gjithashtu kërkohet ndryshimi i nenit 49 të Kushtetutës që të mos ketë diskriminim në mbrojtjen e entiteteve tjera që jetojnë jashtë vendit si dhe neni 75 me qëllim që të gjendet mënyra që kryetari i shtetit të mos mund t'i bllokojë ligjet që miratohen në Kuvend. "Propozimet, që ne i japim për përdorimin e gjuhës shqipe është një çështje që të gjitha subjektet politike shqiptare

²⁶¹ Për më tepër shih: Шкариќ, Светомир, Уставните амандмани се политичко а не стручно дело, Respublica, 12 февруари 2019, linku në dispozicion: <https://respublica.edu.mk/mk/blog/2019-02-12-08-41-03>, (25.07.2020).

²⁶² Maqedoni: Të hënën kuvendi shqyrton ndryshimet kushtetuese, DW, 27.10.2018, linku në dispozicion: <https://www.dw.com/sq/maqedoni-t%D1%91-h%D1%91n%D1%91n-kuvendi-shqyrton-ndryshimet-kushtetuese/a-46060289>, (26.07.2020).

e thonë vazhdimisht, çështjen e preambulës e propozojmë si version që ofron një koncept, i cili është më afër realitetit shoqëror që e kemi në Maqedoni”.²⁶³

Partia shqiptare në pushtet, Bashkimi Demokratik për Integrim, kërkesat e opozitës shqiptare i vlerësoi si të motivuara për fitimin e pikëve politike. Deputeti i BDI-së, Xhevat Ademi deklaroi se, asnjë amendament nga 4 amendamentet e qeverisë nuk do të pranohet dhe se amendamentet shtesë mund të propozohen vetëm për 4 amendamentet që kanë të bëjnë me ndryshimin e kushtetutës në përputhje me Marrëveshjen e Prespës.²⁶⁴

Pas disa takimeve me radhë, për koordinimin dhe harmonizimin e qëndrimeve me partitë opozitare, në vazhden e ndryshimeve kushtetuese, në një atmosferë “nën ethe” kryeministri maqedonas i priste dhe i përcillte partitë shqiptare opozitare, votat e së cilës ishin të nevojshme që të përmbylej obligimi i ndërmarrë me Marrëveshjen e Prespës. Zaevi arriti që të mirret vesh me partitë shqiptare opozitare, duke ua pranuar disa nga kërkesat, kurse për realizimin e të tjerave, të njëjtit do të shqyrtohen në një kohë më të përshtatshme. Kryetari i ASH-së u shpreh krenar që arritën marrëveshje me kryetarin e LSDM-së dhe kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev, me çka deklaroi se “fjali e parë e kushtetutës, Preambula të heq padrejtësi për definimin e keq të gjërave. Kemi folur rreth kërkesave që Aleanca për Shqiptarët i ka pasur. Prej sot nuk do të kemi dy kategori të qytetarëve, qytetarë, si dhe qytetarë të tjerë..., por do të jetë vetëm populli maqedonas, shqiptarë, turk etj.” Edhe kryeministri maqedonas, Zaev u shpreh i kënaqur që arritën marrëveshje dhe tha se nga preambula do të fshihen disa fjali me qëllim të mos ketë ndjenjë se dikush këtu është i përkohshëm. “Do të hiqet pjesa “të cilët jetojnë në kufijtë”, që të mos lihet përshtypje se shqiptarët, turqit dhe të tjerët janë vetëm përkohësisht këtu.”²⁶⁵

Gjithashtu, Qeveria e Maqedonisë përmes një komunikate njoftoi opinionin se është arritur marrëveshje me partinë shqiptare opozitare, Lëvizja Besa e Bilall Kasamit, e cila me dy deputetët e saj do të mbështesë ndryshimet kushtetuese në Kuvend. Nga qeveria njoftuan se është pranuar ligji kushtetues për nënshtetësinë, e cila do të jetë “maqedonase/qytetar i

²⁶³ Maqedoni: Të hënën kuvendi shqyrton ndryshimet kushtetuese, DW, 27.10.2018, linku në dispozicion: <https://www.dw.com/sq/maqedoni-t%D1%91-h%D1%91n%D1%91n-kuvendi-shqyrton-ndryshimet-kushtetuese/a-46060289>, (26.07.2020).

²⁶⁴ Po aty.

²⁶⁵ Zaev dhe Sela kanë arritur marrëveshje për “çështjen shqiptare”, PORTALB, 08.01.2019, linku në dispozicion: <https://portalb.mk/582599-zaev-dhe-sela-kane-arritur-marreveshje-per-ceshtjen-shqiptare-video/>, (26.07.2020);

Republikës së Maqedonisë së Veriut”, me të cilin do të shpjegohet etnia dhe do të konfirmohet në të gjitha ligjet që është e nevojshme. Nga qeveria deklaruan se: “Gjithashtu është pranuar propozimi për amendamentin XXXVI me të cilin konfirmohet se shteti në mënyrë të barabartë do të kujdeset për diasporën e qytetarëve të saj. Shtesë në letërnjoftime do të shkruhet edhe përkatësia etnike e qytetarëve. Për punë tjera që janë propozuar, do të tërhiqen amendamentet pasi formalisht nuk është e mundur të arrihen tani dhe në të ardhmen do të punojmë për të zgjidhur të njëjtat”.²⁶⁶

Pala maqedonase pranoi të kryejë ndryshime kushtetuese, menjëherë pas referendumit. Gama e ndryshimeve është konfirmuar marrëveshjes, ngjashëm si Marrëveshja Kornizë e Ohrit e vitit 2001. Saktë përcaktohet emri i ri kushtetues, si dhe interpretimi i termeve “Maqedonia” dhe “maqedonase” të cilët kanë karakter mbikushtetues.²⁶⁷

Pas një beteje të gjatë dhe të lodhshme, me shumë situata të panjohura që nga qershori i vitit 2018 kur u nënshkrua Marrëveshja e Prespës, më fund Kuvendi i Maqedonisë dha dritë të gjelbër për ndryshimin e emrit të shtetit. U miratuan katër amendamentet që ndryshuan kushtetutën e vendit dhe me hyrjen e tyre në fuqi, shteti u pagëzua me emrin “Republika e Maqedonisë së Veriut”. Ky akt, Maqedonisë së Veriut i siguroi anëtarësim në NATO dhe fillim të negociatave me Bashkimin Evropian. Me 81 vota “për” është votuar edhe Ligji Kushtetues për zbatimin e amendamenteve, me këtë votim edhe zyrtarisht mbaroi procesi i ndryshimeve kushtetuese.²⁶⁸ Amendamentet që u miratuan janë si në vijim:

- Amendamenti XXXII – parasheh që: Në kushtetutë fjalët “Republika e Maqedonisë” të zëvendësohen me fjalët “Republika e Maqedonisë së Veriut”, kurse fjala “Maqedoni” të zëvendësohet me fjalën “Maqedonia e Veriut”, përveç në nenin 36.
- Amendamenti XXXIV – parasheh që: Në preambulën e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, fjalët “Vendimet e KAÇKM-it” të zëvendësohen me fjalët “Shpallja e seancës së parë të KAÇKM deri te populli maqedonas për mbajtjen e seancës së parë të

²⁶⁶ Arrihet marrëveshja mes Zaevit dhe Kasamit, НЕЗАВИСЕН ВЕЧНИК, 11.01.2019, linku në dispozicion: <https://nezavisen.mk/arrihet-marreveshja-mes-zaevit-dhe-kasamit/>, (26.07.2020).

²⁶⁷ Шкарик, Светомир, Договорот со Грција и уставните промени, Respublica, 14 септември 2018, linku në dispozicion: <https://respublica.edu.mk/mk/blog/2018-09-14-08-02-16>, (25.07.2020).

²⁶⁸ Ditë historike! Kuvendi i Maqedonisë dha dritë jeshile për ndryshimin e emrit të shtetit, PORTALB, 11.01.2029, linku në dispozicion: <https://portalb.mk/583316-dite-historike-kuvendi-i-maqedonise-dha-drite-jeshile-per-ndryshimin-e-emrit-te-shtetit/>, (26.07.2020).

KAÇKM”, pas fjalës “viti” shtohen edhe fjalët “dhe Marrëveshja Kornizë e Ohrit”, kurse fshihen fjalët “vendosën të”.

- Amendamenti XXXV – parasheh që: 1. Republika e respekton sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë politike të shteteve fqinje; dhe 2. Me pikën 1 të këtij amendamenti plotësohet neni 3.
- Amendamenti XXXVI – parasheh që: 1. Republika e mbron, garanton dhe kujdeset për trashëgiminë kulturore dhe historike të popullit maqedonas; 2. Republika i mbron të drejtat dhe interesat e shtetasve të saj të cilët jetojnë dhe qëndrojnë në mërgim dhe i avancojnë lidhjet e tyre me atdheun; 3. Republika kujdeset për pjesëtarët e kombit maqedonas të cilët jetojnë në mërgatë; 4. Republika gjatë kësaj nuk do të përzihet në të drejtat sovrane të shteteve tjera dhe në punët e brendshme të tyre; 5. Me këtë amendament zëvendësohet neni 49 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.²⁶⁹

Përderisa vazhdonte seanca e parlamentit, përpara Kuvendit të RM, protestuan një grup i qytetarëve të iniciativës “Maqedonia bllokon” të cilët kundërshtonin ndryshimet kushtetuese dhe ndryshimin e emrit të shtetit.²⁷⁰

Ndryshimet që u aplikuan në Kushtetutën e RMV-së me Marrëveshjen e Prespës, e sidomos në ndërhyrjen e preambulës së saj, dallimi midis preambulës së vjetrës të Kushtetutës së vitit 1991 e cila u zëvendësua me amendamentin IV të vitit 2001 dhe të rejtës me Marrëveshjen e Prespës së vitit 2019, konsiston si në vijim:

“Qytetarët e Republikës së Maqedonisë, populli Maqedonas si dhe qytetarët që jetojnë brenda kufijve të saj, të cilët janë pjesë e popullit shqiptar, popullit turk, popullit serb, popullit vllleh, popullit rom, popullit boshnjak dhe të tjerët, duke marrë përsipër përgjegjësinë për të tanishmen dhe të ardhmen e atdheut të tyre, të vetëdijshëm dhe mirënjohës ndaj paraardhësve

²⁶⁹ Janë miratuar të gjitha draft-amendamentet për ndryshimin e Kushtetutës, pason debati publik, PORTALB, 04.12.2018, linku në dispozicion: <https://portalb.mk/574768-jane-miratuar-te-gjitha-draft-amendamentet-per-ndryshimin-e-kushtetutes-pason-debati-publik/>, (26.07.2020).

²⁷⁰ Собранието на Македонија ги усвои уставните измени: Името на државата е Република Северна Македонија, TRT Македонски, 11.01.2019, linku në dispozicion: <https://www.trt.net.tr/makedonski/rieghion/2019/01/11/sobraniieto-na-makiedonija-ghi-usvoi-ustavnitie-izmieni-imieto-na-drzhavata-ie-riepublika-sievierna-makiedonija-1124132>, (26.07.2020).

të tyre, për viktimat dhe përkushtimin ndaj përpjekjeve të tyre dhe luftës për krijimin e shtetit të pavarur dhe sovran të Maqedonisë dhe përgjegjës para brezave të ardhshëm për ruajtjen dhe zhvillimin e tërë asaj që është e vlefshme nga trashëgimia e pasur kulturore dhe bashkëjetesa në Maqedoni, të barabartë në të drejtat dhe detyrimet e tyre ndaj të mirës së përbashkët – Republikës së Maqedonisë – në pajtim me traditat e Republikës së Krushevës dhe vendimet e KAÇPM-së dhe të Referendumit të 8 shtatorit të vitit 1991, vendosën ta konstitujnë Republikën e Maqedonisë si shtet të pavarur, sovran, me qëllim që të vendoset dhe të forcohet sundimi i së drejtës, që të garantohen të drejtat e njeriut dhe liritë civile, të sigurohet paqja dhe bashkëjetesa, drejtësia sociale, mirëqenia ekonomike dhe përparimi i jetës individuale dhe të përbashkët, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, të zgjedhur në zgjedhje të lira e demokratike e nxjerrin këtë²⁷¹

Në preambulën aktuale në fuqi të Kushtetutës së RMV-së, të ndryshuar në vitin 2019, thuhet: “Qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, populli Maqedonas, pjesë e popullit shqiptarë, popullit turk, popullit serb, popullit vllah, popullit romë, popullit boshnjak dhe të tjerët, duke marrë përsipër përgjegjësinë për të tanishmen dhe të ardhmen e atdheut të tyre, të vetëdëshëm dhe mirënjohës ndaj paraardhësve të tyre, për viktimat dhe përkushtimin ndaj përpjekjeve të tyre dhe luftës për krijimin e shtetit të pavarur dhe sovran të Maqedonisë dhe përgjegjës para brezave të ardhshëm për ruajtjen dhe zhvillimin e tërë asaj që është e vlefshme nga trashëgimia e pasur kulturore dhe bashkëjetesa në Maqedoni, të barabartë në të drejtat dhe detyrimet e tyre ndaj të mirës së përbashkët – Republika e Maqedonisë – në pajtim me traditat e Republikës së Krushevës dhe vendimet juridike që janë të theksuar në Proklamatën e mbledhjes së parë të KAÇPM-së deri te populli maqedonas për mbledhjen e mbajtur të KAÇPM-së dhe të referendumit të 8-të shtatorit të vitit 1991, të cilët shprehën vullnetin për të krijuar shtetin e pavarur sovran dhe Marrëveshjen Kornizë të Ohrit e konstitujnë Republikën e Maqedonisë së Veriut si shtet të pavarur, sovran, me qëllim që të vendoset dhe forcohet sundimi i së drejtës, që të garantohen të drejtat e njeriut dhe liritë civile, të sigurohet paqja dhe bashkëjetesa, drejtësia sociale, mirëqenia ekonomike dhe përparimi i jetës individuale dhe të përbashkët, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, të

²⁷¹ Shasivari, Prof., Dr., Jeton, E drejta kushtetuese, Libri I, (Botimi i dytë), Furkan ISM, Shkup, 2020, fq. 145.

zgjedhur në zgjedhje të lira e demokratike e miratojnë këtë”.²⁷²

Amendamenti XXXIV i përmban ndryshimet në preambulën e Kushtetutës. Siç shihet, disa fjalë janë fshirë, disa janë shtuar, kurse disa janë zëvendësuar me të reja. Intervenimet janë kryer në mënyrë mekanike në shumi vende në tekstit të integruar prej 178 fjalëve. Ashtu që preambula “e lënduar” e rëndë është për ta kuptuar. Për atë shkak, disa deputetë në parlamentin grek kanë kërkuar që t’u dorëzohet “tekst i spastruar i Kushtetutës”. Por, ajo ka qenë e pamundur. Spastrimin mund ta bëjë vetëm Parlamenti, në procedurë të paraparë për sjelljen e një kushtetute të re.²⁷³

Kur jemi te preambula aktuale e Kushtetutës së RMV-së, sipas profesorit të së drejtës kushtetuese, Jeton Shasivari, konsideron se ajo duhet t’i nënshtrohet një procesi të rishikimit serioz kritik, sidomos në aspektin e sendërtimit të funksionit integruar të saj, meqenëse kjo preambulë e mbithekson karakterin etnik të shtetit, ku duke u nisur nga fakti se, njëri komunitet etnik në veçanti shquhet si etnos (komb), gjë që e forcon bindjen se, pjesëtarët e komuniteteve të tjera etnike janë qytetarë të rendit të dytë. Pra, sa i fuqishëm është funksioni koheziv i preambulës së re kushtetuese, dhe a do e ketë ajo potencialin e duhur që të shërbejë si një “material lidhës” për të unifikuar qytetarët e RMV-së sepse, edhe në të ardhmen vazhdohet me ndarjen e qytetarëve të RMV-së, në popull Maqedonas (termi Maqedonas i shkruar me gërmë të madhe) dhe në qytetarë që janë pjesë e popullit shqiptarë, popullit turk, popullit serb, popullit vllah, popullit romë, popullit boshnjak dhe të tjerët, ku edhe pse preambula aktuale i vendosë qytetarët si element konstitutiv të shtetit, megjithatë, popullin Maqedonas e përkufizon si etnos (komb), ndërkaq, shqiptarët si pakicë nacionale gjë që paraqet një diskriminim të hapur etnik të qytetarëve që juridikisht i përkasin këtij shteti.²⁷⁴

Marrëveshja e Prespës parasheh dispozita imperative edhe për Greqinë. Edhe ajo ishte e detyruar që ta ratifikojë marrëveshjen, pas ratifikimit të saj në shtetin fqinj, pra në Maqedoninë Veriore dhe ndryshimet e kryera në kushtetutën maqedonase. E detyruar është që ta mbështet anëtarësimin e RMV-së në BE dhe NATO, si dhe ta zhvillon parnteritetin strategjik me shtetin

²⁷² Shasivari, Prof., Dr., Jeton, E drejta kushtetuese, Libri I, (Botimi i dytë), Furkan ISM, Shkup, 2020, fq. 145.

²⁷³ Шкарик, Светомир, Уставните амандмани се политичко а не стручно дело, Respublica, 12 февруари 2019, linku në dispozicion: <https://respublica.edu.mk/mk/blog/2019-02-12-08-41-03>, (25.07.2020).

²⁷⁴ Për më tepër shih: Shasivari, Prof., Dr., Jeton, E drejta kushtetuese, Libri I, (Botimi i dytë), Furkan ISM, Shkup, 2020, fq. 146.

maqedonas. E detyruar është edhe ta largojë dyshimin e maqedonasve.²⁷⁵ Kështu, pas 11 janarit 2019, pas negociatave të gjata dhe të vështira të shumicës parlamentare me opozitën për sigurimin e 81 votave në Kuvend edhe në parlamentin e Greqisë ndodhi e njëjta gjë, shumica parlamentare me vështirësi të mëdha arriti t'i sigurojë 153 vota për ratifikimin e Marrëveshjes së Prespës më 25 Janar 2019. Nga rezistenca e të dyja vendeve qartë shihet se sa Rabindrant Tagore ka qenë në të drejtë në vitin 1912, kur ka theksuar se “nacionalizmi është epidemi e frikshme e cila e helmon njerëzimin”, se është, “mjegull e trashë e padurueshme e cila e fsheh madje edhe diellin” dhe se “kombi mund të jetë e keqja më e madhe e vetë kombit.”²⁷⁶ Dhe kjo dëshmohet edhe me vetë fjalimin që e ka mbajtur në parlamentin e Greqisë, ish kryeministri Aleksis Cipras, më 25 Janar 2019, përpara se të fillojë votimi për ratifikimin e Marrëveshjes së Prespës. Duke u drejtuar deputetëve të radhës së opozitës të cilët më parë kishin paralajmëruar se do të votojnë kundër marrëveshjes së Prespës, Cipras i quajti “nacionalistë”, duke i kujtuar në paraardhësit e tyre të cilët kanë qenë internacionalistë: “Nuk dua t'i referohem as abetarës së sllavomaqedonasve që komunistët e kanë ndarë në Tashkent fëmijëve të luftëtarëve sllavomaqedonas të Armatës Demokratike të Greqisë. Nuk dua t'i referohem as 70.000 refugjatëve të luftës qytetare të cilët shteti grek i privon nga e drejta në vitin 1983 që të kthehen në atdheun e tyre. Dhe as nuk dua t'i referohem sllavomaqedonases Irini Gini – Mirka Ginova, gruaja e parë e ekzekutuar në luftën qytetare, komuniste. Me këto kujdesje ndaj vetëdijes që e keni, të ballafaqoheni vetë!” Askush deri më tani atë nuk e ka thënë ashtu hapur në parlamentin grek pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Varkizës të shkurtit të vitit 1945.²⁷⁷

Mirëpo, të gjithë nuk mendojnë kështu ose së paku nuk i shohin aspektet pozitive të marrëveshjes, ka edhe prej të atillëve të cilët e sakrifikojnë të ardhmen e shtetit, për çështjen e emrit. Kështu një grup shkencëtarësh dhe autorë, në mesin e të cilëve edhe Xhejms Petifer, Milan Kundera, Gordana Siljanovska – Davkova, Igor Janev, Mihajllo Popovski, Dimitar Apasiev e të tjerë, u drejtuan një letër të hapur opinionit maqedonas për të shfaqur qëndrimin e tyre rreth marrëveshjes në fjalë të cilët marrëveshjen e konsiderojnë si një marrëveshje e cila nuk u

²⁷⁵ Шкарик, Светомир, Договорот со Грција и уставните промени, Republica, 14 септември 2018, линку në dispozicion: <https://republica.edu.mk/mk/blog/2018-09-14-08-02-16>, (25.07.2020).

²⁷⁶ Për më tepër shih: Шкарик, Светомир, Уставните амандмани се политичко а не стручно дело, Republica, 12 февруари 2019, линку në dispozicion: <https://republica.edu.mk/mk/blog/2019-02-12-08-41-03>, (25.07.2020).

²⁷⁷ По ату.

shërben interesave të Maqedonisë dhe as të Greqisë. Ajo nuk është e bazuar në aspekt të së drejtës ndërkombëtare, të të drejtave të njeriut dhe principeve demokratike. Sipas tyre, marrëveshja mundohet të definojë kufijë politik, historik dhe kulturor mes “Maqedonisë antike” dhe (që duhet të jetë) Maqedonisë Veriore është ndërmarrje bizare joadekuante e shekullit 21. Konstruksioni i identiteve nuk është punë për cilëndo qeveri. Maqedonia është e nënshtruar në inxhinieringun arbitrare ndërkombëtare kundër vullnetit të popullit të saj, për shkak të mbështetjes së dobët politike, atmosfera nuk do t’i zvogëlon tensione rajonale, për shkak se vetëm pala më e dobët (maqedonase) është e detyruar për kompromis, që ta detyrojë Maqedoninë (Veriore) në NATO – organizatë, e cila është vetë në krizë identitare. Sipas tyre, artibuti “maqedonase” do të jetë i fshirë në të gjitha dokumentet e udhëtimit edhe nga përdorimi publik nën kërcënimin e sanksionit orvillian. Mismenxhmenti ndërkombëtare siç e quajnë ata, vazhdon duke i mbështetur masat për vendosje të besimit, zgjidhjes së konflikteve dhe paqes, ne veprojmë në theksimin se Marrëveshja e Prespës na premton paqe të qëndrueshme. Anëtarësimi në NATO, nuk do të sjell progres ekonomik dhe social ose siguri për shtetin e vogël maqedonas, ironike, por vetë Greqiaë është fakti më i mirë se çka prodhojnë diktatet ndërkombëtare të periferisë evropiane.²⁷⁸

Për në fund të këtij kapitulli, Marrëveshja e Prespës është shembulli eklatant sesi marrëveshja ndërkombëtare juridike hynë në të drejtën kushtetuese nacionale, si e ndryshon dhe i injoron normat e ngushta të saj, kur janë në kolizion (konflikt) me kushtetutën faktike. Pra, bëhet fjalë për “Marrëveshje-mbikushtetuese”, siç janë Marrëveshja e Përkohshme e vitit 1995 si dhe Marrëveshja Kornizë e Ohrit e vitit 2001. Këtë gjë, nuk e kuptojnë oponentët e marrëveshjes, e as mbrojtësit e “sovrانيتit kushtetues të Republikës së Maqedonisë.”²⁷⁹ Me rëndësi për Maqedoninë e Veriut si dhe për maqedonasit ishte mbajtja e emrit “Maqedoni”. Kjo është përfitimi më i madh dhe më domethënës për palën maqedonase. Edhe pse titulli i këtij nën-kapiulli është “RMV shteti i ri i Ballkanit”, me emrin “Maqedoni” vetëm se vazhdohet kontinuiteti i shtetit maqedonas, nga ASNOM-i deri në kohën e sotme e nga Maqedonia

²⁷⁸ Për më tepër shih: Отворено писмо, Нова Македонија, 01.09.2018, linku në dispozicion:

<https://www.novamakedonija.com.mk/makedonija/%D0%BE%D1%82%D0%B2%D0%BE%D1%80%D0%B5%D0%BD%D0%BE-%D0%BF%D0%B8%D1%81%D0%BC%D0%BE-2/>, (26.07.2020).

²⁷⁹ Për më tepër shih: Шкарик, Светомир, Договорот со Грција и уставните промени, Respublica, 14 септември 2018, linku në dispozicion: <https://respublica.edu.mk/mk/blog/2018-09-14-08-02-16>, (25.07.2020).

Federale (1944-1946) e deri te Republika e Maqedonisë (1991-2018) dhe Republika e Maqedonisë së Veriut.²⁸⁰ Apo siç thotë, ministri i punëve të jashtme, Nikolla Dimitrov, nënshkruesi i Marrëveshjes së Prespës “E para si Federata Demokratike e Maqedonis, Republika Popullore e Maqedonisë, më vonë si Republika Socialiste e Maqedonisë, Republika e Maqedonisë në pavarësi dhe tani Maqedonia e Veriut. Cila është konstantja në të gjitha këto emra të përbëra – emri Maqedonia. Nuk jemi as Madagaskar, as Mauricius ose Mongli, e aq më pak Shkupi”.²⁸¹

²⁸⁰ Për më tepër shih: Шкариќ, Светомир, Договорот со Грција и уставните промени, Respublica, 14 септември 2018, linku në dispozicion: <https://respublica.edu.mk/mk/blog/2018-09-14-08-02-16>, (25.07.2020).

²⁸¹ Димитров до Силјаноска: Кажете дали се залагате да го симнеме знамето на НАТО и да заборавиме на ЕУ, 360степен, 29 јуни 2020, linku në dispozicion: <https://360stepeni.mk/dimitrov-do-siljanoska-kazhete-dali-se-zalagate-da-go-simneme-znameto-na-nato-i-da-zaboravime-na-eu/>, (26.07.2020).

K A P I T U L L I I K A T Ë R T

P E R I U D H A P A S R A T I F I K I M I T T Ë M A R R Ë V E S H J E S S Ë P R E S P Ë S

4.1. Analiza e mundësive eventuale për dështimin e Marrëveshjes së Prespës

Marrëveshja e Prespës, shpesh herë ka qenë objekt i mundësive eventuale të dështimit apo më mirë thënë të anulimit të së njëjtës, nga maqedonasit të cilët nuk pajtoheshin me kompromisin e arritur me Greqinë për zgjidhjen e kontestit të emrit. Në këtë drejtim, më së shumti shquhet partia maqedonase opozitare, VMRO-DPMNE-ja, për qëndrimin e tyre kundër marrëveshjes, duke iu bashkangjitur edhe partia tjetër opozitare parlamentare, E majta, të cilët së bashku janë angazhuar për dështimin e kësaj marrëveshjeje, si dhe të shqyrtimit të mundësisë së anulimit në të ardhmen e afërt ose të largët. Ndërkaq, nëse në Maqedoninë e Veriut, kërcënim për Marrëveshjen e Prespës paraqesin partitë opozitare maqedonase, në Greqi gjithashtu kërcënim për mundësinë eventuale të dështimit apo anulimit të Marrëveshjes mes këtyre dy shteteve, paraqiste opozita greke, kundërshtarë e partisë SIRIZA së ish kryeministrit grek, Aleksis Cipras. Por, sa arriti kjo e fundit ta realizon premtimin elektorale mbi anulimin e marrëveshjes në fjalë dhe se a ekziston kërcënim potencial edhe në të ardhmen? Sa realisht angazhohet VMRO-DPMNE-ja mbi mundësinë e anulimit të marrëveshjes dhe a ekziston gjithashtu rreziku potencial që kjo parti maqedonase me ardhjen në pushtet ta anulon këtë marrëveshje dhe deri ku mund të shtrihen gjasat për anulimin apo dështimin e së njëjtës?

Aleksandar Nikolovski, duke ju drejtuar atyre të cilët e kanë nënshkruar Marrëveshjen e Prespës, duke e quajtur si “marrëveshje kapitulluese” me Greqinë, tha se ata do të përgjigjen penalisht. Ai drejtoi akuza deri te këshilltari i Zoran Zaevit, Zoran Bashanoviç, që sipas tij, ai ka qenë lidhje mes Zaevit dhe Ciprasit dhe se ai drejtpërdrejtë ka negociuar me Greqinë për ndryshimin e emrit kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut, madje se edhe Zaevi dhe Dimitrovi kanë punuar në ndryshimin e emrit që prej para se të formohet qeveria. Këto akuza erdhën kur duheshte të ratifikohet Marrëveshja e Prespës, gjë që partia maqedonase VMRO-DPMNE e konsideron si kundërkushtetuese. Sipas tyre, kjo marrëveshje nuk duhet të jetojë. VMRO-ja nuk do të merr pjesë në zbatimin e saj dhe çdo përpjekje për zbatim të saj me forcë do të sjell edhe përgjegjësi. Ata vlerësojnë, se Marrëveshja e trupit siç e quajnë ata Marrëveshjen e Prespës, nuk është garancë se do të hapërojmë drejt rrugës së evro-integrimeve.²⁸²

²⁸² VMRO-DPMNE со кривични пријави ќе „гласа“, за Договорот со Грција, DW, 05.07.2018.

Ish ministri i punëve të jashtme nga radha e VMRO-DPMNE-së, Milloshoski, në intervistë me gazetën gjermane thekson se partia e tij po i shikon mundësitë e kthimit të emrit kushtetues nëse vjen në qeveri. Sipas tij, kjo variantë është e komplikuar por, ai shpreson se ekzistojnë mënyra që të kthehet emri i vjetër kushtetues “Maqedonia”. Ai këtë e sheh përmes rrugës së Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, që ta miratojë marrëveshjen si nul dhe të pavlefshme, duke marrë për bazë referendumin e kaluar, e cila nuk kishte kaluar shumicën për anulimin e emrit të vjetër. Si opcion të dytë, Milloshovski përmend deputetët të cilët “nën kërcënime dhe presione”, kundër vullnetit të tyre kanë votuar për riemërimin e Maqedonisë së Veriut. Kjo sipas tij, bëhet nëse deputetët e tyre që kanë votuar pro ndryshimeve kushtetuese të gjejnë forcë pas ndryshimit të qeverisë, publikisht të flasin për atë dhe të dëshmojnë përpara Prokurorisë Publike dhe ajo mund ta ndryshojë atmosferën dhe të sigurojë shumicë prej dy të tretave në Parlament për kthimin e kushtetutës së vjetër. Ai gjithashtu është kritik edhe ndaj Qeverisë për miratimin e marrëveshjes, për shkak se ata nuk kanë kërkuar “garancion të fuqishëm” se me ndryshimin e emrit do të fitojnë perspektivë në BE.²⁸³

Qasje të njëjtë ndaj Marrëveshjes së Prespës, ka edhe profesoresha maqedonase e së drejtës kushtetuese, Gordana Siljanovska-Davkova, e cila shpesh herë ka deklaruar se personalisht ajo asnjëherë nuk do ta shfrytëzojë atë emër të imponuar dhe gjithmonë do ta quaj Maqedoni. Kthimi i emrit të vjetër kushtetues, njëjtë si ish ministri i punëve të jashtme të VMRO-së, Milloshoski, e sheh përmes Gjykatës Kushtetuese, duke e marrë për bazë referendumin e pasuksesshëm dhe atë fakt sipas saj askush nuk mund ta ndryshojë. Për atë do të kërkojë edhe respektim të së drejtës ndërkombëtare, për të cilën profesorë eminentë botëror, kanë thënë se është shkelur përmes Marrëveshjes së Prespës. Ajo gjithashtu kthehet në të kaluarën kur përmend se emrin ata nuk e kanë sajuar por e kanë trashëguar dhe nuk kanë të drejtë ta ndryshojnë, për shkak të paraardhësve të tyre dhe të rrënjëve të tyre. Ajo zgjidhjen e marrëveshjes e sheh te ulja e njerëzve në Parlament dhe Qeveri, të cilët janë të gatshëm të japin gjithçka për shtetin, te njerëzit të cilët prej në fëmijëri kanë luftuar për dituri, te njerëzit pa bagazh, me kredibilitet dhe dinjitet.²⁸⁴ Profesoresha në fjalë, njihet edhe për qëndrimet

²⁸³ Милошоски за ФАЦ: ВМРО-ДПМНЕ бара начин да го врати уставното име, DW, 21.10.2019.

²⁸⁴ Гордана Сиљановска ќе бара поништување на Преспанскиот Договор, НОВА ТВ, 29 јуни 2020, линку në dispozicion: <https://novatv.mk/gordana-siljanovska-ke-bara-ponishtuvane-na-prespanskiot-dogovor/>, (27.07.2020);

kontradiktore të saj, ajo njëherë ka deklaruar se do ta respektojë për Marrëveshjen e Prespës për shkak se ajo u bë pjesë e Kushtetutës, por personalisht do t'i ik vetëm përdorimit të emrit Maqedoni e Veriut. “Kuptohet se do ta respektojë, për shkak se ajo u bë pjesë e Kushtetutës. Unë do t'i respektojë mbishkrimet e emrit të shtetit, por personalisht si individë gjithmonë do t'i iki emrit Maqedonia e Veriut dhe kuptohet do t'i përdori mbiemrat maqedonas/maqedonase. Nuk e di si erdhi deri te ajo që vetëm disa institucione publike shtetërore të quhen kombëtare, Teatri Kombëtar që të mund të thirret maqedonase, kurse për ASHAM-in nuk e di ku është logjika. Me përgjegjësi theksoj se kur të thonë kombëtare, mendoni në etnos apo në demos? Unë mendoj në demos. Për mua s'ka pengesë mbiemri maqedonas të qëndrojë përpara të gjitha institucioneve publike. Fundja, edhe në nenin 7, paragrafi 2 qëndron se është i lejueshëm përdorimi i mbiemrit “maqedonase”.²⁸⁵ Për profesoreshën në fjalë, mënyra se si është sjellur Marrëveshja e Prespës nuk ka qenë në përputhje me Kushtetutën e Maqedonisë dhe as në përputhje me obligueshmërinë e së drejtës ndërkombëtare. Ajo theksoi se me Marrëveshjen e Prespës, Greqia nuk e interpreton atë njëjtë si ne, për shkak Ciprasi në interpretimet e tij nuk e njeh nacionalitetin maqedonas, se atë çka maqedonasit e nënkuptojnë nën popullin maqedonas dhe komb maqedonas, nuk e nënkupton edhe ai.²⁸⁶

Kandidatura e saj për Kryetare të Shtetit të RMV-së, shihej si një “referendum i dytë”, përkatësisht një sulm i garës presidenciale për votat “për” dhe “kundër”, si vërtetim i përkrahjes së Marrëveshjes së Prespës, duke pasur parasysh se profesoresha ishte kritikuese e zjarrtë e marrëveshjes, kurse nga ana tjetër do të kishte kandidatë të cilët ishin mbështetës të mëdhenj të marrëveshjes.²⁸⁷ Slogani i partisë kandiduese të saj, “Drejtësi për Maqedoninë – atdheu thërret”, sipas profesorit Svetomir Shkariç, është slogan lufte, e ngjashme asaj të betejës së Stalingradit e vitit 1943, „Родина - Мать зовет!”. Ajo thërret në rregullimin e padrejtësive që i janë bërë Maqedonisë me Marrëveshjen e Prespës dhe me Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Ajo kërkon edhe ndryshim të pushtetit, andaj mesazhin e dërgon në mesnatë, ku mbizotëron errësira “Errësirë gjithkund, ashtu si në shtet. Kërkoj dritë. Mendoj që momenti që e ndaj me

²⁸⁵ Силјановска Давкова: Ќе го почитувам Преспанскиот договор, но лично секогаш ќе го одбегнувам називот Северна Македонија, МКД, 04 април 2019, линку në dispozicion: <https://www.mkd.mk/makedonija/politika/siljanovska-kje-go-rochituvam-prespanskiot-dogovor-no-lichno-sekogash-kje-go>, (27.07.2020).

²⁸⁶ Преспанскиот договор не беше во согласност со Уставот на Македонија ниту во согласност со задолжителното меѓународно право, ВМРО-ДПМНЕ, 24 јуни 2020.

²⁸⁷ Силјановска ќе игра „втор референдум“, за Договорот од Преспа!, DW, 18.02.2019.

juve, do të jetë fillim i fundit të një pushteti. Mesnatë është, kurse unë qëndroj para shtëpisë së vendlindjes në Ohër. Atje filloj jeta ime, në Republikën Popullore të Maqedonisë. Nëse duhet ta ndryshojë kartën e identitetit do të duhet të gënjej se jam lindur këtu, në Republikën e Maqedonisë së Veriut.”²⁸⁸

Slllogani i Siljanovka-Davkova është në funksion të luftimit të pushtetit të tanishëm përmes zgjedhjeve të parakohshme parlamentare që do të duhet ta përcjellin pas uljes së saj si kryetare e shtetit. E vetëdijshme është se vetë ajo nuk mundet ta kthejë emrin “Republika e Maqedonisë”, pa ndryshim të shumicës parlamentare. Për atë edhe ajo kërkon mbështetje nga partia më e madhe opozitare në bllokun maqedonas. Nga këtu, këto zgjedhje nuk ishin zgjedhje të thjeshta presidenciale, edhe nga fakti se kundërkandidati i saj, nga radhët e partisë LSDM, Stevo Pendarovski, u paraqit me sllloganin “Bashkë përpara”, i cili thërriste në bashkim të të gjitha forcave në shoqëri, me dëshirë që të shkohet përpara, duke u bazuar në spotin “Të gjithë njësoj këndojmë”. “Koncepti im është për përpara, ajo e Siljanovskës për mbrapa. Nuk guxojmë të lejojmë që proceset të na kthejnë mbrapa në të kaluarën, në pafundësi (në të panjohur), në izolim, larg nga BE dhe NATO. Ecëm një rrugë të gjatë dhe të rëndë që të arrijmë këtu, por bashkë mundemi edhe më shumë.”²⁸⁹

Në këto zgjedhje presidenciale, Stevo Pendarovski në rrethin e parë morri 42,81% të votave, ndërsa Gordana Siljanovska-Davkova, 42,25% të votave. Në rrethin e dytë, u shpall fitues Stevo Pendarovski me 51.65% të votave të fituara, përkundër kundërkandidatjes së saj, Gordana Siljanovska-Davkova me 44,75% të votave.²⁹⁰ Në këto zgjedhje, duke pasur parasysh rëndësinë e tyre që kishin në aspekt të planeve të Qeverisë për zbatimin e Marrëveshjes së Prespës dhe procesit evro-integrues dhe nga zhvillimi i gjithëmbarshtëm i fushatës parazgjedhore, ku Marrëveshja e Prespës zinte vend kryesor, mund të thuhet se në këto zgjedhje presidenciale “fitoi” Marrëveshja e Prespës në krye me Stevo Pendarovskin, i cili e kishte edhe shumicën e përkrahjes së shqiptarëve.

Kryetari i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickovski, që në fillim ka deklaruar se Marrëveshja

²⁸⁸ Për më tepër shih: Шкарик, Светомир, Колку се остварливи ветувањата на претседателските кандидати?, Republica, 17 април 2019, linku në dispozicion: <https://republica.edu.mk/mk/blog/2019-04-17-07-15-01>, (27.07.2020).

²⁸⁹ По ату.

²⁹⁰ Извештај за спроведените избори за Претседател на Република Северна Македонија одржани на 21 април и 5 мај 2019 година, Мај 2019 година, Скопје, бр. 09-2085/1, 12.06.2019, Скопје, Државна Изборна Комисија.

e Prespës është tradhëti dhe se “ka matematika si të përmirësohet gabimi”. Pra, qëndrimi i tij ndaj Marrëveshjes së Prespës ka ndryshuar në aspekt të qasjes së tij nga ekstremja deri te liberalja. Tani, ai nuk mendon se marrëveshja duhet anuluar në tërësi, por ai thekson se është për revidim të marrëveshjes dhe të përmirësimit të saj, në rritjen e kualitetit dhe kthimit në pozicionet e humbura, që kryeministri Zaev i ka nënshkruar nën presion. Ai mendon se duhet negociuar përsëri me Greqinë dhe në këto negociata ai do të jetë mbrojtës i interesave nacionale maqedonase dhe interesit të shtetit maqedonas dhe nuk tërhiqet nga ajo pikë. Këtë mundësi ai e sheh përsëri në shumicën prej dy të tretave dhe te deputetët e bashkësive tjera etnike, me çka Maqedonia e Veriut do të bëjë një hap mbrapa, në të kundërtën sipas tij, Maqedoninë e Veriut e pret shumë punë.²⁹¹ Këtë linjë qartë e ka shprehur partia e tij, e cila ka vlerësuar se marrëveshje më të mirë me Greqinë nuk është më e mundur. Pra, ato vazhdojnë për qëndrimin se marrëveshja është e keqe, por fatkeqësisht siç thonë ata “ne duhet të jetojmë me Marrëveshjen e Prespës”. Ata qëndrojnë në shpresën e tyre se kur VMRO-ja të ketë shansën ta udhëheq Qeverinë, do të arrijnë në marrëveshje më të mirë me Greqinë, e cila do të jetë e balansuar dhe në favor të Maqedonisë dhe jo vetëm në favor të Greqisë. Kujtojmë se e njëjta parti, ka përjashtuar shtatë deputetët e tyre për shkak se kanë vepruar në kundërshtim me politikat e VMRO-së. Këtë kyetari i VMRO-së, Mickovski e komentoi se “VMRO-DPMNE nuk është shoqëri kori, që secili të këndojë në tone të ndryshme”.²⁹²

Sesi do ta revidojë marrëveshjen kryetari i VMRO-së, shihet qartë nga qëndrimi i partisë së tij që mban përpara çdo fushate parazgjedhore në Maqedoninë e Veriut, parolla “Asnjëherë Veriore, vetëm Maqedoni”, e cila deri vonë dëgjohej nga fyti i tifozëve në tubime sportive si dhe në tifozëri dhe në protesta të ndryshme, kjo parollë u bë zyrtare edhe në ofertën partiake të kësaj partie. Pas shpërbërjes së Parlamentit, nënkryetari i VMRO-DPMNE-së, Vllado Misajllovski, kishte publikuar një video-spot të inçizuar nga selia e partisë. Me disa bashkëpunëtor në preparvijë, fliste për projekte partiake, ekonomike, infrastrukurore dhe ekologjike dhe videoja mbaronte me “Asnjëherë Veriore, gjithmonë Maqedonia”. Këtë seri të videove e vazhdoi edhe nënkryetari tjetër i partisë, Aleksandar Nikoloski. Mesazhe të tilla ka dërguar edhe ministrja e

²⁹¹ Për më tepër shih: Мицкоски бара двотретинско мнозинство за измени во Преспанскиот договор, Мицотакис ревидирање, МКД, 06 декември 2019, linku në dispozicion: <https://www.mkd.mk/makedonija/politika/mickoski-bara-dvotretinsko-mnozinstvo-za-izmeni-vo-prespanskiot-dogovor>, (27.07.2020).

²⁹² Салто во ВМРО-ДПМНЕ: Веќе не е можен подобар Договор со Грција! DW, 02.11.2018.

punës dhe politikës sociale në qeverinë teknike Rashela Mizrahi, e cila u shkarkua, pas vendosi tabelën e vjetër të emrit kushtetues të Maqedonisë së Veriut, duke përçar mesazh deri te opinionioni maqedonase se ata nuk e respektojnë Marrëveshjen e Prespës dhe emrin e ri kushtetues.²⁹³

Kujtojmë se qasje të njëjtë me VMRO-DPMNE-në ka pasur edhe opozita greke në Greqi, e cila në deklaratimet e saj dukej se me ardhjen në pushtet të saj, do të jetë kërcënim dhe rrezik serioz për anulimin e marrëveshjes. Andaj, edhe shumë analistë në këtë drejtim, e marrin për shembull opozitën greke për krahasim me VMRO-DPMNE-në të cilët thonë se “partia opozitare edhe deri më tani i kundërshtohet Marrëveshjes së Prespës, por pritshmëritë se sa të afrohen zgjedhjet ashtu edhe do të përshtatet edhe ndaj realitetit të ri.”, dhe se kjo bëhet vetëm për përfitimin politik. Pra, rasti është i njëjti me NEA Demokracinë në Greqi, që ishin maksimalisht kritikë ndaj Marrëveshjes së Prespës, duke qëndruar rreptë në qëndrimin e tyre se të njëjtin do ta ndryshojnë, por, menjëherë sa erdhi në pushtet Micotakis dekalori se është e rëndë e njëjta të ndryshohet, por do të bëjnë gjithçka që e njëjta të jetë e implementuar me dëm më të vogël për Greqinë. Edhe strategjia e VMRO-së është në këtë drejtim, në maksimalizimin e votës maqedonase duke e shfrytëzuar Marrëveshjen e Prespës.²⁹⁴ Edhe Naser Ziberi, vlerëson se çështja e emrit për VMRO-DPMNE-në është kartë atraktive në të cilën mund të përfitojë një strukturë të caktuar të votuesve dhe ato me vetëdije luajnë në atë kartë. Por, sipas tij, ky opcion i përzgjedhur i VMRO-së mund ta dëmtojë shtetin edhe në plan ndërkombëtar, në aspekt të proceseve evro-integruese, por edhe vetë stabilitetin e brendshëm të vendit, për shkak se një pjesë domethënëse e qytetarëve qëndrojnë pas kësaj marrëveshjeje.²⁹⁵ Dhe kjo u reflektua në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020, ku numri i deputetëve të fituar nga VMRO-DPMNE-ja nga 51 deputetë në zgjedhjet e vitit 2016, rra në 44 deputetë në vitin 2020. Por, në këtë drejtim nuk është më e mirë as LSDM-ja si nënshkruese dhe përkrahëse e madhe e Marrëveshjes së Prespës, e cila pati rrënie të deputetëve nga 49 në vitin 2016 në 46 deputetë edhe atë në koalicion me partinë shqiptare Lëvizja Besa. Të gjitha këto mund të jenë indikator i popullatës

²⁹³ Анализа: Каде цели и каде ќе стигне ВМРО-ДПМНЕ со ставот против договорот од Преспа, 360степени, 25 февруари 2020, линку në dispozicion: <https://360stepeni.mk/video-analiza-kade-tseli-i-kade-ke-stigne-vmro-dpmne-so-stavot-protiv-dogovorot-od-prespa/>, (28.07.2020).

²⁹⁴ Po aty.

²⁹⁵ Po aty.

ndaj mbështetjes së kësaj marrëveshjeje. Partia maqedonase “E majta” që paraqet një parti ekstreme djathtiste, në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020, siguroi 2 ulëse në Kuvendin e RMV-së. Kjo parti së bashku me VMRO-në, njihen për qëndrimet e tyre të ashpëra kundër Marrëveshjes së Prespës me çka partitë maqedonase që janë pro dhe kundra marrëveshjes u barazuan me deputetë në Kuvendin e RMV-së.²⁹⁶

Analistët politikë mbi mundësinë eventuale të dështimit apo anulimit të marrëveshjes e shohin si problematike apo si krizë substanciale nëse do të paraqitej rasti kur do të kemi qeveri edhe në Shkup si dhe Athinë të cilët nuk duan implementin të Marrëveshjes së Prespës. Kështu, analisti Petar Arsovski, vlerëson se përderisa shkyçet çështja e emrit, marrëdhëniet mes RMV-së dhe Greqisë, tradicionalisht kanë qenë të shkëlqyeshme. Ai shton se Greqia është njëra ndër investitorët më të mëdhenj në RMV, kurse marrëdhëniet diplomatike mes dy vendeve janë të qëndrueshme dhe asnjëherë nuk ka pasur ndonjë çështje tjetër të hapur. Për atë, ky analistë mendon se në nivel teknik marrëdhëniet do të vazhdojnë të jenë të mira, për shkak se, Greqia, mes tjerash, është njëra ndër promotorët më të mëdhenj të anëtarësimit të shpejt të të gjithë Ballkanit në BE. Sipas tij, edhe pse NEA Demokracia ka një narrativ nacionalo-romantik në politikën e brendshme, kjo në raport me Marrëveshjen e Prespës nuk do të ndikojë për shkak se nuk mund të anulohet ose të ndryshohet kjo marrëveshje me asgjë tjetër për shkak se është marrëveshje shtetërore dhe Micotakis në këtë drejtim nuk ka shumë hapësirë për manovra, por interpretimi mund të bëhet aty ku ka hapësira, si historia, marka tregtare etj.²⁹⁷

Qeveria e deritanishme majtiste në Shkup ka qenë e hapur në vazhdimin e bashkëpunimit dhe në marrëdhënie të shkëlqyeshme edhe me Micotakis, për shkak se dëshiron zbatimin e Marrëveshjes së Prespës. Kryetari i Këshillit Antlantik të Maqedonisë dhe analisti politik, Ismet Ramadani, vlerëson se që të jenë më të përmbajtura marrëdhëniet e Qeverisë së re në Greqi dhe Qeverisë në RMV, pritet involvim më i madh i BE-së dhe SHBA-së, duke marrë parasysh qëndrimet e Micotakisit ndaj Marrëveshjes së Prespës. Por, përsëri ai vlerëson se beteja e vërtetë mes RMV-së dhe Greqisë do të jetë ajo politike dhe diplomatike se sa ata do ta afirmojnë Maqedoninë e tyre dhe sa ne Maqedoninë tonë dhe sipas tij, këtu do të jetë konkurrenca diplomatike. Ai shpreson se marrëveshja do të zbatohet sepse ajo nuk mund të

²⁹⁶ Për më tepër shih: Предвремени избори во Северна Македонија, Konrad Adenauer Stiftung, јули 2020.

²⁹⁷ Аналитичарите за АА: Преспанскиот договор не може да се укине, но важно е како ќе се спроведува, АА, 12.07.2019.

anulohet dhe çdo përpjekje për prishjen e marrëveshjes, do të involvohet bashkësia ndërkombëtare si OKB-ja, BE-ja dhe SHBA. Por, edhe në rast të ndërrimit të Qeverisë në RMV, as atëherë nuk do të ekzistonte interes për prishjen e Marrëveshjes së Prespës, sepse sipas Ramadanit, strukturat e NATO-s, SHBA-së dhe BE-së nuk do të lejojnë përsëri nga zeroja të fillojnë negociatat për emrin, që në esencë në praktikë, ajo d.t.th. dalje nga NATO, për shkak se kushti për anëtarësim në Aleancë ishte ndryshimi i emrit.²⁹⁸

Gordana Siljanovska-Davkova, e cila ishte edhe bartëse e listës së deputetëve në njësinë e parë zgjedhore e VMRO-DPMNE-së, tani deputete në Kuvendin e RMV-së, në një debat theksoi se Marrëveshja e Prespës nuk mund të mbijetojë. Siç theksoi ajo, si Kushtetuta, përkatësisht emri kushtetues ka qenë i ndryshuar, ashtu mundet përsëri të ndryshohet. “Çdo gjeneratë ka të drejtë në kushtetutë të tyre.”-thotë Siljanovska, duke shtuar se në Marrëveshjen e Prespës nuk ekziston popull maqedonas dhe se me marrëveshje ndërkombëtare nuk mund të ndryshohet emri dhe identiteti.²⁹⁹

Mbi mundësinë eventuale të dështimit të Marrëveshjes së Prespës, se sa e vështirë është ajo të prishte apo të anulohet, më së miri e dëshmon një fjalim i ish kryeministrit dhe politikanit grek, Andonis Samaras i cili në Kongresin e partisë qeveritare NEA Demokracia, tregon se Qeveria e Greqisë nuk është e kënaqur me zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Prespës. “Çështje politike është sesi do të lirohemi nga Marrëveshja e Prespës, pa e paguar çmimin. Dhe kjo nuk është e lehtë, për shkak se nuk mund të ndodh brenda natës, për shkak se bëhet fjalë për marrëveshje që nuk shkon përpara, as brenda, as jashtë, as në Ballkan, as në Evropë. E kuptoj atë që thotë kryeministri se nuk mundemi të lirohemi nga kjo marrëveshje brenda natës, sepse ashtu duam. Por, edhe nuk mund ta zbukurojmë një marrëveshje që ne vetë e kemi vlerësuar si negative, si të dëmshme dhe të papranueshme dhe që nuk shkon përpara. Për tani, ne duhet ta mbrojmë Greqinë nga pasojat e kësaj marrëveshjeje, t’i shfrytëzojmë të gjitha problemet që na i krijon dhe të gjitha dobësitë, e para së gjithash, ta përforcojmë Greqinë dhe pozitën e saj negociuese, që më pas të mundemi të arrijmë që vendi të arsyetohet, arsyetim të tërësishëm të Maqedonisë dhe karakterit të saj grek,

²⁹⁸ Аналитичарите за АА: Преспанскиот договор не може да се укине, но важно е како ќе се спроведува, АА, 12.07.2019.

²⁹⁹ Për më tepër shih: Силјановска: Преспанскиот договор не може да опстои, секоја генерација има право на свој Устав, Фокус, 12.07.2020, линку në dispozicion: <https://fokus.mk/siljanovska-prespanskiot-dogovor-ne-mozhe-da-opstoi-sekoja-generatsija-ima-pravo-na-svoj-ustav/>, (28.07.2020).

prej së cilës nuk dorëhiqemi dhe nuk kemi të drejtë të dorëhiqemi.” Edhe Mickovski, në këtë drejtim, Marrëveshjen e Prespës e sheh nën këtë prizëm se si u ndryshua Qeveria në Greqi dhe erdhi kolegu i ri i Mickovskit nga e djathta evropiane, Kirijakos Micotakis, kritikuesi i zjarrët i marrëveshjes, i cili është deklaruar për revidim të marrëveshjes, por që sipas tij nënshkrimi i saj i njëanshëm nuk është i mundur, ashtu edhe kryetari i VMRO-së, e përkrah këtë ide, i cili mendon se do të fiton pozita më të mira në këtë marrëveshje.³⁰⁰

Kuptohet, se kontesti ishte simptomë dhe një traumë e patejkaluar e Luftës Qytetare në Greqi. Vetëm popujt, të cilët kanë jetuar gjatë në frikë nga fqinjët, grinden për gjëra, të cilët në botën normale zgjidhen me kompromis politik. Për disa ky kompromis ende është shumë i dhimbshëm dhe ajo është ashtu fundja me të gjitha kompromiset. Më e rëndësishmja është që Maqedonia për herë të parë në histori është prezente gjithkund, ku bisedohet dhe vendoset për shtetin e tyre. Madje, në qoftëse edhe Marrëveshjet me fqinjët me Bullgarinë dhe Greqinë ende vazhdojnë vështirë, për shkak se “fantazmat e historisë së të kaluarës” së Ballkanit janë ende të fuqishme, përsëri, rruga e re e historisë evropiane të Maqedonisë është e hapur pikërisht për shkak të Marrëveshjes së Prespës,³⁰¹ dhe e njëjta nuk mund të dështojë, për shkak të procedurave të ndërlikuara që duhet t’i ndërmerr një parti politike në parlament, sigurimi i dy të tretave të votave, gjë që, siç e kemi parë është vështirë e arritshme për një parti politike, pa përkrahjen edhe të partive të tjera politike, përfshirë këtu edhe ato shqiptare, të cilët edhe më tutje dy marrëveshjet me fqinjët i konsiderojnë si linja të kuqe për secilën prej partive maqedonase që do të angazhohet për kundërshtimin e tyre. Ashtu edhe siç thotë, profesori Jeton Shasivari, Marrëveshja e Prespës nuk mund të shfuqizohet nga asnjë marrëveshje ose traktat tjetër dhe as të revokohet, si dhe dispozitat e saj janë juridikisht të detyrueshme për të dyja palët dhe do të jenë në fuqi pafundësisht.³⁰² Pra, çështja tanimë është e mbaruar, Marrëveshja e Prespës është burim i së drejtës kushtetuese të RMV-së dhe siç kemi thënë ajo përbënë marrëveshje mbikushtetuese, ku e drejta ndërkombëtare dominon ndaj asaj kombëtare dhe në këtë drejtim, kjo marrëveshje ka ngelur vetëm të zbatohet nga palët

³⁰⁰ Мицкоски бара двотретинско мнозинство за измени во Преспанскиот договор, Мицотакис ревидирање, МКД, 06 декември 2019, linku në dispozicion: <https://www.mkd.mk/makedonija/politika/mickoski-bara-dvotretinsko-mnozinstvo-za-izmeni-vo-prespanskiot-dogovor>, (28.07.2020).

³⁰¹ Колбе, Кица, За Преспанскиот договор, за името Македонија – една година подоцна, DW, 17.06.2019.

³⁰² Për më tepër shih: Shasivari, Prof., Dr., Jeton, E drejta kushtetuese, Libri I, (Botimi i dytë), Furkan ISM, Shkup, 2020, fq. 57.

nënshkruese, duke pasur parasysh gjithmonë maksimën latine “Pacta sunt servanta” (Marrëveshjet duhet të respektohen).

4.2. Analiza juridike kushtetuese e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të RMV-së të 19.09.2018 mbi kushtetushmërinë dhe ligjshmërinë e vendimit të Kuvendit të RMV-së për shpalljen e referendumit për ndryshimin e emrit kushtetues

Gjykata Kushtetuese e RMV-së, mbi bazën e nenit 110 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe nenit 71 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.70/1992) në seancën e mbajtur më 19 Shtator 2018, solli vendim se nuk do të iniciojë procedurë për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së vendimit të shpallur për referendum nr.08-4666/1, nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më 30 Korrik 2018 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.140/2018).³⁰³

Këtë iniciativë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së vendimit të shpallur për referendum nga ana e Kuvendit të RM-së më 30 Korrik 2018, e ka dorëzuar Kongresi Botëror Maqedonas i përfaqësuar nga kryetari Todor Petrov nga Shkupi, partia politike “E majta” e përfaqësuar nga Dimitar Apasiev nga Shkupi dhe Marjanço Angelovski nga Kumanova.³⁰⁴

Iniciativa e dorëzuar nga Kongresi Botëror Maqedonas fillon me kërkesën që Gjykata Kushtetuese në përputhje me rregulloren e saj, sipas parimit të prioritetit dhe urgjencës sipas nenit 50 paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, të sjell vendim për ndalesë të zbatimit të akteve individuale ose pasoja që ndërmerren mbi baza të vendimit të kontestuar për shkak se ekziston rrezik me pasoja të dëshimshme nga mbajtja e referendumit në buxhet, në fondet publike të RM-së si dhe tatimpaguesve. Sipas tij, vendimi për shpallje të referendumit nuk ka qenë në përputhje me nenin 8 paragrafi 1 alineja 3, neni 51, neni 52, neni 75, neni 118, neni 119 dhe neni 120 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë si dhe me nenin 15 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit për referendum dhe forma të tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve. Ai pretendon se vendimi për shpallje të referendumit nuk është në përputhje me Kushtetutën e RM-së për shkak se është sjellur mbi zbatim të gabuar të së drejtës materiale, përkatësisht, dispozitës kushtetuese, duke pasur parasysh pyetjen e referendumit e cila tinëgllon: “A jeni për

³⁰³ Решение У.бр.88/2018, У.бр.90/2018 и У.бр.91/2018, Уставен Суд на Република Северна Македонија, 19 септември 2018, линку në dispozicion: <http://ustavensud.mk/?p=16832>, (05.08.2020).

³⁰⁴ По ату.

anëtarësim në BE dhe NATO me pranim të Marrëveshjes mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë?”. Kongresi Botëror Maqedonas, pretendon se anëtarësimi i shtetit në bashkësi shtetesh është i rregulluar me nenin 120 të Kushtetutës. Për anëtarësim në BE dhe NATO si bashkësi të shteteve, nuk vlen referendumi sipas neni 73 paragrafi 1 i Kushtetutës, por neni 120 paragrafi 2 i Kushtetutës. Vendimi për shpallje të referendumit është sjellur me 68 deputetë në kundërshtim me shumicën e nevojshme të më së paku 80 deputetë siç është paraparë në nenin 120 të Kushtetutës së RM-së. Më tutje, sipas dorëzuesit të iniciativës, vendimi i kontestuar ka qenë në kundërshtim me nenin 15 të Ligjit për referendum dhe formave të tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve, me ç’rast nxjerrë përfundim se pyetja e referendumit i theksuar në vendimin e kontestuar në një pyetje janë të vendosura tri pyetje, në vend se për çdo pyetje të votohet në fletvotime të veçanta që rrjedhë nga neni 15 paragrafi 3 i Ligjit në fjalë. Dorëzuesi i iniciativës jep përmbajtje të tre pyetjeve të cilët sipas tij duhet të jeni në tri fletëvotime të veçanta, edhe atë:

“A jeni për anëtarësim të shtetit të Maqedonisë në bashkësi me Bashkimin Evropian?”

“A jeni për anëtarësim të shtetit të Maqedonisë në bashkësi me Aleancën e NATO-s?”

“A jeni për marrëveshjen mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë?”

Sipas dorëzuesit, pyetja e referendumit nuk ka qenë në përputhje me nenin 14 paragrafi 4 i Ligjit për referendum, për shkak se votuesit i sjell në huti dhe ajo nuk është precize. Disa votues janë për anëtarësim të shtetit në BE, disa vetëm në NATO, kurse disa të tjerë për antarësim në BE dhe NATO por kundër Marrëveshjes mes Maqedonisë dhe Greqisë për shkak se me atë ndryshohet emri i shtetit dhe identiteti i kombit, me çka prejudikohet ndryshimi i emrit të shtetit në Kushtetutë. Nga këtu, sipas dorëzuesit për çdo pyetje duhet të ketë fletvotim të veçantë dhe në asnjë rast nuk mundet që integrimet evro-atlantike të kushtëzohen me ndryshim të emrit të shtetit dhe identitetit të kombit. Kuvendi nuk mund të shpall referendum për pyetje të cilët nuk janë në kompetencë të tij, të ndryshojë identitetet e kombit, të ndryshojë gjuhën e popullit, historinë dhe emrin e shtetit. Më tutje, dorëzuesi i iniciativës, për rikujtim thekson se maqedonasit sipas shtetësisë, me shumicë absolute në referendumin e mbajtur më 8 Shtator 1991, kanë votuar “PËR SHTET SOVRAN DHE TË PAVARUR MAQEDONAS”, pa parashtesa dhe mbiemra. Në përputhje me nenin 73 paragrafi 4 i Kushtetutës “Vendimi i sjellur në referendum

është i obligueshëm” për të gjithë pa dallim. Ai gjithashtu pretendon se marrëveshja nuk është e lidhur në përputhje me Kushtetutën dhe nuk ka qenë e ratifikuar në përputhje me Kushtetutën. Në tekstin e mëtutjeshëm të iniciativës, dorëzuesi i referohet marrëveshjes dhe thekson se me atë kryhet gjenocid mbi popullin maqedonas dhe paraqet krim kundër njerëzimit, me marrëveshjen suspendohet e drejta për vetëvendosje dhe për vetëidentifikim të popullit maqedonas i garantuar me të drejtën ndërkombëtare, përkatësisht me nenin 1 të Paktit ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore si dhe me Paktin ndërkombëtar për të drejtat qytetare dhe politike. Bëhet fjalë për të drejta të mbrojtura me norma jus cogens të cilët i përkasin jo vetëm popujve dhe jo vetëm të drejtave të tyre kolektive, por janë të drejta shtetërore, përkatësisht e drejtë ndërkombëtare të shtetit.³⁰⁵

Në iniciativën e partisë politike “E majta” theksohet se qëllimi i kësaj iniciative qytetare është vlerësimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së vendimit për shpallje të refrendumit nr.08-4666/1 të 30 Korrik 2018 në përgjithësi dhe në veçanti neni 1 dhe kërkon anulim të plotë për shkak të ekzistimit të defekteve të pariparueshme formale-juridike dhe materiale juridike dhe e njëjta nuk guxon të prodhojë pasoja juridike. Në bashkangjitje të iniciativës theksohen tri kërkesa të veçanta:

1. Kërkesë për shqiptim të masës së përkohshme (nga neni 27 i rregullores) për shkak se me zbatimin efektiv në praktikë të vendimit të kontestuar mund të shkaktohen pasoja të dëmshme dhe të pariparueshme në kontinuitetin juridik të shtetit, identitetit të popullit dhe sovranitetit të qytetarëve. Argumenti shtesë për nevojën e tillë dhe poteza e arsyetuar është aspekti financiar i situatës për shkak se është paraparë mbi 3,5 milion euro mjete financiare nga buxheti republikan për zbatimin e formave të tillë jolegjitime të shprehjes së qytetarëve që është ulur në një nivel të një “ankete shtetërore” pa karakter deçiziv që është në kundërshtim me teorinë tonë të sovranitetit qytetar.

2. Kërkesë për mbajtjen e debatit publik (nga neni 33 i rregullores), për shkak të seriozitetit dhe domethënies më të gjerë shoqërore-politike dhe juridike-kushtetuese të implikimeve të vendimit të kontestuar. Gjykata Kushtetuese duhet përsikaj të seancës përgatitore të caktojë edhe debat publik në të cilën edhe përsikaj pjesëmarrësve në procedurë

³⁰⁵ Për më tepër shih: Решение У.бр.88/2018, У.бр.90/2018 и У.бр.91/2018, Уставен Суд на Република Северна Македонија, 19 септември 2018, linku në dispozicion: <http://ustavensud.mk/?p=16832>, (05.08.2020).

duhet të jenë të thirrur edhe ekspertë shtëpiak dhe ata të jashtëm dhe profesorët nga e drejta kushtetuese, e drejta ndërkombëtare dhe historisë së të drejtës që të mund të fitohet një pasqyrë më e qartë në situatën faktike dhe juridike. Për shkak të kontekstit historik, e dëshirueshme është për debatin e tillë të evidentohen qëndrimet e thëna dhe mendimet juridike, përkatësisht, të sigurohen edhe stenograme dhe magnetofona, të a.q. inçizime vizuale-tonike.

3. Kërkesë për bashkim të procedurës (nga neni 21 i rregullores), për shkak se në publik ekzistojnë informacione se edhe personat e tjerë fizik dhe juridik kanë iniciuar procedurë për punët e njëjta juridike dhe për të gjithë ata së bashku të udhëhiqet vetëm një procedurë e vetme dhe të sillet një vendim in meritum. Sipas dorëzuesit të iniciativës, vendimi i kontestuar ka qenë drejtpërdrejtë në kundërshtim me nenin 1, nenin 2, nenin 8 paragrafi 1 alineja 3, 4, 5 dhe 11, neni 50 paragrafi 3, neni 51, neni 54 paragrafi 1, neni 73, neni 118, neni 119 dhe neni 120 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë si dhe me nenin 2, neni 9, neni 15 paragrafi 3 dhe 4, neni 24, neni 27 dhe neni 29 i Ligjit për referendum dhe formave tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.81.2005). Në tekstin e mëtutjeshëm të iniciativës, dorëzuesi thekson:

A) Mangësitë formale-juridike të vendimit të kontestuar:

1. Vendimi nuk i përmban të gjitha elementet e parashikuara ligjore;
2. E paqartë është edhe pamja e referendumit që i shpallur;
3. Pyetja e referendumit është i dykuptimtë dhe kapcioze;

B) Mangësitë materiale-juridike të vendimit të kontestuar:

1. Nuk ekziston referendum konsultativ për bashkësi;
2. “Marrëveshja” për të cilën votohet nuk është i ratifikuar në përputhje me

Kushtetutën;³⁰⁶

Dorëzuesi i iniciativës, Marjanço Angelovski me dorëzim me shkrim kërkon rishqyrtim të kushtetushmërisë së vendimit në fjalë për shkaqet në vijim:

1. Baza e sjelljes së vendimit;

³⁰⁶ Për më tepër shih: Решение У.бр.88/2018, У.бр.90/2018 и У.бр.91/2018, Уставен Суд на Република Северна Македонија, 19 септември 2018, linku në dispozicion: <http://ustavensud.mk/?p=16832>, (05.08.2020).

2. Pyetja e vetë referendumit e theksuar në nenin 1 paragrafi 3 i vendimit është me gabime teknike;

3. Pyetja e vetë referendumit është i paqartë, e shumëkuptimtë dhe i vendos qytetarët në huti, përkatësisht, e njëjta nuk është precize dhe e qartë;³⁰⁷

Gjykata në seancën e mbajtur theksoi se mbi bazën e nenit 73 paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, Kuvendi i RM-së në seancën e mbajtur më 30 Korrik 2018, ka sjellur vendim për shpallje të referendumit. Sipas nenit 1 të vendimit, shpallet referendum për konsultim të qytetarëve për gjithë territorin e RM-së. Në referendum qytetarët do të deklarohen në pyetjen: “A jeni për anëtarësim në BE dhe NATO me pranim të Marrëveshjes mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë?” Në nenin 2 të vendimit është paraparë se referendumi do të mbahet më 30 Shtator 2018. Në nenin 3 të vendimit është paraparë se referendumi do të zbatohet në mënyrën dhe procedurën e theksuar në ligjin për referendum dhe forma të tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve. Në nenin 4 të vendimit është paraparë se referendumin do ta zbatojë Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Në nenin 5 të vendimit është paraparë se ky vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit të tij në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.³⁰⁸

Në nenin 73 paragrafi 1 i Kushtetutës është paraparë se Kuvendi vendos për shpalljen e referendumit për çështje të caktuara nga kompetenca e vet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Sipas paragrafit 3 të këtij neni, Kuvendi është i detyruar të shpall referendum kur propozim do të dorëzojnë më së paku 150.000 zgjedhës. Vendimi i sjellur në referendum në përputhje me paragrafin 4 të të njëjtit nen nga Kushtetuta është i detyrueshëm. Neni 74 paragrafi 2 i Kushtetutës parasheh se vendimi për ndryshim të kufijve të RM-së është miratuar nëse në referendum kanë votuar shumica nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve. Sipas nenit 118 të Kushtetutës, përcaktohet se marrëveshjet ndërkombëtare në emër të RM i lidh Kryetari i Republikës së Maqedonisë, kurse sipas paragrafit 2 të këtij neni të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare mund t’i lidh edhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë kur ajo është përcaktuar me ligj. Neni 120 i Kushtetutës parasheh se propozim për asocim në bashkim

³⁰⁷ Решение У.бр.88/2018, У.бр.90/2018 и У.бр.91/2018, Уставен Суд на Република Северна Македонија, 19 септември 2018, линку në dispozicion: <http://ustavensud.mk/?p=16832>, (05.08.2020).

³⁰⁸ По аty.

ose në bashkësi me shtetet e tjera ose për dalje nga bashkimi ose nga bashkësia me shtetet e tjera mund të paraqesë Kryetari i Republikës, Qeveria ose së paku 40 deputetë. Vendimin për asocim ose për dalje nga bashkimi ose nga bashkësia me shtetet e tjera e merr Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Vendim për asocim ose për dalje nga bashkimi ose nga bashkësia me shtetet tjera është miratuar, nëse në referendum për të ka votuar shumica nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve. Sipas nenit 121 të Kushtetutës, vendim për asocim në anëtarësi ose për dalje nga anëtarësia në organizatat ndërkombëtare merr Kuvendi me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve ose në bazë të propozimit të Kryetarit të Republikës, Qeverisë ose së paku 40 deputetëve. Nga dispozitat kushtetuese në fjalë, rrjedhë se, Kushtetuta që nga vitit 1991, në disa dispozita të saj i ka vendosur themelet e konceptit të saj si formë e shprehjes së drejtpërdrejtë, përkatësisht të realizimit të pushtetit të qytetarëve, të cilët me Kushtetutën janë përcaktuar kompetenca e Kuvendit të RM-së, bjen edhe shpallja e referendumit. Ajo që është karakteristike për rregullimin e referendumit me Kushtetutën e vitit 1991 është që ajo vetëm parimisht e thekson dhe i rregullon disa çështje të cilët janë të lidhura me referendumin edhe atë është theksuar organi i cili është kompetent për shpallje të referendumit, për cilët çështje dhe sipas propozimit të kujt shpallet dhe të ngjashme. Sipas përmbajtjes së nenit 71 paragrafi 1 dhe neni 68 paragrafi 1 alineja 10 e Kushtetutës, rrjedhë se për shpallje të referendumit vendos Kuvendi i RM-së edhe atë për çështje të caktuara nga kompetenca e vet me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Sipas tij, intenca e kushtetutvënësit me nenin 73 paragrafi 1 nga Kushtetuta ka qenë që Kuvendi mund të vendos për shpallje të referendumit për çështje të caktuara nga kompetenca e vet sipas rregullit të iniciativës së vet, përkatësisht pas kërkesës së vetë deputetëve dhe përderisa për atë vendosin votat e shumicës së numrit të përgjithshëm të deputetëve. Përrjashtimisht nga rregulla në fjalë është neni 73 paragrafi 3 i Kushtetutës sipas së cilës Kuvendi është i obliguar të shpall referendum kur propozim për shpallje do të dorëzojnë më së paku 150.000 zgjedhës. Sipas tij, paragrafi 3 i nenit 73 i Kushtetutës duhet të interpretohet në kuptimin se shpallja e referendumit nga ky paragraf i nenit 73 është i detyrueshëm jo sipas lëndës përkatësisht çështjes së për cilin duhet të shpallet referendum, por sipas cilësisë së propozuesve (150.000 zgjedhësve). D.m.th., në këtë rast, Kushtetuta nuk le

mundësi që Kuvendi të vendos ose të vlerësojë se a duhet ose jo të shpall referendum, por thjeshtë është i detyruar të shpall referendum për propozim-çështjen për të cilën janë mbledhur 150.000 nënshkrime. Sa i përket asaj se, për cilët çështje mund të jenë lëndë e vendosjes së referendumit, Kushtetuta nuk përmban dispozita decide, siç është shembulli me kushtetutat e disa vendeve evropiane (Austria, Danimarka, Franca, Kroacia, Spanja, Italia, Zvicra, etj.) në të cilët është paraparë shprehimisht se kur duhet shpallur referendum kushtetues dhe referendum ligjvënës, përkatësisht referendum për çështje kushtetuese si dhe për çështje ligjore. Kushtetuta thekson tri situata për referendum të detyrueshëm: nëse propozim për shpallje dorëzojnë më së paku 150.000 zgjedhës (neni 73 paragrafi 3), kur duhet të silllet vendim për ndryshim të kufijve të RM (neni 74) dhe kur duhet të silllet vendim për hyrje dhe dalje në bashkim ose bashkësi me shtetet tjera (neni 120). Përveç të përmendurit, Kushtetuta nuk përmban dispozita decide për cilët çështje kushtetuese ose ligjore duhet të shpallet referendum, nuk përmban shpallje të palejuara ose të kufizuara të referendumit për çfarëdo çështje nga kompetenca e Kuvendit, e aq më pak përmban dispozita të llojeve të referendumeve sipas kohës së shpalljes së tyre (paraprak ose të mëpasshëm) dhe të ngjashme. Nga këtu, të gjitha këto, si dhe çështje të tjera me domethënie për referendumin dhe forma të tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve janë të rregulluara me Ligjin për referendum dhe forma të tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve.³⁰⁹

Në nenin 9 të Ligjit është paraparë që: referendumi shpallet me vendim i cili përmban: organi që e shpall referendumin, territori ose rajoni për të cilin shpallet referendumi, emri i shkresës (rregullores), përkatësisht çështja ose pyetja për të cilën qytetarët vendosin në referendum, arsyetimi i vendimit, përkatësisht çështjes ose pyetjes për të cilën është shpallur referendumi, çështja e referendumit ose pyetja, përkatësisht një ose më shumë propozime për rregullat për të cilën qytetarët vendosin, dita e mbajtjes së referendumit dhe lloji i referendumit. Në përputhje me nenin 24 të ligjit të njëjtë, referendumi në nivel shtetëror mund të shpallet edhe për nevoja për ratifikim të marrëveshjeve ndërkombëtare ose për çështje tjera nga kompetenca e Kuvendit (referendum paraprak) dhe për vendime të sjellura nga Kuvendi ose për deklarim të qytetarëve për çështje tjera për të cilën ka vendosur Kuvendi (referendum i

³⁰⁹ Për më tepër shih: Решение У.бр.88/2018, У.бр.90/2018 и У.бр.91/2018, Уставен Суд на Република Северна Македонија, 19 септември 2018, linku në dispozicion: <http://ustavensud.mk/?p=16832>, (05.08.2020).

mëpasshëm). Në përputhje me nenin 27 të Ligjit, për konsultim paraprak të qytetarëve për çështje nga domethënia më e gjerë për Republikën e Maqedonisë mund të shpallet në nivel shtetëror për konsultim të qytetarëve (referendum konsultativ).³¹⁰

Nga analiza e dispozitave ligjore në fjalë në të cilët thirren dorëzuesit e iniciativës për kontestim të vendimit për shpallje të referendumit, rrjedh se duke nisur nga kompetenca kushtetuese, ligjvënësi ka theksuar shpallje të referendumit për konsultim të qytetarëve për çështje që janë nga kompetenca e saj, për të cilët për ligjvënësin janë me domethënie të veçantë, pa marrë parasysh faktin që vendimi i sjellur në referendum nuk është i detyrueshëm. Gjithashtu, ligjvënësi në nenet e përmendura i ka theksuar elementet të cilët duhet t'i përmbajë vendimi për shpallje të referendumit, përkatësisht, organi i cili e shpall referendumin, territori për të cilin shpallet, pyetja për të cilën qytetarët duhet të deklarohen si dhe dita e mbajtjes. Duke filluar nga analiza e dispozitave kushtetuese dhe ligjore dhe nga përmbajtja e vendimit për shpallje të referendumit kundrejt pohimeve të shprehura në iniciativë, Gjykata vlerësoi se të njëjtat janë të pabazuara.³¹¹

Në raport të pretendimeve nga iniciativa se vendimi i kontestuar nga aspekti juridik formal nuk i përmban të gjitha elementet e nevojshme duhet të kemi parasysh se: i qartë është vendimi se i njëjti është sjellur nga Kuvendi i RM si organ kompetent në përputhje me nenin 73 paragrafi 1 i Kushtetutës. Referendumi është i shpallur për konsultim të qytetarëve në gjithë territorin e shtetit, me çka është përcaktuar lloji i referendumit dhe territori për të cilin është shpallur referendumi. Është i definuar edhe pyetja e vetme e referendumit në të cilën përgjigjen me PËR dhe KUNDËR. Është i theksuar dita e mbajtjes së referendumit. Është i përcaktuar se referendumin do ta zbatojë KSHZ-ja si organ kompetent shtetëror, në mënyrën dhe procedurën e theksuar me Ligjin për referendum...dhe i theksuar është se vendimi hyn në fuqi pas shpalljes në Gazetën Zyrtare të RM. Emri i dhënë shkurtimisht i Marrëveshjes, në vend të emrit të plotë të marrëveshjes përfundimtare në fjalë dhe përmbajtja e saj, përkatësisht arsyeimi, siç është theksuar në iniciativë, nuk e bën pyetjen e referendumit të paqartë dhe vendimin të kontestuar në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin, nga shkak se në rastin konkret bëhet fjalë për fakte

³¹⁰ Решение У.бр.88/2018, У.бр.90/2018 и У.бр.91/2018, Уставен Суд на Република Северна Македонија, 19 септември 2018, линку në dispozicion: <http://ustavensud.mk/?p=16832>, (05.08.2020).

³¹¹ По аты.

të përgjithshme të njohura në lidhje me kontestin e më shumë dekadave mes RM dhe Greqisë, dhe nga ku në asnjë mënyrë nuk ekziston dilemë se cilës përgjigje i referohet pyetja e referendumit. Nga këtu, rrjedhë se vendimi për shpallje të referendumit është i qartë, jo i dykuptimët dhe ligjore dhe i përmban të gjitha elementet nga ku Gjykata konsideron se nuk janë të bazuara pohimet për shkelje të nenit 9 të Ligjit për referendum. Thirrja e dorëzuesve të iniciativave në praktika të caktuara dhe teori në këtë rast është i pazbatueshëm. Përndryshe, e qartë është se nga formulimi i pyetjes së referendumit, Gjykata vlerëson se bëhet fjalë për përmbajtje të një çështjeje me ndërlidhje mes vete, me qëllim të domosdoshëm, në kontekst të caktuar historiko-shoqëror për shkak se përmes pjesëve të saj ekziston lidhje të brendshme që e mundëson lirinë e plotë për shprehje të vullnetit të qytetarëve, ashtu siç e kërkon principi i vetëm i përmbajtjes së pyetjes. Nga neni 1 i vendimit të kontestuar rrjedhë se është shpallur referendum për konsultim të qytetarëve në territorin e RM nga ku qartë rrjedhë se bëhet fjalë për referendum për konsultim të qytetarëve në nivel shtetëror me çka janë të pabazuara pohimet se ka qenë i paqartë lloji i referendumit që shpallet. Fundja, vetëm në rastet kur sjelljet vendim për ndryshim të kufijve të RM, vendimi për asocim dhe dalje nga bashkimi ose bashkësia me shtetet tjera në përputhje me nenin 29 nga ligji dhe 120 nga Kushtetuta shpallet referendum i detyrueshëm.³¹²

Vullneti i qytetarëve për anëtarësim në BE është shprehur përmes aplikimit të dorëzuar të RM-së për antarësim në BE, i cili përsëri është i bazuar në Deklaratën për dorëzim të kërkesës për anëtarësim të RM në BE, i sjellur nga Kuvendi i RM në seancën e mbajtur më 13 Shkurt 2004 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.7/2004), i nënshkruar nga Kryetari i RM-së dhe Kryetari i Qeverisë së RM-së më 26 Shkurt 2004. Aplikimi ka qenë lëndë e vlerësimit përpara Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykata me vendim U. Nr.213/2005 nga 12.04.2006 e ka hedhur poshtë iniciativën për vlerësim të kushtetushmërisë për shkak se paraqet dokument i cili i shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet të cilët kanë për qëllim që të sigurohet mënyra optimale e përafrimit, anëtarësimit dhe integritit të vendit tonë në BE. Në procedurën e lëndës U. Nr.89/2017, Gjykata me vendim nga 07.02.2018 nuk ka zhvilluar procedurë për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimit për hyrje të RM në anëtarësim të Aleancës Veriatlantike-NATO,

³¹² Për më tepër shih: Решение У.бр.88/2018, У.бр.90/2018 и У.бр.91/2018, Уставен Суд на Република Северна Македонија, 19 септември 2018, линку në dispozicion: <http://ustavensud.mk/?p=16832>, (05.08.2020).

nr.88-4670/1 nga 23 Dhjetori 1993, i sjellur nga Kuvendi i RM-së ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.78/1993). Sipas Gjykatës, NATO paraqet organizatë ndërkombëtare dhe jo bashkim apo bashkësi shtetesh, siç dëshirohet të tregohet në iniciativë. Hyrja në bashkim ose bashkësi shtetesh është formë e veçantë e bashkësisë ndërshtetërore dhe organizim i cili parasheh implikacione mbi prerogativa të shteteve të cilët bëhen pjesë e asaj bashkësie ose bashkësisë, në veçanti në raport të sovranitetit të shteteve, forma e rregullimit shtetëror etj., që nuk është rast me hyrjen në anëtarësim të organizatave ndërkombëtare. Për atë arsye, Kushtetuta bën dallim të rëndësishëm në vetë procedurën për asocim në bashkim ose bashkësi shtetesh (neni 120) dhe procedura për hyrje në antarësim në organizatat ndërkombëtare, siç parashihet në vendimin e kontestuar (neni 121). Në raport të pohimeve të iniciativave me të cilët dorëzuesit propozojnë që Gjykata të sjell vendim për ndalim të zbatimit të akteve individuale ose pasojave të ndërmirren mbi bazën e vendimit të kontestuar, Gjykata vlerëson se duke pasur parasysh faktin se në raport me vendimin e kontestuar nuk shpreh dyshim për mospërputhshmërinë e tyre me Kushtetutën e RM dhe Ligjit për referendum..., nuk ekzistojnë kushte për sjellje të vendimit në përputhje me nenin 27 të rregullores së gjykatës, për ndalim të zbatimit të akteve individuale ose pasojave që ndërmirren mbi bazën e vendimit të kontestuar. Këtë vendim gjykata e ka sjellur me shumicë të votave në përbërje të kryetarit të gjykatës, Nikola Ivanovski dhe gjykatësit: Naser Ajdari, Elena Gosheva, Jovan Josifovski, d-r Osman Kadriu, d-r Darko Kostadinovski, Vangelina Markudova, Sali Murati dhe Vladimir Stojanoski.³¹³

Mendimet e ndara të gjykatësve mbi vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së vendimit të Kuvendit për shpalljen e referendumit për ndryshimin e emrit - Gjykatësja Elena Gosheva, ka votuar kundër vendimit të gjykatës, e cila me shumicë votash vendosi të mos iniciojë procedurë për vendimin e kontestuar për shpallje të referendumit. Pas elaborimit të vendimit të gjykatës për të cilën ka marrur vendim gjykata me shumicë votash, gjykatësja Elena Gosheva vlerëson se në kundërshtim të argumenteve në fjalë, konsideron se vendimi për shpalljen e referendumit është në kundërshtim me nenet: 1, 2, 8 paragrafi 1 alineja 1, 3, 5 dhe 11, neni 50 paragrafi 3, neni 51, neni 54 paragrafi 1, neni 73, neni 74 paragrafi 2, neni 118, neni 119 paragrafi 1, neni 120 dhe 121 i Kushtetutës së RM-së dhe në kundërshtim me nenin 2, 9,

³¹³ Për më tepër shih: Решение У.бр.88/2018, У.бр.90/2018 и У.бр.91/2018, Уставен Суд на Република Северна Македонија, 19 септември 2018, linku në dispozicion: <http://ustavensud.mk/?p=16832>, (05.08.2020).

neni 15 paragrafi 3 dhe 4, neni 21, 24, 27 dhe 29 i Ligjit për referendum dhe forma tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve. Vendimi i kontestuar i Kuvendit nuk i përmban të gjitha elementet e parapara në nenin 9 të Ligjit për referendum...Me këtë nen parashihet se referendumi shpallet me vendim i cili përmban organin që e shpall referendumin, territorin ose rajonin për të cilin shpallet referendumi, emri i shkresës (rregullorës), përkatësisht çështja ose pyetja për të cilën qytetarët vendosin për referendum, arsyetim i vendimit (rregullores), përkatësisht, çështjes ose pyetjes për çka shpallet referendumi, pyetja ose pyetjet e referendumit, përkatësisht një ose më tepër propozime për çështjen për të cilët qytetarët vendosin, dita e mbajtjes së referendumit dhe lloji i referendumit. Nga 7 elementet e cekura, vendimi i kontestuar nuk i përmban 4 elementet, edhe atë: elementin numër 3, 4, 5 dhe 7, përkatësisht, nuk e përmban emrin e rregullores, përkatësisht çështjes ose pyetjeve për të cilët qytetarët vendosin në referendum, mungon arsyetimi i çështjes, përkatësisht, pyetjes ose pyetjeve për çka shpallet referendumi, pyetja e referendumit ose pyetjet, përkatësisht, një ose më tepër propozime për rregullat për të cilët vendosin qytetarët dhe lloji i referendumit. Në vendimin për shpalljen e referendumit nuk është përmendur emri i plotë i marrëveshjes mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë, por qëndron vetëm “Marrëveshja mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë”. Gjithashtu, vendimi nuk përmban arsyetim të çështjes, përkatësisht pyetjes së referendumit i cili moralisht duhet të arsyetohet sesi do mundeshin qytetarët të njoftohen me efektin juridik të vendimit të sjellur, përkatësisht, në asnjërën pjesë të vendimit nuk është përmendur marrëveshja, që Republika e Maqedonisë do ta ndryshojë emrin në Republika e Maqedonisë së Veriut.³¹⁴

Në raport të pikës së tretë, përkatësisht të pyetjes së referendumit, sjellësi i vendimit i ka bashkuar tri pyetjet në një në të cilën është e pamundur që në vijim të përgjigjet vetëm me PËR dhe KUNDËR. Ligji për referendum, në nenin 15 paragrafi 3, parasheh që nëse votohet për më tepër pyetje, për çdo pyetje votohet në fletvotime të veçanta. Në rastin nuk është ashtu, për shkak se në vendim është paraparë që të ketë vetëm një fletvotim në ditën e referendumit.³¹⁵

Në raport të elementit-lloji i referendumit, në vendim është theksuar se shpallet

³¹⁴ Издвоени мислења по предметот У.бр.88/2018, У.бр.90/2018 и У.бр.91/2018, Уставен суд на Република Северна Македонија, 19 септември 2018, линку në dispozicion: <http://ustavensud.mk/?p=16835>, (06.08.2020).

³¹⁵ По ату.

referendum për konsultim të qytetarëve dhe i njëjti do të realizohet në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë. D.m.th., i paqartë është lloji i referendumit për të cilin shpallet. Në rastin, veçanërisht, është problematike ajo që në asnjë mënyrë nuk duhet se a shpallet referendum paraprak apo të mëpasshëm dhe nuk duket se referendumi a është obligativ apo i detyrueshëm. Në këtë rast, duhet të merret parasysh fakti se efekti juridik i sjelljes së këtillë i vendimit është krejtësisht i ndryshëm, kurse pasojat juridike të saj janë diametralisht të kundërta dhe ekstremisht kontradiktore. Një mosplotësim i tillë i vendimit fut doza të mëdha të konfuzitetit dhe pasiguri juridike gjatë interpretimit të rezultateve të referendumit. Këtu parashtrahet pyetja: çka nëse nuk arrihet cenzusi i nevojshëm, përkatësisht nuk ka dalje të mjaftueshme të votuesve? A nuk do të ekzistojë Marrëveshja e Prespës ose përsëri do të qëndrojë në fuqi dhe cilët vota shumicë do të jenë relevante që të ketë vendim juridik valid? Mos vallë 450.000 votues relativ, siç është rasti me referendumin fakultativ ose përsëri absolute prej rreth 900.000 votues, siç është rasti me referendumin obligativ nga neni 120 i Kushtetutës së RM-së? Me gjithë këtë shkelet parimi i sigurisë juridike të qytetarëve.³¹⁶

Vlerësoj se pyetja e referendumit është e dykuptimtë dhe kapcioze, për shkak se nuk respektohet neni 15 paragrafi 4 i Ligjit për referendum, përkatësisht se pyetja në fletvotim duhet të jetë e formuluar në mënyrë precize dhe jo e dykuptimtë, ashtu që qytetarët në referendum mund të përgjigjen me “PËR” dhe “KUNDËR”. Sjellësi i vendimit në vend të tri pyetjeve të bashkuara në një, është dashur të formulohen tri pyetje të ndara: 1. A jeni për anëtarësim në BE? 2. A jeni për anëtarësim për në NATO? dhe 3. A jeni për pranim të Marrëveshjes mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë? Dhe të realizojë tre referendume në një ditë, duke pasur parasysh se atë të drejtë e jep neni 10 paragrafi 2 i Ligjit për referendum. Sa i përket Marrëveshje së Prespës, i njëjti është absolutisht nul, punë juridike joekzistuese për shkak se është lidhur nga organi jokompetent, ende nuk ka ligj për ratifikimin e saj. Sjellësi në pyetjen e referendumit, marrëveshjen e ka përmendur vetëm si “Marrëveshja mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë”, pa e përmendur më pas numrin dhe datën e sjelljes. Nga analiza e bërë rrjedh se pyetja e vendosur është sugjestive, e paqartë, e pakuptueshme dhe konfuzë. Qytetarëve u imponohet se ata e njohin ekzistimin e Marrëveshjes

³¹⁶ Издвоени мислења по предметот У.бр.88/2018, У.бр.90/2018 и У.бр.91/2018, Уставен суд на Република Северна Македонија, 19 септември 2018, линку në dispozicion: <http://ustavensud.mk/?p=16835>, (06.08.2020).

së Prespës edhe pse ai de jure nuk ekziston. Pyetja e referendumit është i pasaktë, për shkak se nuk ekziston vendim për anëtarësim në BE. Pyetja në lidhje me pranimin në NATO është irrelevante për shkak se vendimi i tillë i Kuvendit ka qenë i sjellur në vitin 1993, përkatësisht, përpara 25 viteve dhe e njëjta nuk është në fuqi juridike. Pyetja për të cilën duhet të shprehen votuesit nuk e kënaq të a.q. “testin e trefishtë të unitetit”, të paraparë në Kodeksin e Venedikut për praktika të mira të referendumit. Sipas këtij testi, për rezultatin e pyetjes që të jetë juridikisht valid, ajo patjetër duhet të ketë: 1. Njeshmëri në formë; 2. Njeshmëri në përmbajtje; dhe 3. Njeshmëri në hierarki. Për këto shkaqe, rezultati i pyetjes nuk mund të jetë juridikisht valid. Pyetja e parashtruar në vendim është kapcioze dhe gjykatësja konsideron se bjen në grupin e a.q. “pyetje kurth”, për shkak se është e pamundur të përgjigjet thjeshtë nga shkak i siç është në rastin, janë të mundur madje tetë përgjigje të ndryshme.³¹⁷

Nga aspekti material juridik, nga analiza e bërë rrjedh se nuk ekziston referendum fakultativ për bashkësi. Ai nuk mund të jetë fakultativ por vetëm i detyrueshëm (referendum për vendosje). Nga e gjithë kjo, mund të përfundohet se Kuvendi nuk ka sjellur vendim formal për anëtarësim në BE, siç ka sjellur vendim për anëtarësim në NATO në viti 1993. Neni 120 i Kushtetutës parasheh se vetëm një vendim i tillë i cili është propozuar së paku prej njërit prej tre propozuesve të autorizuar, që është sjellur me shumicë të kualifikuar prej 2/3 të votave në parlament mund të jetë lëndë e verifikimit të referendumit. Nga neni 27 i Ligjit për referendum, mund të përfundojmë se referendumi konsultativ mund të jetë vetëm referendum paraprak, përkatësisht, për konsultim paraprak të qytetarëve për pyetje nga domethënia më e gjerë, që në rastin nuk është respektuar, për shkak se marrëveshja për të cilën duhet të votohet është e lidhur. Sipas nenit 119 paragrafi 1 dhe 2 i Kushtetutës, marrëveshje ndërkombëtare në emrin e Republikës së Maqedonisë lidh Kryetari i RM-së, kurse në raste të përcaktuara, mund të lidh edhe Qeveria e RM-së, por vetëm kur ajo është e përcaktuar me ligj. Kontestuese në këtë rast është se ministri i punëve të jashtme i RM-së, nuk ka mandat, përkatësisht, të drejtë autorizuese për lidhje të një lloji të tillë të marrëveshjes. Ai vetëm jep mendime jo të detyrueshme për

³¹⁷ Издвоени мислења по предметот У.бр.88/2018, У.бр.90/2018 и У.бр.91/2018, Уставен суд на Република Северна Македонија, 19 септември 2018, линку në dispozicion: <http://ustavensud.mk/?p=16835>, (06.08.2020).

propozimin.³¹⁸

Edhe gjykatësi, Jovan Josifovski, nuk pajtohet me qëndrimet e shumicës së gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese të RM-së, të cilët vendosën që të mos inicohet procedurë për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së vendimit për shpallje të referendumit të sjellur nga Kuvendi i RM-së, me ç'rast, rrjedhimisht edhe ky ka votuar kundër. Ai konsideron se Gjykata Kushtetuese, duhej të vlerësoj se pyetja e formuluar për referendum në vendimin e kontestuar në kuptim të vërtetë të fjalës u mundëson qytetarëve të RM ta realizojnë pushtetin në referendumin e caktuar për 30 Shtator 2018, në përputhje me nenin 2 të Kushtetutës, sipas së cilës në RM, sovraniteti rrjedhë prej qytetarëve dhe u takon qytetarëve. Qytetarët e RM, pushtetin e realizojnë përmes përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë demokratike në rrugë të referendumit dhe forma tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe neni 15 i Ligjit për referendum. Kundër qëndrimit të gjykatës, konsideron gjykatësi se vendimi në fjalë për shpallje të referendumit nuk është në përputhje me nenin 2, neni 8 paragrafi 1 alineja 3, nenet 51, 118, 119 dhe 120 i Kushtetutës së RM-së, si dhe nuk është në përputhje me Ligjin për referendum (nenet 2, 9, 15, 23, 29, 31, 32, 33, 34, 35, nenet 45 deri 61 dhe nenet 63 dhe 64).³¹⁹

Sipas tij, pyetja e referendumit është i dykuptimtë, jo preciz, mashtrues dhe konfuz. Kjo për shkak se, qytetari i cili është për anëtarësim të RM-së në BE ose NATO, kurse është kundër Marrëveshjes mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë, nuk do të mundej ta realizon të drejtën kushtetuese të nenit 2 të Kushtetutës së RM-së për shkak se pyetja e formuluar e cila përmban tri pyetje, e cila për nga karakteri i saj dhe përmbajtja janë plotësisht të ndryshme. Nga këtu, gjykatësi Josifovski, konsideron se neni 1 i vendimit të kontestuar nuk është në përputhje me qeverisjen e së drejtës si bazë e vlerave të rendit kushtetues së RM-së i cili nënkupton se ligji dhe rregullat tjera të përmbajnë norma juridike të qarta, precize dhe jo të dykuptimta. Edhe gjykatësi Josifovski, njëjtë si gjykatësja, Gosheva, janë të mendimit se qytetarët nuk mund të pergjigjen “PËR” dhe “KUNDËR” në pyetjen e referendumit dhe se në këtë rast nuk është zbatuar “testi i trefishtë i unitetit”. Gjithashtu, gjykatësi konsideron se neni 1 paragrafi 1 dhe 2 në pjesën: “A jeni për anëtarësim në BE” nuk është në përputhje me nenin 29

³¹⁸ Издвоени мислења по предметот У.бр.88/2018, У.бр.90/2018 и У.бр.91/2018, Уставен суд на Република Северна Македонија, 19 септември 2018, линку në dispozicion: <http://ustavensud.mk/?p=16835>, (06.08.2020).

³¹⁹ По ату.

paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit për referendum..., sipas së cilit vendimi për asocim në bashkim ose bashkësi shtetesh është i miratuar nëse në referendum për të kanë votuar shumica nga numri i përgjithshëm i qytetarëve të regjistruar në Listën Zgjedhore, si dhe vendimi i miratuar në referendum është i detyrueshëm. Ajo do të thotë se kjo pjesë e pyetjes së referendumi “A jeni për anëtarësim në BE” në asnjë rast nuk mund të ketë karakter konsultativ, por vendimi është i detyrueshëm për të gjithë edhe për Kuvendin e RM. Duke pasur parasysh faktin se pjesa përbërëse e pyetjes së referendumi është “Marrëveshjes mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë”, pyetja bazë që mund të parashtrohet është se a mundet të jetë lënde e pyetjes së referendumi marrëveshja e cila është e lidhur në kundërshtim me nenet 119 dhe 120 të Kushtetutës dhe neni 22 i Ligjit për lidhje, ratifikim dhe ekzekutim të marrëveshjeve ndërkombëtare. Në rastin konkret, ministri i punëve të jashtme nuk është i autorizuar, përkatësisht, nuk është kompetent të lidh një lloj të tillë të marrëveshjes.³²⁰

4.3. Kompetenca eventuale kushtetuese e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së për të vlerësuar kushtetutshmërinë e Marrëveshjes së Prespës – argumentet juridike për dhe kundër

Jo rrallë herë në opinion, sidomos në debate televizive, partia opozitare maqedonase VMRO-DPMNE, por edhe të tjerët si “E majta”, kanë dhënë akuza nga më të ndryshmet mbi Marrëveshjen e Prespës. Pretendimet e tyre, konsistojnë më tepër në anulimin e Marrëveshjes së Prespës, edhe pse së fundmi ata janë për ndryshimin e saj, për shkak se kjo marrëveshja e ndryshoi emrin kushtetues të shtetit, nga Republika e Maqedonisë në Republika e Maqedonisë së Veriut dhe kinse rrejdhimisht ajo ua ndryshoi edhe identitetin maqedonasve. Ata theksojnë se, në rast se vijnë në pushtet do të angazhohen për ndryshim të Marrëveshjes së Prespës, për shkak se marrëveshjen aktuale e vlerësojnë si të turpshme për popullin maqedonas si dhe për vetë shtetin dhe se me këtë marrëveshje, Maqedonia e Veriut në kompromisin e saj ka “kapitulluar” përballë palës greke. Qasja e tyre dhe në tërësi qëndrimi i tyre si para zgjedhjeve ashtu edhe pas zgjedhjeve, konsiston në angazhimin e tyre për rikthimin e emri të vjetër kushtetues, sepse sipas tyre ajo është e drejtë “natyrore”, secili shtet ka të drejtë ta zgjedh emrin për t’u identifikuar dhe se e njëjta gjë nuk mund të kontestohet dhe se kjo që është bërë me Maqedoninë e Veriut e sidomos me Marrëveshjen e Prespës është në kundërshtim me

³²⁰ Издвоени мислења по предметот У.бр.88/2018, У.бр.90/2018 и У.бр.91/2018, Уставен суд на Република Северна Македонија, 19 септември 2018, линку në dispozicion: <http://ustavensud.mk/?p=16835>, (06.08.2020).

rregullat dhe me normat e së drejtës ndërkombëtare. Andaj, i gjithë debati mbi Marrëveshjen e Prespës, zhvillohet mbi argumentet për dhe kundër saj, si dhe mbi kompetencën eventuale kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese të RMV-së për të vlerësuar kushtetutshmërinë e Marrëveshjes së Prespës.

Profesoresha maqedonase e së drejtës kushtetuese, Gordana Siljanovsk-Davkova, kthimin e emrit të vjetër kushtetues e sheh përmes Gjykatës Kushtetuese: “Kthimi i emrit tonë kushtetues është i mundur përmes Gjykatës Kushtetuese”.³²¹ Ajo gjithashtu, si bazë për kontestimin e kësaj marrëveshjeje i referohet referendumit të realizuar më 30 Shtator 2018, të cilin e vlerëson si të pasuksesshëm: “Referendumi ishte i pasuksesshëm dhe atë fakt askush nuk mund ta ndryshon. Për atë do të kërkoj respektim të së drejtës ndërkombëtare, për të cilët profesorët eminentë botëror thanë se është shkelur përmes Marrëveshjes së Prespës.”³²² Imagjinata e saj për një Maqedoni të Veriut pa Marrëveshjen e Prespës nuk ndalet vetëm këtu, ajo thotë se “do të vjen një kryetar i përgjegjshëm i popullit, për popullin dhe me popullin, do të vjen një Parlament i cili do ta respekton opozitën dhe në mënyrë shtetërore do të sillet me çështjet më të rëndësishme, do të vjen një përbërje e re e Gjykatës Kushtetuese e cila do ta mbrojë Kushtetutën me dije dhe me moral. Atëherë ne, një ditë, me një ndryshim kushtetues, të rëndësishëm, do ta mbrojmë emrin me klauzolë për mosndryshim.”³²³

Qasje krejt të ndryshme ndaj anulimit të Marrëveshjes së Prespës ka kryetari i shtetit, Stevo Pendarovski, i cili vlerëson se nuk mund të anulohet marrëveshja “vetëm me deklarata politike, për shkak se kjo është produkt i dy palëve të dakorduara, me garancë ndërkombëtare – Kombet e Bashkuara. Që do të thotë se, për çfarëdo ndryshim do të duhej të bindet Athina dhe pesë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit, që përsëri të hapen negociatat.”³²⁴ Por, profesoresha Siljanovska – Davkova si dhe partia e saj VMRO të cilët janë kundër marrëveshjes, sipas tyre kjo çështje mbetet juridikisht e hapur apo “çështjen do ta mbajnë të hapur, në çdo rast, kur të jetë e mundur.”³²⁵ Nga këto deklarime shihet qartë se edhe ajo e sheh të vështirë

³²¹ Гордана Сиљановска ќе бара поништување на Преспанскиот договор, НОВА ТВ, 29 јуни 2020, линку në dispozicion: <https://novatv.mk/gordana-siljanovska-ke-bara-ponishtuvane-na-prespanskiot-dogovor/>, (27.07.2020).

³²² По ату.

³²³ Клаузулата за името – реалност или изборна пропаганда, Радио Слободна Европа, 05 април 2019.

³²⁴ По ату.

³²⁵ Pendarovski vs Siljanovska: Beteja për dhe kundër “Marrëveshjes së Prespës”, PORTALB, 06.03.2019, линку në dispozicion: <https://portalb.mk/596033-pendarovski-vs-siljanovska-beteja-per-dhe-kunder-marreveshjes-se-prespes/>, (15.08.2020).

kontestimin e saj, andaj pret edhe kohëra më të mira, kurse VMRO-DPMNE, pavarësisht që nuk pajtohet në tërësi me marrëveshjen, ata më tepër fokusohen në aspektin formal si dhe shpresën më të madhe për anulimin e kësaj marrëveshjeje e shohin te deputetët e përjashtuar të kësaj partie të cilët po ato deputet i votuan ndryshimet kushtetuese, por sipas VMRO-DPMNE-së “nën kërcënime dhe presione” dhe ky është një element inkurajues për ato që do të flasin publikisht dhe të dëshmojnë përpara Prokurorisë Publike.³²⁶

Kujtojmë se edhe në Greqi, njëjtë si në Maqedoninë e Veriut, përpara ratifikimit të Marrëveshjes së Prespës në parlamentin grek, Federata greke e shoqatave kulturore të maqedonasve dhe Asociacioni panmaqedonas dhe maqedonasve nga diaspora, dërguan kërkesë për suspendimin e Marrëveshjes së Prespës përpara Gjykatës greke duke vlerësuar se marrëveshja e shkel Kushtetutën greke dhe “dërgon drejt shpërbërjes së Greqisë me procedurë të përshpejtuar”. “Marrëveshja e shkel nenin 27 të Kushtetutës, sipas së cilit para se të nënshkruhet nevojitet votim në Parlament edhe atë me shumicë të lartë, pasi përfshin ndryshimin e termeve gjeografike (rajonin e Maqedonisë në rastin konkret)” thuhet në kërkesën e organizatës, ndërsa në një pikë tjetër thuhet se është shkelur Kushtetuta, pasi që marrëveshja është nënshkruar edhe përkundër “kundërshtimit të popullit grek për çfarëdo kompromisi për emrin, pa mbajtjen e referendumit.”³²⁷

Gjykata e lartë administrative e Greqisë e hodhi poshtë ankesën e grupit të shoqatave maqedonase vendase dhe të huaja që kërkonin anulimin e një marrëveshjeje të nënshkruar mes Athinës dhe Shkupit mbi çështjen e emrit.³²⁸ Gjykata e lartë administrative e vendit tha se marrëveshja nuk mund t’i nënshtrohet rishikimit gjyqësor, sepse lidhet me politikën e jashtme. Gjykata vlerësoi se marrëveshja së bashku me një letër të nënshkruar nga ish ministri i jashtëm, Nikos Kocias, që i hapi rrugë Maqedonisë së Veriut për të filluar bisedimet e pranimit në NATO dhe BE, “në vetvete përbëjnë akte të menaxhimit politik në fushën e politikës së jashtme dhe janë drejtpërdrejtë të lidhur me menaxhimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të vendit.”

³²⁶ Милошоски за ФАЦ: ВМРО-ДПМНЕ бара начин да го врати уставното име, DW, 21.10.2019.

³²⁷ Gjykata Kushtetuese e Greqisë e hodhi poshtë kërkesën për suspendimin e Marrëveshjes së Prespës, KOHA, 18 Korrik 2018, linku në dispozicion: <https://www.koha.mk/gjykata-kushtetuese-e-greqise-e-hodhi-poshte-kerkesen-per-suspendimin-e-marreveshjes-se-prespes/>, (15.08.2020).

³²⁸ Council of State rejects appeal to cancel FYROM name deal, EKATHIMERINI, 18.07.2018, linku në dispozicion: <https://www.ekathimerini.com/230815/article/ekathimerini/news/council-of-state-rejects-appeal-to-cancel-fyrom-name-deal>, (15.08.2020).

Prandaj, “ato lidhen me Qeverinë dhe nuk janë subjekt i anulimit të Këshillit të Shtetit.”³²⁹

Gjykata e Këshillit të Shtetit i hodhi poshtë edhe pretendimet e grupit se marrëveshja shkel nenin 27 të Kushtetutës greke, sipas së cilit, çdo marrëveshje për kufijtë e vendit duhet të ratifikohen nga një shumicë absolute e votave në Parlament. Ata gjithashtu, argumentuan kundër shqetësimeve të paditësve se marrëveshja lidh duart e ligjvënësve grek, të cilët në të ardhmen do të duhet të votojnë nëse Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, duhet ta lejojnë të anëtarësohet në BE dhe NATO, si dhe në lidhje me mënyrën sesi do të mësohet historia në vendin fqinj të Ballkanit. Së fundmi, Këshilli i Shtetit argumentoi kundër pretendimeve të grupit që marrëveshja, duke riemërtuar Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë në Maqedonia e Veriut, do të kërcënonte markat greke që identifikohen si Maqedoni.³³⁰

Kryeministri i tanishëm grek, Kiriakos Micotakis, arriti që ta kanalizojë këtë pakënaqësi të popullatës së revoltuar me këtë marrëveshje, me çka arriti që ta merr pushtetin në Greqi dhe të fitojë bindshëm kundër kundërshtarit të tij, Aleksis Cipras. Zëri i kryeministrit të ardhshëm të Greqisë ishte kompromitues kur erdhi çështja për të ardhmen e marrëveshjes. Kiriakos Micotakis, theksoi se si kryeministër i ardhshëm do ta respektojë marrëveshjen, nëse ajo ratifikohet. Ai premtoi se do ta përdorë procesin e pranimit të Maqedonisë së Veriut për të ndryshuar pjesët e marrëveshjes që janë të dëmshme për interesat greke. Kjo nënkupton se Maqedoninë e Veriut e pret një proces i ngadalshëm i negociatave, por kjo pozitë nënkupton se NEA Demokracia në parim do të rrinte së paku në vetë marrëveshjen dhe se kjo premonte një pozitë se NEA Demokracia nuk do të bënte asgjë për të “goditur varkën” që është njëherë në fuqi.³³¹ Andaj, si pasojë e kësaj, ai u përball me një pakënaqësi nga “Asociacioni panmaqedonas në Greqi”, të cilët shprehën revoltë në një letër drejtuar kryeministri grek, në lidhje me trajtimin që po ia bën Qeveria greke, çështjes maqedonase, që rezulton se është kundër asaj për çka edhe ai fitoi pushtetin. Anëtarët e Asociacionit, në letrën në fjalë, kërkuan një ndryshim të “taktikave të tij nënshtruese dhe të drojtura ndaj çështjes maqedonase që nuk e mbron

³²⁹ Appeal against name deal rejected, EKATHIMERINI, 14.12.2018, linku në dispozicion: <https://www.ekathimerini.com/235707/article/ekathimerini/news/appeal-against-name-deal-rejected>, (15.08.2020).

³³⁰ Council of State rejects appeal to cancel FYROM name deal, EKATHIMERINI, 18.07.2018, linku në dispozicion: <https://www.ekathimerini.com/230815/article/ekathimerini/news/council-of-state-rejects-appeal-to-cancel-fyrom-name-deal>, (15.08.2020).

³³¹ Armakolas, Ioannis; Petkovski, Ljupcho; Voudouri, Alexandra, The Prespa Agreement one year after ratification: from enthusiasm to uncertainty?, p. 10.

helenizmin maqedonas dhe me këtë po e ofendon dinjitetin e maqedonasve dhe rrjedhimisht edhe të të gjithë grekëve.” “Ne përdorim të njëjtën “përvojë dhe dituri” për të reaguar ndaj “Marrëveshjes së Prespës”, si jo-historike dhe të pabesë dhe i karakterizojmë si tradhtarë ata të cilët e nënshkruan atë, për shkak se ne e kuptuam se sa e dëmshme ishte ajo për helenizmin. (Vetëm tradhtia mund të përshkruhet si njohje legale nga grekët ndaj një shteti të sapoformuar me emrin “Maqedonia e Veriut” dhe “gjuhën maqedonase” dhe “përkatësinë etnike maqedonase”) përmes “Marrëveshjes së Prespës”.³³² Ata siç shihet, janë të shqetësuar dhe i kanë bërë me dije dështimin e kryeministrit për angazhimin e tij parazgjedhor që e ka bërë për të reaguar ndaj legalizimit të “gjuhës maqedonase” dhe “etnisë maqedonase”, përmes procesit të pranimit të shtetit fqinjë në BE. “Të indinjuar ne lexojmë vendimin e qeverisë suaj dhe personalisht për zbatimin e plotë të marrëveshjes, të cilët vetë ju, në mënyrë të përsëritur në vazhden e zgjedhjeve të cilën e keni cilësuar si të dëmshme për interesat greke”. Por, sipas tyre, koha e së vërtetës ka ardhur. “Kohët e fundit BE vendosi të fillojë negociatat e pranimit me vendin fqinj. Qeveria bullgare po qëndron konzistente në mbrojtjen e të drejtave të bullgarëve, kundërshton fuqimisht ekzistencën e një “gjuhe maqedonase”. Ju dhe qeveria juaj jo vetëm që nuk e kundërshtoni, në mënyrë që të kërkontë interesat e grekëve, por ju duartroksni zhvillimet kundër nesh.” “Trajtimi efektiv i koronavirusit nuk ju çliron nga përgjegjësitë e juaja në shitjen e Maqedonisë. Jo vetëm ai që votoi për “Marrëveshjen e Prespës”, por edhe ata që e zbatojnë atë me besnikëri janë të kuptueshëm.”³³³

Në këtë kontekst, vlen të përmendet juristi i shquar austriak, Hans Kelsen, i cili e sulmon idenë mbi personalitetin e shtetit si një fikcion meqë shteti e fiton kualitetin e personit, përmes të efekteve të normave juridike. Nga kjo del se e drejta e brendshme aplikohet brenda një sferë territoriale, personale dhe kohore të përcaktuar nga rendi juridik ndërkombëtar dhe kështu gjendet e nënshtruar nga e drejta ndërkombëtare. Sipas kësaj variante, vlera e së drejtës ndërkombëtare pozitive për një shtet nuk varet prej pranimit nga ai, sepse me krijimin e një shteti ai fiton, sipas së drejtës ndërkombëtare, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i janë imponuar shtetit nga rendi juridik ndërkombëtar, pa marrë parasysh se a e pranon shteti të

³³² Pan-Macedonian Union denounces government’s inaction on the Prespa Agreement, GREEK CITY TIMES, 28 May 2020, linku në dispozicion: <https://greekcitytimes.com/2020/05/28/pan-macedonian-union-denounces-governments-inaction-on-the-prespa-agreement/>, (15.08.2020).

³³³ Po aty.

drejtën ndërkombëtare apo jo.³³⁴ Me fjalë të tjera, ashtu siç thotë edhe profesori Zejnullah Gruda, raporti midis së drejtës së brendshme dhe së drejtës ndërkombëtare rregullohet me kushtetutë. Anglia ka qenë vendi i parë që të drejtën ndërkombëtare ka filluar ta trajtojë si “pjesë e së drejtës së vendit” dhe i ka obliguar gjykatat që t’i zbatojnë drejtpërdrejtë rregullat e saj, përpos kur janë në kundërshtim me ndonjë ligj që ka miratuar Parlamenti. SHBA kanë përcaktuar se “të gjitha traktatet që janë të lidhura ose që do të lidhen në emër të SHBA, do të jenë ligj suprem i vendit” dhe i obligojnë gjyqtarët (neni 6 i Kushtetutës – 1789). Kushtetuta e Italisë e vitit 1947 (neni 10), parasheh se rendi juridik i Italisë harmonizohet me rregullat e së drejtës ndërkombëtare të paranuara përgjithësisht. Kushtetuta e Federatës Ruse e vitit 1993 (neni 15 (4)), Kushtetuta e Kroacisë e vitit 1990 (neni 134) etj., parashohin se traktatet ndërkombëtare dhe rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare janë pjesë e rendit juridik të brendshëm të këtyre shteteve dhe për nga fuqia juridike kanë epërsi ndaj ligjeve. Edhe Kushtetuta e Francës e vitit 1958 (neni 55), pëcakton shprehimisht se traktatet ndërkombëtare “kanë vlerë më të madhe se ligji.”³³⁵

Praktika ndërkombëtare, gjithashtu shkon në favor të epërsisë së të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtën e brendshme, gjë që dëshmojnë vendimi në “rastin Alabama” (shpallja e Anglisë fajtoreshë për shkak të cenimit të rregullave të së drejtës ndërkombëtare); vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me Zonat e Lira (1932); Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me aktivitetet ushtarake dhe paraushtarake në Nikaragua dhe kundër saj (1986); mendimi konsultativ lidhur me mbylljen e Misionit vëzhgues palestinez pranë OKB në Nju Jork (1988), me të cilat vërtetohet qëndrimi dominant se asnjë shtet nuk mund të thirret në ligjet ose kushtetutën e vet për t’i zvogëluar detyrimet e veta ose për t’i kufizuar efektet e së drejtës ndërkombëtare ose të traktateve ndërkombëtare, as në mungesë të ligjeve e organeve të caktuara kombëtare, si arsye për mospërbushjen e detyrimeve ndërkombëtare. Përkundrazi, në vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të 21 shkurtit 1925 lidhur me këmbimin e popullsisë greke dhe turke është theksuar parimi sipas të cilit shteti i cili ka marrë detyrime ndërkombëtare është i detyruar që të miratojë ndryshimet

³³⁴ Për më tepër shih: Gruda, Prof., Dr., Zejnullah, E drejta ndërkombëtare publike, Botim i plotësuar dhe i përmirësuar, 2007, fq. 20, 21.

³³⁵ Po aty, fq. 22.

e domosdoshme në legjislacionin e vet për të siguruar plotësimin e marrëveshjes së arritur.³³⁶

Sistemi bashkëkohor i marrëdhënieve ndërkombëtare solli ndryshime të gjithanshme përmbajtësore, edhe atë: themelimi i institucioneve ndërkombëtare dhe rajonale, si: Organizata e Kombeve të Bashkuara, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Organizata Botërore e Tregtisë, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, Bashkimi Evropian, etj.; lidhja e konventave të ndryshme ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, mbi të drejtën dhe rregullat e luftës; etj. Krejt këto institucione dhe konventa ndërkombëtare u paraqitën si pasojë e autorizimeve sovrane të shteteve, por, njëkohësisht ato i ngushtuan autorizimet sovrane të shteteve, andaj, u transformua edhe vetë natyra e sovranitetit shtetëror meqë u zhduk pakufizueshmëria juridike si element i dikurshëm i tretë i sovranitetit shtetëror dhe në vend të tij sot, si element të tretë e kemi autorizimin e shtetit për të nxjerrë kushtetutën si aktin më të lartë juridik.³³⁷ Në këtë drejtim, OKB bazohet në barazinë e shteteve të mëdha dhe të vogla përkatësisht, në barazinë sovrane të të gjitha shteteve anëtare. Mirëpo, nga ky parim ka përjashtime, edhe atë, në organin kryesor të OKB-së, pra, në Këshillin e Sigurimit që ka përgjegjësi për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, pese anëtarët e përhershëm të këtij organi e kanë të drejtën e vetos ndaj çfarëdo lloj vendimi që sjell ky organ. Nga ana tjetër, Këshilli i Sigurimit është i autorizuar që nëse konstaton rrezikimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, të vendos masa që mund të trazojnë sovranitetin e shteteve të tjera, sepse masat e tilla nuk janë vetëm diplomatike (si, ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike) dhe ekonomike (si, sanksionet ose embargoja ekonomike) por, edhe masa të përdorimit të fuqisë ushtarake, andaj, një numër i konsiderueshëm i autorëve pohojnë se nocioni i sovranitetit nuk ekziston përkatësisht ekziston vetëm për shtetet më të fuqishme.³³⁸ Pra, edhe pse OKB-ja e garanton parimin e barazisë sovrane midis shteteve, ky parim duhet kuptuar me mendjeprehtësi sepse jo vetëm që shtetet nuk janë të barabarta, por, madje, nuk janë të kufizuara në mënyrë të barabartë me të drejtën ndërkombëtare. Aq më tepër kur, shtetet e vogla shumë më shumë varen nga institucionet ndërkombëtare politike dhe ekonomike si dhe nga kompanitë transnacionale, se sa shtete e fuqishme, sidomos nga SHBA-të si superfuqi e vetme. Andaj, shtetet e vogla dhe të dobëta, që

³³⁶ Gruda, Prof., Dr., Zejnullah, E drejta ndërkombëtare publike, Botim i plotësuar dhe i përmirësuar, 2007, fq.22.

³³⁷ Për më tepër shih: Shasivari, Dr., Jeton, E drejta kushtetuese, Libri I, (Botimi i parë), Furkan ISM, Shkup, 2015, fq. 161, cituar sipas: Лукић, Др., Радомир; Коштуић, Др., Будимир, Увод у право, Београд, 2008, стр. 30, 31.

³³⁸ По ату, fq. 162, cituar sipas: Лукић, Др., Радомир; Коштуић, Др., Будимир, Увод у право, Београд, 2008, стр. 71, 72.

të ruajnë një shkallë të sovranitetit të tyre e kanë patjetër të mësohen të jetojnë me shtetet e mëdha në botën e globalizuar.³³⁹

Nga analiza e bërë më lartë, pyetja që mund të shtrohet në këtë drejtim është se sa është e mundur realisht që një marrëveshje e tillë ndërkombëtare si “Marrëveshja e Prespës” të kontestohet përpara Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut?

Vet përgjigja e pyetjes mund të jetë komplekse, për arsye se situata e krijuar me Marrëveshjen e Prespës është komplekse dhe specifike, sepse Marrëveshja e Prespës është një ndër marrëveshjet më të rralla të kësaj natyre të arritura ndonjëherë në nivel ndërkombëtar. Andaj, të gjitha përgjigjet që mund të jepen dhe mund të elaborohen kanë të bëjnë me situata hipotetike, me një situatë që ende nuk ka ndodhur, siç është sfidimi i Marrëveshjes së Prespës përpara Gjykatës Kushtetuese! Edhe pse Kushtetuta e RMV-së mbi marrëdhëniet ndërkombëtare thekson se “Marrëveshjet ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar në pajtim me Kushtetutën janë pjesë e rendit juridik të brendshëm dhe nuk mund të ndryshohet me ligj.”³⁴⁰, përsëri del se e drejta ndërkombëtare është një e drejtë supranacionale, mbi kombëtare, gjë që u imponohet të drejtave kombëtare edhe pse një raport i tillë rregullohet me kushtetutat e shteteve përkatëse. Por, rasti i Maqedonisë së Veriut, përbënë një rast specifik, ajo përveçse në këtë rast tregoi një qasje fleksibile në raport me të drejtën ndërkombëtare duke lejuar ndërhyrjen në të drejtën juridik kombëtare të saj, për shkak se marrëveshja në fjalë jo vetëm që paraqet marrëveshja apo traktat ndërkombëtare bilateral, e lidhur midis dy shteteve, pra Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, por një marrëveshje e cila me vullnet të dy palëve parashihte ndryshime kushtetuese³⁴¹ për një zbatim më efektiv të marrëveshjes, por mbi të gjitha zgjedhjen e emrit të saj, për shkak se ajo një kohë të gjatë ka operuar nën referencën e përkohshme “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” në OKB, prej nga e nxjerr edhe Marrëveshja e Prespës bazën juridike në rezolutat e saj, me çka kualifikohet si marrëveshje ndërkombëtare.

Pyetja gjithashtu hipotetike që mund të shtrohet është: çka do të ndodhte nëse

³³⁹ Shasivari, Dr., Jeton, E drejta kushtetuese, Libri I, (Botimi i parë), Furkan ISM, Shkup, 2015, fq. 162, cituar sipas: Лукић, Др., Радомир; Коштуић, Др., Будимир, Увод у право, Београд, 2008, стр. 31.

³⁴⁰ Устав на Република Северна Македонија, член 118.

³⁴¹ Për më tepër shih: Final agreement for the settlement of the differences as described in the United Nations Security Council Resolution 817 (1993) and 845 (1993), the termination of the Interim Accord of 1995, and the establishment of a strategic partnership between the parties, Article 1.

Marrëveshja e Prespës do të sfidohej në Gjykatën Kushtetuese të RMV-së dhe e njëjta të anulohet, me arsyen se është kundërkushtetuese?

Gjykata në Greqi, këtë situatë e ka pastruar me arsyetimin se Marrëveshja e Prespës nuk mund t'i nënshtrohet rishikimit gjyqësor sepse lidhet me politikën e jashtme dhe ajo është drejtpërdrejtë e lidhur me menaxhimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të vendit. Por, në Greqi për shkak të marrëveshjes Kushtetuta e tyre nuk ka pësuar ndryshime, ndërsa e kundërta është tek ne, andaj kjo situatë komplikohet nga kundërshtarët e marrëveshjes. Me vet faktin, që nëse Marrëveshja e Prespës merr trajta dhe përmasa serioze të kontestimit apo kundërshtimit të saj, atëherë aktivizohet "Pjesa e tretë" e marrëveshjes, përkatësisht neni 19 i saj, ku parasheh zgjidhjen e kontesteve. Sipas kësaj, çdo kontest që mund të lind gjatë zbatimit të Marrëveshjes së Prespës dhe këtë nuk mund ta zgjidhin palët bilaterale, sepse si pasojë njëra prej palëve do ta kontestojë, atëherë në skenë paraqitet OKB-ja si ndërmjetësues, nëse dështon edhe ajo atëherë, kjo punë i lihet në dorë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.³⁴² Kjo gjykatë, siç e kemi parë më lart, përmendën se pikërisht kjo gjykatë në kontestin e lindur më 21 Shkurt 1925 mes Turqisë dhe Greqisë, mbi këmbimin e popullsisë greke dhe turke, ka theksuar parimin sipas së cilit, shteti i cili ka marrë detyrime ndërkombëtare është i detyruar që të miratojë ndryshimet e domosdoshme në legjislacionin e vet, për të siguruar plotësimin e marrëveshjes së arritur.³⁴³ Pra, meqënëse Maqedonia e Veriut, ka qenë negociatore dhe nënshkruese e marrëveshjes, ajo me vetëdije ka marrur detyrim ndërkombëtar për implementimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Prespës, përfshirë edhe ndryshimet kushtetuese. Marrëveshja në fjalë, përbëhet prej normave *jus cogens* (imperative), ashtu siç janë rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të cilët janë të detyrueshme juridikisht për të gjitha shtetet anëtare të saj, në përputhje me nenin 25 të Kartës së OKB-së.³⁴⁴ Gjykata nisat nga parimet romake: "Pacta sunt servanda" (Marrëveshjet duhet të respektohen) dhe "Bona fides" (me mirëbesim), për shkak të detyrueshmërisë juridike por edhe morale që rrjedhin nga këto parime ndërkombëtare. Kjo nënkupton se këto norma *jus cogens* i referohen edhe shtetit fqinj, Greqisë e cila duhet t'i

³⁴² Për më tepër shih: Final agreement for the settlement of the differences as described in the United Nations Security Council Resolution 817 (1993) and 845 (1993), the termination of the Interim Accord of 1995, and the establishment of a strategic partnership between the parties, Article 19.

³⁴³ Gruda, Prof., Dr., Zejnullah, E drejta ndërkombëtare publike, Botim i plotësuar dhe i përmirësuar, 2007, fq. 22.

³⁴⁴ Për më tepër shih: Charter of the United Nations and Statute of the International Court of Justice, Chapter V, Article 25, linku në dispozicion: <https://www.un.org/en/sections/un-charter/chapter-v/index.html>, (15.08.2020).

përmbush me mbështetjen e Maqedonisë së Veriut në anëtarësimin e saj në BE si dhe anëtarësimin e saj në institucionet ose organizatat tjera ndërkombëtare, multilaterale ose rajonale,³⁴⁵ andaj, anulimi i saj nga Gjykata Kushtetuese do të sillte dëme të pariparueshme jo vetëm për të dyja palët nënshkruese të marrëveshjes, por edhe për rajonin, duke pasur parasysh anëtarësimin e plotë të Maqedonisë së Veriut në NATO, si anëtarja e 30-të, benefit i nxjerrur nga marrëveshja si dhe fillimi i negociatave për anëtarësim në BE dhe në këtë situatë atëherë Maqedonia do duhej të përjashtohej nga NATO-ja dhe të ndërprehen të gjithat negociatat me BE-në, duke u kthyer në pikën zero.

Çështja tjetër që kontestohet Marrëveshja e Prespës nga oponentët e saj, ka të bëjë mbi mënyrën e lidhjes së saj në kundërshtim me Kushtetutën e RMV-së, përkatësisht se ajo është e nënshkruar nga ministrat e punëve të jashtme të shteteve përkatëse, andaj kjo është një ndër arsyet që të kontestohet ajo përpara Gjykatës Kushtetuese, për arsye se Kushtetuta nuk e parashikon që edhe ministrat e punëve të jashtme të jenë nënshkrues të saj. Kushtetuta e RMV-së, këtë situatë e sqaron në dispozitën e nenit 119, ku thuhet: “Marrëveshjet ndërkombëtare në emër të Republikës së Maqedonisë i lidh Kryetari i Republikës së Maqedonisë. Marrëveshje ndërkombëtare mund të lidh edhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë kur kjo është përcaktuar me ligj.” Megjithatë, Maqedonia është nënshkruese e Konventës së Vjenës, dhe ajo në dispozitën e nenit të 7, ka paraparë që atë mund ta nënshkruajnë edhe ministrat e punëve të jashtme të shteteve përkatëse edhe atë në paragrafin 2: “Në sajë të funksioneve dhe pa pasur nevojë të prodhojnë fuqi të plotë, përfaqësues të shteteve të tyre konsiderohen këto në vijim: a) Kryetari i Shtetit, Kryetari i Qeverisë dhe Ministri i punëve të jashtme, me qëllim të kryerjes së të gjitha akteve të lidhura me konkluzionet (përfundimet) e traktateve; b) Kryetari i misioneve diplomatike, me qëllim të miratimit të tekstit të një traktati midis shtetit akreditues dhe shtetit në të cilin janë akredituar; c) përfaqësuesit e akredituar nga shtetet në një konferencë ndërkombëtare ose në një organizatë ndërkombëtare ose një prej organeve të saj, me qëllim të miratimit të tekstit të një traktati në atë konferencë, organizatë ose organ.”³⁴⁶ Konventa e Vjenës vis a vis protagonistëve të punëve të jashtme i konsideron krerët e pushtetit ekzekutiv, kryetarin

³⁴⁵ Final agreement for the settlement of the differences as described in the United Nations Security Council Resolution 817 (1993) and 845 (1993), the termination of the Interim Accord of 1995, and the establishment of a strategic partnership between the parties, Article 20.

³⁴⁶ Vienna Convention on the Law of Treaties, 1969, United Nations, 2005, Article 7.

e shtetit dhe kryeministrin, duke ia dhënë këtë peshë politike në marrëdhëniet ndërkombëtare edhe ministrit të jashtëm, me çka i barazon këta tre aktorët sa i përket lidhjes dhe nënshkrimit të marrëveshjeve apo traktateve ndërkombëtare, pa i dhënë njëres ose tjetrës fuqi më të madhe politike. Fundi fundit, edhe Marrëveshja e Përkohshme mes Republikës së Maqedonisë apo (IRJM-së) dhe Republikës së Greqisë, nënshkruese të së njëjtës figurojnë emrat e ministrave të punëve të jashtme të shteteve nënshkruese të marrëveshjes si: Karlos Papulas – ministër i punëve të jashtme të Greqisë, si dhe Stevo Crvenkovski – ministër i punëve të jashtme të Maqedonisë.³⁴⁷ Në secilin vend ekziston një praktikë kushtetuese që shumë shpesh instrumentet e ratifikimit i dorëzon Shefi i Shtetit, Kryeministri ose Ministri i Jashtëm, në rastet kur bëhet fjalë për marrëveshje që kanë peshë për identitetin nacional dhe territorial i shtetit.³⁴⁸ Në këtë kuptim reflekton edhe Konventa e Vjenës që i barazon këto tre funksione. Nganjëherë kjo përzihet me ratifikimin ndërkombëtar të marrëveshjeve ndërkombëtare. E kundërt me këtë është ratifikimi kushtetues, ai që kryhet nga organi përfaqësues i sovranit. Ekziston edhe një ratifikim tjetër, po ashtu kushtetues, që kryhet nga Shefi i Shtetit apo Kryeministri me nënshkrim. Këtë e parasheh edhe Kushtetuta e Kosovës. Ky lloj ratifikimi, nuk zbatohet askund veç në vijim të vënies në jetë të një detyrimi ekzistues ndërkombëtar të Kosovës, të cilin e ka krijuar organi përfaqësues i sovranit me votën e tij. Ratifikimi i kryer nga përfaqësuesi i sovranit, parlamenti, në tërësi përjashton Shefin e Shtetit, jo vetëm në demokracitë parlamentare kushtetuese por edhe në demokracitë semi-presidenciale e parlamentare. Këtu gjithmonë e kemi fjalën për marrëveshjet që kanë objekt territorin, paqen, sovranitetin nacional territorial dhe kështu me radhë. Këto çështje janë pjesë përbërëse e shtetit si insitucion dhe aktor kryesor në marrëdhëniet ndërkombëtare. Këtë qasje përjashtuese e ka ndjekur Marrëveshja e Prespës, në të cilën asnjë ndikim nuk kanë pasur Shefi i Shtetit të të dyja vendeve. Këtë qasje e ka pasur edhe dialogu Kosovë-Serbi që deri në momentin kur me insistimin e palës kosovare është zhvendosur në nivel të shefave të shtetit.³⁴⁹

Ndaj të gjitha këtyre çështjeve të elaboruara, asnjëra palë nënshkruese e Marrëveshjes

³⁴⁷ Për më tepër shih: Привремена спогодба меѓу Република Македонија и Република Грција, Њујорк, 13 септември 1995 година, член 23.

³⁴⁸ Hasani, Enver, Marrëveshja e Prespës dhe copëtimi i Kosovës: dallimet dhe ngjashmëritë, Syri Kosova, 13.05.2019, linku në dispozicion:https://www.syri.net/syri_kosova/op-ed/25710/marreveshja-e-prespes-dhe-copetimi-i-kosoves-dallimet-dhe-ngjashmerite/, (15.07.2020).

³⁴⁹ Po aty.

së Prespës nuk mund t'i kontestojë dhe të absentojë në përmbushjen e normave juridike të saj, duke u thirrur në kushtetutat e veta ose në legjislacionin e shteteve përkatëse për arsyetimin e së njëjtës. Mbi të gjitha, e drejta ndërkombëtare ka primatin ndaj së drejtës së brendshme dhe kjo qartë elaborohet në dispozitën e nenit 27 të Konventës së Vjenës, e cila thotë: “Një palë nuk mund të përdorë dispozitat e ligjit të saj të brendshëm si justifikim për mosrespektimin e një traktati.”³⁵⁰ Përsëris edhe njëherë, se “Marrëveshja e Prespës” dhe të gjitha situatat tjera që kanë rrjedhur në korniza të kësaj marrëveshjeje, japin shembullin eklatant shkollor sesi marrëveshja juridike ndërkombëtare ndërhyjnë në të drejtën kushtetuese kombëtare, sesi i ndryshon dhe i injoron normat e saj të ngushta kur janë në koluzion (konflikt) me kushtetutën faktike. Në këtë drejtim, bëhet fjalë për “Marrëveshje – mbi kushtetutën”, siç janë Marrëveshja e Përkohshme e vitit 1995 si dhe Marrëveshja Kornizë e Ohrit e vitit 2001. Por, këtë nuk e kuptojnë “oponentët e marrëveshjes.”³⁵¹

Nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese të RMV-së³⁵² në lidhje me vendimin e kontestuar të Kuvendit të RMV-së për shpalljen e referendumit të 30 shtatorit 2018, i kemi të qartë qëndrimet e dy gjykatësve nga kjo gjykatë ndaj Marrëveshjes së Prespës, të cilët vlerësojnë se Marrëveshja e Prespës përbën marrëveshje e cila është absolutisht nul, punë juridike joekzistuese, duke marrur për bazë subjektin i cili e ka nënshkruar këtë marrëveshje, pra ministri i punëve të jashtme, të cilën e konsiderojnë se e njëjta është lidhur nga organi jokompetent, se nuk ka pasur ligj për ratifikimin e saj dhe se pyetja e vendosur në referendum ku përmendet edhe Marrëveshja e Prespës, u imponohet qytetarëve se ata e njohin ekzistimin e Marrëveshjes së Prespës edhe pse ai “de jure” nuk ekziston. Ata pretendojnë se ministri i punëve të jashtme nuk ka pasur mandat, përkatësisht të drejtë autorizuese për lidhjen e një lloji tillë të marrëveshjes dhe se e njëjta sipas nenit 119 paragrafi 1 dhe 2 i Kushtetutës, këtë të drejtë ia rezervon Kryetarit të RMV-së, kurse në kushte të përcaktuara mund të lidh edhe Qeveria e RMV-së, por vetëm kur ajo është e përcaktuar me ligj.

Hipotetikiisht, në rast sfidimi të Marrëveshjes së Prespës, të nënshkruar mes Republikës

³⁵⁰ Vienna Convention on the Law of Treaties, 1969, United Nations, 2005, Article 7.

³⁵¹ Шкарик, Светомир, Договорот со Грција и уставните промени, Republica, 14 септември 2018, linku në dispozicion: <https://republica.edu.mk/mk/blog/2018-09-14-08-02-16>, (25.07.2020).

³⁵² Издвоени мислења по предметот У.бр.88/2018, У.бр.90/2018 и У.бр.91/2018, Уставен Суд на Република Северна Македонија, 19 септември 2018, linku në dispozicion: <http://ustavensud.mk/?p=16835>, (06.08.2020).

së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Greqisë, vlerësoj se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk do të inicionte procedurë kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së saj, pikërisht për shkak të situatave dhe argumenteve të elaboruara më lartë. Përndryshe, do të ishte barrë e rëndë për Gjykatën Kushtetuese të vendos ndaj kësaj çështjeje, duke pasur parasysh rëndësinë dhe impaktin që e ushtron kjo marrëveshjeje jo vetëm në aspektin e brendshëm shtetëror por edhe atë në nivel ndërkombëtar, andaj pavarësisht aspektit juridik dhe aspektit sentimental që ngërthen vet çështja, ajo më tepër do duhej të fokusohet në të mirën e shoqërisë, në benefitet që rezultojnë nga Marrëveshja e Prespës e sidomos në ardhmërinë evro-atlantike të qytetarëve të saj e sidomos shtetit ku ajo vepron.

4.4. Bashkimi Evropian duhet të mbështesë fuqishëm integrimin evropian të RMV-së

Moti kohë Shkupi dhe Athina kanë bërë hapa kyçe sa i përket normalizimit të kontestit mes dy vendeve fqinje, por këto përpjekje ndonjëherë kanë pasur sukses e ndonjëherë jo edhe aq, i gjithë ky proces ka kaluar në peripeci të ndryshme deri sa është arritur te marrëveshja përfundimtare për zgjidhjen e kontestit të emrit. Me interes të madh është ndjekur lidhja dhe zhvillimi i ngjarjeve në lidhje me Marrëveshjen e Prespës dhe ndryshimi i emrit nga Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë në Republika e Maqedonisë së Veriut, si rezultat i Marrëveshjes së Prespës. Mediumet nga e mbarë Evropa dhe më gjerë, njoftuan për këtë marrëveshje historike, është biseduar shumë për rolin e politikanit grek, Aleksis Cipras dhe atij maqedonas, Zoran Zaev në tërë procesin e marrëveshjes, të cilët marrëveshjen e sollën nën presion të madh. Por, sidoqoftë “me ardhmërinë nuk mund të ballafaqohen ata të cilët janë të ngjuar në të kaluarën” ka thënë ish Kancelari gjerman, Vili Brant nën shërbimin e të cilit ndodhi procesi i qetësimit mes Gjermanisë dhe Evropës Lindore pas Luftës së Dytë Botërore. Ndryshimet e mëdha kërkojnë guxim të madh, ndërsa guxim të jashtëzakonshëm politik kanë treguar Aleksis Ciprasi së bashku me Zoran Zaevin, për shkak edhe të së cilës, mes tjerash, të dy kryeministrat kanë qenë të nominuar për Çmimin Nobel për paqe.³⁵³

Pas shpalljes së pavarësisë në Janar të vitit 1991, Republika e Maqedonisë së Veriut e shprehu qartë anëtarësimin në Bashkimin Evropian, si një nga interesat e saj strategjike. Duke e realizuar këtë përcaktim, RMV u legjitimua si partner i besueshëm dhe aleat i BE-së, që kaloi

³⁵³ Флекенштајн, Кнут, Посветени на Европскиот мировен проект, Предизвици, Списание за општествени прашања, Пост-Преспанска Северна Македонија и предизборна Европа, број I, 03/2019, Friedrich Ebert Stiftung, стр. 7.

nëpër një varg etapash të ndryshme në zhvillimin e marrëdhënieve, të afrimit dhe të integritimit në BE. Por, për shkak të kundërshtimit të Greqisë që RMV të pranohet me emrin kushtetues, u vonua procesi i pranimit ndërkombëtar dhe i vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me BE-në. Marrëdhëniet e plota diplomatike ndërmjet RMV-së dhe BE-së janë vendosur në Dhjetor të vitit 1995 kur është hapur edhe misioni i RMV-së në BE.³⁵⁴ Në ngjarje kronologjike rrugëtimi i saj drejt BE-së do të dukej kështu: ajo që nga vitit 1992 filloi të ndërtojë marrëdhënie ekonomike dhe politike me komunitetin ndërkombëtar, sidomos me Bashkimin Evropian. Sa i përket zhvillimit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar të Maqedonisë së Veriut, vitet e para nuk shënojnë ndonjë avancim më të madh. Ato ishin vite me plot bllokada, shantazhe dhe rreziqe për pavarësinë e Maqedonisë së Veriut. Ndonëse ajo ishte anëtare e disa integritimeve ekonomike që ishin themeluar në atë kohë në rajon (BSEC, CEI, SECI, ROJAMONDI, etj.), prapëseprapë perspektiva e saj nuk ishte e qartë, ndërsa dobitë nga anëtarësimi në këto integritime gati se nuk reflektonin fare. Në vitin 1996, Maqedonia e Veriut arriti t'i realizonte hapat më të mëdhenj drejt bashkëpunimit me BE-në. Kështu gjatë këtij viti u nënshkrua Marrëveshja për bashkëpunim midis Maqedonisë dhe BE-së në kuadër të së cilës u nënshkruan edhe disa marrëveshje. Faza e parë e këtij procesi zgjati deri më 2001 kur Maqedonia e nënshkroi Marrëveshjen për stabilizim dhe asocim. Ishte kjo marrëveshja e parë e këtij lloji në të cilën BE-ja vuri nënshkrimin e vet me ndonjë shtet të Ballkanit Perëndimor. Në prill të vitit 2004, Marrëveshja për stabilizim dhe asocim hyri në fuqi, me çka ekonomia e Maqedonisë së Veriut përfitoi privilegje në tregun e vendeve evropiane në krahasim me vendet e tjera joanëtare. Më 17 mars të po këtij viti Maqedonia e Veriut bëri kërkesë zyrtare për anëtarësim në BE.³⁵⁵ Pra, siç shihet ajo gjithmonë ka qenë e orientuar drejt perëndimit edhe pse në disa periudha kjo mbështetje ka qenë e zbehtë, por asnjëherë e vënë në dilemë se ajo mund të mbijetojë edhe pa të.

RMV si dëshmi për vërtetimin të orientimit të saj strategjik, në përputhje me nenin 49 të marrëveshjes për anëtarësim në BE, pas miratimit të Deklaratës në Kuvendin e RMV-së,

³⁵⁴ Republika e Maqedonisë në rrugën drejt UE-së, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, linku në dispozicion: <https://www.sobranie.mk/republika-maqedonis-n-rrug-n-p-r-n-be.nspix>, (17.08.2020).

³⁵⁵ Selimi, Doc., Dr., Nasir, Ndikimi i integritimeve ekonomike rajonale në zhvillimin e ekonomisë së Maqedonisë, Proceset e integritimit euroatlantik dhe Republika e Maqedonisë, Qendra për hulumtime në Administratën Publike, UEJL, Tetovë & Friedrich Ebert Stiftung, Shkup, ArbëriaDesign, Tetovë, 2008, fq. 56, 57.

zyrtarisht dorëzoi aplikim për anëtarësim në BE më 22 Mars 2004 në Dablin, në kohën e udhëheqjes së Republikës së Irlandës me Këshillin e BE-së. Në Shkurt të vitit 2005, përgjigjet e pyetësorit kanë qenë të dorëzuar në KE, e cila e dorëzoi mendimin e vet dhe vlerësimin në detaje për vendin deri te Këshilli i BE-së për vendosje. KE në kohën e udhëheqjes së Britanisë së Madhe, me këshillin, më 16 Dhejtor 2005 solli vendim pozitiv dhe RMV u bë vendi me status të kandidatit për antarësim, por, fatkeqësisht pa datë për fillim të negociatave për pranim.³⁵⁶

Deklarata e pavarësisë së RMV-së në vitin 1991 ishte kyçe për establishmentin e shtetit të ri dhe njohjen e saj në nivel ndërkombëtar. Më saktë, Greqia e refuzoi njohjen e Maqedonisë së Veriut në komunitetin ndërkombëtar dhe pranimin e saj në OKB. Megjithatë, Marrëveshja për stabilizim dhe asocim përfaqësonte dokumentin kornizë për një rrugë të shpejtë të shteteve ballkanike në progresin e integritimeve në BE. Përgjatë negociatave, është e nevojshme që t'ju përmbahen të gjitha afateve dhe kushteve që shteti duhet t'i plotësojë në drejtim që të bëhet anëtar i plotë i BE. Gjithashtu, ky dokument i definon udhëzimet, principet e përgjithshme për: dialog politik, bashkëpunim ndërkombëtar, lëvizje e lirë e njerëzve, mallra dhe kapitale, harmonizim i legjislacionit të brendshëm me direktivat e BE, përmirësimi i konkurrencës në treg, politika e bashkëpunimit, etj. Prandaj, çdo shtet që përpiqet të bëhet anëtar i BE-së nevojitet të përputhet me rregullat dhe direktivat e BE-së. Përveç kësaj, është e rëndësishme të theksohet se pas Samitit të Selanikut, BE dërgoi mesazh të qartë se “nuk ka shkurtesa në BE” dhe se procesi i pranimit është mjaft kompleks dhe “kërkon angazhim të madh të të gjitha segmenteve kyçe të shoqërisë së një shteti”. Kjo marrëveshje konfirmon statusin e kandidatit potencial për anëtarësim në komunitetin evropian, mirëpo pa e definuar në mënyrë precize datën e hyrjes në BE. Shkurtimisht, marrëveshja përfaqëson “dhomën e pritjes” për vendin që do të hyjë në BE. Prandaj, anëtarësimi i plotë në BE është i bazuar në kapacitetet individuale të shtetit që do t'i pranojë kriteret dhe standardet evropiane, të cilët rrjedhin nga anëtarësia e saj.³⁵⁷ Është interesante për t'u theksuar se më 9 Prill 2001, Republika e Maqedonisë së Veriut ka qenë shteti

³⁵⁶ Бесими, Фатмир; Тилев, Драган, Процесот на интеграција на Република Македонија во Европската Унија (со кус осврт на договорните односи и институционалната координација), Република Македонија на патот кон Европската Унија (2020) – искуства, предизвици, перспективи, прилози од меѓународната научна конференција одржана на 6 мај 2016 година, Македонска академија на науките и уметностите, Секретаријат за европски прашања, Влада на Република Македонија, Скопје, 2016, стр. 32.

³⁵⁷ Šorović, Mira, The Republic of North Macedonia – a “new” country in the Western Balkans, RSC Volume 11, Issue 3, September 2019, p. 93, 94; cituar sipas: Durovič 2012, fq. 335.

i parë nga Ballkani Perëndimor e cila e ka nënshkruar Marrëveshjen për stabilizim dhe asociim më BE-në, nën dritën e rritjes së shqetësimeve të tensioneve etnike mes shqiptarëve dhe sllavëve. Ky dokument i garantonte statusin e kandidatit të RMV-së për anëtarësim në BE në vitin 2005, por ai ende është duke pritur për të filluar procesin e pranimit.³⁵⁸

Qeveria e Zoran Zaevit, që nga koha kur erdhi në pushtet si pjesë të reformave të pushtetit të tij e paraqiti edhe planin e njohur si “Plani 3-6-9”, i cili i kushtojë reformave në drejtësi si dhe Bashkimit Evropian. Këtu përfshiheshin Marrëveshja Politike e Përzhinos dhe i përcjell sugjerimet e takimeve të larta me përfaqësuesit e institucioneve të BE-së, drejtimet e Komisionit Evropian në prioritetet urgjente të reformave (2015), sugjerimet e grupës së lartë të ekspertëve për çështje sistematike të sundimit të së drejtës në lidhje me ndjekjen e komunikimeve (2015), si dhe një sërë sugjerimesh nga Qeveria nga vitet e kaluara nga trupi i Këshillit të Evropës (Komisioni i Venedikut, GRECO), sugjerimet e OBSE/ODHIR, rezultatet dhe sugjerimet vjetore të Raporteve të Komisionit Evropian, duke përfshirë edhe dialogun e aderimit të nivel të lartë, përfundimet e dialogut ministror për Programin e reformave ekonomike, përfundimet e mbledhjes së rregullta të trupave të Marrëveshjes për stabilizim dhe asociacion, dokumenti i përgatitur nga grupi i organizatave qytetare i titulluar si “Propozim për reforma urgjente demokratike” dhe rezultatet nga konsultimi i shoqërisë civile.³⁵⁹ Këtë plan, Zaev e sqaroi si hap serioz që bën Qeveria e RMV-së për integrimet evropiane. Sipas tij, Plani 3-6-9 i prioritetëve urgjente reformuese përpara i përcakton pikat kohore të lëvizjeve të vendit. Për tre muaj duhet t’i rrumbullaksojë reformat e para, qëllimi ishte deri në zgjedhjet lokale të sigurojnë argumente për Komisionin Evropian që ta mënjanojnë kushtëzimin e rekomandimit, për fillimin e negociatave paraqasëse. Për gjashtë muaj, planfikimi ishte rrumbullaksimi i rrethi të dytë reformues me qëllim që në Këshillin e BE-së në dhjetor të tregojnë rezultate serioze në shumë lëmi që do ta përforcojnë perceptcionin për Maqedoninë si vend serioz kandidatë për BE-në. Për 9 muaj qëllimi ishte implementimi i rrethit të tretë të reformave që në raportin e ardhshëm për Maqedoninë t’i drejtojnë vendet anëtare të BE-së kah diskutimi për vërtetimin e datës për

³⁵⁸ Šorović, Mira, The Republic of North Macedonia – a “new” country in the Western Balkans, RSC Volume 11, Issue 3, September 2019, p. 94; cituar sipas: Cvijić, 2009.

³⁵⁹ Për më tepër shih: Влада на Република Македонија, План 3-6-9, 04.07.2017, linku në dispozicion: <http://www.sep.gov.mk/data/file/Dokumenti/Plan%203-6-9%20MK.pdf>, (17.08.2020).

bisedime paraqasëse të BE-së me Maqedoninë.³⁶⁰

Kryeministri i RMV-së në një konferencë në ASHAM për Marrëveshjen me Greqinë, vlerësoi lartë Marrëveshjen e Prespës, si dhe reformat e brendshme si dhe perspektivën që hapet me përgjigjen e duhur dhe të vetme në referendum, fitojmë mundësinë shtesë dhe të qartë për zhvillim apo siç thotë ai “e sjellim Evropën këtu dhe krijojmë mundësi”. Ndërkaq, zëvendëskryeministri i Qeverisë së RMV-së, për çështje evropiane, Bujar Osmani, vlerësoi se me hartimin e master planit nga ana e Qeverisë së RMV-së i cili përfshinte Marrëveshjen për miqësi dhe fqinjësi të mirë për Republikën e Bullgarisë, Marrëveshjen për tejkalimin e kontestit të emrit me Republikën e Greqisë, përmbylljen e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit me miratimin e ligjit për shfrytëzimin e gjuhëve dhe masat urgjente reformuese të përfshira në Planin 3-6-9 dhe sipas tij, realizimi i këtyre pikave nga master plani e solli datën për hapjen e negociatave me BE-në dhe ftesën për NATO.³⁶¹

Për shkak të ndryshimit të kontekstit gjeopolitik, integrimi i Ballkanit Perëndimor në BE ishte pothuajse i harruar. Në fillim, Brukseli e mbronte qasjen e tillë me “lodhje nga zgjerimi”, edhe përkaj ekzistimit të çështjeve tjera lidhur me lodhjen, si sfida institucionale, financiare dhe energjike (Reka, B 2010). Mos pasja e kohës që të ballafaqohet me integrimin e rajonit në BE, ajo kaloi drejt “pauzës për zgjerim”, sipas kryetarit të KE-së, Junker, i cili publikoi planin pesëvjeçar për zgjerim deri më 2020. Më 1 Maj 2005, komesari Han përsëri e vërtetoi të thënë se “nuk ka zgjerim në të ardhmen në Ballkan në këtë mandat”, për shkak se “gjendja me Ish Jugosllavinë dhe shtetet tjera ballkanike është e brishtë” (Hann, J 2015). Pikëvështime të ngjashme mund të shihen edhe te vendet tjera anëtare të BE. Franca nuk është e interesuar për zgjerim. Britania e Madhe, aspak nuk është e interesuar në BE. Vetëm Gjermania në vitin 2014 përpiqeshte përsëri ta filloj këtë proces. Pas një shekulli të Luftës së Parë Botërore, Berlioni kuptoi sesa do të ishte e rrezikshme Ballkani të jetë jashtë BE-së, në kontekstin e ri gjeopolitik me sfida të reja për sigurinë evropiane nga Ukraina e deri te Siria. Në dekadën e parë të këtij shekulli, procesi i zgjerimit u ndal, duke e lënë në pritje atë se kur vendet tjera do të kycen drejt

³⁶⁰Zaev: Plani 3-6-9 për perspektivë evropiane, KLAN MACEDONIA, 5 Korrik 2017, linku në dispozicion: <http://klanmacedonia.mk/zaev-plani-3-6-9-per-perspektive-evropiane/>, (17.08.2020).

³⁶¹ Kryeministri Zaev në konferencë për Marrëveshjen me Greqinë në ASHAM: Kemi një marrëveshje dinjitoze që garanton identitetin dhe ardhmërinë tonë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 11.09.2018, linku në dispozicion: <https://vlada.mk/node/15427?ln=sq>, (17.08.2020).

BE-së. Një dekadë në pritje përpara dyerve të Brukselit, duke i lënë jashtë BE-së, Ballkanin Perëndimor si dhe Turqinë edhe një dekadë, ajo do të thoshte pasoja serioze të sigurisë dhe stabilitetit evropian.³⁶² Përkaj tre lodhjeve të BE-së, e para me zgjerimin (2004-2007), e dyta me atë institucional (2005-2009) dhe e treta me atë financiar (2018), duhet të ketë parasysh BE se euroskepticizmi rritet çdo vjet në vendet aspirante, dhe mbi bazën e tij krijohet një lodhje e re: lodhje nga angazhimi ose lodhje nga përmbushja pa përparim drejt antarësimit në BE.³⁶³

Qytetarët e RMV-së në përgjithësi ishin optimistë, të cilët pritnin se Këshilli Evropian do t'i jap dritë të gjelbërt RMV-së për negociata, kurse më shumë se gjysma e qytetarëve pritnin që të bëhen anëtarë të barabartë për 10 vitet e ardhshme, që është një rënie e 12% nga pritjet që ato i kanë pasur më herët. Ajo që nuk kanë pësuar ndryshim është mbështetja e lartë e qytetarëve për anëtarësim në BE, nëse nesër do të kishte referendum, 65,9% do të votonin "PËR". Anketat tregojnë edhe dallime të mëdha për mbështetjen e BE-së në baza partiake dhe etnike. Te shqiptarët kjo mbështetje është rreth 90%, përderisa te maqedonasit është 30% më e vogël. Sipas Lubço Petkovskit, dallimi i detyrohet antagonizmit të partive politike të bllokut maqedonas. Mbështetja nga LSDM për BE-në është 70%, ndërsa te VMRO-DPMNE është 35,9%.³⁶⁴ Pra, edhe mbështetja si dhe kritikët ndaj Marrëveshjes së Prespës duhet gjykuar në bazë të këtyre numrave, duke pasur parasysh se ajo sjell edhe integrimin e RMV-së në strukturat evro-atlantike. Siç shihet, LSDM është e qartë e orientuar drejt këtyre strukturave, ndërsa te VMRO-ja ka luhatje dhe kjo përqindje është shumë e vogël, ndërsa te shqiptarët është e pakontestuar, mbështetja e tyre për BE-në gjithmonë ka rezultuar shumë e lartë.

Në shkurt 2018, Komisioni Evropian publikoi komunikatë me çka i definoi themelet e "perspektivës kredibile të zgjerimit".³⁶⁵ Me drejtim të drejtpërdrejtë, Komisioni i thirri liderët e shteteve ballkanike për: mungesë të demokracisë dhe lirive themelore, sundimi i së drejtës dhe

³⁶² Река, Блерим, Проширувањето на ЕУ во Западен Балкан во новиот геополитички контекст, Република Македонија на патот кон Европската Унија (2020) – искуства, предизвици, перспективи, прилози од меѓународната научна конференција одржана на 6 мај 2016 година, Македонска академија на науките и уметностите, Секретаријат за европски прашања, Влада на Република Македонија, Скопје, 2016, стр. 49, 50.

³⁶³ По ату, fq. 50.

³⁶⁴ Анкета на Евротинк: Висока поддршка за ЕУ, но намален оптимизам за брзо членство, ТЕЛМА, 15 октомври 2019, linku në dispozicion: <https://arhiva.telma.com.mk/anketa-na-evrotink-visoka-poddrshka-za-eu-no-namalen-optimizam-za-brzo-chlenstvo/>, (17.08.2020).

³⁶⁵ Грикур, Себастиен, Северна Македонија: Вести за запад, Предизвици, Списание за општествени прашања, Пост-Преспанска Северна Македонија и предизборна Европа, број I, 03/2019, Friedrich Ebert Stiftung, стр. 28, cituar sipas: https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspect-western-balkans_en.pdf.

lufta e pamjaftueshme kundër korrupsionit dhe krimi i organizuar. Dokumenti strategjik paraqet kthim të rëndësishëm në kthimin e interesit evropian në Ballkanin Perëndimor. E saktë është se në masë të madhe ka qenë i motivuar nga konstatimi se ndikimi evropian është i rrezikuar në këto hapësira, në kohën kur vetë BE lufton me shumë sfida: çështja legjitime e BE-së (BREXIT), rritja ekonomike dhe papunësia masive, migracioni, terrorizmi, Rusia, Turqia, Kina. Të gjitha këto çështje fokusohen në dobësitë e kohezionit evropian, mos t'i përmendim goditjet mbi autoritetin e saj nga vet vendet anëtare, disa prej tyre nga Ballkani Perëndimor, kundër themeleve të vlerave të projektit evropian.³⁶⁶ Plani 3-6-9, i cili filloi në korrik 2017, nga ana e kryeministrit Zaev, vetëm dy muaj pas tensioneve ekstreme politike, fillimisht ishte i përkushtuar për kthim të vendit në rrugën e reformave, me kalim të dukshëm dhe të përgjegjshëm të standardeve tremujore të përcaktuara. Analistët me të drejtë mund të theksojnë se prej 130 aktiviteteve të planit, vetëm 12% do t'i mbulonin masat e programit nacional për ligjvënien në BE për 2016-2017 ose së paku 51% do të silleshin në reformat urgjente prioritare dhe udhëzimet e grupës së lartë të ekspertëve të sistemit të sundimit të së drejtës.³⁶⁷

Marrëveshja e Prespës e 17 korrikut i lidhur pas një të katërtën e shekullit me ndërmjetësimin e OKB-së, e zgjidhi kontestin rreth emrit me Greqinë dhe i hapi rrugën bashkëpunimit strategjik dhe multisektorial mes dy vendeve. Por, ky rezultat diplomatik nuk ishte kriter që arriti ta ndryshon mënyrën e mendimit të liderëve aktual evropian, veçanërisht atij francez, të cilët e kundërshtonin hapjen e negociatave me BE-në në të ardhmen e afërt. Suksesi apo mospuksesi i referendumit nuk ishte aspak lëndë bregosëse, për fat të keq, edhe pse dihej se vendimi i Këshillit Evropian, referendumin e ekspozoi në rrezik për mospukses. Përgjigja negative e BE-së në njëfarë mënyre ishte i kompenzuar me samitin e NATO-s në Bruksel, më 11 Korrik 2018, në të cilën Aleanca zyrtarisht e thirri Shkupin që t'i fillojë negociatat për hyrje. Kjo perspektivë, drejtpërdrejtë varet nga ratifikimi i Marrëveshjes së Prespës në Shkup pas referendumit dhe në Athinë nga ana e Parlamentit, mundeshte të paraqesë motiv të mjaftueshëm për votim të referendumit. Në raport me BE-në, qeveria është plotësisht e vetëdijshme se përpjeket e saj të dyfishta në fushat e sundimit të së drejtës janë garancioni i

³⁶⁶ Грикур, Себастиен, Северна Македонија: Вести за запад, Предизвици, Списание за општествени прашања, Пост-Преспанска Северна Македонија и предизборна Европа, број 1, 03/2019, Friedrich Ebert Stiftung, стр. 28.

³⁶⁷ По ату, fq. 30, cituar sipas: Пречки на 3, 6 и 9: препорката е обезбедена што следното? „Институтот за демократија Societas Civilis и Фондацијата „Конрад Аденауер,, мај 2018 година.

vetëm që mund ta ofrojë. Kjo është domethënia e planit 18, i cili me theks të veçantë në mungesat e fushave të planit paraprak, e përgatit Maqedoninë e Veriut për hapjen e kapitullit 23 dhe 24. Mirëpo, Maqedonia e Veriut i përkushtuar në të drejtat fundamentale, në drejtësi dhe siguri, u ballafaqua me një proces të rëndë. Shtyrja e vendimit të BE-së për hapjen e negociatave me Shkupin nuk duhet të kërkohet në mungesën e pranimin nga ana e Brukselit për përpjekjet e Qeverisë së Zaevit. Por, para së të flasim për këto ngjarje në vitin 2018, t'i kthehemi Francës. Në fund të konfliktit të armatosur në territorin e Ish Jugosllavisë, kur Republika e Maqedonisë së Veriut kishte dy përfaqësues të njëpasnjëshëm special të BE-së në Shkup, në vitin 2001 dhe 2002, Franca i lejoi Gjermanisë ta merr rolin e promotorit kryesor për integrimin evro-atlantik të shteteve ballkanike. Kjo domethënë se krejt dekada në Paris e ka fokusuar vëmendjen e saj në këto shtete vetëm në raport të mbajtjes së stabilitetit të tyre ose përmes mbështetjeve të proceseve politike pa asnjë lloj iniciative të vetën. Madje, kur socialistët erdhën në pushtet, vërehej interes i ri multisektorial për bashkëpunim.³⁶⁸ Ashtu që, rezistenca e kryetarit të Republikës së Francës, Emanuel Makron, drejt hapjes së negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, u paraqitën si një ndërprerje e para ringjalljes së ndikimit francez në Ballkan, më saktë, ndikimi i tij negativ. Kjo rezistencë dukej edhe më armiqësor, për shkak se ishte në kundërshtim me vërejtjet e tij dhe me fjalët e shumë vlerësuar “Iniciativa për Evropën”, që e mbajti në Universitetin e Sorbonës, më 26 Shtator 2017. Arsyetimi i kryetarit francez tingëllonte, para së gjithash, jo i sigurtë në raport me realitetin e procesit për hyrjen e vendeve kandidate. Kur thotë se nuk do të ketë “hapje të pakushtë të negociatave”, ai bëhet se nuk e di se kushtet janë vetë natyrë e kreut të procesit për hyrje. Në këtë kuptim, shtetet e merituar të Ballkanit Perëndimor nuk kanë nevojë përsëri të dëgjojnë premtimet e vitit 2003, por të jenë të motivuara përmes pranimin të përpjekjeve që i bëjnë në vazhdimësi.³⁶⁹ Nga kjo, u pa se edhe përkaj pozitës franceze, e cila ishte e motivuar më tepër nga pozita nacionale e saj se sa evropiane, u vërtetua thënia se Evropa përparon vetëm kur funksionojnë palët franko-gjermane.³⁷⁰ Megjithatë, Maqedonia e Veriut nuk duhet të dëshpërohet në aspekt se, përse ata e nënshkruan atëherë Marrëveshjen e Prespës, ndërsa BE nuk po tregon gatishmëri për

³⁶⁸ Грикур, Себастиен, Северна Македонија: Вести за запад, Предизвици, Списание за општествени прашања, Пост-Преспанска Северна Македонија и предизборна Европа, број 1, 03/2019, Friedrich Ebert Stiftung, стр. 30, 31.

³⁶⁹ По ату, fq. 32;

³⁷⁰ По ату, fq. 33.

anëtarësimin e saj në strukturat e BE-së. Por, ja që frutat e para të kësaj marrëveshjeje u realizuan, ajo u anëtarësua në NATO, e cila i parapriu politika e re e fqinjësisë së saj, veçanërisht përmes marrëveshjes me Bullgarinë dhe Greqinë. Këta fqinj, me të cilët kemi pasur marrëdhënie të rrënuara me dekada, tani kanë qenë të parët që e ratifikuan Protokollin për hyrjen tonë në NATO, kurse pas tyre nuk mbetën as të tjerët: Shqipëria, Sllovenia, Kroacia, Rumania, Mali i Zi, etj. Këto reagime të fqinjve tanë nuk mundën ndryshe të interpretohen pos si miqësi dhe fqinjësi e mirë të cilët janë kurora e kursit të ri të politikës së jashtme që i filloi Qeveria t'i praktikojë dhe ajo është në vend të armiqësive, të krijojmë miqësi në rajon.³⁷¹

Pavarësisht angazhimit të RMV-së në drejtim të përmbushjeve të standardeve evropiane, ishte e qartë se ajo asnjëherë nuk do të pranohej aty, përderisa ishte aty Greqia e cila e përdorte të drejtën e vetos ndaj anëtarësimi të RMV-së në këtë organizatë, si pasojë e kontestimit të çështjes së emrit kushtetues së saj. Andaj, BE këtë e thoshte hapur, se Maqedonia duhet të angazhohet në normalizimin e marrëdhënieve me Greqinë dhe se duhej ndryshuar emrin. Kështu pati deklaruar edhe Junker së bashku me Johanes Hanin, të cilët gjatë një vizite në Maqedoni bënë thirrje që Shkupi ta zgjidh çështjen e emrit me Athinën duke i theksuar reformat e ndërmarra nga Qeveria Zaev të cilët e habitën botën duke arritur marrëveshje me Bullgarinë, me çka u rrit reputacioni i RMV-së. Ndërsa sa i përket çështjes së emrit, Junker theksoi se ajo ngelet çështje e vet shtetit e cila duhet ta zgjidh këtë problem.³⁷² Edhe Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, në një letër drejtuar zyrtarisht kryetarit maqedonas, Gjorge Ivanov me rastin e Ditës së Pavarësisë së Maqedonisë, 8 shtatorit, theksoi se shtetit maqedonas një nga kushtet e cila mund t'i hapë rrugë drejt antarësimit në NATO si dhe çeljen e negociatave me BE është Marrëveshja e Prespës, pra zgjidhja e konfliktit me Greqinë në lidhje me emrin. Andaj, edhe kjo letër nga Trump erdhi pikërisht para referendumit që duhej mbajtur mbi Marrëveshjen e Prespës më 30 Shtator 2018, ku qytetarët e Maqedonisë duhej të shpreheshin nëse bien dakord që Maqedonia të ndryshojë emrin në Republika e Maqedonisë së Veriut.³⁷³ Ministri i shtetit gjerman për Evropën, Micheal Roth në takimin që kishte patur me kryeministrin Zoran

³⁷¹ Грикур, Себастиен, Северна Македонија: Вести за запад, Предизвици, Списание за општествени прашања, Пост-Преспанска Северна Македонија и предизборна Европа, број I, 03/2019, Friedrich Ebert Stiftung, стр. 43.

³⁷² Junker në Maqedoni: Zgjidhni çështjen e emrit, ABC News, 25 Shkurt 2018, linku në dispozicion: <https://abcnews.al/junker-ne-maqedoni-zgjidhni-ceshtjen-e-emrit/>, (18.08.2020).

³⁷³ Kushti për anëtarësim, Trump-Maqedonisë, zgjidhni emrin pastaj negociatat, Konica, 06.09.2018, linku në dispozicion: <https://konica.al/2018/09/trump-maqedonise-zgjidhni-emrin-pastaj-negociatat/>, (18.08.2020).

Zaev, e përcolli porosinë se ajo atë vitë duhej ta zgjidh kontestin e emrit, ose përndryshe status-quo-ja do të zgjas. Ai apeloj që asnjëra prej palëve të mos shpejtonte me shënimin e vijave të kuqe. Por, me vullnet mund të merren vesh për kompromis të pranueshëm.³⁷⁴

Fryma e Marrëveshjes së Prespës e përshkon pakon e përgjithshme të zgjerimit. Nga njëra anë, kjo është një njohje për vendimet e vështira politike dhe për përcaktimin e qartë të vendit tonë në rrugën drejt BE-së. Nga ana tjetër, kjo marrëveshje është një mundësi që të jetësohet politika edhe ashtu e brishtë për kushtëzimin përmes ruajtjes së momentit pozitiv që krijohet në rajon, por edhe më gjerë. Aq më tepër, BE u testua si për strategjinë e tij për Ballkanin Perëndimor dhe për kredibilitetin e tij, i cili në masë të madhe varej edhe nga realizimi i politikës rigoroze por të drejtë, si dhe aplikimi i parimit të meritës së vendeve gjatë vlerësimit të arritjeve të tyre dhe para së gjithash, për fillimin e negociatave me vendin tonë.³⁷⁵

Puna e Qeverisë me kapacitet të plotë, në fushat prioritare të theksuara në konkluzionet e vitit të kaluar të Këshillit nuk kaloi pa u vërejtur. Në raport theksohet kultura e kompromiseve, synimi drejt bashkëpunimit me të gjitha protagonistët kryesor, duke e përfshirë opozitën dhe shoqërinë civile në mënyrë inkluzive dhe transparente. Nga ana tjetër, merren parasysh angazhimet për bashkimin/pajtimin e shoqërisë dhe ruajtjen e karakterit multietnik përmes përfshirjes së MKO në preambulën e Kushtetutës. Progresi në sundimin e së drejtës, kriteret politike si dhe Kapitulli 23 - për jurisprudencë dhe të drejtat themelore dhe Kapitulli 24 – drejtësi, liri dhe siguri, në shumicën e fushave është vlerësuar si “i mirë”, në disa fusha të tjera “progres i caktuar”. Në krahasim me të gjitha shtetet e rajonit, progresi në sundimin e së drejtës është vlerësuar më së miri. Edhe sa i përket nivelit të përgatitjes, Maqedonia e Veriut nuk mbetet pas shteteve të cilat tanimë janë në procesin e negociatave, siç është Mali i Zi dhe Serbia.³⁷⁶

Në këtë raport, titulli i kapitullit “Çështje rajonale dhe obligime ndërkombëtare” u ndryshua në “Marrëdhënie të mira fqinjësore dhe bashkëpunim rajonal”. Me këtë bëhet përpjekje që të lidhen iniciativat edhe ashtu të fragmentuara të Komisionit, siç janë raportet,

³⁷⁴ Ministri gjerman: Sivjet zgjidhni emrin, në të kundërtën..., FJALA, 10.05.2018, linku në dispozicion: <http://www.fjala.mk/2018/05/ministri-gjerman-sivjet-zgjidhni-emrin-ne-te-kunderten/>, (18.08.2020).

³⁷⁵ Rekomandimi i pakontestueshëm, data e pasigurtë, Koment në lidhje me Raportin e Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut nga data 29 majt të vitit 2019, Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, 30 Maj 2019, fq. 4.

³⁷⁶ Po aty, fq. 5.

strategjia për Ballkanin Perëndimor (6-të iniciativat) dhe procesi i Berlinit. Me zgjidhjen e kontestit me Greqinë dhe me Marrëveshjen bilaterale me Bullgarinë, vendi ynë u bë vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor i cili nuk ka konteste bilaterale. Me këtë, Maqedonia e Veriut bëhet shembulli për pajtim të cilin duhet të ndjekin edhe vendet tjera të rajonit gjatë zgjidhjes dhe mbylljes së kontesteve bilaterale. Ky progres e konfirmon edhe fuqinë e BE-së, për tërheqje përmes perspektivës evropiane, kur ka vullnet politik.³⁷⁷ Për shkak të hapit të madh të ndërmarrë të Maqedonisë së Veriut në planin e brendshëm dhe “arritjet historike” në planin e jashtëm, sipas Komisionit, negociatat aderuese me Maqedoninë e Veriut duhet të hapen tani. Çdo përpjekje që të mos realizohet premtimi i BE-së e dobëson stabilitetin dhe e dekurajon ndërmarrjen e reformave serioze. Sipas KE-së, nëse Maqedonisë së Veriut nuk i hapet drita e gjelbërt për hapjen e negociatave, atëherë BE rrezikon ta humbas kredibilitetin në rajon dhe më gjerë, përfshirë këtu edhe potencialin e saj të ndikojë në zgjidhjen e kontesteve të hapura, siç është dialogu Beograd-Prishtinë. Komisioni Evropian e vendos edhe në kontekst më të gjerë mospasurinë eventuale të BE-së që të përcaktojë datë për negociatat për vendin tonë, duke i vënë në dukje konsekuencat e mundshme gjeopolitike, përkatësisht se mungesa e përgjigjes së qartë nga BE mund të aktivizojë spirale të mbështetjeve që “konkurrentët gjeopolitikë të strehohen në pragun e Evropës.”³⁷⁸

Shqetësuese është vetëdija e ulët e shteteve anëtare të BE-së, sidomos e Francës, në rastet e mospërmbushjes së obligimeve nga ana e tyre të ndërmarrura ndaj Maqedonisë së Veriut për pasojat e mundshme që mund të ndodhin në rajon, madje edhe më gjerë.³⁷⁹ Kështu, Franca për dallim nga Gjermania, tregoi se BE e cila është larg bllokut të sigurt i cili mund të ballafaqohet me shumicën e sfidave, frikësohet se shtetet e vogla ballkanike, do të kishin mundur të rrënojnë projektin e BE-së. Presidenti francez, Emanuel Makron, i cili në skenë doli me premtimin për udhëheqje më të mirë me vizion për Evropë të bashkuar dhe për të mposhtur populizmin si kauzë më e madhe, në kundërshtim me fjalimin e tij në Sorbonë, theksoi se zgjerimi do të “dobësojë Evropën”. BE-ja, tregoi se nuk është në gjendje të plotësojë premtimet e dhëna para pothuajse dy dekadave në Selanik dhe vendosi të mos shtiret më. Jo vetëm që

³⁷⁷ Rekomandimi i pakontestueshëm, data e pasigurtë, Koment në lidhje me Raportin e Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut nga data 29 majt të vitit 2019, Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, 30 Maj 2019, fq. 7.

³⁷⁸ Po aty, fq. 10.

³⁷⁹ Po aty, fq. 10.

lejoj Serbia, ditë pas dite të bëhet gjithnjë e më afër orbitës së Kremlinit, por BE-ja tregoi edhe atë se rolin që e kishin në arritjen përfundimtare të zgjidhjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, është më i dobët se kurdoqoftë deri më tani.³⁸⁰

Pasojat e mundshme që mund të paraqiten për shtetin tonë nëse nuk përkrahet integrimi i RMV-së në BE, mund të ndikojë në motivim të ulët për reforma, nxitje klimës për ndarje politike, madje edhe krizë e mundshme politike. Gjithsesi se përforcimi i debatit rreth asaj se a ia vlente “sakrifica” e bërë me Marrëveshjen e Prespës do të dominoj në diskursin publik, me ç’rast seriozisht do të rrënohet vullneti dhe angazhimi jo vetëm i Qeverisë, por edhe të të gjitha forcave të cilët e mbështesin Marrëveshjen e Prespës. Pastaj, rreziku është real nga humbja e plotë e besimit në procesin e zgjerimit dhe në parimet e tij. Për shkak të këtyre rreziqeve, ndërsa pavarësisht të njëjtave, Qeveria duhet t’i vazhdojë impenjimet diplomatike të udhëzuara mirë dhe të vazhdojë me reformat, po në kuadër të strategjisë qartësisht të përcaktuar me prioritete qartësisht të inkorporuara nacionale.³⁸¹

Në periudhën e ardhshme gjashtëmujore anëtari më i ri i BE-së do të duhet të merret me tre probleme serioze të BE-së, edhe atë: dalja e Britanisë, miratimi i buxhetit afatgjatë 2021-2027 dhe zhbllokimin e procesit integruar të vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilët do të shkaktojnë dridhje brenda BE-së që mund ta ngadalësojnë zhvillimin ekonomik dhe zgjerimin me vende të reja, pasi që dalja e Britanisë lë një boshllëk prej 13 miliardë euro në arkat e BE-së. Shpresojmë që Kroacia të ketë një angazhim më të shtuar me qëllim të sanohen pasojat e vetos së pamertuar franceze ndaj Shkupit dhe Tiranës, e cila u përdor nga presidenti francez, Emanuel Makron në Samitin e Këshillit Evropian në tetor të vitit 2019. Kjo veto shkaktoi ndërprerjen e mandatit të Qeverisë së udhëhequr nga Zoran Zaev, e cila nënshkroi marrëveshjet me Bullgarinë dhe me Greqinë që përmbajnë kompromise të rënda dhe ngadalësoi reformat e sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Njëkohësisht, Franca demotivoi edhe qeveritë në Prishtinë dhe Beograd që të ndjekin rrugën e Maqedonisë së Veriut dhe kështu të zgjidhin çështjen e

³⁸⁰ Селими, Сабин, ЕУ постојано ги разочарува Балканските земји, Respublica, 26 февруари 2020, линку në dispozicion: <https://respublica.edu.mk/mk/blog/2020-02-26-09-21-23>, (18.08.2020).

³⁸¹ Rekomandimi i pakontestueshëm, data e pasigurtë, Koment në lidhje me Raportin e Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut nga data 29 majt të vitit 2019, Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, 30 Maj 2019, fq. 10.

madhe historike midis këtyre dy shteteve, pajtimin dhe njohjen e ndërsjellë.³⁸² Por, këtë vit, rekomandimet për fillimin e negociatave u realizuan, janë “më të pastra”, “të qarta si kristali”, pa kushte plotësuese, nuk ka pengesa dhe ka frymë shumë pozitive. Këtë vit, vendi ynë apostrofohet si shembull për hapat e ndërmarrë pozitiv dhe progresin përmes kriterëve kyçe për antarësim. Megjithatë, qasja e këtyre nuk do të thotë se obligimet tona janë plotësuar, por na vë në një shteg akoma më të vështirë për ruajtjen e imazhit pozitiv përmes reformave më të qëndrueshme për çështjet kyçe të pasqyruara në qasjen “fillimisht bazat” dhe gjashtë iniciativat e strategjisë për BP.³⁸³

4.5. Ecja përpara përtej konfrontimit, bashkëpunimi midis RMV-së dhe Republikës së Greqisë nën frymën e Marrëveshjes së Prespës

Ish kryeministri grek, Aleksis Ciprasi është krahasuar me Vili Brandin gjerman, ose a mundet kjo figurë politike të bëhet Vili Brandi i ardhshëm i politikës paqësore ballkanike? Vizita historike e tij në Shkup, ishte njëra ndër sinjalet në atë drejtim, në të cilën ai e kishte edhe mbështetjen evropiane. Atëherë u duk se ky majtist i ri grek dhe i guximshëm, pragmatik, ka potencial por edhe konstelacion të favorshëm politik të nisur në gjurmët e paqes së madhe evropiane si Vili Brandi. Social-demokrati, Vili Brand më 1970, mes Luftës së Ftohtë, u tregua i guximshëm të fillojë me një politikë përafruese dhe miqësore me Federatën Sovjetike dhe me vendet e bllokut lindor, por para së gjithash me GRD dhe me Poloninë. Vili Brandi dhe bashkëpunëtorët më i afërt i tij në atë projekt, socialdemokrati, Egon Bar atë ide e punuan që nga viti 1963 duke e qujtuar “ndryshim përmes përafrimit”. Atëherë lindja komuniste për gjermanët konservativ dhe nacionalistë përbënte vetëm një “teren armiqësor”. Për atë askush nuk besonte në suksesin e përpjekjeve të Vili Brandit. Përkundrazi, ai nga konservatorët ka qenë i stigmatizuar si tradhtar i interesave gjermane. Historia tregon se intuita e Vili Brandit ka qenë e drejtë. Ajo përfundimisht, i solli atij edhe Çmimin Nobel për paqe, edhe pse, koalicioni i udhëhequr nga ai shkurtë pas asaj, e humbi pushtetin. Ky tregim, i ngjan pak pozitës së ish kryeministrit Aleksis Cipras, i cili u gjend pas Marrëveshjes së Prespës. Në vazhden e kulminacionit të nacionalizmit të të dyja vendeve, ai së bashku me homologun e tij maqedonas,

³⁸² Neziri, Xhelal, Shpresa në Shkup e Tiranë: Çfarë mund të sjellë kryesimi i Kroacisë me BE-në?, Klubi i debatit politik, 17 Janar 2020, linku në dispozicion: <https://kdpolitik.com/2020/01/17/shpresa-ne-shkup-e-tirane-cfare-mund-te-sjelle-kryesimi-i-kroacise-me-be-ne/>, (18.08.2020).

³⁸³ Rekomandimi i pakontestueshëm, data e pasigurtë, Koment në lidhje me Raportin e Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut nga data 29 majt të vitit 2019, Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, 30 Maj 2019, fq. 4.

guxoi të bëjë kompromis. Ai vendim është plotësisht në frymën e politikës paqësore evropiane. Por, Ciprasi në të vërtetë a ka potencial që të jetë paqësor i madh, kjo do t'i ngelet kohës, ose do të tregojë historia.³⁸⁴

Marrëveshja e Prespës është shansë dhe mundësi. A do të inkurajojë në të vërtetë procesin serioz dhe afatgjatë për tejkalimin e padurimit dhe fiksimeve nacionaliste të popujve të ballkanit, para së gjithash kjo do të varet nga palët nënshkruese në të ardhmen, e sidomos nga mençuria e politikanëve të tyre. Sot ajo e ka mbështetjen e të gjithë opinionit demokratik evropian, veçanërisht kur dy tre vitet e fundit në një numër të madh vendesh anëtare të politikës evropiane filloj të forcohet nacionalizmi dhe kthimi i nacionalistëve të ngushtë, në vend të interesave të përbashkëta evropiane, Marrëveshja e Prespës i rikujtoi popujt evropianë në optimizmin e kohës kur Evropa pas Luftës së Dytë Botërore, me përkushtim të madh kërkonte rrugë për qetësi mes popujve si garancion për paqe afagjate. Bashkimi i Evropës, para së gjithash, është projekt për ndërtimin e paqes. Akoma e kaluara e patejkaluar e luftërave post jugosllave të Ballkanit do të duhej edhe më fuqishëm të inkurajojë procesin brenda ballkanik të qetësimit pas modelit të atij që njëherë në Evropë me sukses e përfundoi De Gol, Adenauer, Branti dhe shumë politikanë të tjerë. Për atë nuk është e çuditshme që pikërisht shtypi gjerman shpesh e theksonte se do të ishte e favorshme për gjithë opinionin evropian kur më shumë politikanë në Evropë dhe sot në Ballkan do të shiqoheshin te Vili Branti.³⁸⁵

Megjithatë, RMV me Marrëveshjen e Prespës hapi faqen e re të politikës së ardhshme të paqes dhe bashkëpunimit të Ballkanit. Ish kryeministri grek Aleksis Cipras, udhëtoi për herë të parë në takimin e parë zyrtar në RMV. Sesa historike është dimensionin i këtij takimi bëhet e qartë vetëm nëse njihet historia e Ballkanit. Nëse vendoset takimi i Ciprasit në Shkup në kontekst historik, bëhet e qartë se me atë akt protokollar në dukje tejkalohej stagnimi me decenie i marrëdhënieve të të dyja vendeve fqinje. Ai akt është në të vërtetë historia e re e Ballkanit. Atë nuk mund ta vërejnë kundërshtarët e Marrëveshjes së Prespës. Për shkak se eto ende janë të varrosur në frymën e Luftërave Ballkanike, në frymën e Luftës së Ftohtë. Në botën

³⁸⁴ Колбе, Кица, Алексис Ципрас – идниот Вили Брант на Балканот?, DW, 01.04.2019, linku në dispozicion: [https://www.dw.com/mk/%D0%B0%D0%BB%D0%B5%D0%BA%D1%81%D0%B8%D1%81-%D1%86%D0%B8%D0%BF%D1%80%D0%B0%D1%81-%D0%B8%D0%B4%D0%BD%D0%B8%D0%BE%D1%82-%D0%B2%D0%B8%D0%BB%D0%B8-%D0%B1%D1%80%D0%B0%D0%BD%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D0%B1%D0%B0%D0%BB%D0%BA%D0%B0%D0%BD%D0%BE%D1%82/a-48144055, \(20.08.2020\).](https://www.dw.com/mk/%D0%B0%D0%BB%D0%B5%D0%BA%D1%81%D0%B8%D1%81-%D1%86%D0%B8%D0%BF%D1%80%D0%B0%D1%81-%D0%B8%D0%B4%D0%BD%D0%B8%D0%BE%D1%82-%D0%B2%D0%B8%D0%BB%D0%B8-%D0%B1%D1%80%D0%B0%D0%BD%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D0%B1%D0%B0%D0%BB%D0%BA%D0%B0%D0%BD%D0%BE%D1%82/a-48144055, (20.08.2020).)

³⁸⁵ По аты.

e sotme nuk ka vend për ëndërra të bashkimit nacional, për shtete të mëdha ose të vogla nacionale. Sot ka vetëm një rrugë drejtë atij qëllimi e ajo është Bashkimi Evropian.³⁸⁶

Takimi i parë zyrtar i kryeministrit grek në RMV, prej më përpara e fitoi epitetin “historik”, si rezultat i marrëveshjes, që të dyja palët patën guxim dhe vizion ta zgjidhin kontestin tre dekadësh me emrin, me çka hapën horizonte të reja për fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim mes dy vendeve. Ciprasi erdhi në shoqërim të dhjetë ministrave grek të cilët nënshkruan një sërë marrëveshjesh për bashkëpunim në fusha të ndryshme – ekonomi, energjetik, mbrojtje, politikë të jashtme, infrastrukturë, transport, bujqësi, politikë digjitale dhe shëndetësi³⁸⁷ konform dispozitave të parapara për intensifikimin dhe pasurimin e bashkëpunimit ndërmjet dy palëve.³⁸⁸ Aleksis Ciprasi theksojë se ata kanë përgjegjësi që të tregojnë se popujt e tyre mund vetëm të fitojnë nga rruga që është hapur me zgjidhjen e çështjes së kontestit. Përgjegjësi kanë ata edhe që t’ju përgjigjen forcave të nacionalizmit që në botën e sotme po përforcohen dhe synojnë drejt asaj që mos të kthehen pësëri në kohërat e errëta.³⁸⁹

Marrëveshja e Prespës duhet të jep kurajo edhe më të madhe të të dyja vendeve, edhe pse biznesmenët grek moti janë aktiv në shtetin e tyre fqinj, por kjo marrëveshje duhet t’ju jep kurajo shtesë, si p.sh. ajo e nënshkrimit të marrëveshjes që aviokompania greke “Ejxhian erlajns” për herë të parë vendosi fluturime direkte nga Athina për në Shkup. Gazeta qeveritare “Etnos” ka paraparë aterim të ri në Shkup, para saj mendohet për më shumë se 50 biznesmenë dhe investitorë potencial nga Greqia të cilët e shoqëruan kryeministrin Cipras në udhëtimin e tij në Maqedoninë e Veriut. Përsëri, ka pasur edhe tërheqje. Në shenjë të protestës kundër kompromisit në kontestin me emrin, shefi i shoqatës tregtare të Selanikut, Mihalis Zorpidis,

³⁸⁶ Колбе, Кица, Алексис Ципрас – идниот Вили Брант на Балканот?, DW, 01.04.2019, linku në dispozicion: <https://www.dw.com/mk/%D0%B0%D0%BB%D0%B5%D0%BA%D1%81%D0%B8%D1%81-%D1%86%D0%B8%D0%BF%D1%80%D0%B0%D1%81-%D0%B8%D0%B4%D0%BD%D0%B8%D0%BE%D1%82-%D0%B2%D0%B8%D0%BB%D0%B8-%D0%B1%D1%80%D0%B0%D0%BD%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D0%B1%D0%B0%D0%BB%D0%BA%D0%B0%D0%BD%D0%BE%D1%82/a-48144055>, (20.08.2020).

³⁸⁷ Добредојде за Ципрас и новите односи Скопје-Атина, DW, 02.04.2019, linku në dispozicion: <https://www.dw.com/mk/%D0%B4%D0%BE%D0%B1%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D1%98%D0%B4%D0%B5-%D0%B7%D0%B0-%D1%86%D0%B8%D0%BF%D1%80%D0%B0%D1%81-%D0%B8-%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%BE%D0%B4%D0%BD%D0%BE%D1%81%D0%B8-%D1%81%D0%BA%D0%BE%D0%BF%D1%98%D0%B5-%D0%B0%D1%82%D0%B8%D0%BD%D0%B0/a-48157578>, (20.08.2020).

³⁸⁸ Për më tepër shih: Final agreement for the settlement of the differences as described in the United Nations Security Council Resolution 817 (1993) and 845 (1993), the termination of the Interim Accord of 1995, and the establishment of a strategic partnership between the parties, Article 9.

³⁸⁹ Добредојде за Ципрас и новите односи Скопје-Атина, DW, 02.04.2019.

refuzoi të jetë pjesë e delegacionit të Ciprasit, shkaku “emri i Maqedonisë është i shenjtë për ne dhe do të bëjmë gjithçka që mundemi që ta mbrojmë atë”, thuhet në njoftimin e komorës tregtare.³⁹⁰

Sidoqoftë, Marrëveshja e Prespës e ndryshoi realitetin mes dy vendeve. Kryeministrat e dy shteteve morrën pjesë gjithashtu edhe në një debat kushtuar përfitimeve të Marrëveshjes së Prespës i organizuar nga magazina “Economist”. Deri sa zhvillohej takimi Zaev-Cipras në ndërtesën qeveritare qindra njerëz kanë protestuar në Shkup kundër ndryshimit të emrit në përvjetorin e mbajtjes së referendumit. Në intervistën për emisionin 360 shkallë, Cipras e vlerësoi si “krim” për atë që është bërë në marrëdhëniet midis dy vendeve përgjatë 25 viteve të kaluara. “Ne jemi dy shtete fqinj, nuk kemi çfarë të ndajmë, do të ishte krim nëse do të na jepej mundësia para 25 viteve dhe unë së bashku me Zoranin në vend se ta zgjidhim problemin, atë mundësi ta gjuajmë në mbeturina. Do të ishte krim për shkak se do ta përmbysnim Maqedoninë e Veriut në destabilizim, do të ndodhin situata destabilizuese në tërë rajonin”. Gjatë bisedës, Cipras pranon se ka pasur momenti kur ai dhe Zaevi kanë qenë në buzë që të tërhiqen nga Marrëveshja, kur i kanë gjuajtur stilolapsat dhe kanë thënë se nuk munden të gjejnë gjuhë të përbashkët. Por, në ato raste siç thotë Cipras, “mbizotëroi logjika”.³⁹¹

Ndërmjetësuesi i kontestit të emrit mes Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë thekson se ata të cilët kanë qenë drejtpërdrejtë të kyçur në proces, mund të kuptonin se bëhet fjalë për çështje që prek në bërthamën e identitetit dhe ndjenjës nacionale të sigurisë së të prekurve. “Zgjidhja e kontestit për emrin mes Greqisë dhe fqinjit të saj verior ka krijuar një mundësi të re të rëndësishme për marrëdhëniet më konstruktive dhe për një Ballkan më të sigurtë. Marrëveshja e Prespës i nënshkruar në bregun e liqenit të Prespës, e cila i ndan të dyja shtetet

³⁹⁰ Ципрас во историска државна посета кај поранешниот државен непријател, DW, 01.04.2019, linku në dispozicion: [³⁹¹Ципрас во Скопје на годишнината од референдумот, DW, 30.09.2019, linku në dispozicion: \[177\]\(https://www.dw.com/mk/%D1%86%D0%B8%D0%BF%D1%80%D0%B0%D1%81-%D0%B2%D0%BE-%D1%81%D0%BA%D0%BE%D0%BF%D1%98%D0%B5-%D0%BD%D0%B0-%D0%B3%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D1%88%D0%BD%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%BE%D0%B4-%D1%80%D0%B5%D1%84%D0%B5%D1%80%D0%B5%D0%BD%D0%B4%D1%83%D0%BC%D0%BE%D1%82/a-50651214, \(20.08.2020\).</p></div><div data-bbox=\)](https://www.dw.com/mk/%D1%86%D0%B8%D0%BF%D1%80%D0%B0%D1%81-%D0%B2%D0%BE-%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%BE%D1%80%D0%B8%D1%81%D0%BA%D0%B0-%D0%B4%D1%80%D0%B6%D0%B0%D0%B2%D0%BD%D0%B0-%D0%BF%D0%BE%D1%81%D0%B5%D1%82%D0%B0-%D0%BA%D0%B0%D1%98-%D0%BF%D0%BE%D1%80%D0%B0%D0%BD%D0%B5%D1%88%D0%BD%D0%B8%D0%BE%D1%82-%D0%B4%D1%80%D0%B6%D0%B0%D0%B2%D0%B5%D0%BD-%D0%BD%D0%B5%D0%BF%D1%80%D0%B8%D1%98%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%BB/a-48145089, (20.08.2020).</p></div><div data-bbox=)

është zgjidhja për kontestin dhe bazë për një fillim të ri.” Duke theksuar se marrëveshja ka qenë e përshëndetur nga metropolet botërore si një hap i madh për rajonin, theksoi se e rëndësishme është që të njihet se Marrëveshja e Prespës nuk ka pasur mbështetje të gjerë edhe në të dyja vendet dhe siç ka thënë “mezi i ka fituar votat e nevojshme parlamentare dhe votat e qytetarëve edhe në Greqi dhe në fqinun e saj verior.” Edhe pse percepticioni gjeneral është se problemi në masë të madhe është i zgjidhur me Marrëveshjen e Prespës, nuk ka garancion që polemika për emrin përsëri nuk do të paraqitet në rajon dhe të shkaktojë probleme të reja në të ardhmen, vëren Nimic, i cili në analizën e tij i thekson këndet e ndryshme të pranimit të kontestit të të dyja palëve. Strategjia e negociatave, thotë ai, ishte që të thyeshin dallimet e ashpra në percepticionin e kontestit, të identifikohen percepticionet të cilët dërgojnë deri te dominimi i principit të aversionit të humbjes të të dyja palëve dhe të bëhen përpjekje për rishqyrtim të çështjes. Ky rishqyrtim ishte vetëm pjesërisht i suksesshëm dhe duhet të pranohet se edhe në të dyja shtetet një numër i madh i qytetarëve marrëveshjen e shohin përmes prizmës së humbjes. Sidoqë të jetë, sipas Nimicit dukshëm është ulur intensiteti i aversionit ndaj humbjes gjatë kohës së negociatave, por ishte e nevojshme 20 vjet për reafirmim si dhe liderë efikas dhe të përkushtuar nga të dyja anët. Nimic thotë se Shkupi, është viktimizuar duke pranuar konceptin erga omnes, kurse për kthim kanë qenë të deblluar integritet e vendit në BE dhe NATO, por më me rëndësi prej të gjithave është ajo që po afirmohet pranimi global i identitetit maqedonas dhe gjuhës maqedonase, gjë që askush nuk duhet të dyshojë, duke përfshirë këtu edhe fqinun jugor Greqinë.³⁹²

Sipas Kryetarit të RMV, Pendarovski, Marrëveshja e Prespës është e rëndësishme për tregtinë e Evropës dhe jo vetëm për bashkëpunimin bilateral mes Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë. “Edhe përkaj percepticionit gjeneral për Marrëveshjen e Prespës, ai në një masë të madhe është i drejtuar kah bashkëpunimi ekonomik. Të dyja vendet janë marrur vesh për dialog institucional dhe struktural, duke i prekur procedurat kufitare dhe burokratike dhe shkëmbimet e lira të të mirave dhe shërbimeve.” Ai theksoi se Marrëveshja i siguron vendit qasje të lirë deri

³⁹² Нимиц напиша анализа за спорот: Преспанскиот договор е решение, но и основа за нов почеток, ФОКУС, 07.04.2020, линку në dispozicion: <https://fokus.mk/nimits-napisha-analiza-za-sporot-prespanskiot-dogovor-e-reshenie-no-i-osnova-za-nov-pochetok/>, (20.08.2020).

te porti i Selanikut, që sipas tij është kyçe për ekonominë e të dyja vendeve.³⁹³

Nga perspektiva e sotme, kryetari i LSDM-së, Zoran Zaevi me rastin e dy vjetorit të nënshkrimit të Marrëveshjes së Prespës, i numëron benefitet e marrëveshjes i cili konsideron se periudha e kaluar ka treguar se janë paguar të gjitha përpjekjet dhe sfidat para dhe pas arritjes së kësaj marrëveshjeje. “Sot bëhen saktë dy vjet prej kur e kemi nënshkruar Marrëveshjen e Prespës. Sot lirisht mund të them: IA VLEJTI! Ia vlejti për shkak se u bëmë anëtarja e barabartë në Alecanën më të fortë politiko-ushtarake në botë – NATO. Ulemi në të njëjtën tavolinë, shpatulla me shpatulla me më të suksesshmit, më të zhvilluarit dhe me më të fuqishmit. E ardhmja maqedonase është e sigurtë, kurse kufijtë gjithmonë të sigurt.” Sipas tij ia ka vlejtur, sepse Marrëveshja na solli një hap më afër BE-së dhe përfundimisht i hapëm dyert tona të integritit në BE. Ia ka vlejtur, sipas Zaevit për shkak se sot kemi fqinj të cilët fuqimisht na mbështesin në rrugën tonë për anëtarësim në NATO dhe BE, tani Greqia jo vetëm që nuk na bllokton, por edhe na ndihmon në integrimin tonë të shpejtë. Ia ka vlejtur edhe për shkak të ardhmërisë së sigurtë të fëmijëve tanë, ekonomi të zhvilluar, partnerë dhe miq të rinj, stabilitet më i madh rajonal dhe shembull botëror për të gjithë.³⁹⁴

Ministri pa resor i RMV-së i angazhuar për diasporë dhe kryetar i grupit punues për mbështetje të rajonit të Prespës, Edmond Ademi e përshëndeti iniciativën për themelimin të qëndrës dhe promovimit të gjuhës maqedonase...nga aspekti i projektit kushtuar mbështetjes dhe zhvillimit të rajonit të Prespës. Në projektin janë kyçur qeveritë e tre shteteve fqinje, Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Greqia, dhe njëra prej projekteve është ndërtimi i një qendre multimediale për të rinjtë, e cila në përputhje me vetë simbolikën e Prespës do të jetë vendi ku do të organizoheshin forume ndërkombëtare për dialog dhe bashkëpunim. Më gjerë, projekti përfshin edhe shumë komponenta tjera për zhvillim të rajonit, për mbështetje për përmirësim të kualitetit të jetës, veçanërisht në vendet rurale të rajonit si dhe për projekte për furnizim dhe mbledhje të mbeturinave të ujit rreth liqenit të Prespës me infrastrukturë sipas rregullave dhe standardeve të BE-së për mbrojtje të ambientit jetësor. Nëse Sllovenia është e njohur për

³⁹³ Пендаровски: Преспанскиот договор е насочен кон економската соработка на цел регион, ФОКУС, 29.07.2020, linku në dispozicion: <https://fokus.mk/pendarovski-prespanskiot-dogovor-e-nasochen-kon-ekonomskata-sorabotka-na-tsel-region/>, (20.08.2020).

³⁹⁴ Заев по две години од потпишувањето на Преспанскиот договор: Вредеше!, ФАКТОР, 17 јуни 2020, linku në dispozicion: <https://faktor.mk/zaev-po-dve-godini-od-potpishuvaneto-na-prespanskiot-dogovor-vredeshe>, (20.08.2020).

forumin e Bledit, Zvicra për Davosin, Gjermania për Minhenin, Republika e Maqedonisë së Veriut do të jetë e njohur për forumin e Prespës për dialog.³⁹⁵

Aleksis Cipras, vlerëson se mjafton respekti dhe vullneti i fortë për ardhmëri të përbashkët për paqe dhe zhvillim mes dyja vendeve dhe nuk ka nevojë historia e Ballkanit për fitues dhe humbës duke aluduar në arritjen e kompromiseve të palëve nënshkruese të Marrëveshjes së Prespës. Siç thotë ai “historia u jep nder atyre të cilët e shkruajnë dhe jo atyre të cilët kapen pas saj”. Ciprasi e komenton pozitën e qeverisë aktuale greke, e cila si opozitë ka qenë kundër Marrëveshjes së Prespës. Sipas tij, Greqia është gjendur në anën e duhur të historisë, dhe atë e tregojnë në praktikë madje edhe ato të cilët luftuan kundër marrëveshjes. Ata të cilët flasin për “tradhti” dhe “kompromise nacionale”, ata të cilët hapëruan bashkë me nacionalistët dhe kriminelët, të njëjtit sot flasin me fjalë më të mira për marrëdhëniet me vendin me Maqedonia e Veriut dhe roli i vendit në jetësimin e perspektivës evropiane të Ballkanit Perëndimor, në momentin më të vështirë.³⁹⁶

Megjithatë ekziston një fakt kyç për marrëveshjen me Greqinë, i cili injorohet në vazhdimësi. Ai është se të dyja vendet i kanë rrënuar barrierat e ndërsjella me dekada. Asgjë tjetër edhe po të mos ndodhë, madje as integrimi, vetëm ky fakt është përfitim për të dyja vendet fqinje ballkanike. Kjo situatë e ofruar nga Prespa është përfitimi më i madh i vetë marrëveshjes. Por, natyrisht edhe në këtë përfundim, një grusht hidhërimi do të derdhet për shkak të kushteve greke dhe shantazheve për të arritur marrëveshje. Por, edhe miqësia, qoftë në fillim të ndërtimit të marrëdhënieve e ka çmimin e vet. Ne e paguam shtrenjtë, shumë shtrenjtë dhe ky është fakt. Ndërsa fakti është se nëse deri tani nuk do të paguanim shtrenjtë, çdo vit i ardhshëm vendit dhe neve tani si dhe gjeneratave të ardhshme do t’i kushtonte shumë shtrenjtë. Nga të gjitha aspektet, nga ato ekonomike deri tek aspektet e sigurisë. Ndërsa se me Marrëveshjen e Prespës kemi humbur diçka, më shumë emocionalisht, diçka kemi fituar. Edhe në Maqedoninë e Veriut edhe në Greqi nuk është e lehtë të shpjegohet domosdoshmëria e

³⁹⁵ Духот на Договорот од Преспа треба да е инспирација за многу иницијативи како што е најавата за основање на центар за грижа промоција на македонскиот јазик во Љубојно во согласност со проектот наменет за поддршка и развој на регионот, Влада на Република Северна Македонија, 17.06.2020, linku në dispozicion: <https://vlada.mk/node/21788>, (20.08.2020).

³⁹⁶ Ципрас: Докажавме дека во историјата на Балканот не се потребни победници и поразени, А1ОН, 17.06.2020, linku në dispozicion: <https://a1on.mk/macedonia/cipras-dokazhavme-deka-vo-istorijata-na-balkanot-ne-se-potrebni-pobednici-i-porazeni/>, (20.08.2020).

kompromisit. I gjithë ky proces edhe këtu edhe atje krijoi kriza, frustracione, zgjuarje të reja nga ëndrrat romantiko-historike, prodhoi trauma, polemizime, protesta, veçanërisht duhet edhe guximi politik dhe njerëzor të shtyhet i gjithë procesi i dhimbshëm por i domosdoshëm. Tek ne të sqarohet se as nuk ndryshohet emri dhe as nuk humbet identiteti. Tek ata të pajtohen me faktin se në veri të shtetit të tyre, ekziston një tjetër me emrin Maqedonia dhe popull i cili quhet maqedonas dhe se Maqedonia nuk është greke, të paktën jo e gjitha. E vetmja që është e saktë është se Marrëveshja me Greqinë është kompromis, simetrik, asimetrik, i drejtë, i padrejtë, kjo është kjo. Marrëveshja është kompromis, përfundimisht është zgjidhur një kontest ndërshtetëror, vendit u hoqën bllokadat ndaj integriteteve dhe perspektivave evro-atlantike, maqedonasit arritën ta ruajnë atë që e dëshiruan, identitetin e tyre nacional maqedonas dhe përfundimisht u liruan nga etiketa e pakëndshme FYROM dhe mbi të gjitha, shteti maqedonas e përforcoi identitetin e tij ndërkombëtar pasi është i vetmi i regjistruar në regjistrin e OKB-së si shtet me emrin Maqedonia.³⁹⁷

Situata me identitetin maqedonas mund të sqarohet me një shembull të thjeshtë të përditshmërisë sonë, si për shembull filtër “Jugosllavija” është cigarja e parë filtër në Jugosllavi dhe prandaj e mban këtë emër. Është emri i parë sintetik i cigareve në Jugosllavi, sepse të gjitha cigaret para asaj janë me emra gjenerik, gjegjësisht të gjitha përmbanin emra lumenjsh – Morava, Vardar, Drava, Drini..., në fakt janë emra të llojeve të industrisë së duhanit në Jugosllavi, të prodhuar në Prilep. Në vitin 1998, një nga vendimet e para të Qeverisë së Ljubço Georgievskit ishte të ndërpritet prodhimi i filtër “Jugosllavija”. Ishte vlerësuar se një numër relativisht i vogël e konsumojnë këtë cigare dhe se goditja ekonomike nuk do të jetë serioze, dhe në vend të këtyre filloi të prodhohet filtër “Makedonija”, që do të thotë se disa përfitime politike do të ishin më të forta nga humbja ekonomike që do të pasonte me ndërprerjen e cigareve. Pikërisht atëherë, ose pak më vonë, u ndërpre edhe prodhimi i filtër “Evropa”. Nga këto emra gjeografikë, në treg mbetën vetëm filtër “Makedonija”. Mirëpo, çfarë ndodhi? Filtër “Makedonija” ishte cigare me një identitet tjetër, të veçantë, edhe vizual, krejtësisht tjetër nga “Jugosllavija”, dhe duhanpirësit e “Jugosllavija” refuzuan ta konsumojnë. “Makedonija” ishte njëjtë si “Jugosllavija” e punuar nga duhani i zi, cigare e lirë e cila nuk mundej t’i tërhiqte duhanpirësit që veç më ishin

³⁹⁷ Ivanov, Zoran, Një vit pas Marrëveshjes së Prespës – Maqedonia e mbijetoi veriun, INBOX7, 21 Qershor 2019, linku në dispozicion: <https://al.inbox7.mk/?p=3990>, (21.08.2020).

të mësuar ose kishin identitet personal të duhanpirjes me cigare tjera, e nuk mundej të tërhiqte të ri, sepse me të vërtetë nuk kushtonte shumë. Kaluan disa muaj dhe dikujt në Qeveri i kishte rënë ndërmend dhe pa shumë zhurmë e ndërpre në “Makedonija” dhe ato u zhdukën nga tregu, e në vendin e tyre erdhën filtër “Oriental”. Filtër “Oriental” e kishte integritetin e njëjtë vizual të filtër “Jugosllavija”, e njëjta kuti, ngjyra e njëjtë, grafika e njëjtë dhe e njëjtë cilësia ose jo-cilësia e cigares. Megjithatë, siç sqaron Xvezdan Georgievski “pavarësisht nga emri, i quaja filtër Jugosllavija, deri në fund edhe kur i blija dhe i kërkoja si Jugosllavija dhe asnjëherë nuk erdhi deri në ndonjë konfuzion mes shitësit dhe mua. Çdo herë më jepte “Oriental” ose më thoshte, “sollën filtër Jugosllavija” dhe më jepte paqetë “Oriental”. Për këtë, identiteti i duhanpirësit ishte shumë më i rëndësishëm një gjë tjetër dhe jo emri, ishte pra kultura e pirjes së duhanit dhe ajo shprehi, të ndizet pikërisht ajo cigare dhe kundërmimi i saj. E përkthyer kjo në identitet kombëtar ose kolektiv, del se kultura dhe tradita janë shumë më të rëndësishme se sa vetë emri,³⁹⁸ dhe këtë maqedonasit arritën me anë të kompromisit politik grek ta ruajnë dhe ta zhvillojnë atë edhe më tutje, tani më pa pengesa dhe komplekse se “dikush” atë ua konteston.

Tejkalimi i kontestit me Republikën e Greqisë, bashkërisht me nënshkrimin e marrëveshjes për fqinjësi të mirë dhe miqësore me Republikën e Bullgarisë, edhe me atë të deblokimit të integriteteve evro-atlantike, e përthakojnë (përmbledhin) shtetësinë maqedonase në të gjitha atributet e saj. Por, kjo marrëveshje që të bëhet përgjithmonë “historike” dhe jo përpjekje për “marrëveshje historike”, ngelet edhe shumë për t’u bërë. Duhet që të dyja shtetet dhe shoqëritë e tyre në të ardhmen të punojnë që ta përmirësojnë perceptimin e ndërsjellë dhe të krijojnë dy komunitete, qytetarët e së cilës do të respektoheshin ndërmjet veti, të krijohet besimi si dhe eliminimi i paragjykitimeve.³⁹⁹

Në RMV njëherë e përgjithmonë duhet të tejkalohet debati i përgjithshëm mbi Marrëveshjen e Prespës dhe të mendohet mbi benefitet që rezultojnë nga ajo, njëherë e përgjithmonë të vendoset interesi i përgjithshëm mbi atë individual dhe se debatet e llojit “ne” e mbrojmë emrin për shkak se ia mendojmë të mirën popullit (jemi të mirë) dhe se ajo që do të rrezikohet hyrja në NATO dhe BE është për shkak se kanë bërë marrëveshje të keqe dhe se “ata”

³⁹⁸ Për më tepër shih: Georgievski, Xvezdan, Kultura dhe tradita janë më të rëndësishme për përkatësinë e dikujt, sesa vetë emri!, Humbje e identitetit ose...?, CIVIL – Qendra për liri, Shkup, 2018, fq. 67, 68.

³⁹⁹ Тодоров, Петар, Анализа на спогодбата со Грција од историски и идентитетски аспект, август 2018 година, Скопје, стр. 7.

e kanë nënshkruajtur marrëveshjen për shkak se nuk ia mendojnë të mirën vendit të tyre (të këqinj janë) dhe se ajo që punojnë për hyrjen e vendit në NATO dhe BE është për shkak të bashkësisë ndërkombëtare të cilët i detyrojnë.⁴⁰⁰

Së fundmi, arsimi do të duhet të jetë një ndër faktorët më të mëdhenj të tejkalimit e këtyre konflikteve dhe pranimin e Marrëveshjes së Prespës, për shkak se shumica e qytetarëve nuk e kanë lexuar atë në tërësi dhe se shpesh herë kjo marrëveshje bëhet “vegël” e politikanëve për ta manipuluar popullin në dëm të palës krijuese dhe nënshkruese të marrëveshjes dhe për të përfituar politikisht ata të cilët e shfrytëzojnë atë edhe pse përpara kësaj marrëveshjeje nënshtrohen dhe e implementojnë atë tërthorazi.

⁴⁰⁰ Петровска-Бешка, Проф., д-р., Виолета, Психолошките бариери за прифаќање на „Преспанскиот договор“, од двете страни на границата, Дипломатски летопис, година III, број 6, Декември 2018, Скопје, РИ-ГРАФИКА, Скопје, стр. 29.

PËRFUNDIMET

Marrëveshja e Prespës arriti ta zgjidh kontestin shumëvjeçar mes Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të Republikës së Greqisë. Kjo arritje, e cila jo më kot u vlerësua si ngjarje historike, ngjalli doza optimizmi dhe shprese jo vetëm për palët nënshkruese të marrëveshjes si dhe rajonit por, për mbarë botën. Padyshim, ky sukses, së pari mund t'i atribuohet bashkësisë ndërkombëtare, përkatësisht, Organizatës së Kombeve të Bashkuara, e cila ka luajtur rolin e ndërmjetësuesit në këtë kontest mjaft të vështirë, herë e herë e pamundshme për t'u zgjidhur, e cila i ka mbajtur shtetet fqinje të robëruar nën petkun e historisë dekada me radhë. Pra, inatet historike, kulturore si dhe më e rëndësishmja politike e ka bërë këtë proces të vështirë, e cila asnjëherë më parë nuk mund të imagjinohej se do të përfundonte me një epilog të këtyllë. Është e qartë se, krerët e shteteve nënshkruese të Marrëveshjes së Prespës e tejkaluan vetveten, u treguan vizionar, të mençur, në ndikimin e faktorëve të ndryshëm, qofshin ato natyror dhe kohorqë vinin si nevojë imanente dhe koherente e shteteve për zgjidhjen e këtij kontesti nga njëra anë, si dhe nga ana tjetër presioni ndërkombëtar i cili luajti rol kyç në zgjidhjen e këtij kontesti, që mahniti botën ndërkombëtare me kompromisin e arritur që u shkonte për shtati të dyja palëve, e sidomos RMV-së e cila që nga pavarësia e saj, ka operuar në botën e jashtme pa emër të njohur zyrtar dhe e izoluar nga shtetet tjera evropiane si pasojë e pamundësisë së saj për integrim në botën e civilizuar, pra në BE dhe NATO dhe kjo gjë i kushtonte shumë, pavarësisht përpjekjeve dhe vullnetit të saj e cila përballej çdo herë me veton greke, për shkak të një emri historik dhe gjeografik që ishte e integruar në Kushtetutën e saj të vitit 1991. Kjo marrëveshje ndërkombëtare, përçoi mesazhin pozitiv të kompromisit të arritur, bashkëpunimit konstruktiv gjatë negociatave edhe pse shpesh herë kanë qenë në prag të dështimit dhe kjo dëshmoi edhe njëherë këmbënguljen e shtetit maqedonas si dhe dëshirën e zjarrtë si dhe aspiratat e saj për të sakrifikuar diçka të vlefshme nga vetja e saj për kompenzim të integritetit të saj në BE dhe NATO së bashku me Ballkanin Perëndimor. Pra, kjo qartë demonstroi se me vullnet të mirë politik dhe me kompromis edhe e pamundura bëhet e mundur! Edhe pse shpesh kësaj marrëveshjeje i është kontestuar legaliteti si dhe legjitimiteti i saj, në këtë punim të magistraturës arritëm që të konsumojmë një pjesë të madhe të argumenteve juridike që demonstrojnë dhe vërtetojnë të kundërtën e asaj që është

thënë dhe vazhdohet të thuhet për këtë marrëveshje nga oponentët e saj. Duke përsëritur se kjo marrëveshje nuk është marrëveshje e thjeshtë bilaterale, por është marrëveshje e një rëndësie të veçantë ndërkombëtare, për shkak se karakterizohet nga fryma dhe elementet ndërkombëtare dhe bazën e saj juridike e gjejmë në Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që e bën automatikisht të pakontestuar bazën juridike të saj si dhe obligimet që rrjedhin përmes normave juridike ndërkombëtare jug cogens (imperative) për palët nënshkruese, që tregon edhe njëherë se kjo marrëveshje nuk mund të kontestohet as nga palët e saj, sepse këtu na paraqitet një aktor ndërkombëtar mbi atë nacional, të cilët këta të fundit janë përgjegjës vetëm për implementimin e plotë të saj, për shkak të arsyes së thjeshtë që e kemi përmendur shpesh herë në këtë punim, se ajo paraqet marrëveshje mbi kushtetuese, e cila ndërhyt në kushtetutën e shtetit nacional nëse ajo është në konflikt me kushtetutën faktike. Andaj, në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese e RMV-së, në raste të sfidimit të Marrëveshjes së Prespës përpara saj, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së saj, duhet të mbajë llogari prezencën e elementit ndërkombëtar që përmban marrëveshja ndërkombëtare, rrjedhimisht përmes normave juridike imperative dhe mbështetja në rezolutat e Këshillit të Sigurimit, ashtu siç ka mbajtur llogari Gjykata në Greqi. Meqenëse, Marrëveshja e Prespës nuk ishte kusht për integrimin e RMV-së në strukturat euro-atlantike, por zgjidhja e emrit të saj, padyshim që paraqitej pengesë reale për integrimin e RMV-së në këto organizata ndërkombëtare. Së këndejmi, sakrificat si dhe munda i shpenzuar me vite nuk ka shkuar poshtë, nga shkak se përfitimi më i madh i vendit tonë është emërtimi i saj me një emër të njohur ndërkombëtarisht dhe i pakontestuar nga askush. Pra, Marrëveshjen e Prespës gjithmonë duhet shikuar përmes prizmit të fitores dhe jo atë të humbjes. RMV ka fituar një partneritet të fuqishëm, i cili do ta mbështesë dhe do ta dërgon në rrugën e saj të sigurtë drejt BE-së, pas hyrjes së RMV-së në NATO. Kjo dëshmon se frytet e kësaj marrëveshjeje, ende nuk i kemi shijuar siç duhet, ata janë në çelje e sipër dhe gjatë kësaj periudhe preferohet që të dyja palët ta implementojnë atë me gjakftohtësi në përpikshmëri, t'i respektojnë afatet e parapara në marrëveshje, t'i kenë parasysh pasojat juridike që mund të dalin nga kjo marrëveshje dhe për dallim nga kthimi mbrapa, kushdo që të jetë në krye të qeverive të vendeve në të ardhmen, duhet të shikojnë përpara, përtej konfrontimit, nuk duhet lejuar procese që i kthejnë vendet mbrapa, përkundrazi, palët nënshkruese duhet të

përkushtohen edhe më tej, ta thellojnë bashkëpunimin e tyre në frymën e Marrëveshjes së Prespës dhe më e rëndësishmja ta edukojnë ardhmërinë e vendeve të tyre, përmes arsimit të mirëfilltë mbi këtë frymë kompromisi, me çka e bën këtë marrëveshje më të vlefshme, të përjetshme dhe sublimë.

Në këtë punim të magjistraturës u vërtetua hipoteza gjenerale se Marrëveshja e Prespës siç u morr vesh, në tërësi është e mirë për të dy palët, pavarësisht nga forma e saj asimetrike. Të dy palët marrin atë që duan dhe atë që u takon, sipas parimit të drejtësisë. Askush prej tyre nuk ka një arsye të ndihet i poshtëruar para popullit të vet, e as të konsiderohet si një palë e mundur. Marrëveshja është përfundimtare dhe e përfunduar për të dy palët. Nuk ka negociata të reja dhe as "interpretime liberale" të saj. Nëse lind një mosmarrëveshje, atëherë ajo do të zgjidhet nga të dy palët. Nëse ata nuk mund ta bëjnë këtë gjë me ndërgjegje dhe ndershmëri, atëherë vihen në skenë Kombet e Bashkuara dhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Siç pohon profesori Kambovski, Marrëveshja e Prespës bazohet në parimet, vlerat evropiane, respektimin e miqësisë së qëndrueshme dhe të drejtat e njeriut, dhe për këtë arsye ndryshimet kushtetuese duhet të shihen në kontekstin e këtyre vlerave kushtetuese. Kjo Marrëveshje ka disa elemente imperative, si: ndryshimi i emrit zyrtar të shtetit, një zgjidhje që është një kompromis që ekuilibron interesat e të dy vendeve, ndërsa nuk diskuton identitetin kombëtar. Në histori, Maqedonia poashtu është quajtur edhe Demokratike, Popullore, Socialiste, prandaj, emërtimi "qytetarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut" në kuptimin e demosit, është një formulim i saktë për rregullimin e statusit të qytetarëve në këtë shtet.

Nga ana tjetër, siç pohon profesori Shkariq, me këtë Marrëveshje Greqia po forcon pozicionin e saj gjeopolitik në kufirin e saj verior. Ajo para vetes ka një vend mik me një emër të përhershëm dhe një rend kushtetues që nuk do të përmbajë asnjë dyshim për irredentizëm ndaj pjesës së saj të Maqedonisë gjeografike. Greqia para vetes ka edhe pëlqimin nga pala maqedonase se ekziston një ndryshim midis kulturës sllave dhe kulturës Helene. Kjo nuk është diç e çuditshme ose paranoike, por një mençuria e palës maqedonase për të mos ngatërruar politikën me historinë. Për grekët, emri "Republika e Maqedonisë së Veriut" do të thotë shënjim territorial i termit gjeografik Maqedonia. Emri i ri aludon vetëm në një pjesë të Maqedonisë gjeografike, gjë që nuk është rasti me emrin "Republika e Maqedonisë". Zbatimi i përgjithshëm i

emrit të ri (erga omnes) është gjithashtu një përfitim i madh për Greqinë. Ndërkaq, Greqia duhej të tërhiqej nga disa nga pikëpamjet e qeverive të mëparshme greke që i konsideronin si vija të kuqe. Qeveria greke ra dakord për të ruajtur emrin "Maqedonia" në emrin e ri kushtetues të shtetit. Ky është një përfitim i madh dhe më domethënës për Maqedoninë e Veriut. Me emrin Maqedoni vazhdon vazhdimësia e shtetit, nga KAÇKM e deri më sot, nga Maqedonia Federale (1944-1946), në Republikën e Maqedonisë (1991-2018) dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut. Pala greke bëri lëshime të tjera vendimtare për identitetin kombëtar maqedonas. E para është konfirmimi i gjuhës maqedonase si gjuhë zyrtare, dhe e dyta është njohja e shtetësisë. Këto janë vlera kushtetuese që, së bashku me emrin "Maqedonia", përfaqësojnë tri shtyllat e identitetit maqedonas, të njohura kësaj here nga pala greke, gjë që nuk ka qenë deri më tani. Dhe kjo është e një rëndësie të madhe për Maqedoninë, sepse Greqia është fqinji i saj i rëndësishëm.

BIBLIOGRAFIA

I. Libra, publikime, raporte dhe studime të cituara dhe të shfrytëzuara

1. Аданауер, Конрад, Секавања, (превод од германски јазик Бобан Здравковски Андреевски), Конгресен Сервисен Центар Микена, Макабеј, Скопје, 2014;
2. Апасиев, Димитар, Правните Аспекти на референдумот за т.н. Преспанскио договор меѓу Република Грција и „Втората страна„, Case study, Годишен зборник на Правен факултет бр.8, година 2018, Универзитет „Гоце Делчев„ – Штип;
3. Анализа: Каде цели и каде ќе стигне ВМРО-ДПМНЕ со ставот против договорот од Преспа, 360степени, 25 февруари 2020.
4. Аналитичарите за АА: Преспанскиот договор не може да се укине, но важно е како ќе се спроведува, АА, 12.07.2019.
5. Анкета на Евротинк: Висока поддршка за ЕУ, но намален оптимизам за брзо членство, ТЕЛМА, 15 октомври 2019.
6. Arrihet marrëveshja mes Zaevit dhe Kasamit, НЕЗАВИСЕН ВЕСНИК, 11.01.2019.
7. Appeal against name deal rejected, EKATHIMERINI, 14.12.2018.
8. Armakolas, Ioannis; Petkovski, Ljupcho; Voudouri, Alexandra, The Prespa Agreement one year after ratification: from enthusiasm to uncertainty?;
9. Armakolas, Ioannis; Petkovski, Ljupcho, Blueprint Prespa? Lessons learned from the Greece-North Macedonia agreement, Frierdrich Ebert Stiftung, Скопје, June, 2019;
10. Букурешкиот мировен договор од 28 јули 1913 година, ПРАВДИКО.
11. Без двојна формула нема излез, интервју со проф. д-р Љубомир Д. Фрчковски, 25 мај 2002 година, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008;
12. Барањето на Глигоров за прием на Македонија во ООН под уставното име, разговор со экс-претседателот Киро Глигоров, 16 април 2002 година, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008;
13. Бесими, Фатмир; Тилев, Драган, Процесот на интеграција на Република Македонија во Европската Унија (со кус осврт на договорните односи и институционалната координација), Република Македонија на патот кон Европската Унија (2020) – искуства, предизвици, перспективи, прилози од меѓународната научна конференција одржана на 6 мај 2016 година, Македонска академија на науките и уметностите, Секретаријат за европски прашања, Влада на Република Македонија, Скопје, 2016;
14. Букурешкиот мировен договор (1913) и неговите долгорични последици за Македонија и Југоисточна Европа, Материјали од македонско-рускиот научен собир одржан во Скопје на 27 и 28 јуни 2013, Македонска академија на науките и уметностите, Руска академија на науките, Институт за славистика, Скопје, 2017;
15. Bllazhevska, Katerina, Dekadë e gërryer nga ndarje dhe rilindje të dështuara, Nga Bukureshti në Prespë, Dëshmi të një kohe Maqedoni 2008-2018, Fondacioni Shoqëria e hapur – Maqedonia;
16. Vuxhovi, Jusuf, Maqedonia (Nga antika deri te koha jonë), JalifatPublishing, Houston, Faik Konica, Prishtinë, 2019;
17. Ballkani ka nevojë për pajtim – Konferencë shkencore në Shkup, DW.
18. Ципрас во историска државна посета кај поранешниот државен непријател, DW, 01.04.2019.
19. Ципрас во Скопје на годишнината од референдумот, DW, 30.09.2019.
20. Ципрас: Докажавме дека во историјата на Балканот не се потребни победници и поразени, A1ON, 17.06.2020.

21. Çështja e emrit zyrtar të Maqedonisë drejt zgjidhjes, DW, 19.02.2008.
22. Çfarë është NATO?.
23. Çështja e emrit: Pikëpamje të ndryshme për kontestin, Klan Macedonia, 20.02.2018.
24. Чековиќ, Тимурленк, Повеќедимензионалните придобивки и ефекти од пристапувањето кон НАТО, Институт за европска политика - Скопје, 2018;
25. Charter of the United Nations and Statute of the International Court of Justice, Chapter V, Article 25.
26. Докмановиќ, м-р, Мишо, Грчкиот и македонскиот меморандум за приемот на Македонија во ООН, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.
27. „Државјанство и политички права„ излагање на претставникот на Домот на македонската култура; Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008;
28. Димитров до Силјаноска: Кажете дали се залагате да го симнеме знамето на НАТО и да забораваме на ЕУ, 360степени, 29 јуни 2020.
29. Добредојде за Ципрас и новите односи Скопје-Атина, DW, 02.04.2019.
30. Духот на Договорот од Преспа треба да е инспирација за многу иницијативи како што е најавата за основање на центар за грижа промоција на македонскиот јазик во Љубојно во согласност со проектот наменет за поддршка и развој на регионот, Влада на Република Северна Македонија, 17.06.2020.
31. Давкова, Сиљановска, Гордана, За „Преспанскиот договор„ и пошироко;
32. Димитров до Силјаноска: Кажете дали се залагате да го симнеме знамето на НАТО и да забораваме на ЕУ, 360степени, 29 јуни 2020.
33. Ditë historike! Kuvendi i Maqedonisë dha dritë jeshile për ndryshimin e emrit të shtetit, PORTALB, 11.01.2029.
34. Евро-атлантските перспективи и Република Македонија: проблеми, предизвици и политичка реалност по неуспехот на Самитот на НАТО во Букурешт 2008, (Истражување на актуелната политика и мислењето на граѓаните), Презентирани реферати на научната Конференција одржана во ЈИЕУ на 2 Мај 2009, Истражувачки центар за јавна администрација, Тетово, јуни, 2009.
35. Emri i Maqedonisë: Zgjidhja e nyjes, Brifing i Grupit të Krizave për Evropë Nr. 52, Prishtinë/Bruksel, 12 janar 2009.
36. Флекенштајн, Кнут, Посветени на Европскиот мировен проект, Предизвици, Списание за општествени прашања, Пост-Преспанска Северна Македонија и предизборна Европа, број I, 03/2019, Friedrich Ebert Stiftung.
37. Floudas, Demetrius Andreas, Pardon? A conflict for a Name? FYROM'S DISPUTE WITH GREECE REVISITED.
38. Габер, Виктор, Од објект до субјект, Македонија во меѓународните односи, Фондација „Фридрих Еберт„, Скопје, 2017.
39. Гордана Сиљановска ќе бара поништување на Преспанскиот Договор, НОВА ТВ, 29 јуни 2020.
40. Грикур, Себастиен, Северна Македонија: Вести за запад, Предизвици, Списание за општествени прашања, Пост-Преспанска Северна Македонија и предизборна Европа, број I, 03/2019, Friedrich Ebert Stiftung.
41. Грција ја прекршила Времената Спогодба, Радио Слободна Европа, 05 декември 2011.
42. Грчките медиуми: Атина предлага слеано име (Горнамакедонија, а не Горна Македонија), Фокус, 04.03.2018.
43. Georgievski, Ljubčo, Identiteti “Antik” na grindii me fqinjët dhe me bashkësinë

ndërkombëtare!, Humbje e identitetit ose...?, CIVIL – Qendra për liri, Shkup, 2018;

44. Georgievski, Xvezdan, Kultura dhe tradita janë më të rëndësishme për përkatësinë e dikujt, sesa vetë emri!, Humbje e identitetit ose...?, CIVIL – Qendra për liri, Shkup, 2018;

45. Gruda, Prof., Dr., Zejnullah, E drejta ndërkombëtare publike, Botim i plotësuar dhe i përmirësuar, 2007;

46. Gjykata Kushtetuese e Greqisë e hodhi poshtë kërkesën për suspendimin e Marrëveshjes së Prespës, KOHA, 18 Korrik 2018.

47. Hasani, Enver, Marrëveshja e Prespës dhe copëtimi i Kosovës: dallimet dhe ngjashmëritë, Syri Kosova, 13.05.2019.

48. Името на Македонија: Зошто е важен спорот и како да се разреши, МКГ - Извештај за Балканот бр. 122, Скопје/Брисел, 10 декември 2001.

49. Името „Горна Македонија„ е неприфатливо!, интервју со г. Јонуз Абдулаи, тогашен пратеник на ДПА, 14 мај 2002, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.

50. Името не е проблем на НАТО, интервју со г.Крег Ретклиф, портпарол на НАТО во Р. Македонија, 10 август 2002 година, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.

51. Игнатова, Елена, Македонија: Промена на името за влез во НАТО, ЕУ?, Global Voices, 17 март 2008.

52. Изгласана Одлуката за референдум за консултирање на граѓаните, Академик, 31 јули 2018.

53. Интервју со проф. Игор Јанев за спорот за името со Грција, Весник Македониум, Се за Македонците во Албанија, 14.01.2014.

54. Истражување на ИПИС за перцепцијата на граѓаните за соседните држави, Институт за политички истражувања – Скопје, 08.02.2018 година;

55. Ivanov, Zoran, Një vit pas Marrëveshjes së Prespës – Maqedonia e mbijetoi veriun, INBOX7, 21 Qershor 2019.

56. Јанев, Проф., Д-р, Игор, Стратегија за прашањето на користење на уставното име не Република Македонија во ОН, МКД, 24 јули 2020.

57. Janë miratuar të gjitha draft-amendamentet për ndryshimin e Kushtetutës, pason debati publik, PORTALB, 04.12.2018.

58. Junker në Maqedoni: Zgjidhni çështjen e emrit, ABC News, 25 Shkurt 2018.

59. Janev, Igor, Legality of the Prespa Agreement Between Macedonia and Greece, Journal of Political Science and International Relations, Vol. 2, No. 2, 2019, pp. 50-59.

60. Костиќ, Моника; Наумовски, Владимир, Македонски јазол, се автори на овој есеј кој го разработува истоименото дело од Ханс Лотар Штепан-поранешен амбасадор на Германија во Р. Македонија, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.

61. Колбе, Кица, За македонското малцинство во Грција и за „грижата„ за него, 20.06.2018.

62. Колбе, Кица, За Преспанскиот договор, за името Македонија-една година подоцна, DW, 17.06.2019.

63. Колбе, Кица, Алексис Ципрас-идниот Вили Брант на Балканот?, DW, 01.04.2019.

64. Клековски, Сашо, Спорот за името Македонија (ставови на јавноста во Македонија), МЦМС, ИДСЦС, Скопје, октомври, 2011.

65. Костовска, Вера; Ангеловска, Ивана; Блажевска, Марија; Димиќ, Емилија и Кипријановска, Димиќ, Состојби, решенија и мислења за предлогот на Нимиц, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.

66. Косијас: Груевски глумел дека сака решение за името, Нова Македонија, 04.09.2018.

67. Клаузулата за името – реалност или изборна пропаганда, Радио Слободна Европа, 05 април 2019.
68. Кржаловски, Александар, Живот со Преспанскиот договор, 2019, Скопје.
69. Kollozova, d-r, Katerina, Marrëveshja me Greqinë e mundëson përcaktimin politik të identitetit, Humbje e identitetit ose...?, CIVIL – Qendra për liri, Shkup, 2018.
70. Kryeministri Zaev në konferencë për Marrëveshjen me Greqinë në ASHAM: Kemi një marrëveshje dinjitoze që garanton identitetin dhe ardhmërinë tonë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 11.09.2018.
71. Kushti për anëtarësim, Trump-Maqedonisë, zgjidhni emrin pastaj negociatat, Konica, 06.09.2018.
72. Kiçmari, Sabri, Hyrje në diplomaci, Kolegji Univeristar Victory, Mars, 2011.
73. Council of State rejects appeal to cancel FYROM name deal, EKATHIMERINI, 18.07.2018.
74. Christopoulos, Dimitris; Karpozilos, Kostis, 10+1 questions&answers on the Macedonian question, Rosa Luxemburg Stiftung, Office in Greece.
75. Македонците во Грција се пребројани, Македонска Нација, 09 декември 2015.
76. Македонија не треба да попушти, интервју со г. Сејфедин Харуни, 23 април 2002 година, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.
77. Македонија треба да направи отстапки за името, интервју со г. Џеват Адеми, 14 мај 2002 година, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.
78. Милошоски за ФАЦ: ВМРО-ДПМНЕ бара начин да го врати уставното име, DW, 21.10.2019.
79. Мицкоски бара двотретинско мнозинство за измени во Преспанскиот договор, Мицотакис ревидирање, МКД, 06 декември 2019.
80. Мицкоски: Во Договорот од Преспа има фуснота за македонскиот јазик, 360степени, 3 јули 2020.
81. Марковски, Др., Данчо, Преспанската спогодба и меѓународната положба на Република Македонија, Дипломатски летопис година III број 6, Дипломатски клуб, Скопје, 2018.
82. Меѓународното значење и импликациите на Спогодбата од Преспа врз европските интеграции на Република Македонија, Научна расправа во МАНУ, Дипломатски летопис година III број 6, Дипломатски клуб, Скопје, 2018.
83. Maleska, d-r, Mirjana, Ruga drejt normalizimit të marrëdhënieve me Greqinë është e hapur!, Humbje e identitetit ose...?, CIVIL – Qendra për liri, Shkup, 2018.
84. Mitrevska, Marina; Grizold, Anton; Buçkovski, Vllado; Vanis, Entoni, Parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve, Rasti i Maqedonisë, (Paradigma e re e sigurisë), Shkup, 2009.
85. Maqedonia nuk duhet të ndahet, as të bashkohet, por të çlirohet nga ndikimi serb dhe rus!, (Disa argumente për idenë e ndarjes, ose bashkimin e pjesëve të Maqedonisë me ndonjë shtet tjetër fqinj),PORTALB.
86. Manual i NATO-s, Public Diplomacy Division NATO, 1110 Brussels, Belgium, NATO, 2006.
87. Marfi, Shon D., Principet e së drejtës ndërkombëtare, Ars Lamina, 2012.
88. Marrëveshja e Pages ndërmjet Kosovës dhe Serbisë: Mundësitë dhe Sfidat, Instituti Demokratik i Kosovës, Konrad Adenauer Stiftung, Dhjetor 2019.
89. Maqedoni: Çështja e referendumit mollë sherri, DW, 24.07.2018.
90. Maqedoni: Të hënën kuvendi shqyrton ndryshimet kushtetuese, DW, 27.10.2018.
91. Ministri gjerman: Sivjet zgjidhni emrin, në të kundërtën..., FJALA, 10.05.2018.
92. Matthew Nimetz, Wikipedia the free encyclopedia.
93. Нема потреба од Референдум за „двојното име“, средба со г. Никола Поповски, 25

април 2002 година, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.

94. (Не)официјални предлози за решавање на “name issue”, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.

95. НАТО не може да го реши проблемот со името, DW, 10.11.2011.

96. Никовски, Ристо, Кој е и за кого работи Метју Нимиц?, МКД, 18 јануари 2013.

97. Нимиц: Не ме ни исплатија, Нова Македонија, 04.03.2019.

98. Нимиц: Требаше да го напишам Преспанскиот договор на кинески, DW, 23.05.2019.

99. Нимиц напиша анализа за спорот: Преспанскиот договор е решение, но и основа за нов почеток, ФОКУС, 07.04.2020.

100. Наметнат Устав, Јавна расправа по нацрт-амандманите на Уставот на РМ, Фондација Отворено општество – Македонија, Скопје, октомври, 2014 година.

101. Национална дебата за ЕУ, Дебатна анкета за можностите и предизвиците на пристапувањето на Македонија кон ЕУ, European Policy Institute, Скопје, Nationa EU Debate, 18-19 ноември 2017, Скопје, 2017.

102. Никодиновска – Крстевска, Ана, Договорот од Преспа помеѓу Република Македонија и Република Грција низ призмата на меѓународното право, Годишен зборник на Правен факултет бр.8, Универзитет „Гоце Делчев, – Штип, 2018.

103. Најчевска, Др., Мирјана, Човековите права во судир или во чекор со Преспанската спогоба, Дипломатски летопис година III број 6, Дипломатски клуб, Скопје, 2018.

104. Nesimi, Mahi, Shqiptarët e Maqedonisë dhe Ardhmëria e Shtetit, Focus Print, Tetovë, 2019.

105. Neziri, Xhelal, Shpresa në Shkup e Tiranë: Çfarë mund të sjellë kryesimi i Kroacisë me BE-në?, Klubi i debatit politik, 17 Janar 2020.

106. Отворено писмо, Нова Македонија, 01.09.2018.

107. Одлуката за референдум пред Уставниот суд, Нова Македонија, 09.08.2018.

108. Поделбата на Македонија во Букурешт, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.

109. Папагеоргиу, Е., А., Таканареченото македонско прашање, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.

110. Петрушевска, д-р, Татјана, Името пред Меѓународниот суд за правда, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.

111. Петрушевска, Проф., Д-р., Татјана; Попевски, м-р, Марјан, Моргентау и спорот меѓу Република Македонија и Република Грција, Македонски Политиколошки Форум, е-Зборник на трудови, Year II, Number 5, September 2015.

112. Петрушевска, Д-р., Татјана, Зошто и покрај се, употреба на поимот „спор„?, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.

113. Петрушевска, д-р, Татјана, Кој е Метју Нимиц!?, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.

114. Привремена спогодба меѓу Република Македонија и Република Грција, Њујорк, 13 септември 1995 година.

115. Предлогот на МКГ е прифатлив за нас, интервју со проф. д-р Владо Бучковски, 15 април 2002 година, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.

116. Поповска, Наталија, Поимот Горна Македонија, Глобус, неделен весник, 16.04.2013.

117. Проблемот со името пречка за членство во НАТО?, DW, 23.01.2008.

118. Прислушувани разговори – сет 33: Преговори за името, Вистиномер, 29.01.2016.

119. Претседателот Иванов донесе одлука да не го потпише указот за Законот за ратификација на договорот со Грција, Академик, 26 јуни 2018.

120. Преспанскиот договор не беше во согласност со Уставот на Македонија ниту во согласност со задолжителното меѓународно право, ВМРО-ДПМНЕ, 24 јуни 2020.
121. Предвремени избори во Северна Македонија, Kondrad Adenauer Stiftung, јули 2020.
122. Пендаровски: Преспанскиот договор е насочен кон економската соработка на цел регион, ФОКУС, 29.07.2020.
123. Петровска-Бешка, Проф., д-р., Виолета, Психолошките бариери за прифаќање на „Преспанскиот договор„ од двете страни на границата, Дипломатски летопис, година III, број 6, Декември 2018, Скопје, РИ-ГРАФИКА, Скопје.
124. Промеморија на македонската академија на науките и уметностите во врска со спорот за името на Република Македонија, Македонска академија на науките и уметностите, Скопје, 30 мај 2002 година.
125. Popovski, Ljupčo, Nga Bukureshti deri në Prespë: Kur Amerika hoqi duart nga Gruevski, Nga Bukureshti në Prespë, Dëshmi të një kohe Maqedoni 2008-2018, Fondacioni Shoqëria e hapur-Maqedonia.
126. Pendarovski vs Siljanovska: Beteja për dhe kundër “Marrëveshjes së Prespës”, PORTALB, 06.03.2019.
127. Pan-Macedonian Union denounces government’s inaction on the Prespa Agreement, GREEK CITY TIMES, 28 May 2020.
128. Pergantis, Vassilis, The Prespa Agreement between Greece and North Macedonia and the settlement of the name dispute: Of objective regimes, erga omnes obligations and treaty effects on third parties, QIL, Zoom-in 65 (2020) 63-85;
129. Репортажа на Би-Би-Си за македонците во Егејска Македонија, IN TV Australia, 19 Март 2019.
130. Република Македонија и Организацијата на Обединетите Нации, MACEDONISM, 11 октомври 2018.
131. Река, Блерим, Проширувањето на ЕУ во Западен Балкан во новиот геополитички контекст, Република Македонија на патот кон Европската Унија (2020) – искуства, предизвици, перспективи, прилози од меѓународната научна конференција одржана на 6 мај 2016 година, Македонска академија на науките и уметностите, Секретаријат за европски прашања, Влада на Република Македонија, Скопје, 2016.
132. Република Македонија пред нова историска-одлука, Расправи Дом на АРМ, Дипломатски летопис година III број 6, Дипломатски клуб, Скопје, 2018.
133. Rexhepi, Zeqirija, Zhvillimet politiko-shoqërore te shqiptarët në Maqedoni 1990-2001, Tringa Design, Tetovë, 2005.
134. Reka, Blerim; Bashota, Bardhok; Sela, Ylber, Marrëdhëniet ndërkombëtare (Një hyrje), Instituti për studime politike dhe ndërkombëtare, Shkup, 2016.
135. Reka, Blerim dhe Sela, Ylber, Hyrje në të drejtën e Unionit Evropian, (E drejta kushtetuese dhe institucionale e UE-së), Botimi i dytë, Tetovë, 2011.
136. Republika e Maqedonisë në rrugën drejt UE-së, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
137. Rekomandimi i pakontestueshëm, data e pasigurtë, Koment në lidhje me Raportin e Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut nga data 29 majt të vitit 2019, Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, 30 Maj 2019.
138. Стенограми од говорите на дискусантите кои учествуваа во петте работни сесии (сесија 10 – сесија 14), на различни теми, на средбата организирана од страна на ОБСЕ – Организација за безбедност и соработка во Европа (поранешен КЕБС), во Варшава, главниот град на Полска – од 09 до 11 октомври 2006 година, под наслов: Прашања поврзани со човечката димензија. Изборот на говорите и репликите кои Ви се изложени го направи Д. Апасиев. Извор:

www.florina.org.; Тема: „Демократски институции; Демократијата на национални, регионални и локални нивоа,,“ излагање на претставник на „Виножито,, – организација на македонското национално малцинство во Грција; Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.

139. Ste ja прочитале ли Времената спогодба помеѓу Македонија и Грција?, ПРАВДИКО, 21.11.2013.

140. Сервер: И без промена на името Македонија треба да влезе во НАТО, Нова Македонија, 30.03.2018.

141. Сите предлози за името: од Нова Македонија, преку Република Македонија – Скопје до Република Горна Македонија, МКД, 14 февруари 2018.

142. Собранието го ратификуваше договорот со Грција, Академик, 20 јуни 2018.

143. Собранието на Македонија ги усвои уставните измени: Името на државата е Република Северна Македонија, TRT Македонски, 11.01.2019.

144. Силјановска Давкова: Ќе го почитувам Преспанскиот договор, но лично секогаш ќе го одбегнувам називот Северна Македонија, МКД, 04 април 2019.

145. Силјановска ќе игра „втор референдум,, за Договорот од Преспа!, DW, 18.02.2019.

146. Салто во ВМРО-ДПМНЕ: Веќе не е можен подобар Договор со Грција!, DW, 02.11.2018.

147. Силјановска: Преспанскиот договор не може да опстои, секоја генерација има право на свој Устав, Фокус, 12.07.2020.

148. Селими, Сабин, ЕУ постојано ги разочарува Балканските земји, Respublica, 26 февруари 2020.

149. Стефоска, Др., Ирена, Преспанската спогодба и националното митотворство во контекст на националните политички настани на Балканот, Дипломатски летопис година III број 6, Дипломатски клуб, Скопје, 2018.

150. Selimi, Doc., Dr., Nasir, Ndikimi i integriteteve ekonomike rajonale në zhvillimin e ekonomisë së Maqedonisë, Proceset e integritet euroatlantik dhe Republika e Maqedonisë, Qendra për hulumtime në Administratën Publike, UEJL, Tetovë & Friedrich Ebert Stiftung, Shkup, ArbëriaDesign, Tetovë, 2008.

151. Saliu, Dr., Kurtesh, E drejta kushtetuese, Libri I, (Botimi i tretë), Tetovë, 2002.

152. Шкариќ, проф. д-р, Светомир; Иванов, проф. д-р, Ѓорѓе, Политички теории – Антика, учебник за политички науки на Правниот факултет „Јустинијан Први,, при Универзитетот „Св. Кирил и Методиј,, – Скопје, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.

153. Шкариќ, Д-р., Светомир, Составот на МКГ и предлогот за Словенска транскрипција на името, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.

154. Шкариќ, Светомир, Уставните амандмани се политичко а не стручно дело, Respublica, 12 февруари 2019.

155. Шкариќ, Светомир, Без Договорот со Грција, Македонија и натаму ќе остане без државно име на маѓународен план, Respublica, 22 август 2018.

156. Шкариќ, Светомир, Одлуката на референдумот е налог за пратениците и претседателот Иванов, Respublica, 24 јули 2018.

157. Шкариќ, Светомир, Колку се остварливи ветувањата на претседателските кандидати?, Respublica, 17 април 2019.

158. Шкариќ, Др., Светомир и Давкова-Сиљановска, Др., Гордана, Уставно право, Скопје, 2007.

159. Шкариќ, Др., Светомир, Споредбено и македонско уставно право, Скопје, 2014.

160. Шкариќ, Др., Светомир, 7-те најчести прашања за Преспанскиот договор и за референдумот.

161. Shasivari, Dr., Jeton, E drejta kushtetuese, Libri I, (Botimi i parë), Furkan ISM, Shkup, 2015.
162. Shasivari, Dr., Jeton, E drejta kushtetuese, Libri I, (Botimi i dytë), Furkan ISM, Shkup, 2020;
163. Shasivari, Jeton, Referendumi: kuti e votimit apo kuti e Pandorës, PORTALB, 21.07.2018.
164. Šorović, Mira, The Republic of North Macedonia – a “new” country in the Western Balkans, RSC Volume 11, Issue 3, September 2019.
165. Тупурковски: Глигоров беше нерешителен за признавањето на Македонија, DW, 02.08.2011.
166. Тодоровски, Сашко, Преспанската спогодба, името идентитетот и ризиците, Дипломатски летопис, година III, број 6, Декември 2018, Скопје, РИ-ГРАФИКА, Скопје.
167. Тодоров, Петар, Анализа на спогодбата со Грција од историски и идентитетски аспект, Скопје, август 2018.
168. Тодоров, Зоран, Спогодбата од Преспа и надворешно-политичките безбедносни импликации, Дипломатски летопис година III број 6, Дипломатски клуб, Скопје, 2018.
169. Traktati i Atlantikur të Veriut, Uashington D.C., 4 Prill 1949, (neni 10).
170. The man who has focused on one word for 23 years, BBC NEWS, Magazine, 2 August 2017.
171. Велковска, Зорица; Патчев, Владимир, Критика на „предлогот на Нимиц“, Спорот за името меѓу Грција и Македонија, Студентски проект, ЈП Службен весник на РМ, Скопје, 2008.
172. ВМРО-ДПМНЕ со кривични пријави ќе „гласа“ за Договорот со Грција, DW, 05.07.2018.
173. Влада на Република Македонија, План 3-6-9, 04.07.2017.
174. Во Преспанската спогодба пресликани и „Велики петок“, „Кипар“, „Осло“, „Дејтон“, „Елисејскиот договор...“, Нова Македонија, 29.01.2019.
175. Vankovska, Biljana, The Prespa agreement, ethnicity and nationality.
176. Vukadinović Djordje, Democracy as collateral damage, Implementing the Prespa Agreement on Macedonia, Horizons, Journal of International Relations and sustainable development, The new great game, Winter 2019/ Issue no.13.
177. Veto Maqedonisë fitore e nacionalizmit grek dhe si më tutje, analizë e shkurtër nr.17, Qendra për Hulumtim dhe krijim të politikave, Prill, 2008.
178. VMRO kërkon që qytetarët të deklarohen për referendum për çështjen e emrit, НЕЗАВИСЕН ВЕСНИК, 17.12.2017.
179. VMRO-ja kërkon dorëheqjen e Zaevit dhe Qeveri teknike, AlsatM, 03.10.2018.
180. Vienna Convention on the Law of Treaties, 1969, United Nations, 2005.
181. Зашов, Благој, Меѓународно-правните аспекти на Преспанската спогодба, Дипломатски летопис година III број 6, Дипломатски клуб, Скопје, 2018.
182. Заев по две години од потпишувањето на Преспанскиот договор: Вредеше!, ФАКТОР, 17 јуни 2020.
183. Zaev: Plani 3-6-9 për perspektivë evropiane, KLAN MACEDONIA, 5 Korrik 2017.
184. Zaev dhe Sela kanë arritur marrëveshje për “çështjen shqiptare”, PORTALB, 08.01.2019.
185. Zejneli, Xhelal, Maqedonia – nyje e Gordit, Tetova News.

II. Burimet juridike

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 1991;
2. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, (Teksti jo-zyrtar, i spastruar-për përdorim intern), përkthyer nga: Prof. Dr Kurtesh Salju, Fakulteti juridik-UEJL, Tetovë, 2007;
3. Устав на Република Северна Македонија, 1991;
4. FINAL AGREEMENT FOR THE SETTLEMENT OF THE DIFFERENCES AS DESCRIBED IN THE UNITED NATIONS SECURITY COUNCIL RESOLUTION 817 (1993) AND 845 (1993), THE TERMINATION OF THE INTERIM ACCORD OF 1995, AND THE ESTABLISHMENT OF A STRATEGIC PARTNERSHIP BETWEEN THE PARTIES;

5. Vendim për shpalljen e amendamenteve XXXIII, XXXIV, XXXV dhe XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (11 Janar 2019);
6. Ligji për referendum dhe forma tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve, 2005;
7. Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, 1992;
8. Rregullorja e punës së Kuvendit të RMV-së e vitit 2008, me ndryshimet dhe plotësimet e vitit 2010 dhe të vitit 2013;
9. Предлог на одлука за распишување на референдум, со архивски број. 08-4644/1;
10. Предлог-одлука за референдум за консултирање на граѓаните поднесена од група пратеници;
11. Одлука за распишување на референдум, бр. 08-4666/1;
12. Извештај за конечните резултати од гласањето на Референдумот на државно ниво, 30 септември 2018 година, бр. 12-2139/2, 03.10.2018, Државна Изборна Комисија;
13. Извештај за спроведените избори за Претседател на Република Северна Македонија одржани на 21 април и 5 мај 2019 година, Мај 2019 година, Скопје, бр. 09-2085/1, 12.06.2019, Скопје, Државна Изборна Комисија;
14. Решение У.бр.88/2018, У.бр.90/2018 и У.бр.91/2018, Уставен Суд на Република Северна Македонија, 19 септември 2018;
15. Издвоени мислења по предметот У.бр.88/2018, У.бр.90/2018 и У.бр.91/2018, Уставен суд на Република Северна Македонија, 19 септември 2018;